


EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE, KULTURORE, ISLAME



VITI XXXI NR.70

PRISHTINË
2003

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 70 / 2003

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 70 – 2003

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Isa Bajçinca

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXI nr. 70 / 2003

Prishtinë
2003

njën e drejtësisë, duke e goditur egoizmin, burimin e të gjitha të këqijave sociale.

Hulumtimet dhe studimet e fesë tek ne janë ende në shkallën fillestare. Aty këtu kemi ndonjë vlerësim më tepër në nivel intuitiv, sipas njohurive të pakta sipërfaqësore, shpeshherë edhe të ngarkuara me përcaktime, vlerësime ideologjike, politike e fetare, pa ndonjë shqyrtim ndërdisiplinor dhe shkencor.¹ Kjo edhe sot e vështirëson vlerësimin fetar në popullin shqiptar, në këtë gjendje të ndërlikuar politike, ekonomike, sociale, kulturore e fetare.

Vlen të theksohet se ndër shqiptarët deri më tash bartëset e vetme të jetës fetare janë bashkësitë fetare, qofshin ato islame apo të krishtera. Institucionet e tjera kombëtare deri më tani nuk kanë treguar ndonjë interesim të veçantë ndaj fesë dhe avancimit të saj. Për këtë arsye vetvetiu shtrohet pyetja: Çfarë roli e rëndësie ka pasur dhe duhet të ketë feja të populli shqiptar. Kjo do shikuar nga shumë këndvështrime, në rend të parë nga ai historik, sociologjik, psikologjik, kulturor dhe moral. “Askush s’mund të kuptojë njerëzimin pa e kuptuar së pari fenë e tyre..., sepse feja përfshin jetën e njeriut prej kohës më të lashtë”.²

Roli i fesë ndër shqiptarët

Nëse i bëjmë një vështrim rolit të fesë ndër shqiptarët, do të shohim se feja ka luajtur rol pozitiv gjatë historisë. Për këtë meritë të veçantë kanë prijësit e fesë, të cilët ishin në nivel të misionit të tyre dhe nuk lejuan keqinterpretimin e parimeve fetare.

Koekzistenca par excellence trikonfesionale ndër shqiptarët, e verifikuar për shekuj, me një ekumenizëm dhe dialog shembullor, është shtyllë e qytetërimit shqiptar. Multikonfesionaliteti është një proces i përfunduar historik, prandaj shqiptarët evropianë nuk kanë asnjë fije drojë se mund të ballafaqohen me “thyerje” të reja dhe “konvertime” fetare. Fundja, për shqiptarët trikonfesionaliteti paraqet një begati të trashëgimisë shpirtërore dhe mendore. Nuk mund të mohohet roli i kulturës kristiane në krijimin dhe ruajtjen e individualitetit shqiptar të

EDITORIALI

Qemajl Morina

IDENTITETI FETAR I SHQIPTARËVE

“Askush s’mund ta kuptojë njerëzimin pa e kuptuar së pari fenë e tyre, sepse feja përfshin jetën e njeriut prej kohës më të lashtë”.

Ninuan Suart

Feja ka qenë dhe mbetet një temë madhore për mendimin njerëzor. Ndjenja fetare është instinkt i natyrshëm i njeriut dhe ai u shfaq që nga kohët më të lashta. Ernest Renana, në librin e tij “Historia e feve” thotë: “Mund të ndodhë të pakësohet çdo gjë që ne dëshirojmë, të dobësohet mendja, të stagnojë shkenca dhe të menduarit, të zvogëlohet entuziazmi i njeriut për përdorimin e lirive të njeriut. Mirëpo, është e pamundur të përfytyrojmë mënjanimin e fesë në shoqëri apo pezullimin e dukurisë së bindjes fetare. Këtë më së miri e vërtetoi dështimi i materializmit, i cili nuk pati sukses ta bindte shoqërinë me teoritë dhe konceptet e tij, sepse njeriu me instinktin e tij të natyrshëm orvatet të ngrihet mbi botën e materies që t’i plotësojë nevojat e tij shpirtërore dhe intuitive. Besimi i sjell njeriut qetësinë, i zvogëlon streset, tenton ta pajtojë me realitetin, sado i hidhur qoftë ai, i ushqen shpresën për diçka më të mirë, e largon nga hakmarrja, i forcon mbi të gjitha ndje-

¹ Don Lush Gjergji, Drita, nr. 6/91, f. 8.

² Ninuan Suart, Religije svijeta, enciklopedijski prirucnik, s. 15.

kulturës dhe gjuhës, siç nuk mund të mohohet roli i kulturës islame në ruajtjen e qenies kolektive shqiptare³. Prandaj, përkatësia fetare tradicionale ndër shqiptarët duhet konsideruar si vlerë qytetëruese, kulturore, por edhe kombëtare, e cila duhet kultivuar dhe avancuar në të gjitha shtresat e popullatës, dhe për këtë kontributin e tyre duhet ta japin të gjitha institucionet tona kombëtare.

Nuk ka dyshim, sundimi gjysmëshekullor komunist të shqiptarët e dëmtoi në një masë të madhe çështjen fetare, sidomos në Shqipëri. Për këtë shkak, me fillimin e procesit të demokratizimit të saj, aty nxituan të gjendeshin misionarë nga të gjitha anët e botës, sepse konsideronin se Shqipëria ishte një terren i përshtatshëm për përhapjen e propagandës fetare, sepse aty shqiptarët e në mënyrë të veçantë rinia, kishin humbur identitetin fetar gjatë periudhës së diktaturës së regjimit komunist, i cili bënte shpërlarjen e trurit nga besimet fetare dhe edukimi i popullit në frymën ateiste.

Feja është trajtuar si formë e vetëdijes konservatore e reaksionare, si “opium për popullin” dhe, si e tillë, është përndjekur në mënyra të ndryshme, kështu që qe varfëruar shpirtësia e njeriut.

Për fat të keq, kjo frymë e ateizmit ishte përhapur edhe në Kosovë, në mënyrë të veçantë në mesin e intelgjencies. Në këtë mënyrë ateizmi iu hakmorr popullit shqiptar dhe po i hakmerret edhe sot e kësaj dite. Ende janë të freskëta pamjet e vërshimit të ambasadave të huaja në Tiranë si dhe fluksi i madh i refugjatëve shqiptarë, dëshira e vetme e të cilëve ishte ta lëshonin Shqipërinë dhe të merrnin botën në sy.

Cili është identiteti fetar i shqiptarëve

Shqiptarët gjatë historisë së tyre të gjatë nuk kanë treguar ndonjë lloj fanatizmi të tepruar për përkatësitë e tyre fetare. Ata tradicionalisht ishin tolerantë në aspektin fetar. Këtë e kanë vërtetuar edhe shumë autorë të huaj, të cilët janë marrë me çështjen shqiptare. Ky realitet vihet në pah edhe në kohët e sotme. Në një raport të Grupit Ndërkombëtar të Krizës, me titull: “Feja në Kosovë”⁴ datë 31 janar 2001, rreth rolit të fesë në konfliktin në Kosovë, përveç të tjerash, thuhet: “Shqip-

tarët e Kosovës nuk e identifikojnë identitetin e tyre fetar nëpërmjet fesë, por atë e bëjnë nëpërmjet gjuhës dhe kanë një qasje relativisht relaksuese kundruall formave dhe veprimeve të fesë islame. As prijësit e fesë islame dhe as feja islame nuk kanë luajtur ndonjë rol vendimtar gjatë tetë vjetve të fushatës së rezistencës paqësore gjatë okupimit të regjimit serb apo rezistencës së armatosur të viteve 1998-99. Islami politik apo fundamentalizmi social, terma këto që përmenden me respekt në Lindjen e Mesme, kanë një ndikim shumë të vogël në Kosovë”.

Në anën tjetër, imazhi i serbëve të Kosovës paraqitet nëpërmjet panoramave të manastireve dhe kishave ortodokse serbe.

Një pjesë e intelgjencies shqiptare, duke u mbështetur në paragjykimet që Perëndimi kishte në të kaluarën ndaj Islamit, disi hezitojnë ta shprehin identitetin e tyre fetar islam. Sa për ilustrim, kryetari i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, i cili përfaqëson unitetin e një populli, me mbi 95% janë muslimanë, deklaroi se ai simbolikisht është musliman dhe silltet vazhdimisht brenda një “universi simbolik” kristian. Në këtë aspekt duhet kuptuar edhe formimi i Partisë Demokratiane, të vetmes parti me konotacion fetar, edhe pse shumica e anëtarësisë së saj janë të besimit islam.

Në këtë vazhdë duhen kuptuar edhe paraqitjet e liderëve partiakë si dhe të disa intelektualëve në faqet e shtypit tonë me parullat si: “Do t’i jap Tiranës shkëlqim perëndimor” (Besnik Mustafaj me rastin e zgjedhjeve lokale në Shqipëri, (“Bota sot”, 28/8/2000); Sami Repishti: “Krishterimi, pararojë e hyrjes së shqiptarëve në Evropë”. (Drita, nr. 2-3, 149-150, viti XXIII); “Me PSHD-në në Evropë”, me rastin e zgjedhjeve lokale të PSHD-së në Kosovë; “Vetëm Perëndimi mund t’i nxjerrë në dritë vlerat tona kombëtare” (Dr. Engjëll Sedaj, Opinioni i tretë, nr. 4, 29/9/2000); “Selia e Shenjtë shqiptarët i konsideron perëndimorë” (Opinioni i tretë, nr. 3, 22/9/2000); “Nga të gjitha gjërat që ka krijuar Zoti, më e madhja ishte Nëna Tereze” (Bota sot, 27/8/2000); “Krishterimi identitet shqiptar” (Rilindja, 4 janar 2001); “Në Prishtinë të ngrihet katedralja e identitetit tonë” (Rilindja, 24 mars 2001); “Ku është kisha jonë?” (Ali Podrimja, Gazeta e Re, 28 janar 2001); “Shqiptarët janë popull perëndimor”, (Qerim Ujkani - Interesi nacional, nr. 8, 12 nëntor 2001) etj.

³ Shih: Zëri (revistë javore), nr. 1564, 9 dhjetor 1995, f. 4, Prishtinë.

⁴ Religion in Kosova, International Crisis Group, 31 January 2001.

Në anën tjetër, kur në shtypin tonë shkruhet për Islamin, fesë së cilës i përkasin shumica dërrmuese e shqiptarëve, ku nuk vërehen kurrfarë shenjash të ndonjë ekstremizmi, hasim në titujt si vijon: “Islami kulturë a rrezik?” (Java, nr. 36, 13 fruer 2003); “Tradhtitë ndaj shtetit shqiptar”, (Dr. Kajmak H. Deda, Opinioni i tretë, nr. 16, 3 tetor 2001). “Rreziku i afërm i shqiptarëve muhamedanë” (Fjala e lirë, janar 1996); “Fundamentalizmi islamik në Ballkan” (Stefan Shfarc, “Kombi”, 20 tetor 2000); “Kërcënimi islam për Shqipërinë”; “Bijtë e rinj të Allahut”; “Bij të ndarë të Allahut” (Revista “Klan” javore, Tiranë); “Konaqet e Bin Ladenit” (“Bota sot”) etj.

Nga këta pak shembuj që përmendëm, mund të vijmë në përfundimin se në momentin aktual fetë tona nuk kanë një trajtim të barabartë si rezultat i faktorëve të jashtëm. Për këtë jemi dëshmitarë, shprehja publike e identitetit fetar të njerëzve publikë, qoftë Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi apo në Diasporë, vlen vetëm për ata të përkatësisë së krishtere e jo për ata të përkatësisë islame. Sa për ilustrim, kryeministrin e Shqipërisë, Fatos Nano, asgjë nuk e pengon që martesën e tij ta bëjë në kishë para Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse, Janullatos. Ndërsa, deri më sot nuk dimë se ndonjë nga figurat publike me përkatësi islame të ketë marrë pjesë së paku në një ceremoni fetare islame. Në Kosovë disa nga figurat publike praktikojnë pjesëmarrjen në mesha me rastin e festave të Kishës katolike, por jo edhe në xhami me rastin e faljes së namazit të Bajramit.

Në anën tjetër, nëse dikush nga intelektualët tanë merr pjesë në ndonjë ceremoni fetare islame, gjë që është e drejtë e çdonjërit, për fat të keq ai bëhet objekt talljeje nga ana e shtypit tonë. Ky akt tregon nivelin e ulët të kulturës së një pjese të intelgjencies sonë. Sa për ilustrim po përmendi vetëm dy shkrime: “Lulet e verdha të Xhenetit” (Bujku, tetor 1995), ku kritikohen disa poetë për pjesëmarrje në një iftar, si dhe shkrimi i Mehmet Krajës “Miqte e mi pelegrinë”, (“Koha ditore”, 23 shkurt 2002).

Këtu vlen të përmendim se Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan i kishte bërë vërejtje senatores së Nju Jorkut Hillary Clinton, lidhur me komentet e saj ku kishte përmendur mbrojtjen amerikane të “muslimanëve të Kosovës”, si fakt se SHBA-ja nuk është në luftë me Botën Islame. Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan zonjës Clinton i

kishte shkruar: “Në Kosovë dhe më gjerë ka shqiptarë që janë katolikë, ortodoksë, hebrenj dhe muslimanë. Prandaj, shqiptarët nuk e identifikojnë vetveten nga ndonjë religjion, por sipas etnitetit të tyre”.

Në vend të përmbylljes

Nga e gjithë kjo që përmendëm mund të dalim me këto konkluzat:

E para: Inferioriteti i të qenit musliman është një psikozë me synime të dëmshme, si në aspektin fetar, dhe në atë kombëtar. Prandaj është koha e fundit që intelgjencia jonë të lirohet nga ky kompleks që i është imponuar asaj për shkak të mosnjohes së mjaftueshme me vlerat e larta që predikon Islami.

E dyta: Tek shumica e intelektualëve tanë, Islamizmi identifikohet si fe e Lindjes, ata harrojnë se edhe Krishterimi e ka burimin në Lindje. Të dy fetë, në mënyrën e tyre, shprehin të njëjtën gjë: të mos i gjunjëzohemi askujt përveçse Zotit; njeriu të dojë njeriun, të ndryshojë egoizmin vetjak, të mos cenojë lumturinë e të tjerëve dhe t'i japë paqe e begati njerëzimit.

E treta: Ne muslimanët shqiptarë duhet të jemi krenarë për përkatësinë tonë fetare. Nga radhët e hoxhallarëve tanë kanë dalë jo pak patriotë për fatet e kombit, midis të cilëve mjafton të përmendim muderriz Ymer efendi Prizrenin, kryetar i Lidhjes së Prizrenit, dhe Haxhi Vehbi Dibrën, i cili më 1912 u zgjodh kryetar i Pleqërisë, organ konsultativ në ndihmë të Qeverisë së Vlorës, me të drejtë të zëvendësonte kryeministrin Ismail Qemali, kur mungonte.

E katërta: Ne shqiptarët duhet të kuptojmë se ushtrijmë besimin islam në Evropë, të rrethuar nga shtete kristiane, gjë që na obligon të jemi përfaqësues të denjë të besimit islam.

E pesta: Publiku evropian dhe ai perëndimor e kupton sot fenë në mënyrë demokratike, prandaj nëse edhe ne e kuptojmë fenë dhe rolin e saj në shoqëri në mënyrë të qytetëruar, nuk duhet të krijojmë inferioritet ndaj Evropës për cilëndo fe tonën.

Nga e gjithë kjo sa u tha, besoj se intelektualët tanë në të ardhmen çështjes së identitetit fetar dhe atij islam në veçanti do t'i qasen me një maturi dhe në mënyrë më shkencore.

Qemajl Morina

THE RELIGIOUS IDENTITY OF THE ALBANIANS

(Summary)

Religion was and remains a major topic of human thought. Religious feelings are a natural instinct, which have emerged in the ancient times. Ernest Renana, the author of the "History of religions", writes: It is impossible to eliminate religion in society or the phenomenon of religious belief. This was best proven by the failure of materialism, which did not succeed in convincing the society on its theories and concepts, because human beings with their natural instincts try to go beyond the material world in order to fulfill their spiritual and intuitive needs. Faith brings peace to people, it heals stress, it teaches people to accept the reality (no matter how harsh it is), it gives them hope for a better future, it strengthens their feeling of justice and it hammers egoism, which is the source of all evils.

كمال مورينا

الهوية الدينية لدى الالبانيين

(خلاصة البحث)

الدين كان و سيبقى شيئا عظيما للفكر الانساني. الشعور الديني متأصل و شئ طبيعي في نفس البشرية و هو موجود منذ القدم. الفيلسوف المشهور "أرنست رينان" في كتابه "قصة الديانات" يقول: "يمكن أن يضعف كل شئ نرغب فيه، مثل العقل، يمكن أن يتأخر العلم قد تصاب ارادة الانسان بضعف في استخدامه لحریات الانسان، و لكن من المستحيل أن نتصور ازالة الدين من المجتمع أو منع ظاهرة المعتقدات الدينية"، و أكبر دليل على ذلك هو فشل الشيوعية لاقتناع

الناس بصحة مفاهيمها المادية، لأن الانسان بطبيعته يريد أن يرتفع فوق عالم المادة لكي يكمل احتياجاته الروحية. الايمان يجلب الاستقرار للانسان و يخفف من ضغوطه و يحاول اقناعه بالواقع و يبعدة عن الانتقام و يقوى فيه شعور العدالة و يعالج الانانية التي تعد منبعاً لكل شر في كل مجتمع.

STUDIME

Mr. Xhabir Hamiti

ZANAFILLA E STUDIMIT TË NJOHURIVE KURANORE

Shkencat kuranore janë të gjitha ato hulumtime të cilat janë të lidhura ngushtë me Kur'anin si, shkaqet e shpalljes, tubimi dhe radhitja e Kur'anit, njohja ajeteve mekase dhe medinase, njohja e ajeteve të abroguara dhe abrogimi, problemi i shprehjeve të përmbledhuara dhe të ndërlikuara kuptimi i të cilave nuk kuptohet lehtë, pastaj çështja e ajeteve të përsëritura, thënie direkte dhe jodirekte kur'anore, metafora, alegoria ndarja e ajeteve, ndarja e kaptinave, tregimete e Kur'anit shembujt e Kur'anit si dhe shumë fusha të tjera studiuese të cilat ndër lidhen ngushtë me librin hyjnor.

Shkencat kuranore quhen edhe bazë e Tefsirit sepse janë njohuri të cilat komemntatori gjithsesi dhe paraprakisht duhet t'i ketë të njohura për të hyrë në derën e komentimit dhe shtjellimit të Kur'anit.

Interesimi për njohjen e përmbajtjes së Kur'anit ka qenë preokupim i shumë studiuesve dhe shkencëtarëve islamë dhe jo islam që nga fillimi i shpalljes së tij. Muslimanët ishin ndër studiuesit e parë të Kur'anit, sepse dëshironin të kuptonin dhe sqaronin domethënien dhe përmbajtjen e tekstit të tij qysh në kohën kur ai shpallej dhe interpretohej nga ana e Muhammedit a.s.

Shumë fusha të shkencave kuranore kanë qenë temë diskutimi qysh në kohën e ashabëve¹ si: ndarja e ajeteve dhe kaptinave mekase dhe medinase المكي والمدني, abrogimi dhe ajetet e abroguara - المنسوخ والمنسوخ, ajetet e qarta dhe jo krejtësisht të qarta - المتشابه والمحکم si dhe shume tema tjera të cilët kush më shumë e kush më pak, varsëshit nga aftësitë e të kuptuarit të tyre diskutonin rreth këtyre temave, mirëpo shpjegimet e kësaj gjenerate rreth Kur'anit më shumë kishin të bënin me disa nga ajetet kuranore dhe jo me Kur'anin në tërësi.

Lidhur me këtë po i paraqesim disa shembuj:

Aisheja² shpjegonte se ajeti بل الساعة موعدهم³ "*Por jo, afati i tyre është kijameti*" është shpallur në Meke kur ajo ishte fëmijë i vogël, ndërsa kaptina "En-Nisa" ishte shpallur në shtëpinë e të dërguarit a.s.⁴

Ndërsa Abdullah Ibni Abbasi⁵ sqaron se ajeti 266 i kaptinës El-bekare: أيود أحدكم أن تكون له جنة من نخيل و اعناب. "*A dëshiron ndonjëri prej jush që ka një kopsht me hurma e rrush në të cilin rrjedhin lumenj...*" është një nga shembujt krahasues të përmendur në Kur'an.

Buhariu dhe Muslimi⁶ në përmbledhjet e tyre evidentojnë një thënie të Abdullah ibni Mesudit rreth shpjegimit të ajetit

الذين آمنوا و لم يلبسوا إيمانهم بظلم "*Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë*" kur njerëzit ishin hutuar dhe nuk dinin se cili ishte qëllimi i përdorimit të shprehjes "dhulm", atëherë i ishin drejtuar Muhammedit a.s. për të kërkuar shpjegimin e kësaj fjale me pyetjen: Cili prej neve, o i dërguar nuk i bën "dhulm"- mizori vetes së vet? Muhammedi a.s. u ishte përgjigjur: Nuk është qëllimi i asaj që ju po mendoni, a nuk e keni dëgjuar këshillën e Llukmanit

¹ As-habët janë shokët e Muhammedit a.s. të cilët e kishin shoqëruar atë sa ishte gjallë.

As-hab quhet edhe ai person që e ka takuar Muhammedin a.s. të pakten njëherë në jetë.

² Grueja e Muhammedit a.s.

³ El-Kamer, 46.

⁴ Itkanul Burhan fi ulumul Kur'an f. 7, v.1 Prof.Dr.Fadel Hasen Abbas.

⁵ Njeriu nga komentatorët e parë të Kur'anit dhe më i njohuri në këtë lëmi nga radhët e sahabëve.

⁶ Janë këta emërat e dy përmbledhësve më të mëdhenjë dhe më të njohur si dhe më të saktë të haditheve – thënieve të Muhammedit a.s. gjatë gjithë historisë.

⁷ El-Enam, 82.

drejtuar birrit të tij: *إن الشرك لظلم عظيم* "...idhujtaria është padrejtësia më e madhe"⁸

Në mesin e shpjeguesëve më të njohur të Kur'anit nga ana e Ashabëve dallohen: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.a.⁹, pastaj Abdullah Ibni Abbasi¹⁰, Abdullah Ibni Mesuudi, Ubej Bin K'ab, Zejd bin Thabit, Ebu Musa el-Esh arij dhe Abdullah Ibn Zubjer, Ebu Hurere, Enes Ibni Malik, Abdullah Ibni Omer, Xhabir ibn Abdullah dhe Aisheja, grueja e peygamberit a.s..¹¹

Kjo metodë pra, e cila u cek më lart ishte një nga mënyrat e shpjegimit dhe kuptimit të domethënies të Kur'anit nga gjenerata e parë muslimane gjatë kohës sa ishte gjallë Muhammedi a.s. por edhe gjatë dekadave të para pas vdekjes së të dërguarit a.s.

Këto lloje të komentimeve kuranore nuk kanë qenë të përmbledhura në ndonjë libër të vaçantë, por janë përcjell deri te gjeneratat e mëvonshme përmes librave të parë të Hadithit dhe Tefsirit të cilët qenë paraqitur në shekullin II hixhrij.

Alij El-Medenij¹² ishte ndër të parët që kishte shkruar rreth temës "Shkaqet e shpalljes kuranore" pas të cilit kishin vazhduar edhe autorë dhe studiues të tjerë me tema të ndryshme, si: Ebu Ubejd El-Kasim i cili kishte shkruar rreth abrogimit dhe leximeve kur'anore, Ibni Kutejbe ishte marr me temën rreth paqartësive në Kur'an etj etj. Vlen të theksohet se pas Kur'anit si lëmë i parë studiues që i preokupi gjeneratën e parë të muslimanëve ishte Hadithi, andaj edhe shpjegimet e para të Kur'anit dhe mësimet e para rreth tij i gjejmë në librat e shkencës së Hadithit, të cilët në brendsinë e tyre evidentonin shtjellime të Kur'anit që i kishte bërë Muhammedi a.s.¹³ dhe shokët e tij.

⁸ Llukman. 13.

⁹ Ali r.a. ishte më i njohuri nga ashabët si komentator i Kur'anit. Xhelaludin Sujutiu në librin e tij të njohur "El itkan fi ulumil Kur'an"- v.2/186., evidenton thënien e tij: "Më pyetni rreth Kur'anit çka të doni, betohem në Allahun se nuk ka as një ajet që nuk e di se kur është shapllur, ku dhe pse është shpallur."

¹⁰ Ibni Abbasi Muhammedi a.s. e kishte quajtur "Terxhumanul Kur'an"- mufesir-komentator të Kur'anit për të cilin gjithëashtu ishte lutur me fjalët: "O Zot, aftësoje në njohjen e fesë dhe mësoja komentimin –te'viilin e Kur'anit".

¹¹ Mebahith fi Ulumil Kur'an, f. 11. të autorit: Menna El –Kattan.

¹² Mësuesi i Buhariut.

¹³ Në ditët e para të Islamit Muhammedi a.s. ishte komentatori i vetëm i Kur'anit. Ai komentonte ajetet për të cilat interesoheshin shokët e tij dhe ua sqaronte kuptimin e tyre,

Ndërsa si libër i parë që përmbledhë shkoqitjen e më shumë se një teme lidhur ngushtë me njohuritë kuranore, ishte libri "*Fununul Efnan fii ulumil Kur'an*" i autorit Ebi Ferexh Abdu Rrahman bin El-Xhevzij¹⁴, i botuar për herë të parë në vitin 1408 h., i recensuar nga Dr. Hasen Dija Iter.¹⁵ Libri i dytë me radhë në shkencat kuranore vjen nga autori El-imam Ez-zerkeshij¹⁶ me titull "*El-Bur'an fii ulumil Kur'an*"¹⁷, pastaj libri "*El-itkan fii ulumil Kur'an*" të autorit Xhelaludin Es-sujutij.

Studiuesit islamë nuk u mjaftuan vetëm me librat klasikë rreth Kur'anit, të cilët u botuan në vitet e më hershme, por hulumtuan edhe shumë tematika të tjera kuranore, të reja, të cilat nuk ishin prekur më parë në mënyrë të shtjelluar, si aspekti gjuhësor në Kur'an, radhitja e fjalëve, fjalive dhe kaptinave, stili i lartë gjuhësor, mrekullia kur'anore¹⁸, snijalizimet e shumta shkencore dhe krahasimi i tyre me të arriturat shkencore¹⁹ bashkëkohore, arsyet e pamundësisë së përpilimit të një libri të ngjashëm me Kur'anin, ruajtja e ogjinalitetit të tij²⁰, pamundësia e ndryshimit të tekstit kuranor, e shumë e shumë tematika tjera të cilat me të vërtetë ia shtojnë edhe më tepër vlerën këtij libri

por shpeshherë bënte sqarime të Kur'anit edhe pa ndonjë pyetje paraprake konform ajetit kuranor: "Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atq që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë Kur'anin". En-nahl, 44. Pas vdekjes së Muhammedit a.s. Kur'anin vazhdonin ta komentonin shokët e tij të njohur në terminologjinë islame – ashabët. Komentimi i tyre renditet në rendin e dytë për nga rëndësia, pas komentimit të peygamberit, ngase ishin dëshmitarët dhe nxënësit e parë të Pejgamberit a.s..

¹⁴ Vdekur në vitin 597 hixhrij.

¹⁵ Itkanul Burhan fii Ulumil Kur'an, f. 8 v.1 autor Dr. Fadl Hasen Abbas.

¹⁶ Vdekur në vitin 794.

¹⁷ Ibd.

¹⁸ Libri: "I'xhazul Kur'an", nga autori: Muhamed Sadik Rrafij.

¹⁹ Sipas dy studiuesve bashkëkohor të Kur'anit Dr. Muhamed Xhemil El-habbal dhe Dr. Mikdar Merij El-Xhevarij, në librine tyre të quajtur "Shkencat në Kur'an" pas një studimi të thellë kane evidentuar se në Kur'an janë 1200 ajete që kanë të bëjnë me sinjalizime shkencore nga 6236 sa ka gjithsej Kur'ani, ose me fjalë të tjera 20% nga ajetet e përgjithshme kuranore. Këta dy autorë kanë bërë po ashtu edhe klasifikimin e ajeteve sipas tematikave shkencore si: shkencat e mjekësisë, fizikë, biologji, astronomi, gjeografi, gjeometri, agrokulturë, shkencat detare dhe të lumenjve, mjetet e bartjes, gjenalo-gjia e njeriut dhe krijesave të tjera, inxhinieri, kimi, gjuha e shtazëve etj.

²⁰ Libri: "En-nebeu el-adhim", nga autori: Dr. Muhamed Abdullah Diraz.

hyjnor, i cili për shekuj me radhë vazhdon t'i bëjë sfidë të gjithë libra-ve në botë.

Gjeneza e fjalës Kur'an:

- aspekti gjuhësor

Duhet theksuar se fjala "Kur'an" në gjuhën arabe paraqitet ekskluzivisht me shpalljen e Kur'anit, sepse arabët këtë fjalë më herët nuk e kishin të njohur. Fjala "Kur'an" është bërë emër i përveçëm i librit të Zotit të shpallur Muhammedit a.s.

Mirëpo, studiuesit e gjuhës arabe nuk janë të gjithë të një mendimi rreth prejardhjes së fjalës "Kur'an".

Grupi i parë i gjuhëtarëve arabe mendojnë se fjala "Kur'an" rrjedh nga folja – kur aan, me hemze (قرآن) në formën (فعلان) shumësi i së cilës është "karaain" e që në fakt edhe i përgjigjet Kur'anit sepse pjesët e Kur'anit bashkohen dhe janë të një vlere njëra me tjetrën.

Grupi i dytë në të cilin bëjnë pjesë shumicia dërmuese e gjuhëtarëve arabe, mendojnë se fjala "Kur'an" rrjedh nga folja kar'e (قرا) që ka kuptimin "mbledh" "tubojë" që poashtu i përgjigjet Kur'anit, sepse ajetet dhe kaptinat janë tubuar me njëra tjetrën dhe janë mbledhur-tubuar në një libër²¹

Shafiu²² mendon se fjala "Kur'an" është emër i përveçshëm dhe i shquar siç janë edhe emrat e librave të mëhershëm qiellore, Tavrati dhe Inxhili²³.

Studiuesit e gjuhës po ashtu kanë ndarë kuptimet e fjalës El-ku'r-an kur evidentohen me nyjën shquese "El" (القرآن) dhe pa nyjën shquese "kur'an" (قرآن).

"El-Kuran" është emër i veçant i cili nuk mund të përdoret vetëm për Kur'anin, kurse "kur'an" pa nyjën shquese (قرآن) mund të ketë për qëllim Kur'anin siç është ajeti kuranor:

"Dhe Kur'anin që قرآنًا فرقناه لتقرأه على الناس على مكث و نزلناه تنزيلاً *Ne (e shpallëm) e ndamë pjesë pjesë për t'ua lexuar njerëzve*

²¹ Itkanul Burhan fi Ulumil Kur'an, f.44, Prof. Dr. Fadl Hasen Abbas.

²² Themelues i shkollës juridike islame të drejtimit të njohur shafiij.

²³ "Tarih Bagdad" v.II f.62, Hatib Bagdadij.

²⁴ El-Isra, 106.

dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një", por mund të ketë edhe kuptimin e të lexuarit, siç është ajeti tjetër: *إن علينا جمعه و قرآنه فإذا قرآنه فاتبع قرآنه* "Është obligim Joni tubimi dhe leximi (i Kur'anit) dhe kur ne e lexojmë (Kur'anin) ti përcille (atë).

Edhe të tjerë gjuhëtarë arabë, kanë bërë dallimin e fjalës "El-kur'an" e cila evidentohet me nyjën shquese "El" dhe pa të. Sipas tyre shprehja "El-Kur'an" ka për qëllim Kur'anin në përgjithësi siç përmendet në Kur'an në ajetin 9 të kaptinës El-Isra:

إن هذا القرآن يهدي للتي هي أقوم – "Vërtetë ky Kur'an udhëzon për rrugën më të mirë" dhe në kaptinën El-Enaam, ajeti 19:

و أوحى إلي هذا القرآن لأنذركم به "e mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ua tërheqë vërejtjen".

Ndërsa kur fjala Kur'an përmendet pa nyjën shquese "El", ka për qëllim Kur'anin në përgjithësi ose një pjesë të tij.

Profesori dhe komentatori bashkëkohor i Kur'anit Dr.Fadel Hasen Abbas, mendon se nyja shquese "El" Kur'anin nuk e bën të shquar sepse ai ishte i shquar edhe para se t'i bashkëngjitej nyja "El".²⁵

Emrat që përdoren më së tepërmi për Kur'anin:

- El-Kur'an: *إن هذا القرآن يهدي للتي هي أقوم* "Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta".

- El-kitab: *لقد أنزلنا إليكم كتابا فيه ذكركم* "A nuk e kuptoni se Ne ju shpallëm librin në të cilin gjendet krenaria juaj?"

- El-furkan: *تبارك الذي نزل الفرقان على عبده ليكون للعالمين نذيرا* "Ai që ia shpalli Furkanin (Kur'anin dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhammedit) që të bëhet këshillues i botës."

- Edh-dhikr: *إننا نحن نزلنا الذكر و أنا له لحافظون* "Ne me Madhërinë tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij".

- Et-tenziil: *و إنه لتنزيل رب العالمين* "E edhe ai (Kur'ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve".

²⁵ Itkanul Burhan fii ulumil Kur'an, f. 49.

²⁶

²⁷ El-Enbija, 10.

²⁸ El-Furkan, 1.

²⁹ El-Hixhr, 9.

Përkufizimi i Kur'anit në terminologjinë islame

Që në fillim vlen të theksohet fakti se mendimatrët islamë qysh herët janë munduar t'i japin një përkufizim sa më të saktë Kur'anit. Studiuesit e të drejtës së Sheriatit, p.sh. qëllim të tyre kanë pasur nxjerrjen e dispozitave kuranore në formë të përmbledhur ose të shtjelluar, gjuhtëarët sqarimin e mrekullisë së Kur'anit përmes shprehjeve të tij të larta dhe stilit të tij të veçantë në radhitjen e fjalëve dhe fjalive. Studiuesit e leximeve (të kiraeteve) të Kur'anit janë marrë me shqiptimin e drejtë të tij, e kështu me radhë, dhe secili grup studiuesish nga këndi i vet kanë dhënë mendimet e tyre rreth përkufizimit të Kur'anit.

Përkufizimi më i saktë i Kur'anit rreth të cilit janë bashkuar pjesa dërrmuese e mendimtarëve islamë është ai që e hasim më së shumti në librat e shkencave kuranore në të cilat theksohet: "Kurani është fjalë e Zotit"³¹, i shpallur³² Muhammedit a.s.³³, i shkruar në koleksione³⁴, i transmetuar me besinkëri, leximi dhe recitimi i të cilit është ibadet.³⁵

Kur'ani është fjalë e Zotit, kjo është veçoria më e rëndësishme e tij dhe si të tillë e njohin dhe e respektojnë gjithë ithtarët e tij kudo në botë. Ai është mesazhi i fundit hyjnor drejtuar mbarë njerëzimit, kurse Muhammedi a.s. i dërguari i fundit për mbarë njerëzimin. Këtë fakt e gjejmë të evidentuar në shumë ajete kuranore si:

- قل يا أيها الناس إني رسول الله إليكم جميعا - *"Thuaj (Muhammed); "O ju njerëz! Unë jam i dërguar i Allahut te të gjithë ju ..."*³⁶

- تبارك الذي نزل الفرقان على عبده ليكون للعالمين نذيرا - *"Qoftë i bekuar Ai që i shpalli Furkanin (Kur'anin) robit të vet (Muhammedit) që të bëhet peygamber dhe këshillues i botës."*³⁷

- ما كان محمد أبا أحد من رجالكم ولكن رسول الله وخاتم النبيين - *"Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguar i Allahut dhe vulë e të gjithë peygamberëve."*³⁸

³⁰ Esh-Shuara – 192.

³¹ Kur thuhet, fjalë e Zotit përjashtohet çdo fjalë tjetër nga kushdo qoftë ajo.

³² Përjashtohet fjalët e shpallura engjujve.

³³ Përjashtohen fjalët e shpallura të peygamberëve të mëhershëm.

³⁴ I shkruar në koleksione- d.m.th. është evidentuar me shkrim në mjete të ndryshme që përdoren në atë kohë.

³⁵ Përjashtohet leximi i çfardo teksti tjetër jashtë Kur'anit si dhe haditheve kudsij.

³⁶ El-Earaf – 158.

³⁷ El-Furkan – 1.

Dhe duke u nisur nga një e vërtetë e tillë, atëherë nuk ka vend që të habitemi pse se ky libër hyjnor në realitet ka përmbledhur gjithë kërkesat e jetës njerëzore të bazuara edhe në dispozitat e mëparshme të shpalljeve qiellore:

شرع لكم من الدين ما وصى به نوحا والذي أوحينا إليك وما وصينا به إبراهيم وموسى وعيسى أن أقيموا الدين ولا تتفرقوا فيه

*"Ai u përcaktoi juve për fe atë që i pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne të shpallëm ty, dhe atë me se patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (i porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të."*³⁹

Nga kuptimi i ajeteve të lartcekura dhe domethënia e tyre, nënkuptojmë të vërteten dhe mrekullinë e Kur'anit, i cili vazhdon t'u bëjë sfidë gjithë librave të mëhershëm qiellorë si dhe çdo libri tjetër në botë, të shkruar dhe të menduar nga njeriu.

Kush ishin të parët që kuptuan sfidën e Kur'anit

Ata që u ballafaquan të parët me sfidën e Kur'anit, ishin arabët në gjuhën e të cilëve shpallej teksti tij. Arabët, siç na tregojnë të dhënat historike, në kohën e Muhammedit a.s. ishin të njohur si orator të mëdhnj në dallim nga popujt e tjerë. Duke u bazuar në aftësitë e tyre oratorike ata filluan të mohonin Kur'anin si libër të shpallur të Zotit duke i quajtur ajetet e tij tregime, gënjeshtër, fjalë të shpikura nga një njeri i çmendur etj. Mirëpo e vërteta ishte krejtësisht e kundërt. Ata me gjithë aftësitë e tyre oratorike, nuk arritën të sillnin diçka të ngjashme me Kur'anin, qoftë edhe një kaptinë të vetme.

Sikur që edhe gjithë njerëzit e botës të bashkoheshin, madje edhe krijesat e padukshme siç i quan Kur'ani "xhinët", për të përpiluar një libër të ngjashëm me Kur'anin, nuk do t'ia arrinin. Por, edhe sikurse të gjithë drunjtë mbi tokë të shndërroheshin në pena kurse detit t'i shtoheshin edhe shtatë detëra e të shëndërroheshin në ngjyrë, nuk do të arrinin që të shkruanin dhe të përfshinin fjalët dhe domethëniet që ka përmbledhur Kur'ani.

³⁸ El-Ahzab – 40.

³⁹ Esh-Shura – 13.

Kur`ani ishte dhe do të mbetet sfidë për gjithë botën njerëzore dhe gjithherë do të jetë mrekulli e vetme e pazëvendësueshme, derisa të ekzistojë jeta në këtë botë.

"Ska dyshim se ai (Kur`ani) është thënie e të dërgaurit fisnik (që e pranoi prej Zotit) Që është i fortë dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit .Që është i rrespektuar atje (në mesin e engjëjve) dhe besnik . Nuk është i marrë shoku juaj (Muhammedi) Dhe ai e pati parë atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë qiellor. Dhe ai nuk është që në të fshehtë (shpalljen) ka dyshim (ose ju lë mangu)."⁴⁰

إنه لقول رسول كريم. ذي قوة عند ذي العرش مكين. مطاع ثم أمين. و ما صاحبكم بمجنون. و لقد رآه بالآفق المبين , و ما هو على الغيب بضنين.

Që në fillim arabët kuptuan se nuk kishin të bënë me një libër të rëndomtë, të menduar dhe të shkruar nga mendja e njeriut, ngase, stili i lartë i shprehjeve kuranore, përmbajtja dhe domethënia e thellë e tyre zhduku çdo dyshim të njerëzve rreth prejardhjes së tij hyjnore.

Si e ruajti Kur`ani orgjinalitetin e tij

Një ndër elementet themelore që e bëri Kur`anin të dallohet nga çdo libër tjetër në botë, është edhe ruajtja e tij orgjinale, autentike brez pas brezi duke mos lejuar ndryshimin edhe më të vogël të tekstit të tij, libër i cili sfidoi shekuj me radhë tendencat e panumërta që kishin për qëllim mohimin e shenjtërisë dhe uljen e vlerës së tij.

Që në momentet e shpalljes, Kur`ani u ballafaqua me mohues dhe përgënjeshtues të tij, që e quanin Pejgamberin gënjeshtar, poet e çfarë jo tjetër, ndërsa Kur`anin poezi, vargje të radhitura sipas dëshirës së njeriut, i bartur nga librat e mëhershëm qiellorë nga një magjistar, nga një beduin, nga një orator i shkrëtirës arabe etj.!!⁴¹

Është më së e domosdoshme në këtë rast të theksohet fakti se sikur të mos ishte Kur`ani libër hyjnor- i shpallur nga Zoti, i shfaqur në mesin e njerëzve përmes njeriut të zgjedhur-Pejgamberit, nuk do të arrinte asnjëherë t'i përballonte gjithë shpifjeve të panumërta. Përku-

ndrazi, asnjë libër tjetër në botë nuk do të arrinte të përballojë atë që e përballonte atë që përballoi Kur`ani gjatë gjithë kohërave.

Kur`ani asnjëherë nuk është kursyer nga sulmet e njerëzve me qëllime tendencioze, mirëpo atakimet e tilla gjithnjë kanë përfunduar pa ndonjë rezultat, ndërsa madhështia e tij ka ardhur përherë duke u rritur.

Asnjë libër në botë nuk është ruajtur siç është ruajtur Kur`ani, sepse një gjë të tillë e ka garantuar vetë Zoti i Madhërueshëm duke thënë **"Vërtetë Ne e kemi zbritur Kur`anin dhe Ne do ta ruajmë atë"**. Kur`ani që në momentet e para të shpalljes i është shoqëruar nga dy elemente të cilat vazhdimisht kanë qenë të pandara, si alfa omega: evidentimi me shkrim dhe memorizimi në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Ky fakt e ka bërë të pamundur ndërhyrjen e njeriut për ndryshimin eventual ose harresën e ndonjë fjale të tij, ngase numri i atyre që e kishin zënë Kur`anin përmendsh në prani të profetit Muhammed a.s., ishte i madh dhe kur ndodhte që njëri prej tyre të ngatërronte ndonjë pjesë ose qoftë një fjalë të tij, ndërhyrja të tjerët dhe e përmirësonin e vërtetësinë edhe në mjetet në të cilat e kishin evidentuar atë qysh në çastet e para të shpalljes. Kjo mënyrë e mbrojtjes së Kur`anit vazhdon edhe sot.Kur`ani vazhdon të ribotohet pa ndryshimin më të vogël, por edhe të memorizohet-nxinet përmendsh nga pasuesit e tij në të gjitha anët e botës. Dy elementet e sipërpërmendura ishin pikrisht ato që bënë që Kur`ani të jetë një – autentik dhe i pandryshuar asnjëherë, një fat që nuk e gëzuan librat e mëhershëm qiellorë, Tevrat, Zeburi dhe Inxhili. Muslimanët kudo në botë, e lexojnë të njëjtin Kur`an. Ai është vetëm një, i ruajtur vazhdimisht në orgjinal.

⁴⁰ Et-tekviir – 19/24.

⁴¹ Ishin këto pohime të kundërshtarëve të hershëm të Kur`anit, por dhe të gjeneratave të mëvonshme, sidomos nga radhët e orientalistëve të cilët definonin Kur`anin si libër të hartuar nga Muhammedi a.s..

Xhabir Hamiti

THE ORIGIN OF THE KORANIC STUDIES

(Summary)

The Koranic sciences are all the researches related to the Koran (the revelation, the ayats of Mecca and Medina, the abrogated ayats, etc.).

These sciences are the basis for the interpretation of the Koran. The commentator must have knowledge on them in order to comment the Koran.

جابر حامدي

بداية دراسات المعارف القرآنية

(خلاصة البحث)

العلوم القرآنية تعتبر جميع البحوث التي لها علاقة وطيدة بالقرآن الكريم مثل اسباب نزوله و جمعه و ترتيبه، و معرفة الايات المكية و المدنية و معرفة الناسخ و المنسوخ، و كذلك معرفة الايات التي تتحدث عن عالم الغيب و فصل للايات و السور و قصص القرآن الكريم و كذلك دراسة المجالات الاخرى التي لها علاقة مباشرة بالقرآن العظيم.

TEFSIR

Sabri Bajgora

TEFSIRI I KUR'ANIT NË KOHËN E RESULLAHUT S.A.V.S.

Allahu xh.sh. i zbriti Muhammedit a.s. Librin e shenjtë-Kur'anin, si mrekulli të patejkalueshme deri në momentet e fundit të jetës mbi këtë tokë, sepse ky është libër që thërret për besimin e vërtetë, duke u bazuar në studime, analiza dhe hulumtime në proceset natyrore të kësaj ekzistence. Pa dyshim, ishte kjo dhurata më e madhe hyjnore për mbarë njerëzimin.

Kur'ani është vula e tërë revelatave hyjnore, të cilin i Dërguari i Allahut u urdhërua t'ia proklamonte njerëzimit. Ky mision i shenjtë nuk nënkuptonte vetëm përcjelljen e tij tek njerëzit, por edhe sqarimin e tij ashtu siç na bën me dije ajeti kuranor:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“...Ty ta zbritëm këtë Kur'an, t'ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë” (En-Nahl, 44).

Ky mision i shenjtë i Muhammedit a.s. zgjati rreth 23 vjet, deri në plotësimin e të gjitha dispozitave të Sheriatit, me zbritjen e ajetit të fundit kuranor, disa ditë para vdekjes së tij. I Dërguari a.s. e kreu me nder dhe përgjegjësi të plotë këtë detyrë dhe barrë kaq të rëndë, me të cilën ishte ngarkuar. Ai në asnjë moment nuk u tërhoq e as u zbraps nga përgjegjësia që kishte marrë mbi supe, sepse qysh në fillim të

Shpalljes ishte betuar: *“Pasha Allahun, edhe po të ma sillni Diellin në anën time të djathtë e Hënën në të majtën, nuk do ta lë këtë mision derisa Allahu ta bëjë ngadhënjimtare (këtë fe) ose unë të flijohem për të”*

Por që ky mision të kishte suksesin e dëshiruar, ishte e nevojshme një parapërgatitje shpirtërore nga ana e Allahut xh.sh. për të Dërguarin e Tij, në mënyrë që ai gjatë komunikimit të kësaj shpalljeje të mos haste në ndonjë vështirësi a paqartësi rreth asaj që i zbriste. Nga dëshira e flaktë që menjëherë të zinte përmendsh atë që i shpallej, Muhammedi a.s. ngutej duke përsëritur fjalët pas Xhibrilit..., siç na dëshmojnë këto ajete kuranore:

لَا تُحَرِّكْ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ. إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ.

فَإِذَا قَرَأْنَاهُ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ. ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ

“Ti (Muhammed) mos e shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij! E kur të ta lexojnë atë ty, përcille (me të dëgjuar) leximin e tij. Dhe pastaj është obligim yni që ta shkoqisim atë.” (El-Kijame, 16-19)

Gjatë komentimit të këtyre ajeteve, Fahu Rrazu thotë: *“Ajetet në fjalë argumentojnë se i Dërguari i Allahut e përsëriste me të shpejtë atë që ia lexonte Xhibrili a.s. dhe gjatë diktimit të Xhibrilit e pyeste atë për disa paqartësi dhe kuptime, në mënyrë që të mos i ikte ndonjë gjë, që pastaj ato t'ua përcillte ashabëve. Por i Gjithëfuqishmi ia tërhoqi vërejtjen duke e qetësuar atë të mos ngutej të lexonte e të përsëriste pas Xhibrilit, kur i tha: “Ti (Muhammed) mos e shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij!”*, kurse për pyetjet që ai i bënte Xhibrilit, Allahu i tha: *“Dhe pastaj është obligim Yni që ta shkoqisim atë.”*, do të thotë Ne e kemi obligim të t'i sqarojmë ty detajet dhe kuptimet”¹

Me këtë mendim pajtohet edhe Zimahsheri, i cili gjatë komentimit të këtyre ajeteve, thotë: *“Siç duket, i Dërguari a.s. ngutej të përsëriste atë që i shpallej, por Allahu xh.sh. e qetësoi zemrën e tij duke i*

¹ Fahu Rrazu *“Tefsirul Kebir-Mefatihul Gajbi”*, vëll.15, fq. 225.

thënë se nuk kishte nevojë të ngutej, sepse “Ne të garantojmë nxënien përmendsh të tij (Kur’anit)” dhe pastaj sqarimin e asaj që kishte nevojë për sqarim më detal, për se flet edhe ajeti tjetër kuranor:

وَلَا تَعْجَلْ بِالْقُرْآنِ مِنْ قَبْلِ أَنْ يُقْضَىٰ إِلَيْكَ وَحْيُهُ وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

“Ti mos nxito me Kur’anin para se të përfundojë shpallja e tij tek ti, dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!” (Ta-Ha, 114)²

Ebu Suudi, në lidhje me ajetin: **“Dhe pastaj është obligim Yni që ta shkoqisim atë.”**, thotë: “Këtu bëhet fjalë për sqarimin e ajeteve në të cilat kishte kuptime alegorike dhe dispozita”³

Të njëjtin mendim me Ebu Suudin e mbështet edhe Alusiu⁴, kurse Shevkaniu, në lidhje me këtë ajet, thotë: “Me këtë ajet synohet sqarimi apo komentimi i hallallit e haramit, dhe i ajeteve që kishin nevojë për sqarime më të thukëta”⁵

Allahu Fuqiplotë deshi që ky mision i fundit dhe kjo shpallje hyjnore, të përmbyllte të gjitha shpalljet e mëparshme. Dhe vërtet Kur’ani, si libri i fundit hyjnor ishte mrekullia me të cilën Allahu forcoi zemrën dhe misionin e të dërguarit të Tij, duke sfiduar mendjet njerëzore në çdo kohë. Ishte urtësia hyjnore që ky Kur’an të mbetet mrekulli deri në Ditën e Gjykimit, dhe nga ajetet e tij, çdo brez njerëzor të nxjerrë thesaret e urtisë, të cilat do të jenë argumente të pakontestueshme se Kur’ani është fjalë e Allahut, dhe si të tillë i Dërguari a.s. ua përcolli ashabëve të tij, të cilët do të ishin bartës të këtij amaneti dhe përcjellës besnikë të tij tek gjeneratat e ardhshme.

A e komentoj Muhammedi a.s. krejt Kur’anin?

Pas Kur’anit si burim i parë dhe i pakontestueshëm, i cili në vetë esencën e tij përmban shumë ajete, që sqarojnë njëri-tjetrin, vjen Syneti (Hadithi) i të Dërguarit të Allahut, si burim i dytë i. Pra, çdo gjë që vjen nga i Dërguari i Allahut, nëse është transmetuar paraprakisht me sened (varg transmetuesish) të saktë e të besueshëm, pranohet pa

kurfarë hezitimi, sepse i Dërguari i Allahut nuk ka folur në çështje të fesë dhe të Kur’anit, pa qenë i frymëzuar nga ana e Allahut xh.sh., për se dëshmon edhe ajeti kuranor:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

“Dhe ai nuk flet nga dëshira (hamendja) e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet.” (En-Nexhm, 3-4).

Ndërsa në lidhje me Synetin (Hadithin) Resulullahu s.a.v.s. thotë: “Mua më është dhënë Libri, e me të edhe po aq sa ai (Syneti)...”⁶

Mirëpo se a e komentoj Muhammedi a.s. tërë Kur’anin apo pjesërisht, tek dijetarët ekzistojnë dallime. Disa dijetarë, me Ibn Tejmijen në krye, janë të mendimit se Pejgamberi a.s. ashabëve të tij ua sqaroi tërë kuptimet e Kur’anit.⁷ Por, megjithatë shumica e dijetarëve islamë janë të mendimit se i Dërguari i Allahut nuk e ka komentuar Kur’anin në tërësi, por vetëm disa ajete që kishin të bënin me dispozita të caktuara, dhe disa ajete të tjera për të cilat e pyetnin ashabët e tij kohë pas kohe. Këto ajete kryesisht ishin të natyrës së gajbijateve (gjërave të fshehta), ose ajete që në shikim të parë ishin paksa të komplikuar dhe kërkonin sqarime më të hollësishme. Të këtij mendimi janë El-Huvejbi dhe Es-Sujutiu.⁸ Këtë mendim të tyre në një mënyrë e përkrahin edhe shumë prej dijetarëve bashkëkohorë, të cilët megjithatë mendojnë se ajetet e komentuar nga Muhammedi a.s. nuk ishin aq pak, siç pretendon Sujutiu, por ishin me një numër më të madh dhe u mjaftonin ashabëve që të kuptonin se për se obligoheshin.⁹

⁶ Transmeton Ebu Davudi në kreun “Syneti”, kapitulli V, si dhe Tirmidhiu në kreun “Dituria”, kapitulli X.

⁷ Ibn Tejmije “Mukaddimetu fi Usuli et-Tefsir”, fq. 5

⁸ Imam Sujutiu “El Itkan fi Ulumil Kur’an”, vëll. II, fq. 384

⁹ Dr. Abdul Mun'im Nimr “Ilmu-t-Tefsir”, fq. 23, Kajro 1985

² Zimahsheri “El-Kesh-shaf”, vëll. IV, fq. 165

³ “Tefsir Ebu Suud” vëll. V, fq. 431

⁴ Alusiu “Ruhul Meani”, vëll. 29, fq. 142

⁵ Imam Esh-Shevkanu “Fethul Kadir”, vëll. V, fq. 338.

Argumentet e grupit të parë që thonë se i Dërguari i Allahut ua sqaroi ashabëve të gjitha kuptimet e Kur'anit

- Argumenti i parë i Ibn Tejmijes në lidhje me këtë, është fjala e tij: “Duhet të dimë se i Dërguari i Allahut ua sqaroi ashabëve kuptimet e Kur'anit ashtu siç ua sqaroi edhe shprehjet (fjalët) e tij, sepse ajeti kuranor:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“...Ty ta zbritëm këtë Kur'an, t'ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë”. (En-Nahl, 44), përfshin këto dy nocione.

- Argumenti i dytë, sipas tij, janë edhe fjalët e disa ashabëve të mëdhenj, si të Othmanit r.a., të Abdullah ibn Mes'udit e të tjerë, të cilat i transmeton tabiiu i njohur Ebi Abdurrahman Es-Selmi, se ashabët e Muhamedit a.s., kur i mësonin dhjetë ajete të Kur'anit, nuk fillonin mësimin e të tjerave pa i studiuar mirë e hollësisht dispozitat e ajeteve të mëparshme. Madje është e njohur thënia e tyre: “E mësonim Kur'anin e së bashku me të mësonim edhe dijen edhe mënyrën e të vepruarit me ato ajete.” Ndodhte që shumë ashabë të ndaleshin në nxënien përmendsh të një sureje për një kohë të gjatë, siç ishte rasti i Ibn Omerit, të cilit iu deshën disa vjet për ta mësuar e studiuar në tërësi kaptinën “El-Bekare”. Andaj disa prej tyre jo vetëm që e mësonin përmendsh (Kur'anin), por ndaleshin dhe e studionin në hollësi çdo ajet.

Sipas Ibn Tejmijes, ajeti kuranor:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

“Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni.” (Jusuf, 2), dëshmon qartë se ky Kur'an është shpallur në gjuhën arabe që njerëzit ta kuptojnë. “Logjika e shëndoshë nuk e pranon faktin që f.v. një popull ta lexojë një libër në ndonjë prej disiplinave shkencore, si p.sh. në mjekësi, matematikë, e të mos e shtjellojnë (komentojnë) detajisht, e po atëherë ç'mund të thuhet për Kur'anin si fjalë e Allahut, që është

udhërrëfyes, shpëtim dhe lumturi e tyre, nëpërmjet të cilit ngrenë fenë dhe jetën e tyre.” - thotë në fund Ibn Tejmije¹⁰

- Argumenti i tretë, sipas tij, është ajo që e transmetojnë Imam Ahmedit dhe Ibn Maxhe nga Omeri r.a., i cili ka thënë: “Ajeti i kamatës është ndër të fundit që ka zbritur nga Kur'ani, por i Dërguari a.s. vdiq pa e komentuar atë.”

Sipas Ibn Tejmijes dhe bashkëmendimtarëve të tij, del se i Dërguari i Allahut ua kishte sqaruar ashabëve gjithmonë ajetet që i kishin zbritur, përveç këtij të kamatës, meqenëse nuk kishte arritur, sepse e kishte kapluar sëmundja e vdekjes.

Argumentet e grupit të dytë që thonë se i Dërguari i Allahut nuk ua sqaroi ashabëve të gjitha kuptimet e Kur'anit

- Argumenti i parë i këtij grupi që thonë se i Dërguari a.s. nuk ua sqaroi ashabëve të gjitha kuptimet e ajeteve kuranore, përveç disave, pak nga numri, është thënia e Aishes r.a., të cilën e transmeton Bezzari, e cila citohet të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut nuk bënte ndonjë komentim të Kur'anit, përveç disa ajeteve të pakta, të cilat ia mësonte atij Xhibrili a.s..”

- Argumenti i dytë, sipas tyre, është se i Dërguari i Allahut me qëllim të caktuar nuk ua sqaroi ashabëve të gjitha kuptimet e Kur'anit, sepse muslimanët janë të obliguar në çdo kohë t'i studiojnë e t'i hulumtojnë ajetet kuranore, në mënyrë që të forcojnë bindjen se Allahu xh.sh. është Krijuesi i vërtetë i kësaj gjithësie, për se flasin edhe shumë ajete kuranore.

- Argumenti i tretë sipas tyre, është se, nëse i Dërguari i Allahut do t'ua kishte sqaruar ashabëve të gjitha kuptimet e Kur'anit, atëherë ç'domethënie do të kishte duaja e tij që e kishte bërë për Ibn Abbasin, kur ishte lutur për të: “O Zot, bëje të dijshtëm në çështjet e fesë dhe mësoja komentimin.”¹¹

¹⁰ Ibn Tejmije “Mukaddimetu fi Usuli et-Tefsir”, fq. 6

¹¹ Transmeton Buhariu në kapitullin “Mbi biografinë e Ibni Abbasit” (2/306)

Sipas këtij grupi të dijetarëve, nëse i Dërguari a.s. do ta kishte sqaruar krejt Kur'anin, atëherë përse do ta veçonte me këtë dua Ibn Ab-basin?

Mendimi i dijetarëve bashkëkohorë rreth argumenteve të këtyre grupeve

Pas analizës dhe studimit të argumenteve të të dyja grupeve, edhe dijetarët bashkëkohorë kanë dhënë mendimin e tyre në lidhje me këtë çështje. Ajo që është me rëndësi të ceket në këtë rast, është fakti se të gjithë dijetarët bashkëkohorë janë bashkuar në çështjen se për të Dërguarin e Allahut nuk kishte ndonjë paqartësi rreth kuptimeve të Kur'anit, sepse ato ia mësonte Allahu xh.sh. nëpërmjet vahjit. Në anën tjetër edhe pse ashabët i kuptonin përgjithësisht nga aspekti gjuhësor tekstet kuranore, megjithatë rreth disa çështjeve të fshehta, ishin të pafuqishëm të gjenin ndonjë përgjigje. Mirëpo, fatmirësisht, në mesin e tyre gjendej i Dërguari i Allahut, i cili aty për aty ua sqaronte atë që nuk e kishin të qartë, sepse për një gjë të tillë edhe urdhërohej nga i Plotfuqishmi..

Ndërsa, sa i përket qëndrimit të dijetarëve bashkëkohorë ndaj argumenteve të të dyja grupeve, mund të themi se këta të fundit kanë marrë një qëndrim të mesëm, duke u ikur dy skajshmërive të theksuara dhe duke u munduar të gjejnë një mesatare dhe pajtueshmëri mes këtyre mendimeve, gjë që deri diku edhe e kanë arritur.

Mendimet e tyre rreth argumenteve të grupit të parë

- Dijetarët bashkëkohorë, si kundërpërgjigje ndaj argumentit të parë të grupit që thonë se i Dërguari i Allahut ua ka sqaruar ashabëve të gjitha kuptimet e ajeteve kuranore, thonë: *“Sa i përket argumentit të parë të Ibn Tejmiyes dhe të atyre që e përkrahin atë në lidhje me kuptimin e ajetit: “li tubejjine lin-nasi ma nuzzile ilejhin”- “që t’ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre”, mund të konstatojmë se nuk është argumentim me vend, sepse kjo urdhëresë nga Allahu xh.sh. për Pejgamberin a.s., që t’ua shpjegonte njerëzve atë që u është zbritur, nënkupton në radhë të parë sqarimin e atyre ajeteve, që ashabët i kuptonin më me vështirësi, e këto ishin ajetet dispozita dhe ato*

“metashabih”- të cilat kërkonin edhe disa sqarime shtesë, por jo edhe ajetet që ishin të pakapshme për mendjet e asaj kohe, e ajete të tilla në Kur’an ka shumë.”

- Në lidhje me argumentin e tyre të dytë, dijetarët bashkëkohorë kanë këtë kundërpërgjigje: *“Sa i përket asaj që është transmetuar nga Othmani dhe Ibn Mes’udi r.a., se nuk kalonin në ajetet e tjera pa i mësuar ato dhjetë të parat, as kjo nuk argumenton se i Dërguari a.s. u kishte sqaruar atyre të gjitha kuptimet e Kur’anit. Në thënien e dy ashabëve të mëdhenj, vërehet se ata ishin të vëmendshëm që të mos kalonin në ajetet e tjera pa i mësuar me përpikëri dispozitat me të cilat ishin ngarkuar nga i Plotfuqishmi në ajetet paraprake, në mënyrë që ta përsosnin edhe më përkushtimin dhe devotshmërinë e tyre.”*

- Kurse, sa i përket argumentit të tyre të tretë, se vetëm ajeti i kamatës kishte mbetur pa u sqaruar në detaje nga i Dërguari i Allahut, dijetarët bashkëkohorë edhe këtë e refuzojnë, sepse kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton faktin se Resulullahu s.a.v.s. i kishte sqaruar të gjitha ajetet kuranore, me përjashtim të ajeteve dispozita, siç thamë më parë, të cilat kishin nevojë të sqaroheshin pak më hollësisht.

Se i Dërguari a.s. nuk ua komentoi ashabëve krejt ajetet kuranore, na flet edhe fakti tjetër, se, pas vdekjes së Resulullahut s.a.v.s., në mesin e ashabëve aty-këtu kishte mendime të ndryshme rreth kuptimit të ndonjë ajeti të caktuar. Natyrisht, po të kishin pasur ndonjë tekst të cituar nga i Dërguari i Allahut rreth atij ajeti, sigurisht që nuk do të lindnin mospajtime pas vdekjes së tij.¹²

Mendimet e tyre rreth argumenteve të grupit të dytë

Sa u përket argumenteve të grupit të dytë, të cilët thonë se Pejgamberi a.s. nuk ua ka sqaruar ashabëve të gjitha kuptimet e ajeteve kuranore përveç një numri të vogël të tyre, dijetarët bashkëkohorë, argumentin e parë të tyre e konsiderojnë si të pabazë, sepse hadithi i cituar sipas tyre, është i klasifikuar nga dijetarët si *“hadith i papranueshëm dhe i panjohur”*, për arsye se është transmetuar nga

¹² Dr. Muhammed Husejn Edh-Dhehebi *“Et-Tefsir vel mufessirune”*, vëll. I, fq. 53, Kajro 1985

Muhammed bin Xha'fer Ez-Zubejri, i cili nuk është i besueshëm nga dijetarët e hadithit.

- Kurse, sa u përket dy argumenteve të tjera të këtij grupi, edhe dijetarët bashkëkohorë mendojnë se janë më të fuqishëm në argumentim sesa argumentet e grupit të parë, dhe i pranojnë pa ndonjë hezitim. Kurse në fjalën e tyre përfundimtare lidhur me faktin nëse i Dërguari i Allahut e ka komentuar tërë Kur'anin apo vetëm disa ajete, thonë: *"I Dërguari i Allahut megjithatë nuk e ka sqaruar Kur'anin në tërësi, por i ka sqaruar shumicën e ajeteve dispozita, dhe shumë ajete të tjera, për të cilat ashabët bënin vazhdimisht pyetje. Është fakt se për disa ajete, as i Dërguari i Allahut nuk kishte njohuri të fliste, siç ishin ajetet rreth momentit të Kiametit, ajeti rreth shpirtit dhe të disa gajbijateve të tjera."*¹³

Dijetarët bashkëkohorë këtë konstatim të tyre e mbështetin edhe në një thënie nga Ibn Abbasi, i cili ka thënë: *"Tefsiri është katër llojesh: Një prej tyre është që arabët e njohin prej vetë fjalëve-sinonimeve të tyre, tjetri është ai të cilin e kuptojnë njerëzit nga vetë natyra dhe inteligjenca e tyre e lindur (fitreja), pastaj është tefsiri, që e kuptojnë dhe e zbërthejnë vetëm dijetarët, dhe tefsiri që nuk e di askush tjetër përveç Allahut."*¹⁴

Në anën tjetër, një grup dijetarësh bashkëkohorë me Dr. Xhemal Mustafa Abdulhamid en-Nexh-xhar në krye, vihen në mbrojtje të Ibn Tejmijes, duke thënë se fjalët e këtij dijetari të madh janë keqkuptuar nga Imam Sujutiu dhe nga Dr. Dhehebiu, sepse nga fjalët e Ibn Tejmijes, nuk mund të kuptohet assesi që ai ishte ihtar i mendimit se i Dërguari i Allahut ua ka sqaruar ashabëve të tij të gjitha kuptimet e Kur'anit.

Si argument për këtë konstatim të tij, dr. Xhemal en-Nexh-xhari sjell vetë mendimin e Ibn Tejmijes rreth burimeve të tefsirit tradicional kur thotë: *"...Nëse në Kur'an dhe Synet nuk gjejmë komentim në lidhje me ndonjë çështje, atëherë kthehemi tek fjalët e ashabëve, sepse këta, pas dy burimeve të para, ishin njohësit më të mirë të Librit të Allahut, sidomos dijetarët dhe më të mëdhenjtë prej tyre."*¹⁵

¹³ *"Et-Tefsir vel mufessirune"*, vëll. I, fq. 55

¹⁴ Mennaul Kattan - *"Mebahith fi ulumil Kur'an"*, fq.260-261, Kajro 1995

¹⁵ Ibn Tejmije *"Mukaddime fi Usuli-tTefsir"*, fq. 93.

Dr. Nexhari thotë se *"sikur Ibn Tejmije të insistonte me ngulm në pohimin se i Dërguari a.s. e ka komentuar tërë Kur'anin, atëherë nuk do ta sillte këtë mendim në lidhje me komentimet e ashabëve"*¹⁶, dhe në fund sjell këtë konstatim: *"Duke i bashkuar fjalët dhe mendimet e Ibn Tejmijes në lidhje me këtë çështje, e jo duke i ndarë ato me përzgjedhje, mund të përfundojmë se mendimi përfundimtar i Ibn Tejmijes është se i Dërguari i Allahut nuk e ka komentuar tërë Kur'anin prej fillimit e deri në fund, fjalë për fjalë, madje as shumicën e tij, dhe jo ashtu siç i kanë kuptuar fjalët e tij Imam Sujutiu dhe dr. Dhehebiu si dhe ata që i përcollën fjalët e këtyre dy dijetarëve pas tyre. Allahu i mëshiroftë dijetarët tanë të mëhershëm, këta të sotmit dhe ata që do të vijnë pas nesh. S'ka dyshim se secili prej tyre do të shpërblehet në bazë të njetit dhe përpjekjeve të tij."*¹⁷

Për ç'arsye Muhammedi a.s. nuk e komentoi Kur'anin në tërësi

Po të donte Allahu xh.sh. që këtë Kur'an ta komentonte dikush prej njerëzve, me një komentim përfundimtar, pas të cilit të mos kishte nevojë për ndonjë komentim shtesë, sigurisht që kjo meritë dhe ky nder do t'i takonte të Dërguarit të fundit të Allahut, Muhammedit a.s.. Kjo megjithatë nuk ndodhi, sepse i Dërguari i Allahut, ashabëve u komentoi, sipas nevojës, vetëm disa pjesë kuranore. Në këto komentime-sqarime të Pejgamberit a.s. bëjnë pjesë ajetet dispozita, me të cilat obligoheshin besimtarët, dhe disa nga ajetet që kishin të bënin me urdhëresat dhe ndalesat hyjnore etj. Mund të shtrohet pyetja: Për ç'arsye i Dërguari i Allahut nuk e ka sqaruar-komentuar tërë Kur'anin në të gjallë të tij?

Në lidhje me këtë çështje, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Dijetari më i njohur bashkëkohor, Muhammed Mutevel-li Sha'ravi, jep këtë përgjigje: *"Aftësitë mendore-logjike të njerëzve në kohën e zbritjes së Shpalljes nuk ishin në gjendje të absorbonin kuptimet e të gjitha mistereve që përmbajnë fjalët e Allahut, dhe për këtë*

¹⁶ Dr. Xhemal Mustafa Abdul Hamid en-Nexhar *"Menahixh tefsirije"*, fq. 100-101, Kajro, 2000.

¹⁷ *"Menahixh tefsirije"*, fq. 103.

arsye ai nuk i rëndoi ashabët me gjëra që nuk përputheshin me realitetin e kohës dhe me aftësinë e tyre mendore. Ishte kjo një prej urtësive më të mëdha hyjnore, sepse Allahu i Madhërishëm deshi që çdo gjeneratë të shuajë etjen në detin e pafund të ëmbëlsisë kuranore.”¹⁸

Pra, Allahu xh.sh. deshi që në fjalën e Tij të fundit të zbritur për mbarë njerëzimin – në Kur’an, të përfshinte një thesar të tërë urtësish e sekretesh të Universit, të cilat do të mund t’i kuptonin e deshifronin vetëm gjeneratat e mëvonshme, të cilave do t’ua mundësojë këtë nëpërmjet zbulimeve të mirëfillta shkencore, në mënyrë që të gjithë të binden se ky Kur’an vërtet është fjalë e Allahut dhe mrekulli deri në ditën kur do të dalim para Madhërisë së Tij. Ja se ç’thotë Allahu xh.sh.:

سُرِّيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّى يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ
أَنَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ

“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri sa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fussilet, 53)

Në Kur’an ka shumë ajete që flasin për disa mrekulli shkencore që janë zbuluar vetëm në këta dy shekujt e fundit. Natyrisht që gjeneratat e mëhershme nuk kanë qenë në gjendje t’i deshifronin këto ajete, por me kalimin e kohës ato u bënë realitet i dukshëm. Sa për ilustrim, po cekim vetëm shkurtimisht se në Kur’an flitet për formën eliptike të Tokës (shih ajetet: *El-Hixhr*, 19, dhe *En-Naziat*, 30); për lëvizjen e Tokës rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit (shih ajetin *En-Neml*, 88); për lëvizjet e planeteve rreth orbitave të përcaktuara (shih: *Jasin*, 38-40); pastaj flitet rreth gravitacionit të planetëve (shih: *Er-Rr’ad*, 2). Në anën tjetër Kur’ani flet edhe rreth etapave zhvillimore nëpër të cilat kalon embrioni në barkun e nënës (shih ajetet: *El-Mu’minun*, 12-14) dhe në shumë ajete të tjera bëhet fjalë për gjëra të tilla, para të cilave shkenca dhe njerëzimi mbeten të mahnitur.

Nga gjithë kjo që u tha rreth këtyre ajeteve, mund të përfundohet se i Dërguari a.s. nuk ua ka shpjeguar ashabëve të tij të gjitha kuptimet e ajeteve kuranore. Atyre u mjaftonte sqarimi i dispozitave që kishin të bënin me besimin, legjislacionin dhe normat morale. Nga kjo shihet se Allahu xh.sh. i kurseu mendjet e tyre nga stërngarkesa, sepse kjo ishte një prej urtësive të Tij, që çdo brez a gjeneratë të përfitojë nga Kur’ani famëlartë dhe nga të vërtetat e pakontestueshme të tij.

Mirëpo, shtrohet pyetja: A thua ç’do të ndodhte sikur i Dërguari i Allahut ta kishte komentuar tërë Kur’anin dhe prej tij të kishte zbuluar e nxjerrë të gjitha urtësitë dhe të kishte shkoqitur detajet?!

Përgjigjja është se, sikur i Dërguari i Allahut të bënte një gjë të tillë, atëherë sigurisht që do të ndodhte një prej këtyre dy gjërave:

- Ose kjo botë do të ndalej nga ripërtëritja (përparimi) në formën që ka dëshiruar Allahu;

- Ose kuptimet e Kur’anit fisnik do të ngurtësoheshin e më nuk do të ishin joshëse e as tërheqëse për dikë, meqenëse askush më nuk do të kishte të drejtë të shtonte ndonjë koment tjetër mbi komentin e të Dërguarit të Allahut.

Për fat të mirë, nga mëshira e Allahut për robërit e Tij, asnjëra prej këtyre nuk ndodhi, sepse i Larmadhërishmi i dha rast mendjes njerëzore që të thellohet në dije e në njohuri, që nga ky Kur’an, që është mrekulli e përrjetshme, të nxjerrë thesarin e çmueshëm të dijes e të njohurive.¹⁹

Në anën tjetër, dijetari tjetër bashkëkohor, dr. Muhamed Sejid Xhibril, në fjalën e tij të fundit gjatë shtjellimit të çështjes nëse Kur’ani është komentuar në tërësi nga Pejgamberi a.s. apo jo, thotë: “Disa kuptime të Kur’anit në të kuptuarit dhe në të komentuarit e tyre janë lënë të tilla, në mënyrë që dijetarët nëpër kohë, në bazë të ixhtihadit të tyre pas hulumtimeve dhe studimeve të mirëfillta, të nxjerrin kuptimet e dëshiruara dhe të synuara, në mënyrë që shkencat islame të mbeten gjithmonë të gjalla e të ripërtërihen...”²⁰

Dhe, vërtet, nëse bota vazhdon me këtë trend të zhvillimit teknologjik, sigurisht se do të bëhen edhe shumë zbulime kolosale, por me

¹⁹ Muhamed. M. Sha’ravi, “*Havatiri havlel Kur’anil Kerim*”, fq. 38

²⁰ Dr. Muhammed Sejid Xhibril “*Med-hal ila menahixh el mufessirin*”, fq.40, Kajro, 1987.

¹⁸ Muhammed M. Sha’ravi, “*Havatiri havlel Kur’anil Kerim*”, fq. 35, Kajro 1988.

siguri, çdo zbulim i mirëfilltë shkencor, patjetër që do të ketë mbështetje të fortë edhe në ndonjë prej ajeteve kuranore, sepse, meqë Kur'an-i është fjalë e Allahut, atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta as në të kaluarën dhe as në të ardhmen:

لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ تَنْزِيلٌ مِنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ

“Atij (Kur'anit) nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit” (Fussilet, 42).

Disa shembuj të komentimeve-sqarimeve nga Resulullahi s.a.v.s., bërë disa ajeteve kuranore

(El-Fatiha)

- Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu e gjithashtu edhe Ibn Hibbani në Sahihun e tij nga Adij bin Hibbani, të ketë thënë: I Dërguari i Allahut rreth ajetit 7 të kaptinës *El-Fatiha*:

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

“...e jo në të atyre ndaj të cilëve je i hidhëruar, dhe që kanë humbur!”

ka thënë: “Ata ndaj të cilëve është i hidhëruar Allahu, janë hebrenjtë, kurse të humburit janë të krishterët.”

- Po ashtu transmeton Ibn Merdevije nga Eba Dherr el Gaffariu të ketë thënë: E pyeta të Dërguarin e Allahut për fjalët: **“El magdubi alejhim”** – **“Ata ndaj të cilëve është i hidhëruar Allahu”** e më tha: **“Këta janë hebrenjtë”**. I thashë: po **“Ed-dal-lin”** – **“Të humburit”**, më tha: **“Këta janë të krishterët.”**

(El-Bekare)

- Transmeton Taberaniu nga Ebi Emame të ketë thënë: I Dërguari i Allahut për ajetin kuranor:

الْحُجَّ أَشْهُرُ مَعْلُومَاتٍ

“Haxhi është në muajt e caktuar...” (El-Bekare, 197)

ka thënë: “Këta muaj janë: Shevvali, Dhul Ka'de dhe Dhul Hixhe”.

- Transmeton Taberaniu me sened të pranueshëm nga Ibn Abbasi të ketë thënë: I Dërguari i Allahut në lidhje me ajetin:

فَلَا رَفَثَ وَلَا فُسُوقَ وَلَا جِدَالَ فِي الْحَجِّ

“(Ai që është duke e kryer Haxhin) nuk duhet t'i afrohet gruas, nuk bën të marrë nëpër këmbë dispozitat e Sheriatit, as nuk duhet të shkaktojë grindje.” (El-Bekare, 197)

ka thënë: **“Er-Rrefethu”** është t'u afroresh grave për marrëdhënie intime gjatë ditëve të Haxhit; **“El Fusuka”**, janë mëkatet-gabimet, kurse **“El Xhidalu”** është kur dikush grindet dhe polemizon me shokun e vet.”

- Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibn Hibbani nga Ibn Mes'udi të ketë thënë, në lidhje me ajetin 238 të kaptinës *El-Bekare*:

حَافِظُوا عَلَى الصَّلَوَاتِ وَالصَّلَاةِ الْوُسْطَى وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ

“Vazhdoni (të falni) rregullisht namazet, e edhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj All-llahut të jeni respektues (në namaze).”

ka thënë Resulullahu s.a.v.s. **“Salatul vusta”**- është namazi i ikindisë.”

- Në lidhje me të njëjtin transmetim, por nga rrugë të tjera të isnadeve, transmetojnë edhe Ahmedi e Tirmidhiu nga Semurete, pastaj Ibn Xheriri nga Ebu Hurejre dhe Ebi Malik El-Esh'ariu etj.

(Ali-Imran)

- Transmeton Hakimi nga Enesi r.a. të ketë thënë: Është pyetur i Dërguari a.s. për ajetin 97 të kaptinës *Ali-Imran*:

وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنْ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا

“Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo...”

se ç'është **“Sebil”**?, e ai tha: **“Sebil”** - është mundësia materiale (ushqimi i mjaftueshëm që merr me vete dhe ai që i lë familjes derisa të kthehet nga Haxhi, - (sqarim yni) dhe mjeti i udhëtimit.”

(El-En'am)

- Transmetojnë Ahmedi, Buhariu, Muslimi dhe të tjerët nga Ibn Mes'udi, të ketë thënë: Kur zbriti ajeti:

الَّذِينَ آمَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ ۖ أُولَٰئِكَ هُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ مُهْتَدُونَ

“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.” (El-En'am, 82)

shumë njerëzve u erdhi rëndë, prandaj u brengosën dhe i thanë Resullullahut s.a.v.s.: O i Dërguar i Allahut, a thua cili prej nesh nuk i bën mizori-padrejtësi vetvetes?

Atëherë Muhammedi a.s. ua ktheu: “Kjo nuk ka të bëjë me atë që po mendoni ju, a nuk keni dëgjuar se ç’ka thënë njeriu i urtë (Llukmani duke e këshilluar të birin, fjalët e të cilit janë cekur në Kur'an, - sqarim yni):

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ

“(I kujto popullit tënd) Kur Llukmani, duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i bëj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.” (Llukman, 13),

...pra mizoria (padrejtësia më e madhe) është shirku.”

- Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu nga Ebi Seidi e ky nga Pejgamberi a.s. të ketë thënë në lidhje me ajetin:

لَمْ تَكُنْ آمَنْتَ مِنْ قَبْلُ يَوْمَ يُأْتِي بَعْضُ آيَاتِ رَبِّكَ لَا يَنْفَعُ نَفْسًا إِيْمَانُهَا

“(në) ditën kur vijnë disa shenja të Zotit tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i Tij nëse nuk ka besuar më parë” (El-En'am, 158),

“Kjo ditë është kur dielli lind nga Perëndimi.”

Ky hadith ka edhe shumë rrugë të tjera të sakta të transmetimit, të cekura edhe në Sahihun e Buhariut edhe në atë të Muslimit nga Ebu Hurejra e të tjerët.

- Transmeton Taberaniu dhe të tjerët, me sened të mirë, nga Omer ibn Hattabi të ketë thënë: I Dërguari i Allahut në lidhje me ajetin:

إِنَّ الَّذِينَ فَرَّقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا لَسْتَ مِنْهُمْ فِي شَيْءٍ إِنَّمَا أَمْرُهُمْ إِلَى اللَّهِ ثُمَّ يُنَبِّئُهُم بِمَا كَانُوا يَفْعَلُونَ

“Vërtet ndaj atyre që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm te All-llahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan.” (El-En'am, 159)

i ka thënë Aishes: “Këta janë ata që sjellin risi dhe pasojnë epshin-egon”.

- Në lidhje me këtë ajet, Taberaniu me isnad të saktë e të shëndoshë, transmeton edhe nga Ebu Hurejra të ketë thënë: “Ka thënë i Dërguari i Allahut: “Këta janë ata që sjellin risi (të dëmshme), dhe janë pasuesit e epsheve e të mendimeve të kota, nga ky Ymet.”

(El-A'ëraf)

Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi, Hakimi dhe të tjerët nga Ber-rra'e bin Azibi të ketë thënë: I Dërguari i Allahut s.a.v.s., duke folur për momentin e marrjes së shpirtit të pabesimtarit, ka thënë: “... Ndërsa, kur pabesimtarit t'i jetë afruar fundi i jetës në këtë botë, për të kaluar në Ahiret, nga qielli zbresin melaiket e tmerrshme të ndëshkimit, me fytyra të zeza e të vrenjtura, dhe me vete sjellin rroba të vrazhda (ferra-ferra) të Xhehennemit dhe ulen para tij; pastaj vjen meleku i vdekjes dhe i ulet te koka duke i thënë me vrazhdësi: “O shpirt i keq (i ndyrë). Dil (shko) në hidhërimin dhe dënimin e Allahut. Në ato çaste shpirti i pabesimtarit nxirret me vështirësi, sikurse gërrhanët që me vështirësi nxirren nga leshi i lagur, dhe menjëherë e mbështjellin me ato rroba të vrazhda të Xhehennemit, duke kundërmuar erë më të rëndë e më të keqe se të çfarëdo coftine në fytyrë të tokës. Pastaj ky shpirt i keq ngrihet në hapësirat qiellore dhe në çdo grup të melaikeve që hasin, ato pyesin: Cili është ky shpirt i keq e i ndyrë? U thuhet: filan filani, duke e thirrur me emrat më të këqij me të cilët e kanë thirrur në këtë botë, derisa të mos arrijë te qielli i kësaj bote, kur kërkohet leje për të vazhduar më tutje (më lart) me të, por këtë shpirti të keq nuk i lejohet të shkojë më tutje në sferat e larta qiellore, dhe pastaj i Dërguari a.s. e lexoi këtë ajet kuranor:

إِنَّ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَاسْتَكْبَرُوا عَنْهَا لَا تُفَتِّحُ لَهُمْ أَبْوَابُ السَّمَاءِ وَلَا يَدْخُلُونَ
الْجَنَّةَ حَتَّى يَلِجَ الْجَمَلُ فِي سَمِّ الْخِيَاطِ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُجْرِمِينَ

“Nuk ka dyshim se ata që përgënjeshtroan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, të tillëve nuk u hapen dyert e qiellit dhe ata nuk do të hyjnë në Xhennet derisa të përbirojnë deveja nëpër vrimën e gjilpërës. Ja, kështu i shpërblejmë kriminelët” (El-A’ëraf, 40)

...dhe pastaj i Dërguari i Allahut vazhdoi: “Allahu i urdhëron melai- ket: Shkruani librin (emrin) e tij në regjistrin Sixh-xhin (libri i xhehe- nnemlinjve), në fund të tokës.

Pastaj melaiKET shpirtin e tij e hedhin me rrëmbim e forcë poshtë në tokë... Më pastaj i Dërguari a.s. lexoi këtë ajet kuranor:

وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنَ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ
الطَّيْرُ أَوْ تَهْوِي بِهِ الرِّيحُ فِي مَكَانٍ سَحِيقٍ

“...E kush i bën shok Allahut, ai është sikur të bjerë nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin era e stuhishme e hedh në ndonjë vend të humbur” (El-Haxh-xh, 31)

(El-Enfal)

- Transmeton Ebu Shejhi nga Ibn Abbasi ta këtë dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke komentuar ajetin:

وَاذْكُرُوا إِذْ أَنْتُمْ قَلِيلٌ مُسْتَضْعَفُونَ فِي الْأَرْضِ تَخَافُونَ أَنْ يَتَخَطَّفَكُمُ النَّاسُ فَآوَاكُمْ
وَأَيَّدَكُمْ بِنَصْرِهِ وَرَزَقَكُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“Rikujtoni kur ishit pakicë e të dobët në tokë, dhe frikësoheshit se do t’ju rrëmbenin njerëzit (idhujtarët), e Ai ju mundësoi vend të sigurt (në Medinë) dhe ju përkrahu me ndihmën e Tij, ju furnizoi me të mira, që të jeni mirënjohës.” (El-Enfal, 26)

Shokët e pyetën se kush janë këta njerëz nga të cilët kishim frikë. I Dërguari a.s. u përgjigj: “Këta janë persianët.”

- Transmeton Tirmidhiu nga Ebi Musa el Esh-ariu të këtë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: “Allahu m’i zbriti dy siguri për ymetin tim, dhe lexoi ajetin 33 të sures El-Enfal:

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ وَأَنْتَ فِيهِمْ وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Po All-llahu nuk do t’i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) të jesh në mesin e tyre dhe All-llahu nuk do t’i dënojë, derisa ata të kërkojnë falje (istigfar).”

Pastaj tha: “Kur të kaloj unë nga kjo botë, ymetit tim do t’ia lë istigfarin deri në Ditën e Gjykimit.”

- Transmeton Muslimi dhe të tjerët nga Ukbe bin Amir të këtë thënë: E kam dëgjuar Resulullahun s.a.v.s. derisa ishte në minber pasi që lexoi ajetin kuranor:

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ
وَالْآخَرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhetojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata...” (El-Enfal, 60)

tha: “Forca (në këtë rast) është hedhja me shigjetë (me mjet lufte).”

(Et-Tevbe)

Transmetojnë Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Hibbani dhe Hakimi nga Ebu Seid el Huderiu të këtë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut: “Kur të shihni ndonjë njeri që vjen rregullisht në xhami, dëshmoni për imanin e tij, sepse Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللَّهِ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَحْشَ
إِلَّا اللَّهَ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَنْ يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ

“E drejtë e përkujdesjes së xhamive të All-llahut është vetëm e atij që i ka besuar All-llahut dhe ditës së mbramë e që e fal namazin,

jep zekatin e nuk i frikësohet askujt pos All-llahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë)." (Et-Tevbe, 18)

- Transmeton Muslimi dhe të tjerët nga Ebi Seidi, të ketë thënë: "Dy njerëz nuk pajtoheshin dot mes vetes lidhur me atë se çfarë kishte për synim ajeti 108 i sures Et-Tevbe:

لَمَسْجِدٍ أُسِّسَ عَلَى التَّقْوَى مِنْ أَوَّلِ يَوْمٍ أَحَقُّ أَنْ تَقُومَ فِيهِ

"Një xhami e cila që prej ditës së parë është themeluar për respektin ndaj Allahut (pa hile), është më e drejtë të falesh në të"

Njëri prej tyre thoshte se fjala është për xhaminë e Pejgamberit a.s. në Medinë, kurse tjetri thoshte se fjala është për xhaminë në Kuba. Pastaj që të dy erdhën tek i Dërguari a.s. dhe e pyetën në lidhje me këtë, e ai u dha këtë përgjigje: "Në këtë ajet është fjala për xhaminë time (në Medinë) – (sqarim yni)."

(Junus)

- Transmeton Muslimi nga Suhejbi e ky nga i Dërguari a.s. të ketë thënë në lidhje me fjalët e Allahut:

لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ

"Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xhenneti) po edhe më tepër (e shohin All-llahun)..." (Junus, 26)

"fjala **"husna"** d.m.th. Xhenneti, kurse **"zijadeh"** do të thotë "shikimi i Allahut xh.sh.."

- Në lidhje me këtë ajet, po ashtu transmeton Ibn Merdevije nga Ibn Omeri r.a. e ky nga Resulullahu s.a.v.s., të ketë thënë: **(Lil-ledhi-ne ahsenu)** - janë ata që kanë dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut", **(el-husna)** është Xhenneti, kurse **(ez-zijadeh)** është shikimi në Allahun xh.sh."

- Transmeton Ebu Davudi dhe të tjerët nga Omer ibn Hattabi të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut: "Është një kategori njerëzish prej robëve të Allahut, të cilëve ua kanë lakmi pejgamberët dhe dëshmorët". I thanë: Cilët janë ata, o i Dërguar i Allahut?, Ai tha: "Këta janë ata njerëz që janë dashur në mes vete vetëm për hir të Allahut, pa interes të pasurisë a të prejardhjes. Këta njerëz nuk do të

frikësohen e as nuk do të dëshpërohen atë ditë kur njerëzit do të frikësohen e do të dëshpërohen" e pastaj lexoi ajetin 62 të sures Junus

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) dhe as kurrfarë brengosjeje"

- Në lidhje me këtë ajet, po ashtu transmeton Ibn Merdevije nga Ebu Hurejre të ketë thënë: Është pyetur i Dërguari i Allahut për fjalët e Kur'anit:

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosjeje" (Junus, 62)

kurse përgjigjja e tij ishte: "Këta janë ata që duhen në mes vetes vetëm për hir të Allahut xh.sh."

- Transmetojnë Ahmedi, Seid bin Mensuri, Tirmidhiu dhe të tjerët nga Ebu Derdaja, i cili, kur ishte pyetur rreth komentimit të ajetit 64 të kaptinës Junus:

لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ

"Atyre u jepen myzhde në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër (për hyrje në Xhennet)...",

kishte thënë: Nuk më ka pyetur për këtë askush që kur e kam pyetur Resulullahun s.a.v.s. për të dhe atëherë më pati thënë: "O Ebu Derda, prej se ka zbritur ky ajet, pos teje, nuk më ka pyetur askush rreth këtij. Kjo është ëndrra e mirë (ru'ja) që sheh muslimani në gjumë, ose dikush e sheh për të. Pra, kjo është përgëzimi për të në jetën e kësaj bote, kurse përgëzimi për botën e ardhshme, është Xhenneti."

(Ibrahim)

- Transmetojnë Tirmidhiu, Nesaiu, Hakimi, Ibn Hibbani dhe të tjerët nga Enesi r.a. e ky nga Resulullahu s.a.v.s. të ketë thënë, në lidhje me ajetin 24 të sures Ibrahim:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ
وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ

“A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë rrënjët e së cilës janë thellë (në tokë) e degët janë lart”

“ajo është pema e hurmës”,
kurse për ajetin 26 të po kësaj sureje:

وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ اجْتُثَّتْ مِنْ فَوْقِ الْأَرْضِ مَا لَهَا مِنْ قَرَارٍ

“Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar”

ka thënë: “ajo është **handhali** – kungulli i egër e i idhët (bot. Citrullus colocynthis)”.

- Lidhur me ajetin 24 të sures Ibrahim

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا
ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ

“A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart”,

kemi edhe një komentim tjetër, të cilin e transmetojnë Ahmedi, Ibn Merdevije me sened të mirë nga Ibn Omeri, e ky nga Resulullahu a.s.v.s. të ketë thënë: “Kjo është pema e hurmës, së cilës nuk i pakësohen (nuk i bien) fletët”.

- Transmetojnë të gjithë autorët e koleksioneve të hadithit nga Berra’ë bin Azibi e ky nga Pejgamberi a.s. të ketë thënë: “Kur muslimani pyetet në varr, dëshmon se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe Muhammedi është i dërguar i Tij. Ky është sqarimi i fjalëve të Allahut:

يُثَبِّتُ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ وَيُضِلُّ اللَّهُ
الظَّالِمِينَ . وَيَفْعَلُ اللَّهُ مَا يَشَاءُ

“Allahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të dëshmisë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur. Allahu punon çka të dojë.” (Ibrahim, 27)

- Transmeton Muslimi nga Thevbani të ketë thënë: I erdhi të Dërguarit të Allahut një rabin çifut dhe e pyeti: Ku do të jenë njerëzit në momentin për të cilin flet ajeti 48 i kaptinës Ibrahim:

يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَاوَاتُ وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ

“Ditën kur Toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt (në të tjerë qiej), e ata (njerëzit) të gjithë dalin sheshazi para Allahut, Një, Mbizotërues.”,

për se Resulullahu iu përgjigj: “Do të jenë në errësirë të plotë, mu para urës (së Siratit)” – (sqarim yni).

- Transmetojnë Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe të tjerët nga Aishja r.a. të ketë thënë: “Jam njeriu i parë që e kam pyetur të Dërguarin e Allahut rreth këtij ajeti (d.t.th. rreth ajetit 48 të kaptinës Ibrahim):

يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَاوَاتُ وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ

“Ditën kur Toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt (në të tjerë qiej), e ata (njerëzit) të gjithë dalin sheshazi para All-llahut, Një, Mbizotërues.”,

se ku do të jenë njerëzit në ato momente, o i Dërguar i Allahut? Ai tha: “Do të jenë mbi urë (Sirat).”

(El-Hixhr)

- Transmetojnë Taberaniu, Ibn Merdevije dhe Ibn Hibbani nga Ebu Seid el Huderiu, i cili është pyetur nga disa njerëz nëse e kishte dëgjuar të Dërguarin a.s. të fliste diçka rreth ajetit 2 të kaptinës El-Hixhr:

رُفَا يَوْمَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْ كَانُوا مُسْلِمِينَ

“Ata që nuk besuan, shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë muslimanë.”

e ai tha: Po e kam dëgjuar Resulullahun tek thotë në lidhje me këtë ajet: “Allahu do t’i nxjerrë disa njerëz besimtarë nga zjarri pasi ta kenë marrë dënimin për atë që i ka shtyrë të futeshin në Xhehennem, tok me idhujtarët. Më parë idhujtarët do t’i drejtohen këtij grupi me fjalët nënçmuese: Ju thoni që keni qenë të dashurit e Allahut në jetën e dynjasë, atëherë përse jeni këtu me ne në zjarr?” Kur Allahu dëgjon këtë bisedë të tyre, jep leje që dikush të ndërmjetësojë për ta, dhe në ato momente ndërmjetësimi vjen nga të gjitha anët: nga melaiket, nga pejgamberët dhe nga besimtarët e mirë, derisa të gjithë ata besimtarë që kishin bërë ndonjë mëkat (me të cilin kishin merituar zjarrin e Xhehennemit përkohësisht, - sqarim yni), të nxirren e të dalin nga Xhehennemi me lejen e Allahut. Në ato çaste idhujtarët thonë nga dhembja: Ah sikur të ishim sikur këta (të ishim muslimanë, qoftë edhe mëkatarë) dhe të na arrinte shefati (ndërmjetësimi) edhe neve e të kishim dalë së bashku me ta.”

Ky hadith nga rrugë të tjera të transmetimit transmetohet edhe nga Ebi Musa el Esh’ariu, Xhabir bin Abdil-lahu dhe Aliu r.a.

(El-Isra’ë)

Transmeton Tirmidhiu, kurse Nesaiu e vërteton saktësinë e thënies nga Ebu Hurejra e ky nga i Dërguari i Allahut të ketë thënë në lidhje me fjalët e Allahut:

إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا

“Vërtet, lutja e agimit është e përcjellë.” (El-Isra’ë, 78)

“Për këtë (këndimin e Kur’anit në namazin e sabahut) dëshmojnë melaiket e natës dhe ato të ditës.”

- Transmetojnë Ahmed i dhe të tjerët nga Ebu Hurejre të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. në lidhje me ajetin 79 të kapitlës El-Isra’ë:

وَمِنَ اللَّيْلِ فَتَهَجَّدْ بِهِ نَافِلَةً لَكَ عَسَى أَنْ يَبْعَثَكَ رَبُّكَ مَقَامًا مَحْمُودًا

“Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të (me Kur’anin-namazin), është e sigurt se Zoti yt do të ngrejë ty në një vend të lavdishëm.”

“Ky është vendi (i lavdishëm), nga i cili do të më mundësohet të ndërmjetësoj për Ymetin tim.”, ndërsa në një version tjetër: “ky është (shefati) ndërmjetësimi.”

(El-Kehf)

- Transmeton Ahmed i nga Ebi Seid el Huderiu e ky nga Resulullahu s.a.v.s. që në lidhje me ajetin:

الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ
عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.” (El-Kehf, 46),

të ketë thënë: “Këto janë: **tekbiri**, (fjala Allahu ekber, sqarim yni), **tehlili** (fjala La ilahe il-la Allah), **tesbihi** dhe **hamdi** (fjalët: Subhanallahi vel hamdu lil-lahi ve la ilahe il-la Allahu vallahu ekber) dhe: **havleka** (fjalët La havle ve la kuvvete il-la bil-lah)”.

- Po ashtu transmeton Ahmed i nga Nu’mān bin Beshiri e ky nga Pejgamberi a.s. të ketë thënë: “Subhanallahi, vel hamdu lil-lahi, ve la ilahe il-la Allahu, vallahu ekber”, janë **“El-Bakijatu es Salihatu.”**

- Të njëjtin transmetim, porse nga Ebu Hurejra, e transmeton edhe Ibn Xheriri.

(Ta-Ha)

- Transmeton Bezzari me sened të shëndoshë nga Ebu Hurejre e ky nga i Dërguari i Allahut që në lidhje me fjalët e Allahut:

وَمَنْ أَعْرَضَ عَنْ ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا

“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë”, (Ta-Ha, 124)

të ketë thënë: “Ky është ndëshkimi në varr”.

(Es-Sexhde)

- Transmeton Ibn Ebi Hatimi nga Ibn Abbasi e ky nga Pejgamberi a.s. që në lidhje me fjalët e Allahut:

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa dhe nga ajo që Ne u kemi dhënë (pasuri) atyre, ata japin.” (Es-Sexhde, 16)

të ketë thënë: “Kjo është të ngriturit për të falur namaz të natës.”

(Gafir)

- Transmetojnë Ahmedi, Hakimi, Ibn Hibbani dhe autorët e Sune-neve nga Nu'man bin Beshiri të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut: “*Dua*ja është adhuring” e pastaj lexoi fjalët e Allahut:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ

عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhuringit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem”. (Gafir, 60)

(Edh-Dharijat)

- Transmeton Bezzari nga Omer ibnul Hattabi të ketë thënë në lidhje me kuptimin e ajeteve 1, 3 dhe 4 të kaptinës Edh-Dharijat: فَالْجَارِيَّاتِ يُسْرًا – (Edh-Dharijat, 1) janë erërat, وَالذَّارِيَّاتِ دُرُوءًا – (Edh-Dharijat, 3) janë anijet në det, kurse فَالْمُقَسَّمَاتِ أَمْرًا – (Edh-Dharijat, 4) janë melaiket. Po të mos e kisha dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thoshte kështu, as unë nuk kisha thënë.”

(Er-Rrahman)

- Transmeton Begaviu nga Enes ibn Maliku të ketë thënë: E lexoi i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ajetin 60 të kaptinës Er-Rrahman:

هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ

“A mund të jetë shpërblimi i veprës së mirë diçka tjetër, përveçse e mira!”

dhe pastaj na tha: “A e dini se çfarë ka dëshiruar të thotë Zoti juaj?” Ashabët thanë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Atëherë ai tha: “Allahu thotë: A ka shpërblim tjetër për atë që e begatova me besimin në një Zot, përveç Xhennetit.”

(El-Buruxh)

- Transmeton Ibn Xheriri nga Ebi Malik el Esh'ariu të ketë thënë: “Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. në lidhje me ajetet:

وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ وَشَهِيدٍ وَمَشْهُودٍ

“Pasha ditën e premtuar. Pasha atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet!” (El-Buruxh, 2-3)

(El jevmul mev'ud) - “është Dita e Gjykimit, (shahid) - është dita e xhumasë, kurse (mesh'hud) - është dita e Arefatit.”. Ky hadith përcillet edhe nga rrugë të tjera të transmetimit.

(Ez-Zelzeletu)

- Transmeton Ahmedi nga Ebu Hurejra të ketë thënë: “E lexoi Pejgamberi a.s. këtë ajet:

يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا

“Atë ditë, ajo (Toka) i rrëfen tregimet e veta” (Ez-Zelzele, 4)

dhe pastaj na tha: “A e dini se cilat janë lajmet e saj (Tokës)?” Ashabët thanë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Atëherë tha: “Kjo do të thotë se Toka do të dëshmojë për çdo njeri dhe popull, se çfarë punuan mbi sipërfaqen e saj, dhe në Ditën e Gjykimit ajo (Toka) do t'i thotë secilit: Ti ke punuar këtë e këtë në filan ditën, etj.”

(El-Maun)

- Transmetojnë Ibn Xheriri dhe Ebu Ja'la nga Sa'd ibn Ebi Vekasi të ketë thënë: E pyeta Resulullahun s.a.v.s. për ajetin:

الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

“Të cilët janë të shkujdesur (të harrueshëm), për namazin e tyre”
(El-Maun, 5)

e ai më tha: “Këta janë ata që e vonojnë namazin nga koha e tyre.”

(El-Kevther)

- Transmetojnë Ahmedi dhe Muslimi nga Enesi r.a. të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut në lidhje me ajetin e parë të kaptinës “El-Kevther”:

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ

“Ne, vërtet të dhamë ty (o Muhammed), shumë të mira.”

“Kevtheri, është një lum që Allahu ma ka dhënë mua në Xhennet”.

- Ky hadith transmetohet edhe nga rrugë të tjera të shumta të transmetimit.

(En-Nasr)

- Transmeton Ahmedi nga Ibn Abbasi të ketë thënë: “Kur zbriti kaptina:

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ. وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا.

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا

“Pasi (të) erdhi ndihma (fitorja) e Allahut dhe ngadhënjimi (çlirimi i Mekës). Dhe i pe njerëzit duke hyrë grupe-grupe në fenë e Allahut. Atëherë, pra, madhëroje Zotin tënd me falënderim dhe kërko falje prej Tij. Ai vërtet është pranues i madh i pendimeve.”
(En-Nasr, 1-3),

i Dërguari i Allahut tha: “Më është paralajmëruar vdekja ime” (Më është bërë me dije vdekja ime).”

(El-Felek)

- Transmetojnë Ahmedi, Tirmidhiu dhe Nesaiu nga Aishja r.a. të ketë thënë në lidhje me ajetin e 3 të kaptinës “El-Felek”:

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ

“dhe prej dëmit të natës kur ajo ngryset”,

“Më mori i Dërguari i Allahut për dore, ma dëftoi Hënën kur doli dhe më tha: “Kërko mbrojtje tek Allahu prej kësaj (hënës në të sosur), sepse kjo është **“gasiku” – “errësira kur ngryset”**.”

* * *

Këto ishin vetëm disa nga komentimet e të Dërguarit të Allahut, bërë disa ajeteve kuranore, të cilat i shkëputëm me përzgjedhje nga vepra madhështore e Imam Sujutiut **“El Itkan fi Ulumil Kur’an”**²¹, komente që gjenden pothuaj në të gjitha koleksionet e hadithit nën kapituj të veçantë **“Kapitulli i tefsirit të Kur’anit”**, si dhe në të gjithë librat e tefsirit, qofshin ata të komentimit tradicional apo racional.

Sabri Bajgora

COMENTATORY OF THE KORAN DURING PROPHET LIFE

(Summary)

The holy book – the Koran contains the revelation of Allah to mankind. The Koran is the greatest miracle of all. There is no doubt that the Koran is the greatest gift to mankind. The Koran is the greatest revelation of all, the revelation which the messenger of God was ordered to transmit to mankind. This holy mission did not mean only the transmission of the Koran to mankind. It also contained the explanation of what was sent to them (An-Nahl, 44).

²¹ Shih vëll II, prej fq. 420-450.

صبري بايعورا

تفسير القرآن الكريم في عهد رسول الله صلى الله عليه و سلم

(خلاصة البحث)

أنزل الله سبحانه و تعالى القرآن الكريم إلى نبيه مُحَمَّد صلى الله عليه و سلم معجزة حتى قيام الساعة، لانه كتاب يدعو الى الايمان الصحيح، معتمدا على الدراسة و التفكير و البحث المستمر في ظواهر الكون، و لا شك بأن القرآن الكريم يعتبر أكبر هبة من الله جلّت قدرته للبشر كافة.

القرآن الكريم هو خاتم الرسالات الالهية التي أمر الله نبيه ليبلغه إلى البشر و هذا لا يعنى فقط ابلاغه إلى الناس و لكن ايضا شرحه كما قال الله عز و جل في القرآن الكريم:

"وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ" (سورة النحل: ٤٤).

DORËSHKRIME

Dr. Hasan Kaleshi

DORËSHKRIMET ARABE NË JUGOSLLAVI¹

Me ardhjen e turqve në tokat jugosllave, ndodhën ndryshime rrënjësore në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të banorëve. Edhe pse mënyra e përhapjes së Islamit dhe depërtimi i tij në këto troje ende nuk është studiuar në mënyrë të mjaftueshme, ka indikacione se ai ka filluar të përhapet menjëherë pas depërtimit të osmanlinjve. Po ashtu është më se e sigurt se njerëzit e përqafuan Islamin me dëshirën dhe vullnetin e tyre, ndoshta një numër i caktuar e pranoi fenë islame për shkak të privilegjeve që gëzonin muslimanët. Mirëpo, në asnjë mënyrë përqafimi i fesë islame nuk ishte si rezultat i dhunës, detyrimit apo mizorisë, siç pretendojnë disa historianë joobjektivë në studimet e tyre.

Përveç kësaj, që në fillim të depërtimit të tyre turqit muslimanë u vendosën në vende të ndryshme e në mënyrë të veçantë në disa qendra të mëdha ku ishin vendosur kazermat e ushtrisë dhe administrata osmane. Rreth këtyre qendrave islame u formua një jetë e re, në veçanti në aspektin fetar dhe kulturor. Kjo kishte ndikuar në themelimin e institucioneve të ndryshme fetare, kulturore dhe sociale: xhamive, teqeve,

shkollave fillore, të cilat në kohën e osmanlinjve quheshin “mektebe” (mejtepe), si dhe shkollat e tjera fetare dhe laike.

Pranë këtyre institucioneve fetare dhe sociale u themeluan po ashtu biblioteka, pjesa më e madhe e të cilave përbëhej prej dorëshkrimeve arabe. Kështu me përhapjen e Islamit, përhapej dhe shtohet numri i këtyre institucioneve, kështu që u shtua numri i librave dhe shkollave, deri në atë shkallë sa që me kalimin e njëqind vjetve, numri i këtyre shkollave u bë shumë i madh e disa prej tyre u bënë të njohura në tërë pjesën e Turqisë Evropiane (Rumelisë).

Për këtë nuk duhet të habitemi kur thuhet se themelimin e bibliotekave të para Lindore në tokat jugosllave të tashme (Bëhet fjalë për ish-Jugosllavinë, e cila nuk ekziston më - Shënimi i përkthyesit), lypset të hulumtohen në periudhën e parë të depërtimit të turqve, do të thotë në përfundim të shekullit katërmëdhjetë dhe në fillim të shekullit pesëmbëdhjetë. Unë jam i mendimit se bibliotekat e asaj periudhe mund të ndahen në tri lloje:

1. Bibliotekat private (personale).

2. Bibliotekat e xhamive, mesxhideve dhe teqeve.

3. Bibliotekat e shkollave. Në realitet ky ishte lloji më i rëndësishëm i bibliotekave, sepse në një farë mënyre ato ishin biblioteka publike, se qytetarët kishin mundësi t'i huazonin librat, t'i lexonin apo t'i përshkruanin ato.

Bibliotekat private i themeluan disa dijetarë, personalitete të rëndësishme si dhe dashamirët e librit, të cilët kishin mundësi për blerjen e librave. Është e njohur se librat ishin shumë të shtrenjtë, sepse ata shkruheshin me dorë dhe ilustrheshin me ilustrime të ndryshme. Nuk ishin të rralla rastet kur këta libra liheshin vakëf para vdekjes së pronarëve të tyre, apo ata t'i lënin vakëf trashëgimtarët e tyre pas vdekjes, për disa shkolla (medrese), bibliotekat e të cilave ishin rritur në këtë mënyrë dhe ishte rritur numri i librave në to.

Bibliotekat e xhamive të shumtën e rasteve ishin të pajisura me mus-hafe dhe pjesë të tij, si dhe libra fetarë të përgjithshëm. Këta libra u jepeshin në dispozicion njerëzve për lexim apo për përshkrimin e tyre.

¹ Ky studim i autorit shtë botuar në vitin 1966, gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime të mëdha, prandaj shumë nocione politike e shtetërore janë të asaj kohe dhe jo të sotme (Përkthyesi).

Dokumentet e ndryshme flasin për disa personalitete të rëndësishme, që kanë lënë vakëf dhe i kanë dedikuar për këto biblioteka kopjet më të bukura të Kur'anit si dhe një numër të madh të librave të tjerë.

Teqetë, po ashtu kanë pasur bibliotekat e tyre, të cilat të shumtën e rasteve ishin të pajisura me vepra që i dedikoheshin misticizmit dhe biografive të themeluesve të rendeve mistike të ndryshme. Në këtë lloj të bibliotekave i gjejmë veprat e klasikëve të njohur persianë si: Xhelaludin Rumiut dhe Feridudin El-Attarit.

Si përmendëm më sipër, bibliotekat më të rëndësishme ishin ato që gjendeshin pranë komplekseve shkollore, sepse ato ishin më të pajisurat, kishin një numër të madh të librave dhe ishin më të dobishme në aspektin përmbajtësor.

Sipas mendimit tim, këtë e vërtetojnë edhe hulumtimet e fundit, në tokat jugosllave gjendeshin treqind shkolla (medrese), të cilat i kishin bibliotekat e tyre, disa ishin të mëdha e disa të vogla, sipas vjetërsisë dhe kushteve në të cilat gjendeshin medresetë si dhe sipas thesarit të vakëfit dhe vlerës së trashëgimtarëve të saj... etj.

Secila bibliotekë ishte e pajisur me veprat me të njohura në lëmin e shkencave natyrore dhe fetare, të cilat mësoheshin në atë kohë.

Si bibliotekat po ashtu dhe medresetë, në atë kohë ishin të themeluara vetëm sipas sistemit të vakëfit.

Meqenëse vakëfi ishte institucion i bamiërisë dhe librat ishin prej gjërave që mund të lireshin vakëf, shumë biblioteka, të cilat në kohën e themelimit të tyre ishin shumë modeste, me kalimin e kohës u pajisën me një numër të konsideruar të librave. Kështu ne nuk i shohim vetëm personalitetet e njohura dhe të pasurit, që lënë libra vakëf, por këtë e bënin edhe njerëzit, që kishin një pasuri modeste.

Prej dokumenteve të vakëfeve të ndryshme, shohim se mësuesit ishin ata që kujdeseshin për këta libra, atëherë kur bibliotekat ishin të vogla, ndërsa sekretari i bibliotekës, apo siç quhej ruajtësi i librave, atëherë kur bibliotekat ishin të mëdha.

Biblioteka e Isa beut në Shkup

Sekretari i bibliotekës përmendet për herë të parë në tokat jugosllave në vakëfin e Isa beut më 1469, ku shihet se puna e sekretarit të bibliotekës ishte profesion dhe mjeshtëri e posaçme, kështu që sekretari i bibliotekës e merrte pagën e tij ditore kundruall kryerjes së punës së tij.

Duke u mbështetur në dokumentet e gjetura deri më tash, mund të thuhet se biblioteka më e vjetër në tokat jugosllave, është biblioteka që e kishte themeluar para vitit 1455, Isa beu në kuadër të Medresesë së Shkupit. Në momentin e themelimit të saj, kjo bibliotekë kishte tri dhjetë libra të zgjedhur. Të gjitha ishin në gjuhën arabe, shumica prej tyre në tefsir, hadith, fikh, gjuhë arabe dhe fetva. Ja disa nga titujt më të rëndësishëm të veprave, që përmenden me rastin e lënies vakëf: “*El-Kesh-shaf*”, i Zemahsheriut, Tefsiri i Begaviut, “*Mesharikul env-ar*”, “*Sherhul Mesharik*” i Ekmelud-dinit, “*El-hidaje*” në fikh, “*Sherhul hidajeti*” i Xhevher Zades, “*Sherhul muxhm-meul bahrejn*”, “*Sadrush-sheriat*”, “*Fetavi*” e Kadi hanit, “*Kunjetutl fetavi*”, “*Sherhul Miftah*” e Sejjid Sherifit, “*Et-telvi*”, “*Metnul Kafijeti*”, “*Sherhul Mevakif*” i Sejjid Sherifit etj.

Nuk ka dyshim se numri i librave u shtua vazhdimisht, sepse ne shohim se kjo medrese nga mesi i shekullit gjashtëmbëdhjetë, u bë prej medreseve më të njohura në pjesën evropiane të Turqisë.

Nuk duhet të na habitë fakti se të gjitha veprat në këtë shkollë ishin në gjuhën arabe, sepse gjuha arabe në atë kohë konsiderohej në një nivel shumë më të lartë se gjuha turke.

Ajo ishte gjuha e fesë islame dhe civilizimit islam, ajo kishte shprehjet adekuate jo vetëm në shkencat fetare, por edhe në të gjitha artet dhe shkencat e tjera. Ajo ishte gjuha e diplomacisë në tërë Botën Islame.

Në shekujt, që pasuan pas shekullit të pesëmbëdhjetë, gjendja paksa ndryshoi, mirëpo, megjithatë ne shohim se 75% të dorëshkrimeve ishin në gjuhën arabe e pjesa tjetër ishin në gjuhët turke dhe persiane.

Isa beu, komandanti dhe luftëtari turk i njohur, i cili konsiderohet prej bamirësve dhe atyre që më së shumti lanë vakëfe në tokat jugosllave, në vitin 1468 themeloi bibliotekën më të madhe tek ne. Shihet nga vakëfnamja e tij e vërtetuar nga Gjyqi i Sheriatit në vitin 1469, se biblioteka e tij posedonte veprat më të njohura të dijetarëve të Islamit. Më shumë se 330 libra në disa volume, të cilët përfshinin disa disiplina shkencore dhe letrare, të cilat mësoheshin në atë kohë. Vakëfi me rastin e lënies së testamentit të vakëfit të tij, librat i ndau sipas disiplinave shkencore si vijon:

Nga lëmi i tefsirit 75 libra
 Nga lëmi i hadithit 44 libra
 Nga lëmi i usuli fikhut 23 libra
 Nga lëmi i fetvave 26 libra
 Nga lëmi i retorikës 16 libra
 Nga lëmi i logjikës 2 libra
 Nga lëmi i morfologjisë 2 libra
 Nga lëmi i leksikografisë 12 libra
 Nga lëmi i Kiraeteve 8 libra
 Nga lëmi i këshillimeve 16 libra
 Nga lëmi i fikhut 15 libra
 Nga lëmi i apologjistikës 15 libra
 Nga lëmi i urtësisë 8 libra
 Nga lëmi i gramatikës 8 libra
 Nga lëmi i letërsisë 4 libra
 Nga lëmi i mjekësisë 15 libra

Të shohim tash titujt e disa veprave, që përmenden në këtë vakëfname, prej të cilëve sot nuk ka mbetur asnjë.

Në lëmin e *tefsirit*: “El-kesh-shaf” (Keshafi), “Et-tefsirul kebir” (Tefsiri i madh) prej 16 volumeve, “Tefsiri i el-Kadi el-Bejdaviut”, “Tefsiri i el-Bigeviut”, “Tefsiri i Ebi Lejthit”, “Sherhi i el-Kesh-shafit” të Mevlana Seidudinit, “Hashija e el-Kesh-shafit” të Sejid Sherifit, “Xhevahirul Kur’an” (Margaritarët e Kur’anit), “Përgjigjet ndaj Zemahsheriut” etj.

Prej librave të *kiraeteve*: “Esh-shatibije”, “Xhamiul Kur’an” “Ah-kamul Kur’ani” i Ebi Bekr Err-rrazi etj.

Prej librave të *hadithit*: “Sahihu i Muslimit”, “Sahihu i Buhariut” nga Zerkeshiu, “Sherhi i Muslimit”, “Xhamiul usul”, “El-mesabihu”, “El-Meshariku”, “Sherhul Mesabih” i Zejnul Arebiut, “Sherhul Mesa-bih” i Kadi Bejdaviut, “Sherhul Meshariki” i Ibnu Fershene, “Muhtesarul Buhari”, “Sherhul Mesharik” i Ekmeludinit etj.

Prej librave të *këshillimeve*: “Risaletul Vaidhi”, “Tedhkiretul Kurtubi”, “Medarixhus-salihine” i Bezdeviut, “Gajetus-suali fil ed’ijeti”, “Minhexhul arifine”, “Nesaihu Shejh Zejnud-din”.

Prej librave të *Usulifikhut dhe fikhut*: “Metnuil-Bezdevi”, “Et tevdihu”, “Et-telvihi”, “El-hidaje”, “El-kifajetu fi sherhil bidajeti”, “Sherhul hidajeti” “Buhariu”, “Et-texhdidu fil-lugati”, “Sherhul xhami-i l-Kebir”, “El axhamiu es-sagir”, Durerul Bihari” etj.

Prej librave të *fetvave*: “Maxhmeul fetavi”, Kunjitul fetavi”, “Hazanetul fetavi”, “Fetavi Kadi Han”, “El-fetavi el-berazijetu” etj.

Prej librave të *retorikës*: “Sherhul Miftah” i Sejid Sherifit, “Metn-ul Miftah”, “El-Mutavvel”, “Hashijetul Mutav-vel”, “Sherhu idahil Meani” etj.

Prej librave të *apologjetikës*: “Sherhul Mevakifi”, “Sherhul Meka-sidi”, “Sherhut-texhsidi”, “Sherhul Akaidi”, “Bahrul kelami” etj.

Prej librave të *gramatikës, morfologjisë, letërsisë dhe leksikografisë*: “Mugni El-lebibi”, “Sherhul Kifajeti”, “Sherhul Uz-za”, “Es-saha-hu” i Xhevheriut, “Essami fil esami”, “Ed-desturu fil-lugati”, “Muhtasaru saha-hil xhevheri”, “Divanu Zuhejr”, “Mekamatu el-Hariri” etj.

Prej librave të *mjekësisë*: “Kamilus-sanaati”, “Kitabu ibnul Bejtar”, “Sherhul Muxhez lis-sedidi”, “El-muxhezu fit-tibbi”, “El-kifaje fit-tibi”, “El-kanunu fit-tibi”, “Esh-shifau fit-tibbi” etj.

Titujt e këtyre librave tregojnë qartë se çfarë librash përmbante kjo bibliotekë, dhe na tregon për llojin e librave që lexoheshin dhe përshkruheshin si dhe për llojin e librave që përdorehin si tekste mësimore në medrese.

Nëse ky lloj i librave gjendej në kohën e themelimit të bibliotekës, mund të merret me mend se sa ishte rritur numri i tyre gjatë dyqind apo treqind vjetve. Por, fatkeqësisht, sot nuk kemi asnjë gjurmë të tyre.

Ashtu siç shihet nga dokumentet, gati të gjithë librat ishin në gjuhën arabe dhe ky është argumenti më i mirë për përhapjen e civilizimit arab në vendin tonë në atë kohë.

Këtu vlen të përmendim se ruajtësi i librave, i cili paguhej nga dy dërhemë si pagë ditore, përmendet për herë të parë në këtë dokument. Është me interes të përmendim këtu se Isa beu kishte lënë si vakëfe ndërtesa të shumta, një numër të fshatrave, dyqaneve, maleve, tokave të punueshme, mullinjve, hamameve etj., të gjitha këto ishin në shërbim të medresesë dhe bibliotekës.

Në periudhën e viteve 1503-1511, ai bëri regjistrimin e vakëfeve të tij dhe vërtetoi vakëfimin e tyre Isak Çelebiu, kadi i Manastirit, e pastaj kadi i Selanikut. Isak Çelebiu i la disa vakëfe në Manastir, Selanik dhe Plovdiv (Bullgari). Vakëfet e tij në Manastir ai i kishte lënë në emër të një xhamie, e cila gjendet edhe sot e kësaj dite, pranë së cilës gjenden një medrese, një mesxhid dhe një mejtep. Në mesin e vakëfeve që ai kishte lënë, ishte një numër i librave për përdorimin e tyre në medrese. Prej librave të shumtë, mund të përmendim titujt e disave. “El-hidaje” të Ali ibnu Ebi Bekr el-Fereganit, “Sadrush-she-riati”, “Tefsiri i Kadi el-Bejdavit”, “Tefsiri i ebi Lejthit”, “Fetfat e el-Bezarit”, “Tefsiri i Maxhmeul-bahrejnit”, “Fetfat e Kadi Hanit”, “Sherhul Hidajeti”, “Xhamiul fusulijin”, “Maxhmeul-fetavi”, “Fetavi el-vexhizi”, “Hulasatul fetavi”, “Mushtemelu el-ahkami”, “Sahihul Buhari”, “Erramuz fil-lugati”, “El-mutav-velu” i Taftazaniut, “Kitabul mevakifi fi ilmil-kelami”, i Abdurrahman ibnu Ahmet el-Ixhiu, “Me-kasidu et-talibine fi usulid-dini” i Taftazaniut, “Menarul envari fi usulil fikh” i Hafidhudin Ebi El-berekat Abdullah El-meshhur bin ne-sefi, “El-hafijetu fin-nahri”, “Esh-shafijetu”. “El’uza fit-tasrif” e Ibrahim Ez-zenxhaniut, “Feraidu” e Sexhavendit, “Metnul Mufas-sal” i Zemahsheriut, “El-mugni” i Xhelaludin El-habazit, “El-enmu dhexh fin-nahi” i Zemahsheriut.

Nëse i krahasojmë këta libra, që përmendëm më parë, do të shohim se ata ishin të ngjashëm. Mund të thuhet se edhe bibliotekat e tjera posedonin libra të ngjashëm. Mirëpo, ekzistojnë dëshmi që tregojnë se para kësaj medreseje, në Manastir ka ekzistuar një medrese më e vjetër, për arsye se Islami ka depërtuar në Manastir, para se të përhapet në qytetet e tjera.

Në një vakëfname, të cilën e kam botuar kohë më parë, e cila konsiderohet dokumenti më i vjetër në vendin tonë, që mban datën e vitit 1432, ku përmendet Isa Fekih, babai i pronarit të vakëfit Xhavish beu, ndërsa Xhamia e Isa beut edhe sot e kësaj dite gjendet në Manastir, edhe pse në të janë bërë disa meremetime dhe nuk është ruajtur forma autentike e saj.

Isa Fekihu ishte myderriz i lëndës së fikhut në njërën prej medreseve të Manastirit prandaj u quajt “Fekih”. Në këtë medrese, e cila u ndërtua para vitit 1434, patjetër ka pasur edhe libra. Mirëpo, për fat të keq, aty sot nuk ka mbetur asgjë nga tërë ajo literaturë.

Biblioteka e Suziut në Prizren

Në vitin 1549 u themelua Medreseja e parë në Prizren. Ai sot është një qytet i vogël në pjesën jugore të Kosovës. Këtë Medrese e themeloi njëri prej banorëve të Prizrenit me emrin “Suzi”, i cili ishte poet shumë i njohur në gjuhën turke. Në mesin e shumë librave në gjuhën arabe dhe turke, aty hasim edhe një numër të librave në gjuhën persiane. Prej atyre, veprat e At-tarit, Xhelaludin Rumiut gjë që tregon se në atë kohë ka pasur njerëz që e kanë ditur shumë mirë gjuhën persiane dhe i kanë lexuar veprat në fjalë. Tregohet se Suzi kishte një kusht shumë të mirë në vakufimin rreth përdorimit të librave të tij e ai është:

“Derisa ai të jetë gjallë, ai do të jetë pronar i tyre, ndërsa pas vdekjes së tij për to do të kujdeset imani i xhamisë time. Le t’ua japë ato në huazim dijetarëve dhe atyre që janë në gjendje të kenë dobi prej tyre, të cilët do të lexojnë salavate për shpirtin e tij”.

Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, turqit ishin zotërinj të Gadishullit Ballkanik. Kështu shohim se Islami depërtoi në shumë qytete. Për këtë hasim biblioteka të shumta, në të cilat gjenden dorëshkrime arabe, si në Beograd, Nish, Prishtinë, Novi Pazar, Uzhiçë, Sarajevë, Mostar, Banjallukë si edhe në shumë qytete të vogla.

Ndërsa në shekullin e shtatëmbëdhjetë, numri i këtyre bibliotekave ishte në rritje e sipër dhe kështu edhe numri i dorëshkrimeve.

Shtrohet pyetja prej nga u pajisën ato biblioteka me atë numër aq të madh të dorëshkrimeve? Ku u përshkruan dhe si arritën deri në tokat jugosllave?

Shumica e atyre librave që gjendeshin në bibliotekat e përmendura, u përshkruan në vende të ndryshme islame.

Shumë dashamirës të librave i blinin ata nga qendrat e ndryshme dhe i dërgonin në vendet tona, ndërsa një numër të atyre librave i sollën vendësit tanë me rastin e kthimit të tyre nga haxhi. Një numër i konsiderueshëm i njerëzve tanë që kishin pozita të larta në vende të ndryshme islame, i blinin atje librat dhe i dërgonin në vendlindjen e tyre e pastaj ua dhuronin bibliotekave. Më vonë këta libra përshkruheshin nga njerëzit e viseve tona nëpër qendra të mëdha, si Sarajeva, ku gjendej tregu i libërldhësve. Sot shohim libra të përshkruar në Mekë, Kajro, Damask, Bagdad si dhe në vende të ndryshme të tokave jugosllave e ndonjëherë edhe në qytete shumë të vogla.

Përveç këtyre gjendet edhe një numër i librave autoktonë të shkruar nga autorë vendës në gjuhën arabe, turke dhe persiane dhe këta libra ata i linin vakëf.

Biblioteka e Gazi Husrev beut në Sarajevë

Nga ky vështrim i shkurtër historik, u pa se numri i bibliotekave private dhe publike ishte shumë i madh, në vendet ku sot gjendet Federata Jugosllave. Mirëpo, për fat të keq, prej gjithë atyre sot ka mbetur vetëm biblioteka e Gazi Husrev beut në Sarajevë si dhe disa biblioteka të tjera të vogla. Kjo medrese, thesari i së cilës u shtua gjatë shekujve me anën e librave të lënë vakëf në një anë, si dhe me sjelljen e librave nga disa biblioteka të tjera nga vende të ndryshme të Bosnjës, në anën tjetër. Themelues i kësaj biblioteke qe valiu i Bosnjës, Gazi Husrev beu, në vitin 1537, edhe pse kjo bibliotekë u dëmtua shumë me rastin e sulmit të austriakëve në vitin 1697, kur u zhdukën shumë dorëshkrime. Mirëpo, ajo e mori veten shumë shpejt me gjithë ato dëmtime dhe shkatërtime, kështu që gjatë viteve 1867 dhe 1950 u transferuan në bibliotekën e Gazi Husrev beut shumë biblioteka private, në mesin e të cilave edhe biblioteka e Karaxhoz beut në Mostar,

biblioteka e Kantamirit nga Sarajeva, biblioteka e Haxhi Halit efendikut nga Gračanica etj.

Gjatë këtyre viteve të fundit është rritur fondi i kësaj biblioteke me blerjen e dorëshkrimeve nga burime të veçanta, kështu që ajo sot konsiderohet biblioteka më e pasur me dorëshkrime orientale jo vetëm në Gadishullin Ballkanik por edhe në tërë Evropën.

Meqenëse i bëmë një vështrim të shkurtër historikut të bibliotekave dhe dorëshkrimeve në vendet jugosllave, të shohim tash shkurtimisht se cila është gjendja e dorëshkrimeve arabe në Jugosllavi në kohën e sotme:

Është vështirë të jepet një pasqyrë e saktë për dorëshkrimet arabe në Jugosllavi, për arsye se ende nuk ka katalogji të këtyre dorëshkrimeve.

Në vitin e kaluar doli nga shtypi pjesa e parë e dorëshkrimeve arabe, persiane dhe turke e Bibliotekës së Gazi Husrev beut, të cilën e përgatiti Kasim Dobrača, njëri prej studentëve të Universitetit të El-Az-harit. Sipas këtij katalogu, edhe pse ai deri më tani nuk është i plotë, vërehet se në këtë bibliotekë në mesin e dorëshkrimeve arabe gjenden një numër i veprave shumë të vjetra dhe shumë të rëndësishme, por edhe një numër i dorëshkrimeve unike, si dhe një numër i veprave të panjohura në disiplina të ndryshme të shkencave islame, në veçanti në lëmin e tefsirit, hadithit dhe fikhut.

Dorëshkrimi më i vjetër në këtë bibliotekë është “Firdevsul ahbar bimethuril hitab” që përfshin një përmbledhje të haditheve të Ebu Shuxha Shirevejh ibnu Shehr dare ed-dilemij, i cili është përshkruar në vitin 546 sipas hixhretit (1151 sipas erës së re).

Ky dorëshkrim është përshkruar në Hamedhan në Medresenë El-imadije, tridhjetë e shtatë vjet pas vdekjes së autorit. Prandaj mund të përfundojmë se ky dorëshkrim mund të jetë kopja më e vjetër e këtij libri.

Ndërsa libri i dytë, sa i përket vjetërsisë, është vëllimi i tretë i librit me titull “El-keshf vel bejan fi tefsir Kur’an” i Ebu Is-hak Ahmed bin Muhamed Eth-Thalebi En-nisaburi, i përshkruar në vitin 571 (1179).

Ndërsa prej veprave unike dhe me vlerë, është përmbledhja e haditheve të njohura “El-erbune hadithen” (Dyzet hadithet) apo “Irsha-

dus-sairine ila menazili el-mut-tekine” i Ebul Futuh Muhamed Et-taih El-hemedani.

Ekzistojnë edhe disa vepra të cilat supozojmë për shumë shkaqe se ato janë me shkrimin e autorit, sepse ato nuk i gjejmë në katalogët e botuar. Prej tyre do të përmendim:

1. “*Revdatul ahbari fi sherhi mesharikiul anvari*” i Arzunxhan Omer bin Abdul Muhsin.

2. “*Kitabu Muhtasaru mavludat*” i ibni El-Xhevzi Nyganed bub Sykehnab Eb-bygu 748/1347.

3. “*El-muktedea min kitab el-mavdut minel ahdith el-merfuati*” i ibni El-Xhevzi vdiq më 626 H (1329).

Ekzistojnë një numër veprash, të cilat janë përshkruar nga origjinali; përmendim prej tyre:

1. “*El-kesh-shafu an hakaikit-tenzili*” i Zemahsheriut, i cili është përshkruar në vitin 626 H (1229), kopja e Bilal ibnu Xhebrail Et-Turkmaniut, në Medresenë El-Mustanserije në Bagdad.

2. “*Kibu sherhil elfijeti liliraki*” i përshkruar nga kopja që e kishte shkruar autori me dorën e vet në vitin 785/1383, do të thotë njëzet vjet para vdekjes së autorit.

Ekzistojnë dorëshkrime të përshkruara në vende të largëta, po përmendim sa për ilustrim pjesën e tretë të Sahihul Buhariut, i përshkruar në Buhara në vitin 821 H (1418), dhe pjesa e dytë dhe e tretë po ashtu e Sahihul Buhariut, përshkruar në Kajro në lagjen El-karafa në vitin 841 H (1431). Poashtu gjenden dorëshkrime të përshkruara në Krime, Tebriz, Damask etj.

Vlera e veçantë e kësaj biblioteke qëndron në faktin se në të gjenden një numër shumë i madh i veprave të autorëve të Bosnjës e Hercegovinës, të cilët kishin shkruar veprat e tyre në gjuhën arabe, persiane dhe turke. Mirëpo, në këtu nuk do të flasim për to, sepse ato ishin temë e disertacionit të Dr. Kamil El-buhit dhe ne shpresojmë se disertacioni i tij do të botohet së shpejti.

Kjo bibliotekë ka gjashtëmijë e katërqind e katërdhjetë e gjashtë vëllime mbi nëntëmijë vepra të formatit të madh dhe të vogël në gjuhën arabe, persiane dhe turke, mirëpo mbi 70% e tyre në gjuhën arabe.

Përveç kësaj biblioteke, në Sarajevë gjenden edhe institucione dhe institute të tjera, në të cilat gjenden dorëshkrime në gjuhën arabe.

Biblioteka e Institutit Oriental të Sarajevës

Vendin e parë, për sa i përket numrit, e zë Instituti i Studimeve Orientale i Sarajevës² në të cilin gjenden afër gjashtëmijë dorëshkrime në gjuhën arabe, persiane dhe turke.

Vlen të përmendim se aty gjenden libra unikatë dhe me vlera të mëdha, mirëpo është vështirë të japim një vlerësim të prerë për të sepse nuk gjendet katalogu i dorëshkrimeve.

Një numër i dorëshkrimeve gjenden në Bibliotekën Kombëtare të Sarajevës si dhe në Bibliotekën e dorëshkrimeve, por edhe aty nuk gjendet katalogu i dorëshkrimeve.

Dorëshkrimet në Maqedoni

Vendin e tretë, sa i përket numrit të dorëshkrimeve e zë Arkivi Qendror i Maqedonisë në Shkup, menjëherë pas Bibliotekës së Gazi Husrev beut dhe Institutit të Studimeve Orientale të Sarajevës.

Ndonëse Shkupin e shkatërroi tërmeti në vitin që kaloi (1963 – shën. i përkthyesit) dhe arkivi i tij u rrënuar, dorëshkrimet përveç disa dokumenteve turke mbetën të paprekura. Edhe pse këto dorëshkrime u tubuan dhe u sistemuan vetëm para pesëmbëdhjetë vjetve, ai numër kishte tejkaluar tre mijë e pesëqind dorëshkrime në gjuhën arabe, persiane dhe turke. Arkivi në fjalë u formua me bartjen e dorëshkrimeve nga disa biblioteka të vogla në Maqedoni, si dhe me blerjen e disa dorëshkrimeve të tjera. Këtu vlen të përmendim se në Maqedoni kanë ekzistuar disa qytete të njohura në kohën e osmanlinjve, si Shkupi e Manastiri, në të cilat vinin shumë njerëz prej vendeve të tjera për t’u pajisur me dituri fetare dhe në institucionet e tjera shkollore që ekzistonin në atë kohë.

Në qytetet e vogla gjendeshin medresetë dhe myderrizët dhe numri i dorëshkrimeve ishte shumë i madh, mirëpo rrethanat historike

² Për fat të keq, gjatë agresionit serb në Sarajevë Instituti në fjalë ishte në shënjestër të soldateskës serbe dhe nga granatimet e shumta ai u dogj më 1992, si edhe të gjithë dorëshkrimet në të. (Përkthyesi).

ishin tejet të vështira, për arsye se agresorët, okupuesit dhe luftërat ishin të njëpasnjëshme. Kështu nga tërë ai thesar aq i madh prej dorëshkrimeve dhe prej atyre bibliotekave e medreseve nuk mbetën përveç atyre që përmendëm.

Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore si dhe pas Luftës së Dytë Botërore, një numër i madh i muslimanëve nga Maqedonia u shpërngul në Turqi. Kështu ata e shitën një numër të dorëshkrimeve me një çmim shumë të lirë dhe një numër tjetër e morën me vete në Turqi. Me gjithë këto katastrofa, një numër i vogël i këtij thesari të madh u ruajt, kur u themelua sektori i dokumenteve orientale pranë Arkivit të Shkupit, para pesëmbëdhjetë vjetve, ashtu si u theksua më parë. Por as këto dorëshkrime nuk e kanë katalogun e vet.

Gjatë studimeve dhe hulumtimeve të mia kam vërejtur ose aty gjenden libra me vlera të mëdha, të cilat janë përshkruar nga të gjitha kontinentet ku është përhapur kultura islame. Aty po ashtu gjendet një numër i veprave, të cilat janë të shkruara nga dijetarë dhe shkrimtarë vendës.

Këtu vlen të përmendim se me rastin e hartimit të historisë së civilizimit islam në tokat jugosllave të tashme gjatë periudhës së sundimit osman, këto vepra do të luajnë rol shumë të rëndësishëm.

Prej këtyre veprave, unë kam regjistruar vetëm disa që kanë zgjuar kërshërinë time, sepse ato janë shkruar dhe janë kopjuar në vendet tona, si për shembull “*Sherhu Err-rrisaleti el-ved-ijeti*” i Xhurxhanit, i kopjuar në Shtip, një qytet i vogël në Maqedoni. Pastaj “*Vikajetu Err-rrivajeti*” në Shkup, si dhe “*Et-tegjridu fi kelimati et-tevhidi*” në Tetovë, “*Shuruhu il fil Fetavi*” (Shpjegimi i fetfave) në Manastir, si dhe “*Risaletu El-Mebdei vel meadi*” në Shkup etj.

Dorëshkrimet e kësaj biblioteke, sa i përket tematikës, u përngjajnë bibliotekave të tjera. Aty gjejmë dorëshkrime që kanë të bëjnë me tematikën e tefsirit, hadithit, fikhut, apologjetikës, morfologjisë, sintaksës, retorikës, letërsisë, poezisë, mjekësisë, farmacisë, kimisë, gjeometrisë, matematikës, filozofisë etj.

Dorëshkrimet orientale në Beograd

Në vitin 1935 pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Beograd u ngrit një komision i vençantë për tubimin e burimeve orientale. Ai po ashtu tubonte dorëshkrime dhe dokumente. Mirëpo, numri i dorëshkrimeve të tubuara ishte modest. Numri i dorëshkrimeve të tubuara sot arrin përafërsisht dyqind dorëshkrime në të tri gjuhët orientale.

Dorëshkrimet orientale në Zagreb

Në Zagreb, pothuajse në të njëjtën kohë, u themelua një komision i veçantë për tubimin e dorëshkrimeve dhe dokumenteve orientale. Ky komision pati mundësi të tubonte një mijë e shtatëqind dorëshkrime. Mirëpo, deri më sot nuk është përpiluar katalog për dorëshkrimet në fjalë.

Dorëshkrimet orientale në Kosovë

Dhjetë vjet më parë në Prishtinë u themelua Biblioteka e Vakëfit pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame, së cilës shumë njerëz i dhuruan dorëshkrimet e tyre. Në këtë bibliotekë tash gjenden përafërsisht një mijë e pesëqind dorëshkrime nga fusha të ndryshme, por shumica dërrmuese janë me tematikë fetare. Nga numri i përgjithshëm i dorëshkrimeve, 70% janë në gjuhën arabe. Në kohën kur u bëra një studim dorëshkrimeve të kësaj biblioteke, i shënova disa tituj prej të cilëve po përmend:

“*Tarifatu Ess-sej-jid Esh-sherif*” i kopjuar (përshkruar) në vitin 1506, “*El-itkan fi ulumil Kur'an*” e autorit Xhelalud-din Es-sujuti, i përshkruar në vitin 1606, “*Kenzu Ed-dekaiki*” i Nesefiut, i përshkruar në vitin 1403, “*Sahihul Buhari*” i përshkruar në vitin 966 H, pastaj “*Tefsirul begevi*” i Kadi bejdaviut, Ebi Suudit etj.

Ndërsa në qytetin e Prizrenit, në Kosovë, gjendet një numër i konsiderueshëm i dorëshkrimeve, të cilat janë nën mbikëqyrjen e Bibliotekës së vakëfit, numri i të cilave është afër pesëdhjetë dorëshkrime. Prej këtyre dorëshkrimeve po përmend: “*Tefsiru el-Kashifi*” në gjuhë

ën persiane. Ky është një dorëshkrim shumë i bukur i stolisur me ar, i përshkruar në vitin 984, “*El-Xhami Es-sahih*” i Buhariut, “*Fetfat e Kadi Hanit*” i përshkruar në vitin 966, “*Sherhu Maxhmeul Bahrejn*” i përshkruar në vitin 863 H. Pastaj “Fjalori i Fejruz Abadit”, i përshkruar në vitin 968, si dhe “Sahahul Xhevheri” etj. Aty kam hasur në disa dorëshkrime, të cilat i ka lënë vakëf Sinan Pasha, i cili e çliroi Jemenin, ishte vali në Kajro dhe kryeministër i Perandorisë Osmane. A kishte lindur në një prej fshatrave të asaj ane.

Në Bibliotekën Universitare në Beograd

Gjendet një numër i konsiderueshëm i librave orientale, ndër të cilat edhe treqind e pesëdhjetë dorëshkrime, të cilat biblioteka i bleu prej njerëzve të ndryshëm. Shumica e këtyre dorëshkrimeve janë sje-llë nga njëri prej imamëve nga qyteti i Nishit, i cili për një kohë të gjatë është marrë me tubimin e dorëshkrimeve, në veçanti të atyre që janë shkruar nga autorë vendës. Këto dorëshkrime po ashtu paraqesin një burim me vlerë për studimin dhe hulumtimin e historisë së kulturës dhe arsimit, sepse vërejmë se disa dorëshkrime në gjuhën arabe, persiane dhe turke janë përshkruar në vende të vogla, të cilat në kohën e osmanlinjve nuk kanë mundur të kenë më shumë se dy mijë apo tre mijë banorë. Meqenëse shumicën e këtyre dorëshkrimeve i kam blerë në emër të Bibliotekës dhe kam bërë regjistrimin, si dhe kam studiuar përmbajtjen e tyre, do të përmend disa prej tyre:

“*Mishkatul Envar*” të Gazaliut, “*Ej-juhel veled*” i Gazaliut, të cilat janë përshkruar në një vend të vogël siç ishte Gjakova, “*Muktatu bejan*” është përshkruar në Prizren, “*Tefsiri i Begeviut*”, Libri “*Sadrush-sheriat*”, libri “*Fetfat*” e Bezaziut, “*Avariful Mearif*” i Shihabud-din Es-sehruridit, “*Kul-lijatu Ebil-bika*” i përshkruar në vitin 1176 H., “*Hajatul hajvan*” i përshkruar në vitin 776 H, “*Muhtesarul Meani*” i përshkruar më 890, Libri “*El-kitabul munif fi sana’ati et-tarif*” i Kadi Bejdaviut, “*Sahihu i Muslimit*”, “*Hashijetu Es-seraxhijeti fil feraidi*”, “*En-nasih vel-mensuh fil mekamati*”, *Kitabus-salati fi ma’rifeti enva’is-salati*”, i përshkruar në vitin 630 H, Komentimi i Muslimit i përshkruar në vitin 642, “*Kitabu en-nezhati fi ilmil hisab*” i Shihabudinit, “*Kelile dhe Dimne*” etj.

Këtu vlen të përmendim traktet e *Shejh Muhamed Nurul Arabi Et-tantavi El-misri*, i cili u shpërngul prej Tantes në (Egjipt) dhe në qytetet si Prizreni, Shkupi dhe Shtipi themeloi teqetë e *Mevlevinjve* dhe përhapu këtë tarikat dhe shkroi disa trakte, të cilat i përmend autori i veprës “*Hedijetul Arifinie*” dhe të gjitha kanë të bëjnë me misticizmin me komentet e Muhidin ibnu Arebiut. Unë supozoj se këto trakte janë të rralla, sepse Muhamed Nurul Arebi i kishte shkruar në Shkup dhe Shtip, ku vdiq e u varros dhe aty gjendet varri i tij edhe sot.

Si të ruhen dorëshkrimet orientale?!

Në fund nuk na mbetet tjetër vetëm të shohim se ç’është punuar deri më sot dhe ç’duhet të bëhet në të ardhmen për tubimin, studimin dhe hulumtimin e dorëshkrimeve në këto treva.

Një numër i madh i dorëshkrimeve arabe gjendet ende në pronësi të njerëzve të ndryshëm, sepse ishte i madh numri i atyre që kishin mësuar gjuhën arabe dhe sidomos shkencat fetare, dhe secili prej tyre kishte në bibliotekën e vet një numër të dorëshkrimeve. Ndodh që trashëgimtarët të mos u kushtojnë rëndësi pas vdekjes së tyre, apo t’i shesin ato me një çmim simbolik, duke mos ditur vlerën e tyre. Këtu mund të përmend se një numër i konsiderueshëm i dorëshkrimeve me vlera shumë të mëdha nga trevat tona është bartur jashtë me rrugë të ndryshme nga të huajt.

Të gjitha dorëshkrimet e mbetura në pronësi private duhet të tubohen. Mirëpo, kjo nuk mjafton, lypset angazhim më i madh në studimin e tyre si dhe për hartimin e kategorive. Ne përmendëm se në mesin e mijëra dorëshkrimeve, deri më tash është botuar vetëm libri i parë i katalogut të dorëshkrimeve të Bibliotekës së Gazi Husrev beut, ndërsa shkaqet e mospërpilimit të katalogjeve deri më tash janë të shumta:

E para: Numri i ekspertëve që mund t’i studiojnë dorëshkrimet në mënyrë të përpikët dhe të përpilojnë katalogë sipas rregullave shkencore, është i vogël.

E dyta: Mungesa e mjeteve financiare, se shtypja e katalogut tek ne kushton shumë shtrenjtë, sepse në tërë vendin gjendet vetëm një shtypshkronjë, që mund të shtypë tekste në gjuhën arabe. Kjo shtypshkronjë vazhdimisht është e zënë. Tash po bëhen përpjekje për harti-

min e katalogut të dytë të Bibliotekës Universitare në Beograd. Kur të përfundojmë punën e hartimit të katalogëve atëherë do të kemi një pasqyrë të qartë të dorëshkrimeve arabe në këto treva (Jugosllavi). Jam i sigurt se atëherë do të shohim një numër të madh të veprave të rralla dhe me vlerë, të cilat flasin për madhësinë dhe ndikimin e civilizimit e kulturës arabe dhe reflektimin e tij në këto troje.

*Marrë nga: Mexhel-letu Ma'hadul Muhtatat El-arabijjeti,
El-muxhel-led Eth-thani 'ashere El xhuzu eth-thani.*

Nëntor, 1966, f. 3-20, Kajro

Nga arabishtja: Qemajl Morina

Dr. Hasan Kaleshi

ARAB MANUSCRIPTS IN YUGOSLAVIA

(Summary)

The arrival of the Turks in the territories, which are currently part of former Yugoslavia, was marked with radical changes in the political, economic and cultural life of the inhabitants. Despite the fact that the spread of Islam in these territories has not been studied thoroughly, there are indications that it began immediately after the arrival of the Ottomans. It is apparent that people embraced Islam voluntarily. Nonetheless, there is a chance that a number of people embraced Islam due to the privileges they would enjoy. The spread of Islam in these territories was not achieved by force, as is claimed by a number of biased historians in their works.

د. حسن قلشي

المخططات العربية في يوغسلافيا

(خلاصة البحث)

بمجيئ الاتراك إلى الاراضى اليوغسلافية حدثت تغيرات جذرية في الحياة السياسية و الاقتصادية و الثقافية للسكان، و بالرغم من ان عملية نشر الاسلام و سيره في مختلف مناطق بلادنا لا يزال غير مدروس دراسة كافية، فانه من المؤكد أنه بدأ فوراً بعد قدوم العثمانيين، و من المؤكد أيضاً أن الناس كانوا يعتنقون الاسلام بمحض رغبتهم و لعل عددا منهم اعتنق الاسلام من أجل الامتيازات التي كانت لمعتنقى الاسلام، و ليس بان حال من الاحوال بالعنف و الاجبار و الظلم، كما يؤكد بعض المؤرخين غير الموضوعيين.

DORËSHKRIME

Resul Rexhepi - Sadik Mehmeti

"RISALEJA" E HAXHI RRUSTEM EF. SHPORTËS - NJË VEPËR E RËNDËSISHME PËR SHKENCAT KURANORE

Haxhi Rustem ef. Shporta i takonte plejadës së intelektualëve më të shquar të qytetit të Prizrenit në fillimshkullin e kaluar. Megjithatë, deri më tani për jetën dhe veprën e këtij alimi e atdhetari të shquar, me sa dimë, nuk është shkruar ndonjë studim, përveç ca të dhënave tepër modeste.

Ai më shumë kujtohet, gjithsesi me pietet, se më 1908 ishte një nga organizatorët dhe anëtarët kryesorë të komisionit për formimin e organizatës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e ujit për prodhimin e rrymës në Prizren. Falë angazhimit të kësaj organizate, më 1909 mbi lumin Bistricë pati filluar ndërtimi i hidrocentralit të Prizrenit.¹

Haxhi Rustem ef. Shporta kujtohet po ashtu si organizator i vrasjes së inxhinierit Ivan Vangelov, i cili më 1919 kishte dashur të rrëronte, - madje edhe kishte arritur t'i rrëronte hajatat e njëres prej xhamive më të bukura dhe më të vjetra jo vetëm në Prizren, po edhe me gjerë - xhaminë e famshme të Sinan Pashës.

Ç'është e drejta, më 1919 pushteti serb kishte vendosur ta rrëronte në tërësi xhaminë e Sinan Pashës, e cila më herët gjatë okupimit bullgar të Prizrenit 1915 - 1918 kishte shërbyer si depo municioni. Kështu, më 15 maj 1919, pushteti serb kishte nisur rrënimin e çardakëve të saj, me qëllim të rindërtimit të "Manastirit të Kryeengjëjve" në Grykën e Bistricës së Prizrenit.²

Atëbotë, atypari kishte kaluar poeti i njohur prizrenas, miku dhe bashkëpunëtori i ngushtë i haxhi Rustem ef. Shportës, haxhi Ymer Lutfi ef. Paçarizi, i cili duke parë aktin barbar dhe pa precedent të shkatërrimit të njërit prej monumenteve më të bukura të trashëgimisë islame-shqiptare, kishte hyrë në dyqanin e një miku të tij, haxhi Vehebiut, përballë xhamisë së Sinan Pashës, dhe në shenjë reagimi e revolte kundër këtij veprimi antivilizues kishte shkruar vjershën me titull shumë domethënës - "Xhahilët".

Me të rrënuar çardakët e xhamisë "Sinan Pasha" që, sikur thotë mbishkrimi i saj "I ngjan parajsës" - "Xhennet mithali", inxhinieri Ivan Vangelov me bashkëveprimtarët e tij, kishin shtruar rakinë në mejhanen e Shatërvanit, në afërsi të xhamisë, për ta festuar nismën e suksesshme të rrënimin të xhamisë. Pas këtij akti barbar, menjëherë kishte filluar tubimi dhe protesta e qytetarëve, andaj pushteti ishte detyruar të ndërpresë rrënimin e mëtejme të xhamisë.³ Po atë kohë, nga paria e qytetit, ishte organizuar dhe kryer edhe vrasja e Vangelovit. Për këtë arsye, me akuzën se kishte porositur dhe paguar vrasjen e Vangelovit, myftiu i atëhershëm i Prizrenit, haxhi Rustem Dhihi ef. Ramadani – Shporta, që dënuar me 20 vjet burgim dhe konfiskim të pasurisë.⁴

Nuk dimë sa vjet burg i mbajti myftiu Rustem ef. Shporta, por e dimë se ai për të vuajtur dënimin që dërguar në burgun e Nishit dhe se atje, ai, si njëri i penës që ishte, kishte shkruar edhe disa vepra origjinale në gjuhën arabe e turke, një prej të cilave është edhe kjo që po e bëjmë objekt shqyrtimi në këtë shkrim modest, me shpresë se kështu do të nxisim edhe studiues të tjerë të merren më gjerësisht me jetën

² Abdullah Gërguri, Antikitetet e Kosovës, VIII, Prishtinë, 1987, f. 87.

³ Shih: Dr. Hasan Kaleši, Najstari vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Priština, 1972, str. 264.

⁴ Shih: Muhamet Shukriu, E kaluëmja e Prizrenit, Prizren, 2001, f. 298.

¹ Katalogët në Muzeun e Prizrenit, Hidrocentralet e Kosovës, cituar sipas: Salajdin Krasniqi, Prizreni - udhëtim nëpër kohë, Prizren, 2002, f. 74.

dhe veprën e këtij personaliteti të njohur të Prizrenit dhe më gjerë. Po e bëjmë këtë edhe për faktin se "Risaleja..." e myftiut h. Rustem ef. Shporta, kujtojmë, përveç të tjerash, paraqet një vepër me rëndësi për shkencat kuranore, sidomos është me interes për studiuesit nga fushat e tefsirit dhe të akaidit.

Pas vdekjes myftiu i Prizrenit, h. Rustem ef. Shporta, kishte lënë një bibliotekë të pasur, në të cilën, sipas M. Shukriut, gjendeshin edhe 18 dorëshkrime, pa e thënë se ç'titull mbanin, ç'përmbajtje kishin dhe cilit autor (nëse nuk ishin të Rustem efendiut) i përkisnin. Në këtë bibliotekë, gjithnjë sipas të njëjtit burim, ishte gjetur edhe një fletore, në të cilën ky qytetar i nderuar, hoxhë e atdhetar i madh, kishte mbajtur shënime gjatë qëndrimit të tij në burgun e Nishit. Fletorja qenka studiuar nga ekspertë dhe i qenka kthyer Vakëfit të Prizrenit. Biblioteka e h. Rustem ef. Shportës më vonë paskësh dashur t'i shitet Institutit të Orientalistikës të Sarajevës, por meqë nuk ishin plotësuar kushtet e marrëveshjes, ajo kishte mbetur pa ikur që atje, dhe sot, sipas të njëjtit, gjendet në duar të sigurt (?!).

Ndërkaq, dr. N. Hafizi, në një shkrim të tij për h. Ymer ef. Paçarizin, thotë se Rustem ef. ishte ai që Ymer ef. i preferoi të shkonte në studime në Stamboll, meqë Rustem efendiut atë kohë gjendej atje. Sipas tij, myftiu Rustem ef. Shporta ishte një nga njerëzit më të ditur të Prizrenit. Mirëpo, për arsye politike ishte burgosur, dhe kishte shkruar një vepër fetare (cilën ?), e cila në dorëshkrim origjinal sot ruhet në Entin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Prizrenit.⁵

Dorëshkrimi konkret i "Risalesë..." është gjetur gjatë hulumtimeve tona në Arkivin e Kosovës dhe, kujtojmë, nuk është "fletorja" që përmend M. Shukriu, sepse ajo do të duhej të ishte aty ku ishte dorëzuar, pra në Vakëfin e Prizrenit (d.m.th. në Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit), as nuk është njëri prej atyre 18 dorëshkrimeve të bibliotekës së Rustem ef., sepse "ato janë në duar të sigurt", dhe as nuk është vepra fetare, të cilën e përmend dr. N. Hafizi, sepse ajo "sot ruhet në Entin... e Prizrenit", por është një dorëshkrim unikat, i cili, deri më tani, si edhe dorëshkrimet e tjera të h. Rustem efendiut, nuk është bërë i njohur. Nëse dorëshkrimi konkret - "Risaleja..." ka qenë e njo-

hur për studiuesit e lartpërmendur, atëherë ky dorëshkrim, kujtojmë, qëllimisht është shmangur, për të mos thënë është injoruar, pikërisht për shkak të përmbajtjes kryekëput fetare të tij, ndërsa autorit me apo pa qëllim i është bërë një shërbim shumë i keq.

Sido që të ketë qenë, dorëshkrimi konkret mbanë emërtimin

"Risale fi bejani Esmail-lahi te'ala ve esmai nebijjina alejhis-selam ve esmai xhemi'- l-enbijai-l-medhkureti fi-l-Kur'ani-l-adhim", që ne e përkthym: "Risale mbi shpjegimin e emrave të Allahut të Madhërishëm, të emrave të peygamberit tonë (Muhammedit a.s.) dhe të emrave të të gjithë peygamberëve të përmendur në Kur'anin famëlartë".

Dorëshkrimi është në gjuhën arabe, i shkruar me shkrimin arab "nes'h" shumë të bukur dhe fort korrekt. Ka format 42x17 cm., kurse teksti 40x15cm. Është i shkruar me laps grafik. Letra e bardhë e lëmuet. Ka të shënuar numrin e faqeve dhe përmbledh gjithsej 12 faqe. Është, sikurse u tha, dorëshkrim autograf dhe unikat, prandaj si i tillë pasuron katalogët e dorëshkrimeve orientale të përmasave botërore.

Dorëshkrimi është shkruar, sikurse shkruan, gjatë kohës sa autori ishte në burg në muajin shaban të vitit 1344/1925 nga Rustem Dhihni ibn Ramadani nga Prizreni.

Fillimi i veprës, pas titullit, është bërë, sikurse ka qenë dhe është traditë e veprave islame orientale, me invokacionin "besmele", "hamdele" dhe "salvele".

Në faqen e parë e të dytë, autori i "Risalesë...", h. Rustem ef., bën fjalë për shkaqet që e kanë shtyrë të shkruante këtë vepër, pastaj për qëllimet, vështirësitë që ka hasur gjatë punës, dhe rezultatet e arritura. Në faqen e katërt autori ka shkruar parathënien apo "mukaddimen", në të cilën tregon metodën që ka ndjekur gjatë hartimit të kësaj vepre. Të theksojmë edhe se metoda që ka ndjekur h. Rustem ef. gjatë sistemit të emrave që përmenden në Kur'an, është shumë interesante dhe meriton një studim të veçantë. Në faqet në vazhdim, ai në mënyrë tabelare dhe shumë qartë, ka paraqitur përfundimet e studimit të tij. "Risalenë..." e ka ndarë në 4 kapituj.

Teksti, pas titullit dhe besmeles, fillon: El-hamdu lil-lahi el-ledhi enzele el-Kur'ane 'ala abdihi lijkune lil'alemine nedhira ves-salatu

⁵ Dr. Nimetullah Hafizi, O životu i pesničkim delima Hadži Omer Ljutfi Pačarizija, "Vjetari" i Arkivit të Kosovës, nr. VIII - IX, Prishtinë, 1975, f. 90.

ves-selamu 'ala nebijjihi... emma b'adu felemma suxhintu bi kaderil-lahi te'ala...

Përfundimi i dorëshkrimit: Temmet bi hamdil-lahi te'ala ves-salatu ves-selamu 'ala nebijjina el-mustafa... ver'ham abdeke el-mu'teref bit'-taksir Rrustem Dhihni ibn Ramadan el-Prizreni... vekad sadefe hita-muhu shehril sh'aban senete erbe'a ve erbe'ine ve thelathemiete b'adel elfi min hixhreti....

Nuk do të qe kurrfarë teprimi nëse konstatojmë se haxhi Rrustem ef. Shporta, sipas "Risalesë..." së tij, paraqitet si një lexues i pasionuar dhe shumë i devotshëm i fjalës së Allahut, një njohës i mrekullueshëm i gjuhës dhe shkrimit arab, një studiues i thellë dhe shumë serioz i Kur'anit dhe shkencave të tij. Të na lejohet të themi se edhe sikur të ishte vetëm kjo vepër, do të mjaftonte t'i siguronte h. Rrustem ef. Shportës vend me rëndësi në radhën e ylemave më eruditë të Kosovës dhe më gjerë.

Në vazhdim po japim tekstin e përkthyer të "Risalesë..." të autorit h. Rrustem ef. Shporta, pa duanë të cilën autori e ka shënuar në faqen e dytë. Gjithashtu po paraqesim vetëm përfundimet e studimit të autorit, d.m.th. emrat që përmenden në Kur'an, ashtu si i ka shënuar h. Rrustem ef. Shporta, por pa sjellë dhe shënuar numrin e faqeve të Kur'anit ku ka gjetur autori ata emra, sepse kjo, kujtojmë, do ta ngarkonte tekstin, kurse lexuesin do ta ngatërronte. Kjo, edhe për faktin se nuk dimë se ç'botim të Kur'anit ka përdorur asokohe autori, ndonëse ndonjë studiues i zellshëm këtë shumë lehtë mund ta bëjë.

Shpresojmë se me botimin e "Risalesë..." në njëfarë mase, po kryejmë një obligim moral ndaj h. Rrustem ef. Shportës dhe veprës së tij, ndërsa studiuesve të shkencave kuranore po u ofrojmë një vepër shumë interesante dhe me rëndësi.

"Risale mbi shpjegimin e emrave të Allahut të Madhërishëm, të emrave të pejgamberit tonë - Muhammedit a.s. dhe të emrave të të gjithë pejgamberëve të përmendur në Kur'anin famëlartë".

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili ia shpalli Kur'anin rob të Vet (Muhammedit a.s.) që të bëhet pejgamber (këshillues) i botës.⁶ Salavatet dhe selamet qofshin mbi të dërguarin e Tij, të cilin e dërgoi mëshirë për gjithë botët, përgëzues e këshillues. (Salavatet dhe selamet qofshin) edhe mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij, të cilët patën një nder të madh që ishin në shoqërim të tij dhe të shihnin bukurinë e tij; të cilët luftuan me të; shpenzuan pasurinë e tyre dhe (sakrifikuan) vetveten e tyre në rrugën e tij; dhe të cilët u mbështetën që të gjithë - të mëdhenj e të vegjël - në Kur'an.

Kur isha i burgosur, - e kjo pa dyshim qe caktim i Zotit, - për të falënderuar Atë për butësinë e Tij absolute ndaj robit të tij të përvuajtur, vazhdimisht lexoja Kur'an.

Kështu, gjatë leximit të Kur'anit, vëmendjen ma tërhoqi një gjë: se pejgamberët e tjerë (a.s.) janë përmendur shumë herë në Kur'an, sidomos Nuhi, Ibrahim, Musai dhe Isai (a.s.), kurse pejgamberi ynë (Muhammedi a.s.- vër jonë), edhe pse atij i pati zbritur Kur'ani, është përmendur më pak në raport me ata (pejgamberët e tjerë - vër. jonë).

Kështu, më kaploi smira, aq sa nisa të meditoja e të meditoja për këtë, derisa Allahu xh.sh. më frymëzoi se në Kur'an, për pejgamberin tonë (Muhammedi a.s.) ka shumë emra, dhe se Allahu nga butësia e Tij absolute që ka ndaj tij, e ka përmendur atë me shumë emra të ndryshëm, madje më shumë sesa të gjithë pejgamberët e tjerë së bashku.

Kur kjo zuri vend në zemrën time, ndjeva një kënaqësi dhe qetësi të madhe. Prandaj, desha të mësoja se sa nga emrat e Muhammedit a.s. përmenden në Kur'an, sa është numri i përgjithshëm i atyre emrave që Allahu e ka përmendur, dhe sa nga ata emra kanë për qëllim pikërisht Muhammedin a.s.

Kështu, nxitova ta lexoja Kur'anin, për të dalluar emrat me të cilët qëllim është Muhammedi a.s., qoftë edhe në mënyrë kuptimore (te'vilen), siç do të shihet në mukaddimen - parathënien tonë.

Për këtë shkak kam radhitur të gjithë emrat e pejgamberëve të tjerë, pastaj emrat e njerëzve, exhinëve dhe engjëjve që përmenden në Kur'an.

⁶ El-Furkan, 1.

Kur mbarova, pashë se nga emrat e përmendur në Kur'an, 59 i takonin Muhammedit a.s., dhe ata emra në Kur'an përsëriten gjithsej 675 herë. Në Kur'an ndërkaq, përveç Muhammedit a.s., janë përmendur gjithsej edhe 27 pejgamberë dhe, që të gjithë, përveç Muhammedit a.s., përmenden 524 herë, siç do të shihet nga tabela me të dhënat për secilin veç e veç. Kështu, Muhammedi a.s. në raport me të gjithë pejgamberët e tjerë përmendet 151 herë më shumë se të gjithë ata së bashku. Ky fakt më gëzoi pa masë dhe mbeta i kënaqur nga dashuria që ndiej ndaj Muhammedit a.s., sepse shumësia e të përmendurit dëshmonë për pozitën e lartë që ka i përmenduri, sikundër që shumësia e të përmendurit tregon për dashurinë ndaj të përmendurit, ndonëse unë i dua shumë që të gjithë pejgamberët a.s.

Duke u nisur nga ky fakt, më pas më lindi ideja dhe dëshira të numëroja edhe të gjithë emrat e bukur të Allahut që përmenden në Kur'an, për të mësuar kështu se sa nga emrat e Allahut janë përmendur në Kur'an dhe nga sa herë janë përsëritur ata. Prandaj i shënova dhe i saktësova me numrat e faqeve në të cilat janë përmendur ata emra, për t'ia lehtësuar kështu punën atij që është i interesuar dhe dëshiron të ndalet në këta emra.

Angazhim të veçantë i kam kushtuar dallimit në mes të emrave të Allahut të Madhërishëm dhe të atyre të pejgamberit Muhammed a.s., sepse, siç kam shpjeguar në vazhdim, shumë herë përmenden emra me të cilët jo gjithmonë është për qëllim emri i Allahut xh.sh. dhe i Muhammedit a.s.

Mirëpo, njeriu nuk mund t'u shpëtojë dot mangësive e gabimeve, sidomos një si unë, i mangët në çdo aspekt, aq më parë kur dihet se Kur'ani është një det i thellë dhe i gjerë, që nuk i gjendet dot fundi e as brigjet, dhe, sepse, "edhe po të tuboheshin njerëzit dhe exhinët për të sjellë (bërë) një Kur'an të ngashëm si ky, kurrë nuk do të mund ta bënë, sado që do ta ndihmonin njëri-tjetrin".⁷

Po, si mund të bëhet një i tillë kur ai është të folurit e Allahut xh.sh.; kur në të gjenden dijet e të parëve dhe të mbramëve; ku nuk ka të njomë a të tharë të mos gjendet në Librin e qartë. Kjo, sepse, edhe "sikur të ishte deti ngjyrë për t'i shkruar fjalët e Zotit tim, deti (uji i tij)

do të shterej para se të përfundonin fjalët e Zotit tim"⁸, dhe "sikur ç'ka në tokë nga drunjtë të ishin lapsa, dhe sikur detit t'i shtoheshin edhe shtatë dete (e të jenë ngjyrë) nuk do të mbaronin fjalët e Allahut⁹, d.m.th. kuptimet e fjalëve të Tij. Prandaj, siç thoshte Bajazit el-Bustami: "sikur ne dijetarët të futeshim në det, kurse në brigjet e tij të qendronin pejgamberët, ne do të hynim në det, d. m. th. në Dijen e Zotit - në detin e kuptimeve të fjalëve të Tij, dhe kurrë nuk do të mund t'i arrinim brigjet e tij. Kurse pejgamberët a.s., për shkak të dijes dhe njohurive të tyre, do të notonin dhe do të arrinin në brigjet e detit dhe aty do të ndaleshin. Ne, në krahasim me ta, kurrë nuk do të arrinim në brigjet e atij deti e as të qendronim në to, siç ia kanë arritur pejgamberët a.s.".

Po ashtu, kam gjetur 75 emra të bukur të Allahut xh.sh. që përmenden në Kur'an, të cilët, siç shihet nga tabela, janë përsëritur gjithsej 4.779 herë.

Kështu, kush e lexon Kur'anin në tërësi, ai në fakt po aq herë ka përmendur Allahun xh.sh. E dihet mirëfilli se ndër punët më të vlefshme, është të përmendurit e Allahut xh.sh. me lexim.

Nëse ndokush e gjen ndonjë emër që unë nuk e kam vërejtur, le ta fusë atë në vendin e duhur në tabelë, por këtë le ta bëjë pasi të jetë thelluar dhe të jetë bindur për këtë, ta ketë vërtetuar dhe të jetë i sigurtë, e jo me hamendje.

Kam shpjeguar gjithashtu se në Kur'an janë përmendur emra nga ata të Allahut xh.sh dhe të Muhammedit a.s., por që në fakt nuk kanë për qëllim ata, prandaj i shkrova veç e veç, me qëllim që lexuesi të mos i ngatërrojë ata emra midis tyre.

Allahu është ndihmës për qëllimin e mirë e të sinqertë të atij që angazhohet për këtë, dhe Ai, gjithashtu e di edhe qëllimin e tij. Nëse kam gabuar, pasi që jam angazhuar, qoftë duke shtuar a munguar ndonjë emër, Allahu ma faltë për hir të pejgamberit tonë Muhammedit a.s., sepse unë kurrë nuk do t'i kisha hyrë kësaj pune kaq të vështirë, po të mos qe dashuria ime e madhe ndaj Allahut xh.sh. dhe pejgamberit Muhammed a.s.

(pason duaaja)

⁸ El-Isra, 108.

⁹ Llukman, 27.

⁷ El-Isra, 88.

(Fq. 4)

Mukaddime - Parathënie

Allahu xh.sh. në shenjë nderimi ka emëruar të dashurin e Tij, Muhammedin a.s. me 20 emra: El-Birr, El-Xhami', El-Xhebbar, El-Hakk, Err-Rreuf, Err-Rrahim, Es-Sadik, El-Afuvv, El-Aziz, El-Kavijj, El-Kerim, El-Metin, El-Mubin, El-Muhejmin, El-Muhji, El-Muxhib, En-Nur, El-Vekil, El-Velijj dhe El-Hadi.

Këta emra kanë për qëllim anën kuptimore të emrit e jo esencën e tij. Njësoj është edhe tek emrat e Allahut xh.sh., përveç emrit Lafdhail-Xhelal - Allah, i Cili, në të vërtetë, është emër i qenësisë së të Lartmadhërishmit.

Për shembull, fjala "el-hakku" në Kur'an është përmendur më shumë se 250 herë. Nga kjo shifër nganjëherë synohet Allahu xh.sh., nganjëherë, sipas kuptimit, synohet Muhammedi a.s., e në disa raste është përmendur sipas kuptimit të vërtetë që ka fjala "el-hakku" - i/e drejtë, i/e vërtetë.

Prandaj, në tabelën në vazhdim, do t'i përmendim që të tri këto mënyra, të ndara në tri shtylla, e gjithashtu edhe emrat e tjerë të përbashkët do t'i përmendim veç e veç.

Këtë metodë do ta vazhdojmë edhe tek emrat e tjerë, duke përmendur secilin veç e veç. Për të qenë dobia më e madhe, do të përmendim gjithashtu edhe fjalët me të cilat kuptohet një nga emrat e Allahut xh.sh ose fjalët që kanë të bëjnë me një nga emrat e Pejgamberit a.s., por që nuk kanë për qëllim as Allahun e as pejgamberin Muhammed a.s.

1. Emrat e Allahut xh.sh. që përmenden në Kur'an:

1. Emri *Allah xh.sh.* përmendet gjithsej 2739 herë (emri *Ilah* që ka për qëllim Allahun xh.sh. në Kur'an përmendet gjithsej 28 herë)

2. *Err-Rabb*, gjithsej 958 (ky emër përmendet edhe 4 herë të tjera, por nuk ka për qëllim Allahun xh.sh.)
3. *El-Alim* - përmendet gjithsej 151 herë (emri el-alim, përveç emrit të Allahut, në Kur'an përmendet 9 herë).
4. *El-Hakk* - gjithsej 130 herë (pa pasur për qëllim Allahun xh.sh., përmendet 34 herë)
5. *Err-Rrahim* - gjithsej 112.
6. *El-Hakim* - gjithsej 91 herë (pa pasur për qëllim emrin e Allahut përmendet 4 herë)
7. *El-Aziz* - gjithsej 88 herë (pa pasur për qëllim emrin e Allahut xh.sh. e as të Muhammedit a . s., përmendet 9 herë)
8. *Err-Rrahman* - gjithsej 53 herë .
9. *Es-Semi'* - 45 herë (përveç emrit të Allahut xh.sh., përmendet 2 herë)
10. *El-Habir* - 45 herë
11. *El-Besir* - gjithsej 42 herë (përveç emrit të Allahut, gjendet në 6 vende)
12. *El-Gafur* - gjithsej 90 herë
13. *El-Velijj* - gjithsej 30 herë (përveç emrit të Allahut dhe të Muhammedit a.s., përmendet në 9 vende)
14. *El-Vahid* - gjithsej 22 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet në 8 vende)
15. *Esh-Shehid* - gjithsej 20 herë (përveç emrit të Allahut dhe të Muhammedit a.s., përmendet në 11 vende)
16. *El-Ganijj* - gjithsej 18 herë (vetëm një herë përmendet pa pasur për qëllim emrin e Allahut xh.sh.)
17. *El-Hami* - gjithsej 17 herë
18. *El-Vekil* - gjithsej 17 herë
19. *El-Kadir* - gjithsej 12 herë
20. *Et-Tevvab* - gjithsej 11 herë
21. *El-Halim* - gjithsej 11 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet në 3 vende)
22. *El-'Adhim* - gjithsej 11 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet 98 herë, siç do të shihet kur të bëhet fjalë në vazhdim për këtë temë)
23. *El-Halik* - gjithsej 10 herë
24. *Err-Rreuf* - gjithsej 10 herë
25. *El-Vasi'* - gjithsej 9 herë

26. *El-Kavijj* - 9 herë (përveç emrit të Allahut, në 2 vende)
27. *El-'Alij* - 9 herë (dy herë përveç emrit të Allahut)
28. *El-Kebir* - 7 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet 33 herë)
29. *El-Letif* - 7 herë
30. *El-Kahhar* - 6 herë
31. *El-Hajj* - 5 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet në 14 vende)
32. *El-'Afuvv* - 5 herë
33. *El-Gaffar* - 5 herë
34. *El-Melik* - 5 herë (përveç emrit të Allahut, gjendet edhe në 6 vende)
35. *El-Hadi* - 5 herë
36. *El-Hafidh* - 4 herë (përveç emrit të Allahut, përmendet edhe 7 herë)
37. *Es-Selam* - 4 herë (përveç emrit të Allahut, gjendet edhe në 36 vende)
38. *Esh-Shekur* - 6 herë
39. *El-Hasib* - 3 herë (që nuk është emër i Allahut, përmendet 1 herë)
40. *Err-Rrekib* - 3 herë (që nuk është emër i Allahut xh.sh., përmendet 2 herë)
41. *El-'Adl* - 3 herë (që nuk është emër i Allahut xh.sh., përmendet 9 herë)
42. *El-Kajjum* - 3 herë
43. *El-Metin* - 3 herë
44. *El-Muktedir* - 3 herë
45. *En-Nuru* - 3 herë (që nuk është emër i Allahut xh.sh. dhe as i Muhammedit a.s., përmendet 16 herë)
46. *El-Vehhab* - 3 herë
47. *El-Kerim* - 2 herë (që nuk është emër i Allahut xh.sh. e as i Muhammedit a.s. përmendet 23 herë)
48. *El-Mexhid* - 2 herë (që nuk është emër i Allahut përmendet 1 herë)
49. *El-Bari* - 2 herë
50. *El-Bedi'* - 2 herë
51. *El-Xhami'* - 2 herë
52. *El-Kuddus* - 2 herë
53. *El-Muhji* - 2 herë
54. *El-Vedud* - 2 herë
55. *Dhul-Xhelali ve El-Ikram* - 2 herë

1. Emrat e Allahut xh.sh. që përmenden vetëm nga një herë në Kur'an janë

56. *Maliku-l-Mulk* - 1 herë
57. *El-Mukit* - 1 herë
58. *El-Muxhib* - 1 herë
59. *El-Vali* - 1 herë
60. *El-Mute'ali* - 1 herë
61. *El-Mubin* - 1 herë
62. *El-Fettah* - 1 herë
63. *Err-Rrezzak* - 1 herë
64. *El-Birr* - 1 herë
65. *El-Evvel* - 1 herë
66. *El-Ahir* - 1 herë
67. *Edh-Dhahir* - 1 herë (përveç emrit Allah përmendet edhe 3 herë)
68. *El-Batin* - 1 herë
69. *El-Mu'min* - 1 herë (përveç emrit Allah përmendet edhe 20 herë)
70. *El-Muhejmin* - 1 herë
71. *El-Xhebbar* - 1 herë (përveç emrit të Allahut xh.sh. dhe emrit të Muhammedit a.s., përmendet edhe 5 herë të tjera)
72. *El-Mutekebbir* - 1 herë (vetëm 1 herë përmendet përveç emrit të Allahut xh.sh.)
73. *El-Musavvir* - 1 herë
74. *El-Ehad* - 1 herë (përmendet edhe 59 herë, por që nuk ka për qëllim Allahun xh.sh.)
75. *Es-Samed* - 1 herë

1. 2. Emrat e Allahut xh.sh. që nuk përmenden qartë në Kur'an:

1. *El-Basit*
2. *El-Baith*
3. *El-Baki*
4. *El-Xhelil*

5. *El-Hafidh*
6. *El-Hikem*
7. *Err-Rrafi'*
8. *Err-Rreshid* (emri i Allahut *Err-Rreshid* nuk përmendet në Kur'an, ndërsa ky emër pa pasur për qëllim Allahun xh.sh., përmendet 3 herë).
9. *Es-Sabur*
10. *Ed-Darr-rr*
11. *El-Kabid*
12. *El-Maxhid*
13. *El-Mani'*
14. *El-Mueh-hir*
15. *El-Mubdi*
16. *El-Muhsi*
17. *El-Mudhil-l*
18. *El-Mu'izz*
19. *El-Mu'ir*
20. *El-Mugnijj*
21. *El-Mukaddim*
22. *El-Mukassid*
23. *El-Muhit*
24. *El-Muntekim*
25. *En-Nafi'u*
26. *El-Vaxhid*
27. *El-Varith*
28. *Es-Settar*
29. *El-Mu'ti*
30. *El-Mun'im*
31. *Es-Sadiku xhel-le xhelaluhu*

Allahu xh.sh. në Kur'an përmendet gjithsej 4779 herë. Allahu e di se sa dhe si i ka përmendur ata emra të bukur të Tij. Ne i kemi gjetur ata sipas angazhimit tonë. Allahu na faltë për gabimet që kemi bërë. Ai më të vërtetë është Mëkatefalës, Falës, Përdellimtarë dhe Mirënjohës i madh.

2. Emrat e Muhammedit a.s. që përmenden në Kur'an

1. Emri *Muhammed a.s.* përmendet gjithsej 4 herë
2. *Resul* - përmendet 186 herë (emri err-rresul, por që nuk ka për qëllim Muhammedin a.s. në Kur'an përmendet gjithsej 51 herë, si në vazhdim: 1. për të gjithë pejgamberët a.s. - 16 herë, 2. Isai a.s. - 8 herë, 3. Musai a.s. - 11 herë, 4. Musai dhe Haruni a.s. - 1 herë, 5. Nuhi a.s. - 1 herë, 6. Nuhi dhe Hudi a.s. - 2 herë, 7. Ismail a.s. - 1 herë, 8. Ibrahim a.s. - 1 herë, 9. Salihu a.s. - 2 herë, 10. Luti dhe Shuajbi a.s. - 2 herë, 11. Hudi a.s. - 1 herë. 12. Meleku (engjëlli) - 3 herë. 13. Xhebraili - 1 herë, 14. (të gjithë pejgamberët) sipas kuptimit - 1 herë)
3. *Nebijj* - 36 herë (fjala *nebij* por që nuk ka për qëllim Muhammedin a.s., në Kur'an përmendet 17 herë)
4. *Nedhir* - 35 herë (që nuk ka për qëllim Muhammedin a.s., 8 herë)
5. *Huda* - 53 herë (që nuk ka për qëllim Muhammedin a.s., 32 herë)
6. *Hakk* - 83 herë
7. *En-Nur* - 22 herë
8. *Rahmet* - 37 herë (që nuk ka për qëllim Muhammedin a.s., 71 herë)
9. *Dhikrull-llah* - 31 herë (që nuk mund të thuhet se a ka për qëllim Muhammedin a.s., përmendet 6 herë)
10. *Ni'met* - 22 herë (që nuk ka për qëllim emrin Muhammedit a.s., 22 herë)
11. *Siratu Mustekim* - 26 herë (që nuk ka për qëllim emrin e Muhammedit a.s., 11 herë)
12. *Mubin* - 12 herë - përveç emrit të Allahut dhe të Muhammedit a.s., kjo fjalë në Kur'an përmendet edhe 106 herë)
13. *Abdull-llah* - 10 herë (që nuk ka për qëllim emrin e Muhammedit a.s., 14 herë)
14. *Beshir* - 8 herë (që nuk ka për qëllim emrin e Muhammedit a.s., 1 herë)
15. *Bushra* - 7 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., përmendet 8 herë)
16. *Munedhahir* - 7 herë
17. *Vekil* - 7 herë
18. *Velijj* - 6 herë
19. *Shahid* - 6 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 2 herë)
20. *Had* - 5 herë

21. *Da'i* - 4 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 4 herë)
22. *Ummijj* - 4 herë
23. *Shelih* - 4 herë
24. *Shefi'u* - 4 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 1 herë)
25. *Kajjim* - 4 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 1 herë)
26. *Mubeshshir* - 4 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 1 herë)
27. *Kerim* - 3 herë
28. *Tajjib* - 3 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 9 herë)
29. *Muhted* - 3 herë
30. *Hizbull-llah* - 3 herë
31. *Aziz* - 2 herë
32. *Sidk* - 2 herë (përveç emrit të Muhammedit a.s., 5 herë)
33. *Misbah* - 2 herë
34. *Ruhul-Hakk* - 2 herë
35. *Siratull-llah* - 2 herë
36. *Urvetun vuthka* - 2 herë

2.1. Emrat e Muhammedit a.s.

që përmenden në Kur'an vetëm nga 1 herë janë:

37. *Xhami'* - 1 herë
38. *Xhebbbar* - 1 herë
39. *Reuf* - 1 herë
40. *Rahim* - 1 herë
41. *Muhejmin* - 1 herë
42. *Edhine hajr* - 1 herë
43. *Harisun* - 1 herë
44. *Kademe sidkin* - 1 herë
45. *Ta Ha* - 1 herë
46. *Hatemun-nebijjin* - 1 herë
47. *Ja Sin* - 1 herë
48. *Ahmed* - 1 herë
49. *Muzzemmil* - 1 herë
50. *Muddeththir* - 1 herë
51. *Muta'in* - 1 herë
52. *Dhu kuvvetin* - 1 herë

53. *En-Nexhmuth-thakib* - 1 herë
54. *Mudhdhekkir* - 1 herë
55. *Emin* - 1 herë
56. *Siraxh* - 1 herë
57. *Meshhud* - 1 herë
58. *Mekin* - 1 herë
59. *Munir* - 1 herë

Pejgamberi ynë Muhammed a.s. në Kur'an përmendet me 59 emra dhe gjithsej 675 herë.

3. Emrat e 27 pejgamberëve a.s.

që përmenden në Kur'an, përveç Muhammedit a.s.

1. *Ademi* (Safijull-llah) a.s. - 25 herë
2. *Idrisi a.s.* - 2 herë
3. *Nuhi* (Nexhijull-llah) a.s. - 43 herë
4. *Hudi a.s.* - 7 herë
5. *Salihu a.s.* - 9 herë
6. *Shuajbi a.s.* - 11 herë
7. *Ibrahimi* (Halilull-llah) a.s. - 69 herë
8. *Ejjubi a.s.* - 4 herë
9. *Junusi a.s.* - (1 herë përmendet si Dhen-nun dhe 1 herë si Sahibul-huti) gjithsej - 6 herë
10. *Dhulkarnejni a.s.* - 2 herë
11. *Iljasi a.s.* - 1 herë
12. *Lukmani a.s.* - 2 herë
13. *Luti a.s.* - 27 herë
14. *Ismaili a.s.* - 12 herë
15. *Eljesai a.s.* - 2 herë
16. *Dhulkifli a.s.* - 2 herë
17. *Ishaku a.s.* - 17 herë
18. *Jakubi a.s.* - 16 herë
19. *Jusuifi a.s.* - 27 herë
20. *Zekerija a.s.* - 7 herë
21. *Jahajai a.s.* - 5 herë
22. *Musa* (Kelimull-llah) a.s. - 124 herë

23. *Haruni a.s.* - 19 herë
24. *Davudi a.s.* - 16 herë
25. *Sulejmani a.s.* - 17 herë
26. *Isai (Ruhull-llah) a.s.* - 38 herë
27. *Uzejri a.s.* - 1 herë

Të gjithë pejgamberët e Allahut, pa Muhammedin a.s., në Kur'an përmenden gjithsej 524 herë, kurse së bashku me Muhammedin a.s. përmenden (524 + 675) gjithsej 1199 herë.

4. Emrat e tjerë që përmenden në Kur'an përveç emrave të Allahut xh . sh., Muhammedit a.s. dhe të pejgamberëve a.s.

1. *Merjemi* (radijAll-llahu anha) përmendet 34 herë
2. *Imrani* - 3 herë
3. *Taluti* - 2 herë
4. *Tubbe'i* - 2 herë
5. *Nesuh* - 1 herë
6. Emrat e engjëjve:
 - 1 - *Xhebraili a.s.* 3 herë
 - 2 - *Mikaili a.s.* - 1 herë
 - 3 - *Haruti* - 1 herë
 - 4 - *Maruti* - 1 herë
 - 5 - *Maliku* (hazinun-nari) - 1 herë
7. *Je'xhuxh dhe Me'xhuxh* - 2 herë
8. *Dabbetu-l-erdi* - 1 herë
9. *Shejtani* (mallkimi qoftë mbi të) - 81 herë
10. *Faraoni* (e gjetë atë që ka merituar) - 74 herë
11. *Hamani* (e gjetë atë që ka merituar) - 6 herë
12. *Karuni* (e gjetë atë që ka merituar) - 4 herë
13. *Samirijju* (e gjetë atë që ka merituar) - 3 herë
14. *Xhaluti* (e gjetë atë që ka merituar) - 3 herë
15. *Azeri* - 1 herë
16. *Ebi Lehebi* - 1 herë
17. *Misiri* (vendi i faraonëve) - 5 herë

18. *Meke-i Mukerreme* – në Kur'an përmendet me 11 emra dhe gjithsej 50 herë:

- 1 - *Bejt* - 15 herë
- 2 - *Mesxhidu-l-haram* - 15 herë
- 3 - *Beledu Emini* - 6 herë
- 4 - *Karjetu Aminin* - 3 herë
- 5 - *Kible* - 2 herë
- 6 - *Ka'be* - 2 herë
- 7 - *Haramun aminin* - 2 herë
- 8 - *Ummu-l-Kurra* - 2 herë
- 9 - *Mekke* - 1 herë
- 10 - *Bekke* - 1 herë
- 11 - *Mesh'ari-l-haram* - 1 herë

19. *Medine El-Munevvere* në Kur'an përmendet 5 herë me dy emra:
 - 1 - *Medine* - 4 herë
 - 2 - *Jethrib* - 1 herë

١٨٨	١٨٩	١٩٠	١٩١	١٩٢	١٩٣	١٩٤	١٩٥	١٩٦	١٩٧	١٩٨	١٩٩	٢٠٠	٢٠١	٢٠٢	٢٠٣	٢٠٤	٢٠٥	٢٠٦	٢٠٧	٢٠٨	٢٠٩	٢١٠	٢١١	٢١٢	٢١٣	٢١٤	٢١٥	٢١٦	٢١٧	٢١٨	٢١٩	٢٢٠	٢٢١	٢٢٢	٢٢٣	٢٢٤	٢٢٥	٢٢٦	٢٢٧	٢٢٨	٢٢٩	٢٣٠	٢٣١	٢٣٢	٢٣٣	٢٣٤	٢٣٥	٢٣٦	٢٣٧	٢٣٨	٢٣٩	٢٤٠	٢٤١	٢٤٢	٢٤٣	٢٤٤	٢٤٥	٢٤٦	٢٤٧	٢٤٨	٢٤٩	٢٥٠	٢٥١	٢٥٢	٢٥٣	٢٥٤	٢٥٥	٢٥٦	٢٥٧	٢٥٨	٢٥٩	٢٦٠	٢٦١	٢٦٢	٢٦٣	٢٦٤	٢٦٥	٢٦٦	٢٦٧	٢٦٨	٢٦٩	٢٧٠	٢٧١	٢٧٢	٢٧٣	٢٧٤	٢٧٥	٢٧٦	٢٧٧	٢٧٨	٢٧٩	٢٨٠	٢٨١	٢٨٢	٢٨٣	٢٨٤	٢٨٥	٢٨٦	٢٨٧	٢٨٨	٢٨٩	٢٩٠	٢٩١	٢٩٢	٢٩٣	٢٩٤	٢٩٥	٢٩٦	٢٩٧	٢٩٨	٢٩٩	٣٠٠	٣٠١	٣٠٢	٣٠٣	٣٠٤	٣٠٥	٣٠٦	٣٠٧	٣٠٨	٣٠٩	٣١٠	٣١١	٣١٢	٣١٣	٣١٤	٣١٥	٣١٦	٣١٧	٣١٨	٣١٩	٣٢٠	٣٢١	٣٢٢	٣٢٣	٣٢٤	٣٢٥	٣٢٦	٣٢٧	٣٢٨	٣٢٩	٣٣٠	٣٣١	٣٣٢	٣٣٣	٣٣٤	٣٣٥	٣٣٦	٣٣٧	٣٣٨	٣٣٩	٣٤٠	٣٤١	٣٤٢	٣٤٣	٣٤٤	٣٤٥	٣٤٦	٣٤٧	٣٤٨	٣٤٩	٣٥٠	٣٥١	٣٥٢	٣٥٣	٣٥٤	٣٥٥	٣٥٦	٣٥٧	٣٥٨	٣٥٩	٣٦٠	٣٦١	٣٦٢	٣٦٣	٣٦٤	٣٦٥	٣٦٦	٣٦٧	٣٦٨	٣٦٩	٣٧٠	٣٧١	٣٧٢	٣٧٣	٣٧٤	٣٧٥	٣٧٦	٣٧٧	٣٧٨	٣٧٩	٣٨٠	٣٨١	٣٨٢	٣٨٣	٣٨٤	٣٨٥	٣٨٦	٣٨٧	٣٨٨	٣٨٩	٣٩٠	٣٩١	٣٩٢	٣٩٣	٣٩٤	٣٩٥	٣٩٦	٣٩٧	٣٩٨	٣٩٩	٤٠٠	٤٠١	٤٠٢	٤٠٣	٤٠٤	٤٠٥	٤٠٦	٤٠٧	٤٠٨	٤٠٩	٤١٠	٤١١	٤١٢	٤١٣	٤١٤	٤١٥	٤١٦	٤١٧	٤١٨	٤١٩	٤٢٠	٤٢١	٤٢٢	٤٢٣	٤٢٤	٤٢٥	٤٢٦	٤٢٧	٤٢٨	٤٢٩	٤٣٠	٤٣١	٤٣٢	٤٣٣	٤٣٤	٤٣٥	٤٣٦	٤٣٧	٤٣٨	٤٣٩	٤٤٠	٤٤١	٤٤٢	٤٤٣	٤٤٤	٤٤٥	٤٤٦	٤٤٧	٤٤٨	٤٤٩	٤٥٠	٤٥١	٤٥٢	٤٥٣	٤٥٤	٤٥٥	٤٥٦	٤٥٧	٤٥٨	٤٥٩	٤٦٠	٤٦١	٤٦٢	٤٦٣	٤٦٤	٤٦٥	٤٦٦	٤٦٧	٤٦٨	٤٦٩	٤٧٠	٤٧١	٤٧٢	٤٧٣	٤٧٤	٤٧٥	٤٧٦	٤٧٧	٤٧٨	٤٧٩	٤٨٠	٤٨١	٤٨٢	٤٨٣	٤٨٤	٤٨٥	٤٨٦	٤٨٧	٤٨٨	٤٨٩	٤٩٠	٤٩١	٤٩٢	٤٩٣	٤٩٤	٤٩٥	٤٩٦	٤٩٧	٤٩٨	٤٩٩	٥٠٠	٥٠١	٥٠٢	٥٠٣	٥٠٤	٥٠٥	٥٠٦	٥٠٧	٥٠٨	٥٠٩	٥١٠	٥١١	٥١٢	٥١٣	٥١٤	٥١٥	٥١٦	٥١٧	٥١٨	٥١٩	٥٢٠	٥٢١	٥٢٢	٥٢٣	٥٢٤	٥٢٥	٥٢٦	٥٢٧	٥٢٨	٥٢٩	٥٣٠	٥٣١	٥٣٢	٥٣٣	٥٣٤	٥٣٥	٥٣٦	٥٣٧	٥٣٨	٥٣٩	٥٤٠	٥٤١	٥٤٢	٥٤٣	٥٤٤	٥٤٥	٥٤٦	٥٤٧	٥٤٨	٥٤٩	٥٥٠	٥٥١	٥٥٢	٥٥٣	٥٥٤	٥٥٥	٥٥٦	٥٥٧	٥٥٨	٥٥٩	٥٦٠	٥٦١	٥٦٢	٥٦٣	٥٦٤	٥٦٥	٥٦٦	٥٦٧	٥٦٨	٥٦٩	٥٧٠	٥٧١	٥٧٢	٥٧٣	٥٧٤	٥٧٥	٥٧٦	٥٧٧	٥٧٨	٥٧٩	٥٨٠	٥٨١	٥٨٢	٥٨٣	٥٨٤	٥٨٥	٥٨٦	٥٨٧	٥٨٨	٥٨٩	٥٩٠	٥٩١	٥٩٢	٥٩٣	٥٩٤	٥٩٥	٥٩٦	٥٩٧	٥٩٨	٥٩٩	٦٠٠	٦٠١	٦٠٢	٦٠٣	٦٠٤	٦٠٥	٦٠٦	٦٠٧	٦٠٨	٦٠٩	٦١٠	٦١١	٦١٢	٦١٣	٦١٤	٦١٥	٦١٦	٦١٧	٦١٨	٦١٩	٦٢٠	٦٢١	٦٢٢	٦٢٣	٦٢٤	٦٢٥	٦٢٦	٦٢٧	٦٢٨	٦٢٩	٦٣٠	٦٣١	٦٣٢	٦٣٣	٦٣٤	٦٣٥	٦٣٦	٦٣٧	٦٣٨	٦٣٩	٦٤٠	٦٤١	٦٤٢	٦٤٣	٦٤٤	٦٤٥	٦٤٦	٦٤٧	٦٤٨	٦٤٩	٦٥٠	٦٥١	٦٥٢	٦٥٣	٦٥٤	٦٥٥	٦٥٦	٦٥٧	٦٥٨	٦٥٩	٦٦٠	٦٦١	٦٦٢	٦٦٣	٦٦٤	٦٦٥	٦٦٦	٦٦٧	٦٦٨	٦٦٩	٦٧٠	٦٧١	٦٧٢	٦٧٣	٦٧٤	٦٧٥	٦٧٦	٦٧٧	٦٧٨	٦٧٩	٦٨٠	٦٨١	٦٨٢	٦٨٣	٦٨٤	٦٨٥	٦٨٦	٦٨٧	٦٨٨	٦٨٩	٦٩٠	٦٩١	٦٩٢	٦٩٣	٦٩٤	٦٩٥	٦٩٦	٦٩٧	٦٩٨	٦٩٩	٧٠٠	٧٠١	٧٠٢	٧٠٣	٧٠٤	٧٠٥	٧٠٦	٧٠٧	٧٠٨	٧٠٩	٧١٠	٧١١	٧١٢	٧١٣	٧١٤	٧١٥	٧١٦	٧١٧	٧١٨	٧١٩	٧٢٠	٧٢١	٧٢٢	٧٢٣	٧٢٤	٧٢٥	٧٢٦	٧٢٧	٧٢٨	٧٢٩	٧٣٠	٧٣١	٧٣٢	٧٣٣	٧٣٤	٧٣٥	٧٣٦	٧٣٧	٧٣٨	٧٣٩	٧٤٠	٧٤١	٧٤٢	٧٤٣	٧٤٤	٧٤٥	٧٤٦	٧٤٧	٧٤٨	٧٤٩	٧٥٠	٧٥١	٧٥٢	٧٥٣	٧٥٤	٧٥٥	٧٥٦	٧٥٧	٧٥٨	٧٥٩	٧٦٠	٧٦١	٧٦٢	٧٦٣	٧٦٤	٧٦٥	٧٦٦	٧٦٧	٧٦٨	٧٦٩	٧٧٠	٧٧١	٧٧٢	٧٧٣	٧٧٤	٧٧٥	٧٧٦	٧٧٧	٧٧٨	٧٧٩	٧٨٠	٧٨١	٧٨٢	٧٨٣	٧٨٤	٧٨٥	٧٨٦	٧٨٧	٧٨٨	٧٨٩	٧٩٠	٧٩١	٧٩٢	٧٩٣	٧٩٤	٧٩٥	٧٩٦	٧٩٧	٧٩٨	٧٩٩	٨٠٠	٨٠١	٨٠٢	٨٠٣	٨٠٤	٨٠٥	٨٠٦	٨٠٧	٨٠٨	٨٠٩	٨١٠	٨١١	٨١٢	٨١٣	٨١٤	٨١٥	٨١٦	٨١٧	٨١٨	٨١٩	٨٢٠	٨٢١	٨٢٢	٨٢٣	٨٢٤	٨٢٥	٨٢٦	٨٢٧	٨٢٨	٨٢٩	٨٣٠	٨٣١	٨٣٢	٨٣٣	٨٣٤	٨٣٥	٨٣٦	٨٣٧	٨٣٨	٨٣٩	٨٤٠	٨٤١	٨٤٢	٨٤٣	٨٤٤	٨٤٥	٨٤٦	٨٤٧	٨٤٨	٨٤٩	٨٥٠	٨٥١	٨٥٢	٨٥٣	٨٥٤	٨٥٥	٨٥٦	٨٥٧	٨٥٨	٨٥٩	٨٦٠	٨٦١	٨٦٢	٨٦٣	٨٦٤	٨٦٥	٨٦٦	٨٦٧	٨٦٨	٨٦٩	٨٧٠	٨٧١	٨٧٢	٨٧٣	٨٧٤	٨٧٥	٨٧٦	٨٧٧	٨٧٨	٨٧٩	٨٨٠	٨٨١	٨٨٢	٨٨٣	٨٨٤	٨٨٥	٨٨٦	٨٨٧	٨٨٨	٨٨٩	٨٩٠	٨٩١	٨٩٢	٨٩٣	٨٩٤	٨٩٥	٨٩٦	٨٩٧	٨٩٨	٨٩٩	٩٠٠	٩٠١	٩٠٢	٩٠٣	٩٠٤	٩٠٥	٩٠٦	٩٠٧	٩٠٨	٩٠٩	٩١٠	٩١١	٩١٢	٩١٣	٩١٤	٩١٥	٩١٦	٩١٧	٩١٨	٩١٩	٩٢٠	٩٢١	٩٢٢	٩٢٣	٩٢٤	٩٢٥	٩٢٦	٩٢٧	٩٢٨	٩٢٩	٩٣٠	٩٣١	٩٣٢	٩٣٣	٩٣٤	٩٣٥	٩٣٦	٩٣٧	٩٣٨	٩٣٩	٩٤٠	٩٤١	٩٤٢	٩٤٣	٩٤٤	٩٤٥	٩٤٦	٩٤٧	٩٤٨	٩٤٩	٩٥٠	٩٥١	٩٥٢	٩٥٣	٩٥٤	٩٥٥	٩٥٦	٩٥٧	٩٥٨	٩٥٩	٩٦٠	٩٦١	٩٦٢	٩٦٣	٩٦٤	٩٦٥	٩٦٦	٩٦٧	٩٦٨	٩٦٩	٩٧٠	٩٧١	٩٧٢	٩٧٣	٩٧٤	٩٧٥	٩٧٦	٩٧٧	٩٧٨	٩٧٩	٩٨٠	٩٨١	٩٨٢	٩٨٣	٩٨٤	٩٨٥	٩٨٦	٩٨٧	٩٨٨	٩٨٩	٩٩٠	٩٩١	٩٩٢	٩٩٣	٩٩٤	٩٩٥	٩٩٦	٩٩٧	٩٩٨	٩٩٩	١٠٠٠
-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	------

رسالة في بيان أسماء الله تعالى وأسماء نبينا عليه السلام وأسماء جميع الأنبياء المذكورة في القرآن العظيم
 بسم الله الرحمن الرحيم وبه نستعين
 الحمد لله الذي أنزل القرآن على عبده ليكون للعالمين نذيرا والصلوة و
 السلام على نبيه الذي أرسله رحمة للعالمين بشيرا ونذيرا وعلى آله
 وأصحابه الذين فازوا بصحبته ورؤيته جماله فوزا عظيما وجاهدوا معه
 ونزلوا أموالهم وأنفسهم في سبيله وسلكوا القرآن باجمعهم صغيرا
 وكبيرا أما بعد فلما سمعت بقدر الله تعالى حمدا على الظافر الخطير
 على عبده الحقير وكنت أقرأ القرآن خطري حين فرئت أن الأنبياء
 عليهم السلام صلوات الله الملك المنان قد ذكر ذكرهم في القرآن خصوصا
 سيدنا نوح وإبراهيم وموسى وعيسى صلوات الله عليهم أجمعين
 وذكر نبينا عليه السلام مع أنه نزل القرآن عليه خليل بالنسبة
 إليهم فآخذني الغيرة منه وكنت أفكر فيه فالرحمى الله تعالى
 أن نبينا عليه السلام أسماء كثيرة فباطفه تعالى له ذكره بأسمائه
 المتعددة الكثيرة أكثر من غيرهم فلما بقي في ظلي هذا كنت في سرور
 ونشاط عظيم فمن هذا اردت أن أعلمكم كم من أسماء الله عليه السلام
 ذكر في القرآن العظيم ولم يقدر ذكره بجميع أسمائه فشملت
 في القرائة التحيين الأسماء المراد به نبينا عليه الصلوة والسلام
 ولزنا وأبلا كما يحكي في المقدسة وبسبب ذلك كثرت جميع الأسماء
 الأنبياء وأسماء غيرهم من الأنس والجن والملائكة فلما تمكنت
 وجدت تسعة وخمسين اسما لنبينا عليه الصلوة والسلام

“RISALEJA” – AN IMPORTANT CONTRIBUTION TO THE KORANIC SCIENCES

(Summary)

Hajj Rustem ef. Shporta is among the most distinguished intellectuals of the town of Prizren in the first part of the XX century. Despite this, there are no written records on the life and work of this distinguished patriot.

He is best remembered as one of the leading members of the commission for the construction of a hydroelectric station in Prizren.

Thanks to the efforts of this organization, in 1909, the construction of a hydroelectric station over the Bistrica River began in Prizren.

رسول رجب – صادق محمد

منشور "الرسالة" للحاج رستم شبورتا كتاب مهم لدراسة علوم القرآن

(خلاصة البحث)

الحاج رستم شبورتا ينتمي إلى المجموعة المختارة للمثقفين الذين عاشوا بمدينة بريزن في بداية القرآن العشرين، إلا أن حسب معلوماتنا ما كتب عن حياته و عمله يعتبر شيئاً قليلاً جداً.

شهرته تكمن في أنه كان في قائمة اللجنة التي قامت ببناء محطة مائية لإنتاج الطاقة الكهربائية بمدينة بريزن سنة ١٩٠٨ و اعتماداً على جهوده بدأ بناء المخطط المذكورة فوق نهر "بستريسا" سنة ١٩٠٩م أكثر مما هو معروف بمساهماته كعالم كبير.

أحمد صقز

الجن

(خلاصة البحث)

من أصعب الموضوعات لاي كاتب هو ان يكتب عن الجن. هل هم يسمون جنا او ارواحا او شياطين او دجالين و هل هم مخلوقات؟ هل هم الذين يخوفون الناس و يهاجموهم و يحكموهم في بيوتهم؟ هل هم الوحيدون الذين يقدمون المساعدة و يأخذون المعلومات و كذلك خبرا ما لاي شخص هو في حاجة اليه في اى مكان من العالم؟ هل باستطاعتهم القاء الاذى بالناس؟ و هل صحيح انهم يتلقون معلومات من السماء؟ هل هم الوحيدون الذين بإمكانهم التنبؤ بالمستقبل؟

DORËSHKRIME

Gazmend Shpuza

KOLEKSIONI I DORËSHKRIMEVE ORIENTALE I BUSHATASVE

Historiografia shqiptare edhe në kushtet e mbizotërimit të rreptë të kriterit klasor në vlerësimin e personaliteteve historike ka mundur të japë, përgjithësisht, gjykime objektive për feudalë si Bushatasit dhe Ali Tepelena. Kjo dhe për faktin se figura me përmasa të tilla, pa bërë fjalë në këtë rast për Gjergj Kastriotin Skenderbeun, ishte shumë vështirë të futeshin nëpër kallëpet e ngurta të politizuara dhe të ideologjizuara të së ashtuquajturës filozofi marksiste-leniniste. Megjithatë, kërkesat e kësaj filozofie zyrtare që shtroheshin përpara studiuesve të figurave dhe dukurive historike, diktonin jo vetëm tematikën, drejtimet dhe ritmet e studimeve tona. Ato kanë lënë gjurmë, pak së paku, në vlerësimin me dorë të shtrënguar të ngjarjeve dhe sidomos të mjaft personaliteteve borgjezë dhe, sidomos, feudalë e klerikë. Mbizotëronte prirja për të parë te këta përfaqësues të klasave të larta të kohës së sundimit osman, në radhë të parë e kryesisht, për të mos thënë tërësisht, vetëm shhfrytëzuesin, vetëm qeveritarin e lidhur pas Portës së Lartë, vetëm veglën ideologjike të saj, vetëm komandantin mercenar që në të gjitha veprimet e tij udhëhiqej kryekëput nga interesa të ngushtë vetiakë.

Ky këndvështrim i ideologjizuar e ka zbehur dukshëm vlerësimin tërësor të tyre, vlerësimin e ndihmesës që mjaft përfaqësues të shquar

të këtyre shtresave dhanë në luftën e popullit tonë për liri. Një prirje e tillë i ka penguar, sado pak, studiuesit për t'i parë sa duhet Bushatasit në të gjitha pamjet dhe përmasat. Nuk është vënë në pah apo edhe është injoruar deri vonë formimi kulturor i tyre, interesi i veçantë për letërsinë dhe shkencën, për çka nuk kanë munguar dhe nuk mungojnë dëshmi autentike. Në këtë drejtim kanë ndikuar jo për mirë dhe qëndrimet sektare, krahinariste dhe, sidomos, ato fetare.

Këto përmasa të realitetit historik të asaj kohe të jetës dhe të veprimtarisë së vezirëve Bushatas të Shkodrës, të pavëna në pah sa duhet deri më tani, kërkojnë ridimensionimin e gjithë vlerësimit të tyre të deritashëm. Lidhjet me kulturën, interesin për shkencën e kohës i dëshmon bindshëm koleksioni shumë i pasur i dorëshkrimeve orientale të trashëguara prej tyre, që ruhet në Bibliotekën Kombëtare.

Në Koleksionin e Karamahmud pashë Bushatit janë ruajtur 18 dorëshkrime.¹ Të gjitha janë në gjuhën arabe dhe me përmbajtje fetare, me përjashtim të një dorëshkrimi në të cilin trajtohen probleme juridike, dhe një gramatike të gjuhës arabe prej 764 faqesh. Midis dorëshkrimeve, dy prej tyre janë shumë të hershme dhe i përkasin shekullit XV. Ata datojnë në vitet 1451 dhe 1464.

Koleksioni i trashëguar nga Mustafa Bushati është shumë më i pasur dhe numëron në gjendjen e sotshme 127 dorëshkrime.² Midis

¹ Abdul-latif Emin, **Sherhi Megma'al-Bahrejn**, Amasja, 869 H.515 f. Arabisht. Ebussud al-'Umadi, **Tefsir Al-Kur'an**, pa v., pa dt., 760 f., arabisht, (Teologji). Esifihani, **Serh Ala Al-Tevali**, pa v., 797 H., 170 f., arabisht, (Teologji), Hasan al Sagani, **Meşarik-Al-Envar**, pa v., 730 H., 116 f., arabisht, (Teologji), Hasan al-Vefat, **Nur Al-Idab**, pa v., pa dt., 31 f., arabisht, (Teologji), **Kitab Al-Tahareh**, pa v., 963 H., 362 f., arabisht, (Teologji), **Menagati Emirul-Muminin ali Rediyellahi Arhu**, pa v., pa dt., 35 f., arabisht, (Teologji), Muhammad Alaeddin, **Dur Al - Muhtar**, Cild 1., pa v., 1174 H., 255 f., arabisht, (Jurisprudencë), Osman Zeyli'i, **Tebyinul-Hakaik**, **Sherhi Kenzul Dekaik**, pa v., pa dt., 515 f., arabisht, (Teologji), **Tefsiri Kebiyr**, pa v., pa dt., 165 f., arabisht, (Teologji), **Tefsiri Kuran**, pa v., 855 H., 132 f., arabisht, (Teologji), (Koleksioni i Kara Mahmud pashë dhe Mustafa pashë Bushatit), Tenvirul-Ebsar, Cild 1., pa v., 1062 H., 643 f., arabisht, (Teologji), Zihni Zade Huseyn, **I'Rab Al Qafiye**, *Istanbul*, 1200 H., 748 f., arabisht, (Gjuhësi).

² Abd-allah bin Malik, **Tes'hil al-Fevaid**, pa v., pa dt., 84 f. Arabisht. (Gjuhësi). Abduhraman Aksarayi, **Imad ul-Islam**, 1030 H. 275 f.. Arabisht. (Teologji). Abd ur-Rahman al Suyuti, **Cami al-Sagir**, pa v., 907 H. 123 f. (Teologji), Arabisht. Abd-al-Latif, **Kitabul-Hac ve saire**, pa v., pa dt., 234 f. Arabisht, (Teologji), **Bahr-Al-Rayik**, Cild 3. pa v., pa dt., 380 f., arabisht, (Jurisprudencë).. **Bahri Al Raik**, Çild 1., pa v., pa

dt., 422 f., arabisht, (Jurisprudencë), Berz'hendi, Hashiyeh Ala Qadizadei, **Rumi Fil-Mey'eh**, pa v., pa dt., 42 f., arabisht, (kozmografi), **Al-Dirayen Ala Sherhi Vikayi**, Cild 1., pa v., pa dt., 264 f., Arabisht. (Teologji), Ebil-Teth al-Kemali, **Ifadat Al Ziyiyadat**, pa v., pa dt., 58 f. me ilustrime, arabisht, (Teologji), Fadil ibni Shaban, **Sherhi Kafiyah li Mevlahami**, Iskenderiye (Shkodër), 1182 H., 219 f., arabisht (Gjuhësi), Halil bin Hasan (Kara-Halil), **Ilmi Mantik va Al-Beyan**, pa v., pa dt., 86 f., arabisht, (Retorikë), **Hayali Ve Siyalkuti Ala Sherhi Akaid**, pa v., pa dt., 238 f., arabisht, (Teologji), **Hašiyeh Alettefsir Al Beyravi li ibni Temcid**, pa v., pa dt., 400 f., arabisht, (Teologji), **Hüdi-li-Nurredin Min Meani**, Shkodër, 1043 H., 102 f., (Retorikë), arabisht, Huseyn bin Ahmed, **Murib Al-Cedid**, pa v., pa dt., 83 f., arabisht, (Gjuhësi), Ibni Melik Abdulletiyt, **Mebarikul-Ezhar Fi Sherhi Meşarikul-Envar**, pa v., pa dt., 260 f., arabisht, (Teologji), Ibn-ul-Tahir Ahmet, **Nasih Ve Mensul**, pa v., pa dt., 18 f., arabisht, (Teologji), **Iftitah Sherhi Misbah**, pa v., pa dt., 80 f., arabisht, (Gjuhësi), **Ikazul-Raimin**, pa v., pa dt., 18 f., arabisht, (Teologji), **Ilm ul Munzera**, **Kanun**, Manastir, 1163 H., arabisht, 75 f., (Logjikë), Isameddin, **Al Tasdik**, pa v., 1221 H., 1227 f., arabisht, (Jurisprudencë), Is'hak al-Zendcani, **Ziya el Kulub Sherhi D'lael-Kulub**, pa v., 1122 H., 146 f., arabisht, (Teologji), **Iz'har**, pa v., 1235 H., 181 f., arabisht, (Gjuhësi), I.Karamani, **Resalei Heyet Ala Tarikis-Sumeh ve Resalai Itisab**, pa v., pa dt., 42 f., (Kozmografi, Arithmetikë), Kastelani, **Serhul-Buhari**, Çild 3., pa v., 1218 H., 545 f., arabisht, (Teologji), **Kavaid Al-Fars Bilsan Al-arabi**, pa v., pa dt., 17 f., arabisht dhe persisht, (Gjuhësi), **Kitab Al-Kunuz**, pa v., 1180 H., 76., arabisht, (Teologji), **Kitab Al-Tehdhir va Saireh**, pa v., 1115 h., 140 f., arabisht, (Teologji), **Kitab - Ul- Fevfaik Li-Sadri Al-Seria**, pa v., pa dt., 325 f., arabisht, (Teologji), **Kitab-Ul-Buyü**, pa v., 1162 H., 719 f., arabisht (Jurisprudencë), **Lugati Mustahrece min metun ul Lagavat ul Arabi ve Farisi**, pa v., pa dt., 90 f., arabisht, turqisht, persisht, (Gjuhësi), **Mecma'al-fetava**, pa v., 873 H., 283 f., arabisht, (Jurisprudencë); Mehmet b. Cezri, **Kitab ul Cezriye**, pa v., 1185 H., 75 f., arabisht, (Teologji), **Mehudi i Kebiyz ala Sherhi**, Cild 2., pa v., pa dt., 55 f., arabisht, (Teologji), **Menuyyeh Al Musalli**, pa v., pa dt., 83 f., arabisht, (Teologji), **Metni sahaiyek fial-hisab ve hashiye. Ibni yeli ve sherhi lari ala risale al firisiye li ala kushji fial: Heyeti ve sherhi astrolab lial, Berjendi**, pa v., 1088 H. 258 f., persisht dhe arabisht, (Kozmografi), **Metni Kuduri**, pa v., 1019 H., 105 f., arabisht, (Teologji), Muharek bin Ergesi, **Ilmi Ilahiye** (Mesail Fi Ilmi Heyet), pa v., 891 H. 75 f. me ilustrime, arabisht, (Kozmografi), Mugzi Al-Tullab, **Sherhi Isaguyi**, pa v., pa dt., 48 f., arabisht (Logjikë), Muhammad Bistani Elvari, **Aryis al Kur'an**, pa v., 1136 H., 318 f., arabisht, (Teologji), Muhyi al-din ibn Arabi, **Telqih Al Edhihan**, pa v., 974 H., 206 f., arabisht, (Filozofi), Mustafa Karahisari, **Lugati Ahteri**, pa v., 1233 H., 199 f., arabisht dhe turqisht, (Gjuhësi), **Al Qurra Al Seba**, pa v., pa dt., 110 f., arabisht, (Teologji), **Qadi Baydavi**, cild 1, pa v., pa dt., 483 f., arabisht, (Teologji), **Resaili Edebiye**, pa v., pa dt., 111 f., arabisht, (Letërsi), **Risalei Kurreb**, pa v., pa dt., 9 f., arabisht (Kozmografi), Sa'd al Feftazani, **Sherhi Telhia Al-Miftah**, pa v., 1011 H., 70 f., arabisht, (Gjuhësi), Sadeddin alel-Kushaf, pa v., pa dt., 82 f., arabisht, (Gjuhësi), **Safvatu al Safvah Al Gur Al-thalith**, pa v., pa dt., 195 f., arabisht, (Biografie), (Letërkëmbim), Salah al Din al Safedi, **Sherhi-Ummiyyeh**, pa v., 1101 H., 256 f., arabisht, (Poezi), **Sherhi Bazi Istilahati Teesavvuf ve saire**, pa v., 991 H., 141 f., arabisht, persisht e turqisht; (Filozofi), **Su- alname**, pa v., pa dt., 44 f., turqisht e arabisht, (Teologji), **Sherh Meshariq Al-Envar**,

pa v., pa dt., 131 f., arabisht, (Teologji), **Sherhi Mevaqif**, pa v., pa dt., 330 f., arabisht, (Teologji), **Tefsiri Kuran**, pa v., pa dt., 103 f., arabisht, (Teologji), **Tercumei Sahhai Evheni**, pa v., pa dt., 167 f., arabisht dhe turqisht, (Gjuhësi), **Tetavayur-Zehire**, pa v., 962 H., 262 f., arabisht, (Jurisprudencë), **Tet'hisi al miftar**, pa v., 1025 H., 59 f., arabisht, (Retorikë), **Usam Alel-Feride minel Istiare**, pa v., pa dt., 28 f., arabisht, (Gjuhësi), Usamuddin, **Hashiyetu Tesavvurat**, pa v., pa dt., 127 f., arabisht, (Logjikë), Zeyni Zade, **Murib Al-Izhar**, pa v., 1217 H., 138 f., arabisht (Gjuhësi) **Mecma'al-fetava**, pa v., 873 H., 283 f., arabisht, (Jurisprudencë), Mehmet b. Cezri, **Kitab ul Cezriye**, pa v., 1185 H., 75 f., arabisht, (Teologji), **Mehudi i Kebiyz ala sherhi**, Cild 2., pa v., pa dt., 55 f., arabisht, (Teologji), **Menuyyeh Al Musalli**, pa v., pa dt., 83 f., arabisht, (Teologji), **Metni sahaiyek fial-hisab ve hashiye. Ibni yeli ve sherhi lari ala risale al firisiye li ala kushji fial: Heyeti ve sherhi astrolab lial, Berjendi**, pa v., 1088 H. 258 f., persisht dhe arabisht, (Kozmografi), **Metni Kuduri**, pa v., 1019 H., 105 f., arabisht, (Teologji), Muharek bin Ergesi, **Ilmi Ilahiye** (Mesail Fi Ilmi Heyet), pa v., 891 H. 75 f. me ilustrime, arabisht, (Kozmografi), Mugzi Al-Tullab, **Sherhi Isaguyi**, pa v., pa dt., 48 f., arabisht (Logjikë), Muhammad Bistani Elvari, **Aryis al Kur'an**, pa v., 1136 H., 318 f., arabisht, (Teologji), Muhyi al-din ibn Arabi, **Telqih Al Edhihan**, pa v., 974 H., 206 f., arabisht, (Filozofi), Mustafa Karahisari, **Lugati Ahteri**, pa v., 1233 H., 199 f., arabisht dhe turqisht, (Gjuhësi), **Al Qurra Al Seba**, pa v., pa dt., 110 f., arabisht, (Teologji), **Qadi Baydavi**, cild 1, pa v., pa dt., 483 f., arabisht, (Teologji), **Resaili Edebiye**, pa v., pa dt., 111 f., arabisht, (Letërsi), **Risalei Kurreb**, pa v., pa dt., 9 f., arabisht (Kozmografi), Sa'd al Feftazani, **Sherhi Telhia Al-Miftah**, pa v., 1011 H., 70 f., arabisht, (Gjuhësi), Sadeddin alel-Kushaf, pa v., pa dt., 82 f., arabisht, (Gjuhësi), **Safvatu al Safvah Al Gur Al-thalith**, pa v., pa dt., 195 f., arabisht, (Biografie), (Letërkëmbim), Salah al Din al Safedi, **Sherhi-Ummiyyeh**, pa v., 1101 H., 256 f., arabisht, (Poezi), **Seyyid Alel-Ferais**, pa v., 1237 H., 211 f., arabisht, (Jurisprudencë), **Sualname**, pa v., pa dt., 44 f., turqisht e arabisht, (Teologji), **Sherh Meshariq Al-Envar**, pa v., pa dt., 131 f., arabisht, (Teologji), **Sherhi Mevaqif**, pa v., pa dt., 330 f., arabisht, (Teologji), Shems al Din Muhamed, **Sherh Lanuyel Al-Efal**, Shkodër, pa dt., 123 f., arabisht, (Gjuhësi), **Tefsiri Kebiy**, pa v., pa dt., 165 f., arabisht, (Teologji), **Tefsiri Kuran**, pa v., pa dt., 103 f., arabisht, (Teologji), **Tercumei Sahhai Evheni**, pa v., pa dt., 167 f., arabisht dhe turqisht, (Gjuhësi) **Tetavayur-Zehire**, pa v., Koleksioni i Mustafa pashë Bushatit), **Tet'hisi al miftar**, pa v., 1025 H., 59 f., arabisht, (Retorikë), **Usam Alel-Feride minel Istiare**, pa v., pa dt., 28 f., arabisht, (Gjuhësi), Usamuddin, **Hashiyetu Tesavvurat**, pa v., pa dt., 127 f., arabisht, (Logjikë), Zeyni Zade, **Murib Al-Izhar**, pa v., 1217 H., 138 f., arabisht (Gjuhësi), Mustafa Karahisari, **Lugati Ahteri**, pa v., 1233 H. (Nëntor 1817-1818), 199 fq., arabisht e turqisht, (Gjuhësi), Abdurrahim Ef. **Kanunname Erazi için**, pa v. (Tetor 1788-1789), pa dt., 48 fq., turqisht, (Jurisprudence), **Divani Feri**, pa v., pa dt., 84 fq., turqisht, (Poezi), **Divan-i Fuzuli**, pa v., pa dt., 63 fq., turqisht, (Poezi), Fuzuli, **Divan-i Meshet**, pa v., 1081 H. (maj 1670-1671), 118 fq., turqisht (Poezi), Fuzuli-i Bagdadi, **Hadikatus-Suada**, pa v., pa dt., 340 fq., turqisht, (Histori), **Güftüha-i kaimi ve hayniye-i nabi**, pa v., pa dt., 110 fq., turqisht, (Poezi), **Guzide-i Ilhani**, pa v., pa dt., 108 fq., turqisht, (Teologji), **Inshai Acibe**, pa v., 1234 H. (Tetor 1818-1819), 293 fq., turqisht, (Letërkëmbim), **Inshai Garibe**, Shkodër, 1196 H. (1782), 533 fq., turqisht, (Letërkëmbim), **Inshai Güzide**, pa v., pa dt., 150 fq., turqisht, (Letërkëmbim), **Inshai Kabir**, pa v.,

tyre, përveç dorëshkrimeve me temë fetare, më shumë se gjysma e tyre, rreth 70 sosh, janë me përmbajtje letrare, juridike, gjuhësore. Ka dhe nga ato që bëjnë fjalë për retorikë, për kozmografi, për logjikë, për filozofi e për histori.

Nga dorëshkrimet që ruhen në Bibliotekën Kombëtare, në të cilat Shkodra është shënuar si vend i kopjimit apo dhe i krijimit të tyre, numërohen rreth 16 ekzemplarë.³ Për to dhe për dorëshkrime të tjera si këto, shtrohet pyetja : A i përkiste ndonjeri prej tyre koleksionit të Bushatasve ?

1149 H.(maj 1736-1737), 186 fq., turqisht, (Letërkëmbim), Yahya Arnaud Beligradi (Berati), **Menkabet Name-i Sahi Keda**, pa v., 985 H. (Mars 1577-1578), 64 fq., turqisht, (Poezi), **Kaside-i Nasi vesair kasideler**, pa v., pa dt., 103 turqisht, (Poezi), Kemal Ummi, **Divan**, pa v., 901 H. (Shtator 1495-1496), 115 fq., turqisht, (Poezi), **Kitabi Imadel Islam**, pa v., pa dt., 258 fq., turqisht, (Teologji), **Menkabetname ve risalei Cemceme Sultan**, pa v., pa dt., 17 fq., turqisht, (Poezi) **Menakibi Hazreti Ali Kanher ve said Binivekkas-Behadiriname**, pa v., 1075 H. (Korrik 1664-1665), turqisht, (Histori), **Muhammediyetü-Sherife**, pa v., 1206 H.(gusht 1791-1792), 263 fq., turqisht, (Poezi), Niazi, **Divan**, pa v., 1129 H. (1717), turqisht, (Poezi), 156 fq., Saadi-i Shirazi, **Gülüstan sherhi ve tercümesi**, pa v., pa dt., 157 fq., turqisht e persisht, (Poezi), Saadi-i Shirazi, **Gülüstan**, Mütercimi(përkthyes) Suudi, Shkodër, 1167, H.(tetor 1753-1754), 341 fq., persisht e turqisht, (Poezi).

³ Abd-al-Rrezzak bin Mustafa, **Keshful-Kunuz'Ala Al Vadryl**, Shkodër, 1283 H. 40 f. Arabisht (Teologji). Abdi-bin Suleyman, **Risalet ush-Sherife**, Shkodër, 1148 H.86 f. Arabisht dhe turqisht. (Teologji). Ahmet bini Ali Mes'ud, **Merah**, Shkodër, 1252 H. 38 f. (Gjuhësi), Arabisht dhe turqisht. Kopje e Mustafajt. Hasan Muhamed es-Sagani, **Mesharik Al Envar**, Shkodër, 1189 H., 176 f., arabisht, (Teologji), Kopje e Bektash Hasan Demirit nga Shkodra. **Al I'Tisam**, Shkodër, 1177 H., arabisht, (Teologji), Muhammad al-Gazzali, **Eyuhel-Veld**, Shkodër, 1200 H.,16 f., arabisht, (Etikë) Muhamed bini Esad, **Nush'atus-Sherife**, Iskenderiye (Shkodër), 1161 H, 97 f., arabisht, (Teologji), Semargandi Ebil Layth, **Risalah Fi Haqisalat**, Isen Deriyeh., Shkodër, 1200 H., 48 f., arabisht, (Teologji), Shems al Din Muhamed, **Sherh Lanuyel Al-Efal**, Shkodër, pa dt.,123 f., arabisht, Muhammad al-Gazzali, **Eyuhel-Veld**, Shkodër, 1200 H.,16 f., arabisht, (Etikë) Muhammad Emin, **Bechet al-Nahde**, Shkodër, 1256 H.,85 f., arabisht, (Logjikë), Muhamed bini Esad, **Nush'atus-Sherife**, Iskenderiye (Shkodër), 1161 H, 97 f., arabisht, (Teologji), Ebu Isa-Et-Termidhi, **Qitab-ush-Shemail ve saire**, (Libri i etikës apo i moralit), pa v., 1178 H.(1764-1765), 42 fq., arabisht e turqisht, (etikë), (Kopje e Ali Suleyman Voglit nga Shkodra), Hafiz Shirazi, **Divan**, pa v., 1175 H. (Gusht 1761-1762), 120 fq., persisht e turqisht, (Poezi), (Türkçeye Mütercimi Suudi),(Përkthyer në turqisht nga Sudiu) Shevki Mehmet, **Qitabi Tabirat**, Shkodër, 1164 H. (Nëntor 1750-1751), 87 fq., turqisht, **Tarihi Seyyah der Beyani Zuhuri Agvanian**, latineceden mutercimi (përkthyer nga latinishtja nga:) Ibrahim Muteferika, Shkodër, 1195 H. (1781), 97 fq., turqisht, (Histori),

Nuk përjashtohet, gjithashtu, fakti që shumë nga dorëshkrimet e tjera, që ruhen jo vetëm në Bibliotekën Kombëtare, por dhe në Arkivin Qendror të Shtetit, edhe pse nuk mbajnë vulën e Karamahmudit e të Mustafa Bushatit ose shënimin që janë kopjuar dhe hartuar në qytetin e Shkodrës apo dhe në qendra të tjera urbane e fetare myslimane të kohës brenda dhe jashtë viseve shqiptare, mund të kenë qenë pjesë përbërëse e këtij fondi.

Fakti që në këtë koleksion nuk gjenden librat, të cilët, pa dyshim, kanë pasuruar bibliotekën e Ibrahim pashë Bushatit, i përforcon dhe më tej hamendjet e mësipërme.

Nëse dorëshkrime të tjera që posedojmë sot, kanë qenë apo jo pjesë përbërëse e këtij koleksioni të Bushatasve, është çështje që kërkon shqyrtime të posaçme. Porse dhe pa to, koleksioni në fjalë, gjithsesi, është shumë i pasur dhe përmban vlera të konsiderueshme jo vetëm për atë kohë.

Tërë këtë dorëshkrime që zotërojmë sot, janë shumë pak çka ka mundur të ruhet përmes rrebesheve të kohës nga populli ynë kulturëdashës, nga sa e sa breza intelektualësh. Autori i mirënjohur turk Ali Emiriu përcjell thëniet e bashkatdhetarit të tij, shkrimtarit të njohur të kohës, Adem Habil beut, i cili u ndodh në Shkodër në kohën e pushtimit të saj nga malazeztë më 1913. Ai, siç shprehet ky shkrimtar, kish-te mbetur pa mend kur kishte parë se sa dorëshkrime islame qenë shkapërderdhur nëpër kalldrëmet e qytetit në ato momente. Përkundrajt ndonjërit që tregohej dyshues ndaj këtyre pohimeve, vetë Ali Emiriu konfirmonte dhe vërtetonte këto thënie të këtij intelektualit dhe krijuesi turk të kohës, i mbështetur në ato çka kishte parë dhe dëgjuar vetë në Shkodër, para afro dy dhjetëvjeçarësh.⁴

Pavarësisht nga humbjet që pësoi ky koleksion, në këtë periudhë më se dyshekullore, dhe kaq sa kemi trashëguar, lejon të kuptohet qartë se kemi të bëjmë me reliket e një biblioteke-arkiv shumë të madhe e tejet të pasur jo vetëm për atë kohë. Ky koleksion është

⁴ Iškodra šairleri ve Ali Emiri'nin diger eserleri, Hazirlayan Hakan T. Karateke, Istanbul, 1995, Enderun Yayinlari:41, s. 178.

vetëm një pjesë e atyre gjurmëve të depërtimit të kulturës orientale të shqiptarët.⁵

Gjuhët arabisht, persisht e turqisht të këtyre dorëshkrimeve, siç dihet, ishin gjuhë të kulturës, të fesë, të poezisë dhe të administratës në Perandorinë Osmane. Bie në sy fakti që krahas teksteve fetare, kemi dhe jo pak dorëshkrime me përmbajtje laike: letrare, gjuhësore, juridike, logjike, filozofike, retorike dhe, madje, dhe nga shkencat e natyrës.

Në tekstet arabisht dhe turqisht mbizotëron sikurse dhe në dorëshkrimet e tjera të këtij lloji, tema fetare, juridike dhe filozofike.

Ndërsa persishtja, e cila mësohej në medrese, u imponua si gjuhë kulture, mjet për njohjen e qytetërimit të mirënjohur dhe të lashtë iranien, pasqyrë e të cilit u bë poezia. Prandaj midis dorëshkrimeve persiane mbizotërojnë tekstet e veprave të klasikëve të poezisë persiane. Vendin kryesor ndër to e zë Saadiu.⁶ Midis këtyre dorëshkrimeve të bie në sy përkthimi i Gjylistanit të Saadiut në turqisht nga Suadiu, shqiptar, i mirënjohur, për studiuesit iranien.⁷ Dorëshkrimi mban datën 1167 H / 1754 dhe vendin e kopjimit: Shkodër. Ky dorëshkrim dëshmon se, krahas kontakteve të drejtëpërdrejta me poezinë perse,

⁵ Shih: **World Survey of Islamic Manuscripts**, Volume One, General Editor Geoffrey Roper, Islamic Bibliography Unit, Cambridge University Library, Al-Furqan Islamic Heritage Foundation, London, 1992, G. Shpuza, *Albania*, pf. 12-16; si dhe: G. Shpuza, **Dorëshkrimet islame në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin Qëndror në Tiranë**, në: *"Feja, Kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët"*, Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15-16 tetor 1992, botim i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Redaksia e botimeve historike, Prishtinë, 1995, f. 529-532. Al-Halwayi, Abd al -Sattar ed Fihri al-maktutat al Islamiyah bi Maktabat al-Wataniyah Albaniyah fi Tirana, London, Al-Furkan, 1997; Arnavutluk Devlet Arşivleri Osmanlı yazmalar Kataloğu-Katalogu i dorëshkrimeve osmane në Arkivat e Shqipërisë-Ottoman manuscripts catalog of Albanian state Archives, Ankara, 2001.

⁶ Saadi-i Shirazi, GÜLISTAN, Şerhi ve tercümesi, pa v., pa dt., 157 f., persisht dhe turqisht, poezi, nga koleksioni i Mustafa pashë Bushatit; Saadi i Shirazi, GÜLISTAN, mütercimi Suadi, Shkodër, 1167 H. (1754), 341 f., persisht dhe turqisht, poezi, nga koleksioni i Mustafa pashë Bushatit.

⁷ Rijahi, Dr. Mohamed Emin. *"Zeban ve adabi farisi der kalemravi Othman"*, [Gjuha dhe letërsia persiane në zonën e ndikimit osman], Teheran, 1369 (1990; A. Zijai, Udhëtim nëpër hapësirat e Bibliotekës Kombëtare, "Perla", nr. 4, 1997.

shqiptarëvet u kanë interesuar dhe studimet mbi këtë letërsi.⁸ Atyre u ka interesuar dhe interpretimi filozofik i kësaj poezie të pasur me ide të tilla në frymën e mistikës, tesavufit.⁹

Midis dorëshkrimeve të Bibliotekës-Arkiv të vezirëve të Shkodrës përfaqësohet dhe vepra e Attarit.¹⁰ Një vend të veçantë zë Rumi.¹¹ Ndeshen dhe dorëshkrime të autorëve si Urfi,¹² Edib Tiflisi,¹³ si dhe teksti i mirënjohur "Mexhnuni dhe Lejlaja",¹⁴ e të tjera.

Sundimtarëve Bushatas të Shkodrës, njohës të gjuhëve orientale, si koleksionistë dhe si intelektualë u kanë interesuar dhe veprat kush-tuar shkencave natyrore. Kjo për arsyen kuptimplotë që në këtë gjuhë ato gjenin arritjet e shkencëtarëve islamë në këto fusha. Prandaj, në këto dorëshkrime nuk mungojnë dhe tekste jo të pakta për kozmografinë.¹⁵ Koleksioni dëshmon se në kuadër të kulturës islame në mesin e shqiptarëve, po zinte vend dhe letërsia shkencore.

Në mesin e këtyre dorëshkrimeve orientale si dhe në koleksione të tjera veprat me karakter teologjik zënë, çka është e kuptueshme, një vend të rëndësishëm.¹⁶

Koleksione si ky i Bushatasve dhe të tjera që i kemi të ruajtura deri më tani, provojnë se kanë qenë, në radhë të parë, vlerat e larta të

⁸ Yakub Sinani, ASNEABET NAME pa v., 1059 H (1649), 235 f. Persisht (Literaturë), (Koleksion i Mustafa Pashë Bushatit).

⁹ ŞERHI BAZI ISTILAHATI TESASVVUF VE SAIRE, pa v., 991 H, 141 f., arabisht, persisht dhe turqisht, filozofi, nga koleksioni i Mustafa pashë Bushatit,

¹⁰ Attar Feriduddin, MANIK UT-TAYR, pa v., pa dt., 178 f., persisht, (Poezi), (Koleksion i Mustafa Pashë Bushatit).

¹¹ ŞERHI BAZI EBYATI METHNEI, pa v., pa dt., 125 f. Persisht (Poezi), (Koleksion i Mustafa Pashë Bushatit).

¹² Urfi, DIVAN, Shkodër, 1177 H. (1763-1764), 120 f. Persisht (Poezi), (Koleksioni i Mustafa Pashë Bushatit).

¹³ Edib Tiflisi, KANUN - I EDEB, pa v., pa dt., 348 f. Persisht (Literaturë), (Koleksion i Mustafa Pashë Bushatit).

¹⁴ MECNUN VE LEYLA, pa v., pa dt., 57 f. Persisht (Poezi), (Koleksion i Mustafa Pashë Bushatit).

¹⁵ SHERHI LARI VA SHEMSIYYAH, pa v., pa dt., 84 f. Persisht (Kozmografi), (Koleksioni i Mustafa Pashë Bushatit).

¹⁶ Shaban Tuzi, KITAB - AL - MUBEYYIN AL ESRAR, Shkodër, 1190 H. (1777-1778), 158 f., persisht, (Teologji), R. ISTIVANAME (Rregullsi), Shkodër, 1109 H (1697-1698), 108 f. Persisht (Teologji), SHERHI AKAIID (Shpjegim i rregullave), Shkodër, 1144 H. (1731-1732), 204 f. Persisht (Teologji), USTUN AN NAME Shkodër, 1156 H. (1743-1744), 85 f. Persisht (Teologji), Zejnel Ibni Huseyn, ISTIVANAME, Shkodër, 1154 H. (1741-1742), 122 f. Persisht (Teologji).

qytetërimit dhe të kulturës arabo-persiano-turke ato që i kanë hapur rrugën vetes për të gjetur admirues në mesin e shqiptarëve sikurse në mesin e shumë popujve të tjerë. Është e kuptueshme që institucionet fetare islame kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në zgjerimin e kontakteve dhe të marrëdhënieve të ndërsjella kulturore midis shqiptarëve dhe bartësve të këtij qytetërimit. Jo vetëm xhamitë dhe teqetë e shumta u shndërruan në qendra të popullarizimit, të studimit dhe të përpunimit të arritjeve të shkëlqyera të qytetërimit islam në të gjitha fushat. I tillë u bë, çka vlen të theksohet, siç dëshmon qartë koleksioni për të cilin po bëjmë fjalë, dhe oborri i dinastisë së Bushatasve në kështjellën Rozafat.

Gjithë këto dorëshkrime të vyera provojnë katërcipërisht, se këta pashallarë të konsideruar gabimisht dhe, në përgjithësi në këtë kuptim edhe me të padrejtë, “*anadollakë*”, faktikisht kanë qenë qeveritarë të kulturuar. Me sa del nga këto dëshmi, ata qenë ndër njerëzit më të kulturuar të kohës. Vezirët e Shkodrës e kishin të qartë se përpjekjet e tyre për sigurimin e të drejtave kombëtare të popullit të vet dhe të pozitës së tyre politike, qoftë dhe në kuadër të Perandorisë Osmane, nuk mund të kishin sukses pa një nivel të kënaqshëm kulturor, pa përvetësimin e arritjeve të shkencës së kohës. Përpjekje të tilla ndeshnin, çka është e kuptueshme, në kundërshtimin e elementëve reaksionarë, të cilët nuk kanë munguar jo vetëm në radhët e feudalëve turkomanë, por edhe të klerikëve obskurantistë.

Bushatasit si sundimtarë autonomë dhe në momente të caktuara edhe të pavarur, shfrytëzuan për qëllimet e tyre politike dhe kulturën orientale me të mirat e shumta dhe madhore, qoftë me kufizimet e saj të natyrshme si për çdo dukuri tjetër të këtij lloji. Me lëvrimin e letërsisë shqipe me alfabet arab, në oborrin e vezirëve të Shkodrës bëhet një hap i madh përpara. Vërehen dhe përpjekjet për t’i dhënë veprimtarisë kulturore të nxitur, të përkrahur dhe pse jo edhe të lëvruar prej tyre edhe përmasa kombëtare.

Krahas kopjimit të veprave madhore të letërsisë dhe të kulturës orientale apo dhe përkthimit të tyre midis dorëshkrimeve që ruhen dhe sot, kemi dhe krijime origjinale të hartuara nga autorë vendës në gjuhët perse, arabe dhe turke. Sipas modeleve të poezisë klasike persiane,

në stilin e kasideve dhe të gazeleve si dhe të nefeseve bektashiane, ata krijuan një letërsi të tërë.

Të shijojë poezinë persiane dhe sidomos ta studiojë e ta përkthejë atë në turqisht apo edhe në shqip, dhe veçanërisht, të vjershëroje sipas modeleve të saj, kjo kërkonte një njohje të përsosur të gjuhëve orientale. Dhe këtë aftësi dhe bagazh shumë shqiptarë në ata shekuj e kanë pasur në shkallë të lartë. Për t’ia arritur kësaj njohjeje atyre u kanë shërbyer një radhë manualësh gjuhësorë dhe fjalorë disagjuhësh. Këto manuale intelektualët shqiptarë të kohës jo vetëm i kanë kopjuar por të tillë kanë hartuar dhe vetë. Këtë dëshmojnë dhe ato pak dorëshkrime që kemi trashëguar nga e kaluara.¹⁷

Dorëshkrimet orientale të bibliotekave dhe të arkivave tanë nuk janë vetëm relike me vlerë të një trashëgimie shumë herë më të pasur. Ata kanë ndikuar fuqimisht në kultivimin e një poezie vendëse në gjuhët arabe, turke dhe perse me vlara të shquara që ka tërhequr dhe vëmendjen e autorëve specialistë të letërsisë. Këtë dëshmojnë të dhënat që na japin autorë si Ali Emiri i mirënjohur. Ai na jep një pasqyrë sa të pasur aq dhe interesante të lëvrimin të poezisë në trevat shqiptare, konkretisht, për vilajetin e Shkodrës dhe më gjerë, në shekullin XIX dhe më parë.¹⁸

Ali Emiri, njohës i mirë i poezisë së kultivuar në gjuhët orientale në Perandorinë Osmane, ishte mrekulluar nga kontakti me këtë mjedis letrar-artistik të Shkodrës dhe më gjerë që deri më atëherë ishte i panjohur jo vetëm për të. Ai zbuloi jo pa habi ekzistencën e një vjershërimit të fuqishëm në gjuhët e Lindjes së Afërme në një vend të Ballkanit, në vilajetin e Shkodrës me rrethina, të përbërë, siç vëren ai, nga një popullsi shqiptare, jo vetëm myslimane por dhe të krishterë, ku

¹⁷ KAVAIID AL-FARS BI LISAN AL-ARABI, pa v., pa dt., (gjuhësi), nga koleksioni i Mustafa pashë Bushatit, LUGATI MUSTAHREDJE MIN METUN-UL- LAGAVAT UL ARABI VE FARISI, pa v., pa dt., 90 f., nga koleksioni i Mustafë pashë Bushatit.

¹⁸ Ishkodra šairleri ve Ali Emiri'nin diger eserleri, Hazirlayan Hakan T. Karateke, Istanbul, 1995, Enderun Yayinlari:41, 208 s. Përgatitësi i veprës së Ali Emiriut, Hakan T. Karateke, vëren, me të drejtë, që nga kjo tezkere provohet ekzistenca e një tradite të fuqishme të hartimit të divanëve në Shkodër dhe në Ballkan. Ai njofton se Ali Emiri kishte përgatitur një vepër si kjo dhe për autorët e vilajetit të Janinës. Shpresohet që kjo vepër të gjendet dhe të plotësohet njohja jonë rreth zhvillimit të vjershërimit të autorëve shqiptarë në gjuhët orientale.

gjuha turke nuk njihej dhe flitej veçse nga një rreth i ngushtë nëpunësish. Prandaj veprën e përmbledhur prej tij ai e quan “Një thesar që shfaqet rishtazi në botën e letërsisë osmane”.¹⁹ Dorëshkrimet e grumbulluara dhe të studiuara prej tij e bindën autorin që letërsia, vjershërimi në Shqipëri kishte përparuar po në atë shkallë si dhe në vendet e tjera osmane.

Ali Emiriu na dëshmon se në oborrin e vezirëve autonomë të Shkodrës jo vetëm janë koleksionuar vepra të letërsive orientale, por dhe është lëvruar edhe letërsia artistike në gjuhët arabe, turke e persiane.

Konkretisht, midis autorëve me dorëshkrimet e të cilëve ai arriti të njihej gjatë një shërbimi të tij në vilajetin e Shkodrës, fjala është për 20 të tilla, ndër të parët rreshton Ibrahim pashë Shkodrën (?-1808-1809), i biri i Koxha Mehmed Pashës (?-14.7.1775). Si poet i zoti, Ibrahim pashait iu dha titulli Halili (i sinqertë, mik).²⁰ Në bisedë me njerëz që e kanë njohur dhe kanë pasur kontakte me pashanë autori i librit “Poetët osmanë të Shkodrës” merr vesh që zyra e vezirit të parafundit të sundimtarëve Bushatas ishte në të vërtetë një bibliotekë. Ai nuk ndahej nga leximi dhe studimi i autorëve të shquar persianë, si Yrfiu, Saadiu, Hafizi, Selmani, Hasan, Enveri, Talib, Feyzi, Saaib, Shevket, Xhami, Zahir, Naziri, Hakani dhe nga ato osmanë, si Baki, Nefi, Jahja, Fehim, Sabri, Vexhdi, Naili, Mezaqi, Shehri, Xhevri, Nabi, Nedim, Nahifi, Ragib pasha e të tjerë.²¹

Më tej Ali Emiriu përmend dhe Hasan Haqqi pashanë (3.9.1826-17.5.1896), i biri i Mustafa Sherif pashës, pra, i biri i vezirit të fundit të Shkodrës, Mustafa Bushatit.²² Siç shihet, sundimtarët faktikisht autonomë të Shkodrës ishin jo vetëm dashamirës të dijeve dhe të kulturës, por dhe krijues të mirëfilltë. Pra, fjala është për një dinasti të tërë sundimtarësh të pashallëkut autonom të Shkodrës dhe trashëgimtarëve të tyre, dituri - dhe artdashës, madje dhe intelektualë të mirëfilltë.

¹⁹ Po aty, s. 69.

²⁰ Për të ilustruar se sa e meritonte ai këtë titull, Ali Emiri citon moton e këtij sundimtari të Shkodrës, të cilën ai e përsëriste shpesh: “Ata që janë vezirë, duhet të jenë të drejtë dhe ata që janë të drejtë, duhet të jenë të ekuilibruar”.

²¹ Po aty, s. 90.

²² Zotëronte pesë gjuhë, - arabisht, persisht, turqisht, frëngjisht dhe shqip. (Po aty, s. 113).

Kur bëjmë fjalë për kontaktet kulturore shqiptaro - islame, nuk kemi parasysh vetëm kontakte të thjeshta, por bëhet fjalë për marrje e dhënie të ndërsjella. Kjo për faktin që shqiptarët nuk qenë thjesht konsumatorë, admirues të kësaj kulture dhe të arritjeve të saj. Rasti i Ibrahim pashë Bushatit, midis sa e sa të tjerëve, dëshmon se shumë përfaqësues të inteligjencies shqiptare të kohës dhanë kontributin e tyre në përhapjen e kësaj kulture. Dhe jo vetëm kaq. Midis tyre u dalluan dhe personalitete të shquara që dhanë, siç është pranuar tashmë, një ndihmesë të përmasave jo të vogla, dhe në lëvrimin e fushave të ndryshme të kulturës e të dijes, të letërsisë e të artit, filozofisë dhe teologjisë në gjuhët orientale.²³ Kjo ndihmesë nuk u kufizua vetëm me përkthimin e veprave nga arabishtja, turqishtja dhe persishtja në vetë gjuhët orientale. Kjo punë intelektuale me vlerat e veta dhe me vështirësitë e saj u çua dhe më tej. Dolën shumë autorë shqiptarë si Ibrahim Bushati, e të tjerë, të cilët trajtuan motive të poezisë orientale, në radhë të parë, të asaj persiane, në gjuhën shqipe. Në këtë rrugë u krijua një traditë e tërë. Nga kjo rrymë dolën dhe poetë të shquar. Pa këtë traditë nuk mund të bëhej ai hop që u arrit në zhvillimin kulturor të shqiptarëve gjatë Rilindjes së tyre Kombëtare.

Pra, shqiptarët si një popull i lashtë me kulturë dhe me traditat e veta si dhe me kapacitete intelektuale të dallueshme në shekuj, jo vetëm qenë në gjendje të përvetësonin arritjet e qytetërimit islam dhe të kulturës orientale, por dhe u bënë bartës aktivë të këtij qytetërimi dhe të kësaj kulture.

Koleksioni i dorëshkrimeve të Bushatasve dhe të dhënat e tjera nga literatura janë dëshmi e atyre lidhjeve dhe kontakteve me karakter të ndërsjellë të kulturës shqiptare me kulturën orientale. Janë dëshmi e marrjeve e dhënieve në një fushë specifike të komunikimit shpirtëror të njerëzve pavarësisht nga racat, nga kombësia e, madje, dhe nga feja.

Nga sa na dëshmon Emiriu për krijimtarinë poetike të Ibrahim pashës, mund të arrihet në përfundimin që lëvizja letrare në mesin e shqiptarëve e lëvruar në gjuhët orientale, qe lidhur nga kultivuesit e

²³ Hasan Kaleshi, Kontribut i shqiptarëve në dituritë islame, Prizren 1992; Po ai, Vepra, “A-Logos”, Elsie Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997.

saj me përpjekjet për emancipim kombëtar. Rasti i vezirit të parafundit të vilajetit të Shkodrës, poet, dëshmon se si ata kulturën dhe krijimtarinë e tyre e vunë në shërbim të këtyre përpjekjeve. Aq më tepër, krijimtaria letrare në gjuhën shqipe me alfabet arab, në një masë të madhe, u lidh po ashtu me çështjen kombëtare. Këtë provon plotësisht edhe fakti që teqetë qenë njëkohësisht jo vetëm institucione të kultivimit, të ruajtjes dhe të përhapjes së kësaj letërsie, por dhe vatra të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Për të përfunduar, mund të ritheksojmë se fakti që kjo letërsi në gjuhët orientale është përhapur dhe, për më tepër, dhe lëvruar në një familje e cila kishte shpalosur flamurin për sigurimin e mëvetësisë së popullit shqiptar në kuadrin e Perandorisë Osmane, të fton për të saktësuar shkencërisht më drejt funksionin dhe rolin e kulturës orientale dhe të kësaj veprimtarie krijuese të përmasave të gjera e të niveleve që kanë befasuar studiuesit e kohës në kuadër të detyrave themelore që qëndronin para popullit shqiptar në ata shekuj.

Të gjitha këto vepra të këtyre autorëve në gjuhët orientale, kanë qenë tek ne pothuajse tërësisht të panjohura e për rrjedhim dhe të pas-tudiuara. Të paragjykuara ato kanë qenë braktisur dhe lënë në harresë, edhe pse ato ishin ashtu sikurse letërsitë në gjuhën latine dhe atë greke pjesë përbërëse e jetës kulturore të vendit me të mirat dhe të pamirat e tyre. Ato përbënin faktikisht atë shtrat mbi bazën e të cilit u realizua përgjithësisht zhvillimi kulturor i shqiptarëve deri në prag të Rilindjes. Mbi këtë truall, në fund të fundit, çau përmes shumë vështirësish dhe kundërshtimesh mendimi politik rilindas. Në këtë mjedis, nën tryshninë e këtyre ndikimeve lindi po ashtu dhe letërsia e jonë e Rilindjes. Studimi i këtij trashëgimi kulturor merr një rëndësi të veçantë për faktin se në gjirin e kësaj jete letrare nisi të kultivohej poezia e mirëfilltë shqipe, e ashtuquajtura rrymë letrare e bejtexhinjve. Vlerësimi i këtij prodhimi letrar nga shkenca jonë letrare deri vonë, përgjithësisht, ka qenë jopozitiv dhe edhe sot e kësaj dite nuk ka shpëtuar nga qëndrimet kontradiktore ndaj tij.

Qëndrimet dhe vlerësimet ndaj poezisë së bejtexhinjve mbeten tregues tejet shprehës për të kuptuar dhe shkaqet e injorimit dhe, kuptohet, të vlerësimit mohues që u mbajt ndaj prodhimit letrar të shqiptarëve në gjuhët orientale. Letërsia e bejtexhinjve dhe rrjedhimisht dhe

pa diskutim dhe ajo në gjuhët arabo-perso-turke është parë, pothuajse tërësisht, e lidhur ngushtë me synimet dhe presionin ideologjik e kulturor të qeveritarëve osmanë.

Ndihmesa e autorëve shqiptarë në kultivimin e letërsisë dhe të mendimit shkencor në gjuhët lindore, si dhe përpjekjet për të vjershëruar shqip, edhe pse me alfabet arab, nuk janë, siç pretendohet, një kundërvënie ndaj kulturës orientale. Kultura orientale në vetvete, ashtu sikurse dhe kultura perëndimore përbëjnë atë sfond e, mund të thuhet, dhe atë truall mbi të cilin u zhvillua, në fund të fundit, kultura moderne shqiptare. Përpjekjet dhe arritjet në këto fusha, në të vërtetë, në thelb, qenë, vetëm një kundërvënie, mund të thuhet e fuqishme, ndaj politikës osmane të mileteve. Si rrjedhim i identifikimit të besimit me kombësinë, kjo politikë në përgjithësi liberale, për shqiptarët e ndarë në tri besime, ishte tejet e rrezikshme për zhvillimin e tyre kombëtar. Ajo i zinte frymën zhvillimit të njësuar të elementeve të kulturës vendëse në gjuhën amtare mbi baza thjesht kombëtare.

Fakti që përmbajtja e kësaj letërsie, qoftë në gjuhët orientale qoftë në gjuhën shqipe me alfabet arabo-turk, qe shpesh fetare, e angazhuar në përhapjen e besimit islam, ose qe intime apo haptazi didaktike-moralizuese, nuk i përligj vlerësimet negative të shkencës historiko-letrare tek ne për këtë zhvillim letrar. Karakteri kryesisht meditativ i kësaj letërsie, e cila, siç thuhet, e merrte frymëzimin nga rrymat e Islamit : nga spiritualiteti autoritar sunit deri tek sferat e thella mistike të sufizmit shii e më pas, deri tek meditimet më liberale, ndonëse po aq mistike, të panteizmit bektashian,²⁴ nuk vërteton që këto krijime të ishin thjesht dhe vetëm e vetëm mjete të presionit ideologjik e kulturor të qeveritarëve osmanë.²⁵

Duke vënë shenjën e barazimit midis besimit islam dhe politikës osmane dhe madje edhe midis kësaj politike e kulturës, feja dhe kultura islame konsideroheshin si mjetet kryesore të përdorura nga qeveritarët osmanë për përpunimin ideologjik të nënshtetasve të tyre myslimanë joturq. Rolin kryesor në këtë drejtim e luante, sipas këtyre koncepteve, pak të quhen sektare, deri edhe mësimi dhe komenti i

²⁴ R. Elsie, vep. e cit., f. 72.

²⁵ Historia e letërsisë shqipe, vëll. i, Tiranë 1969; Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë, 1983, f. 75.

Kuranit, si dhe letërsia orientale. Ekzistonte mendimi tejet i gabuar, se mbi këtë bazë u formua një shtresë e veçantë intelektualësh, përçues të ideologjisë e të kulturës së osmanëve. Duke vënë shenjën e barazimit midis osmanizmit dhe kulturës orientale, kjo shtresë trajtohej e njësuar, unike, duke harruar që nga gjiri i saj dolën, për të mos u zgjatur shumë, personalitete të shquara të Rilindjes Kombëtare si vëllezërit Frashëri, Hoxha Hasan Tahsini, pa bërë fjalë dhe për poetë si Ibrahim pashë Bushati që vjershëruan në gjuhët orientale, e sa e sa të tjerë. Kësaj shtrese i përkisnin dhe myderriz Haxhi Ymer Prizreni, Daut Boriçi e deri tek Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu e sa e sa të tjerë.

Duke i marrë letërsinë orientale dhe alhamjadën shqiptare si rryma unike, ato u shpallën vegla dhe pronë ekskluzive e sundimtarëve osmanë. Krijimtaria e autorëve arabë, persë dhe turq, sipas këtyre vlerësimeve ishte vetëm e vetëm, siç thuhej, një letërsi që pasqyronte “shijet e moralin e shthurur të shtresave të larta.” Në kundërshtim me këtë mendim negativ të përgjithshëm, disa prej poetëve të kësaj rryme, të cilët vjershëruan shqip me alfabet arab, Naim Frashëri i përmend me nderim të veçantë, duke vlerësuar lart poezitë e tyre. Ai i quan ata, me shumë të drejtë, “vjershëtorë të Shqipërisë”.²⁶

Duke vënë përsëri shenjën e barazimit midis ideologjisë dhe kulturës, jo vetëm letërsia orientale dhe e gjithë krijimtaria e bejtexhinjve, por dhe filozofia dhe morali islam në këtë kuadër u vlerësuan jo drejt. Këngët mistike të ilahive, përfaqësonin, sipas kësaj skeme, pa asnjë dallim midis tyre, një veprimtari letrare në të cilën “shfaqej myku i Lindjes”.

Pavarësisht nga synimet dhe përpjekjet e sundimtarëve osmanë për shfrytëzimin e institucioneve fetare dhe të klerit, jo vetëm të atyre myslimanë, për interesat e tyre, politika osmane nuk mund të barazohet me kulturën orientale dhe me qytetërimin islam dhe aq më pak me besimin e moralin islam. Me gjithë ngjyresat mjaft të theksuara teokratike të pushtetit të sulltanëve, kurrsesi nuk mund të bëhen identifikime të tilla.

Kultura orientale nuk ka qenë, siç thuhet në mjaft raste, e, vlen të përsëritet, thjesht mjet presioni ideologjik në duart e sundimtarëve osmanë. Pavarësisht nga përpjekjet e tyre për të manipuluar me të, letërsia në gjuhët arabe, perse dhe turke përçonte në mesin e shqiptarëve të shkolluar dhe jo vetëm midis tyre, mesazhe humanizmi, ide të lirisë dhe të përparimit.

Veprat e autorëve të shquar turq, arabë dhe persianë që pasuronin bibliotekën e Bushatasve në Rozafat të Shkodrës, edhe pse jo të gjitha, përfaqësojnë një dëshmi të pakundërshtueshme se edhe vezirët e Shkodrës u ushqyan me idetë e Rilindjes Perso-Arabe. Në këtë rrugë jo të lehtë ata arritën vetë drejtpërsëdrejti si shumë intelektualë shqiptarë të tjerë të periudhës osmane në një nga burimet kryesore të Rilindjes Evropiane.

Për vlerat e qytetërimit islam, pa u zgjatur me karakterizimin që i ka bërë atij shkenca botërore, po kujtojmë këtu vetëm vlerësimet e figurave madhore të mendimit shkencor shqiptar, ndër ta dhe vlerësimet e Sami Frashërit për qytetërimin islam. Ndërsa Fan Noli peshkop konkludonte: “Nga kjo Përlindje e shkëlqyer që buron drejtpërdrejt nga qytetëria grekoromane, lindi Përlindja arabe, e cila me anën e Spanjës influençoi Evropën medievale dhe gatiti Përlindjen e madhe italiane, nënën e qytetërisë moderne”. Konsiderata si këto apo vlerësimi i Gëtes dhe i kolosëve të tjerë të poezisë evropiane për poezinë orientale përgjithësisht dhe për poezinë persiane veçanërisht, na jep një përfytyrim përgjithësues të atij burimi filozofik e artistik të përmasave planetare të historisë së njerëzimit, në të cilin u ushqyen jo pak intelektualë, politikanë dhe ushtarakë shqiptarë të periudhës osmane, qofshin këta edhe efendilerë, haxhilerë, baballarë e hoxhallarë, myderrizë e plot të tjerë si dhe bejlerë, e madje dhe pashallarë, si Karamahmuti, Ibrahim e Mustafa Bushati.

Trashëgimia kulturore dhe letrare e vezirëve Bushatas në gjuhët orientale flet qartë për lidhjen gjithnjë e më të ngushtë të kësaj kulture me përpjekjet e popullit tonë për çlirim kombëtar asokohe. Është pikërisht lufta e feudalëve, si Bushatasit dhe Ali Tepelena, që i hapi rrugën epokës së ndritur të Rilindjes Kombëtare jo vetëm në rrafsh luftarak e politik, por, do të thoshim ne, dhe në atë kulturor. Kjo duhet

²⁶ N. H. F. Iliadhë e Omirit, Këngë e parë, Bukuresht, 1896, f. 13.

thënë me plot gojën edhe pse studimet tona vijnë t'i detyrohen shumë këtij aspekti.

Letërsia, e quajtur myslimane, e shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë, është pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve, pjesë e vyer e saj, e cila pret të vlerësohet siç duhet e madje, në një masë të madhe, pret edhe për t'u zbuluar.²⁷

Në këtë mjedis kulturor dolën vezirët e Shkodrës të cilët, me gjithë kufizimet e epokës në të cilën ata jetuan dhe vepruan, hapën një faqe të re në historinë e përpjekjeve të popullit tonë për emancipim kombëtar. Midis tyre shquhet Karamahmuti, i cili vuri, me sa dokumentohet deri më tani, themelet e këtij koleksioni kaq të pasur për të cilin folëm më sipër.

Gazmend Shpuza

THE COLLECTION OF ORIENTAL MANUSCRIPTS BELONGING TO THE BUSHATI FAMILY

(Summary)

Albanian historiography, despite the strict class criterion which was used to evaluate the historical figures from the past, in general, has managed to give an objective judgment on the feudal lords from the past (the members of the Bushati family and Ali Pasha Tepelena). It was very difficult to evaluate these figures using the rigid politicized frames of the Marxist-Leninist Philosophy. Due to this, certain personalities were not properly evaluated, especially those who were members of the higher classes and the clergy. There was a tendency to present the representatives of the higher classes (during the times of the Ottoman Empire) as exploiters, executives in the service of the Sublime Porte, tools in the hands of the Porte, mercenaries, who were driven by their personal interests.

غازمند شبوزا

مجموعة المخطوطات الشرقية لدى عائلة بوشاتلي

(خلاصة البحث)

بالرغم من التشدد الطبقي الذي كان يسود التاريخ الالباني حول اختيار الشخصيات الالبانية التاريخية فانه أعطى احكاما موضوعية فيما يتعلق بحكام عائلة بوشاتلي و على باشا تيبيلندي، اذا اخذنا في الاعتبار بان الشخصيات التاريخية اذا استثنينا شخصية جورج كاستريوتي - اسكندربك، كان من الصعب ادخالها في اطرار جامدة للفكر الماركسي السائد آنذاك في البانيا، الا أن مع ذلك فان اطار البحث كان ضيقا جدا خاصة بالنسبة للشخصيات التاريخية البورجوازية و علماء الدين الاسلامي. كان ينظر اليهم في الماضي فقط كشخصيات مرتبطة بالحكم العثماني و كأشخاص عملوا لصالح الباب العالي.

²⁷ R. Elsie, vep. e cit., f. 87.

²⁷ Al-Halwaji, Abd al-Sattar ed Fihris al-maktutat al-Islamijah bi Maktabat al-Watanijah Albanijah fi Tirana, London, Al-Furkan, 1997; Arnavutluk Devlet Arsivleri Osmanli yazmalar Katalogu-Katalogu i dorëshkrimeve osmane në Arkivat e Shqipërisë- Ottoman manuscripts catalog of Albanian state Archives, Ankara 2001.

KUMTESË

Prof. As. Dr. Ferit Duka

RRËNJËT HISTORIKE TË TOLERANCËS FETARE NË SHQIPËRI

Historia e popullit shqiptar ofron një model pothuajse unik përsa u përket veçorive të kompozicionit fetar të këtij populli në rrjedhën e shekujve. Shqiptarët ishin ndër të parët popuj të Evropës që përqafuan Krishtërimin në fillimet e erës së re të historisë së njerëzimit. Skizma e vitit 1054 kur Kisha Katolike (Perëndimore) u nda përfundimisht nga Kisha Lindore (Ortodokse), shënoi ndarjen e parë të shqiptarëve në ndjekës të ritit katolik dhe në ndjekës të ritit ortodoks. S'ka dyshim se prania e riteve të ndryshme të krishtere në mesin e shqiptarëve krijonte një gjendje specifike në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit, të cilët pothuajse ishin homogjenë nga pikëpamja e strukturës fetare.

Megjithatë, pamja fetare në tokat shqiptare do të pësonte ndryshime thelbësore duke filluar nga shek. XV. Me vendosjen e sundimit osman në tokat shqiptare, përkatësia e krishterë e shqiptarëve (pjesërisht në ritin ortodoks dhe pjesërisht në atë katolik) filloi të reduktohej në dobi të përhapjes së Islamit, fe zyrtare e shtetit osman.

Në se vështrohet procesi i islamizimit nga pikëpamja sociale, bëhet e qartë se pjesa e sipërme e piramidës shoqërore, fisnikëria shqiptare, ishte e para që provoi dukurinë e kalimit në Islam, ndërsa, nga ana tjetër, vëmë re se depërtimi në shkallë të gjërë i fesë islame në radhët e popullit shqiptar gjeti shprehje pikësëpari në qytete.

Qytetet kryesore shqiptare, si Elbasani, Berati, Prizreni, Shkodra, Vuçitërna (sot: Vushtrria-F.D.), etj. u bënë seli e dinjitarëve të lartë të pushtetit provincial osman si, e sanxhakbejlerëve, allajbejlerëve, kadijve, etj. Qytete të tjera më të vogla u shndërruan në qendra të kazave apo nahijeve. Nga ana tjetër, degët kryesore të veprimtarisë ekonomike në qytete, zejtaria dhe tregtia, filluan të modelohen në përputhje me kërkesat e ushtrisë dhe të funksionarëve të pushtetit osman në provinca dhe në qendër. Në këto rrethana, fillimi i rimëkëmbjes ekonomike dhe shoqërore të qyteteve shqiptare në fund të shek. XV dhe fillim të shek. XVI, përkon në kohë edhe me fillimet e depërtimit të Islamit në masën e gjërë të popullsisë qytetare. Ndërsa për mjaft qendra qytetare fillimet e këtij procesi konstatohen vetëm në vitet '20-30 të shek. XVI, për disa të tjera duket se feja e re ka nisur të "zbresë" nga parësia e islamizuar në masën e popullsisë qytetare të krishterë, të paktën që nga vitet 80 të shek. XV.

Kështu p.sh. qytetet e Vlorës, Gjirokastrës dhe Beratit, ende në fillim të shek. XVI nuk kishin të regjistruar asnjë shtëpi myslimane (këtu përjashtohet klasa ushtarake-administrative pjesëtarët e së cilës nuk regjistroheshin në defterët osmanë, sepse nuk bënë pjesë në popullsinë taksapaguese). Ndryshe nga qytetet e lartpërmendura, që në vitin 1485 qyteti i Shkodrës numëronte 26 shtëpi myslimane, ndërsa qyteti i Pejës 23 syresh. Për më tej, në qytetin e Vuçiternës më 1487, ekzistonte "bashkësia e myslimanëve" me 33 shtëpi nga 107 shtëpi që kishte qyteti; po këtë vit në qytetin e Prishtinës numëroheshin 51 shtëpi të islamizuara nga 299 shtëpi që kishte gjithsej qyteti; ndërsa qyteti i Tetovës që më 1468 kishte të regjistruara 41 shtëpi të kthyera në Islam nga 164 shtëpi që numëronte gjithsej ky qytet.

Ndërsa në pjesën qytetare të popullsisë shqiptare feja islame u përhap me ritme relativisht të shpejta, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI, dukuria e apostazisë (lëshimit të fesë) ende kësaj kohe nuk ishte karakteristike për popullsinë fshatare. Dallimet e mëdha midis popullsisë qytetare dhe asaj fshatare përsa i përket shkallës së islamizimit, duken në faktin se aty nga fundi i shek. XVI përqindja e islamizimit të së parës kapte shifrën 49 në një kohë që e dyta ishte islamizuar vetëm në rreth 17% të saj. Megjithatë, kalimi total në Islam i parësisë shqiptare, konsolidimi i pozitave të fesë islame në qytete

nëpërmjet depërtimit masiv të saj në radhët e popullsisë qytetare, ishin premisa të fuqishme për shpejtimin e ritmeve të islamizimit edhe në pjesën rurale të popullsisë.

Për këtë arsye, duke filluar që nga shek. XVII, burimet historike flasin për kalime masive në Islam të popullsisë së krishterë. Gjatë kësaj kohe një numër i madh fshatrash u islamizuan tërësisht. Në mjaft fshatra të tjerë konstatohet rënie e dukshme në numrin e shtëpive të krishtera nga njëra anë dhe shtim i shtëpive myslimane nga ana tjetër.

Në vitin 1624 në tërë dioqezën katolike të Tivarit nuk numërohehin më shumë se 2000 banorë të besimit katolik, ndërsa në qytetin me të njëjtin emër kishte mbetur vetëm një kishë e ritit të lartpërmendur, e cila mundi të shërbente si e tillë deri në fund të shekullit XVII. Sipas një relacioni të kreut të Arkipeshkvisë së Tivarit V. Zmajević, përpiluar më 1703, procesi i islamizimit në dioqezat e përfshira brenda juridiksionit të arkipeshkvisë së lartpërmendur (Shkodra, Pulti, Zadrima, Lezha dhe Durrësi) kishte arritur në kuota të konsiderueshme. Në vitet 20 të shek. XVIII, në nahijet dhe në kazatë e Shqipërisë së Mesme, popullsia pothuajse tërësisht kishte përqafuar besimin islam. Gjatë shek. XVIII edhe popullsia e krahinave të Shqipërisë Jugore u fut në rrugën e islamizimit masiv. Në vitet 1735-40 pjesa dërrmuese e banorëve të Vlorës, Beratit dhe krahinave përreth, e kishte lëshuar fenë ortodokse duke kaluar në Islam.

Vrojtimi i dinamikës së procesit të islamizimit tregon se rreth mesit të shek. XVIII struktura e re fetare e popullit shqiptar, d.m.th. përpjesëtimet sasiore midis popullsisë së krishterë dhe asaj të islamizuar, kishin arritur pak a shumë në nivele të qëndrueshme, të cilat, me ndryshime të pakta, do të ruhen deri në ditët tona. Kalimet e mëvonshme në Islam, nga ana numerike nuk ishin të asaj shkalle sa të kishin ndikime të ndjeshme në strukturën konfesionale të popullit shqiptar.

Islami u përhap në tokat shqiptare jo vetëm në variantin e vet kryesor, sunit, por edhe në formën e sekteve (tarikateve) të ndryshme siç ishin Bektashizmi, Halvetizmi, Rufaizmi, etj. Dëshmi të pranishëm së këtyre sekteve mistike në territorin shqiptar ishin teqetë e ndërtuara në një numër vendbanimesh. Midis sekteve islamike në fjalë, Bektashizmi fitoi një popullaritet dhe shtrirje të konsiderueshme në viset shqiptare.

Natyra liberale dhe eklektike e Bektashizmit e bëri këtë sekt mjaft të pranueshëm për mjedisin ballkanik e veçanërisht për atë shqiptar ku feja e krishterë bashkëjetonte me elemente të fuqishëm të trashëgimisë pagane të periudhës parakristiane. Në këtë mënyrë, përhapja e Bektashizmit në tokat shqiptare u bë një nga aspektet kryesore të procesit të islamizimit të popullsisë, duke e shoqëruar këtë proces që nga fillimet e tij. Edhe pse siç u theksua më sipër, tradita bektashiane duhet të ketë qenë e hershme në Shqipëri (fundi i shek. XIV - fillimet e shek. XV), burimet historike të njohura deri më tani, i regjistrojnë gjurmët e saj që nga gjysma e dytë e shek. XVII.

Ritmet e përhapjes së Bektashizmit në radhët e popullit shqiptar u shpejtuan gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII dhe fillimeve të shek. XIX. Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIX përmasat gjeografike të shtrirjes së Bektashizmit në viset shqiptare ishin pothuajse të trajtës përfundimtare dhe më pas, mund të flitet përgjithësisht vetëm për evolucion të brendshëm të këtij sektit në Shqipëri dhe jo për ndonjë ridimensionim hapësinor të përhapjes së tij.

Me përhapjen e fesë islame, në viset shqiptare u thellua më tej diversiteti fetar, gjë që potencialisht krijonte kushte për përçarjen dhe shpërbërjen e kombit shqiptar. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi për arsye se realiteti i ri fetar ishte një mozaik i vendosur mbi një shtrat të fuqishëm, të përforcuar në rrjedhën e historisë nga veprimi i faktorëve të konvergencës siç ishin tiparet etnopsikologjike, gjuha dhe kultura e përbashkët, etj. Nga ana tjetër, ashtu sikundër Krishtërimi (Ortodoks apo Katolik), edhe Islami tek shqiptarët, përgjithësisht, mbeti një fe popullore (veçanërisht në pjesën rurale të popullsisë), larg intolerancës dhe fanatizmit doktrinar. Për më tepër, përhapja në viset shqiptare e sekteve (tarikateve) të ndryshme islamike krahas Islamit sunit, e zbuti së tepërmi klimën e marrëdhënieve ndërfaqetare në trevat shqiptare. Një rol të veçantë në këtë drejtim luajti urdhëri bektashian, i cili duke qenë i afërt me të dy besimet kryesore, Krishtërimin dhe Islamin, duke predikuar tolerancën dhe mirëkuptimin mbarëshqiptar, kontribuoi në frenimin e prirjeve ndarëse në gjirin e popullsisë dhe në fuqizimin e lidhëzave të unitetit mbi baza etnike e kombëtare.

Të dhënat e perftuara nga burime të ndryshme historike mund të konsiderohen si vërtetimi më i sigurtë për ekzistencën e tolerancës

dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Misionarët katolikë të shek. XVII në raportet e tyre dërguar Selisë së Shenjtë të Romës na e përcjellin me qartësi një realitet të tillë kur theksojnë se nga që rrijnë vazhdimisht bashkë, të krishterët mësonin shumë sende nga myslimanët, si p.sh., të kremtonin ditën e premte që ishte festa kryesore e këtyre të fundit, ndersa myslimanët, si të pre-jardhur nga të krishterët, ruanin shumë zakone të këtyre të fundit. Të dy palët ftonin njeri-tjetrin në kremtime festash, në raste vdekjesh, në dasma, etj. Shumë nga të krishterët, sipas të njejtave burime, duke marrë e dhënë me myslimanët, besonin se edhe ata çliroheshin nga mëkatet, në se kishin të tilla. Një gjë të tillë e vinte re edhe një vëzhguese e huaj në Stamboll, e cila më 1717 në lidhje me shqiptarët shkruante: “ Këta njerëz, që jetojnë midis të krishterëve dhe muhamedanëve dhe që nuk ua kanë marrë dorën mosmarrëveshjeve (fetare-F.D.), deklarojnë se nuk janë aspak në gjendje të gjykojnë se cili besim është më i miri. Por, për hir të së vërtetës, ata i ndjekin me maturi të dy besimet. Shkojnë në xhami të premteve dhe në kishë të dielave, duke nxjerrë si pretekst se në ditën e gjykimit do të kenë mbrojtjen e profetit të vërtetë; mirëpo, se kush është ky profet, nuk janë në gjendje ta përcaktojnë në këtë botë”.

Veçanërisht gjatë shekujve kur procesi i islamizimit të popullsisë shqiptare ishte në zhvillim e sipër, vija dalluese midis pjesës së krishterë dhe asaj të islamizuar të popullsisë paraqitej jo fort e theksuar. Kështu, p.sh. në mjaft raste, ndryshimet në përkatësinë fetare u neglizhuan në sfera të tilla të rëndësishme të jetës shoqërore siç ishin marrëdhëniet martesore. Burimet historike të shek.XVII-XVIII jo rrallë ofrojnë të dhëna, sipas të cilave, vajza të krishtera martoheshin me djem të islamizuar dhe se këta të fundit u kërkonin priftërinjve katolikë që grave të tyre të krishtera t’u jepeshin sakramentet e shenjta (pagëzimi, kungimi, rrëfimi etj.). Për më tej, ishin të shumta rastet kur edhe familje tërësisht të islamizuara u kërkonin priftërinjve pagëzimin e fëmijëve të vet. Në zonën rurale sidomos, toleranca në zbatimin e normave dhe të porosive të fesë islame ishte akoma më e shprehur. Në mesin e popullsisë fshatare, ishin pothuajse të panjohura dukuri të tilla si mbulimi i fytyrës së grave, etj. Në këtë segment të popullsisë shqiptare, për shkak të prirjeve konservuese më të fuqishme, bashkë-

jetesa e traditave parakristiane (pagane), kristiane dhe islamike, ishte më karakteristike se sa në mjedisin qytetar.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e përbashkët e popullsisë shqiptare, si të krishterë ashtu dhe myslimane, në lëvizjen çlirimtare kundërosmane, flet qartë për cektësinë e ndarjes fetare përballë vetëdijes së bazuar në njësinë etnike e kombëtare. Midis të tjerash, këtë fakt e përforcon edhe Pjetër Budi, një nga prelatët katolikë dhe intelektualët e shquar shqiptarë të shek.XVII, i cili në një projekt të vetin të vitit 1621, për organizimin e kryengritjes çlirimtare në Shqipëri, llogariste si pjesëmarrës në të, jo vetëm pjesën e krishterë, por edhe atë myslimane të popullit shqiptar.

Realiteti i ri konfesional i cili gjente shprehje në ekzistencën tashmë të katër komuniteteve fetare (mysliman-sunit, bektashian, ortodoks dhe katolik), fatmirësisht në rastin shqiptar, nuk u shoqërua me krijimin e një realiteti të ri etnik. Si popullsia e krishterë ashtu dhe ajo e islamizuar, pavarësisht nga dallimet fetare, vijuan të ruanin përkatësinë etnike shqiptare, e cila shprehej në gjuhën, zakonet, traditat dhe përgjithësisht në konstitucionin shpirtëror të përbashkët. Fuqia e lidhjeve tradicionale midis shqiptarëve të përforcuara në rrjedhën e historisë ishte e tillë që neutralizonte një përçarje të mundshme të shkaktuar nga diversiteti fetar. Në këtë mënyrë, vetëdija kombëtare e shqiptarëve mbeti parësore në identifikimin e tyre përpara të huajve. Ndryshe nga provincat e tjera të Perandorisë Osmane, ku njerëzit që pyeteshin se ç’ishin, të përgjigjeshin se ishin “turq” apo “kristianë”, në Shqipëri për të njëjtën pyetje përgjigja ishte “ jam shqiptar”.

Bashkëjetesa paqësore dhe toleranca në marrëdhëniet ndërfitare si një vlerë e spikatur dhe e qëndrueshme e popullit shqiptar ka gjetur shprehje të qartë edhe në veprën e njohur “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” të rilindasit shqiptar Pashko Vasë Shkodrani, ku, ndër të tjerash thuhet: “Myslimanët e Shqipërisë janë shqiptarë si dhe të krishterët; flasin po atë gjuhë, kanë po ato zakone, vazhdojnë po ato doke dhe po ato tradita. Në mes atyre dhe të krishterëve kurrë s’ka pasur smira të rrënjosura as dhe armiqësira shekullore. Ndryshimi fesë kurrë s’ka qenë një shkak për t’i shtyrë në një përçarje sistematike; myslimanët dhe të krishterët, me pak përjashtime, gjithmonë kanë je-

tuar në një shkallë barazie, që gëzojnë po ato të drejta dhe përmbushin ato detyra”.

Mjaft domethënëse janë në këtë drejtim edhe përshtypjet e përfuturara nga publicistja dhe etnologia e njohur E. Durham, e cila e ka vizituar Shqipërinë në vitet e para të shek. XX. Gjatë udhëtimit në juglindje të vendit ajo kishte takuar kajmekanin e Leskovikut, një shqiptar i ri që fliste mirë frengjisht. Në bisedë e sipër ai i kish thënë zonjës angleze se të gjitha fetë, për të, të nxirrnin në të njëjtin shteg: që të shkojmë në një vend duhet të ndjekim rrugën; shkojmë nëpërmjet rrugës së Kishes apo të Xhamisë, s’ka asnjë ndryshim. Zoti është gjithmonë po ai por ajo që duhet të mbajmë mend në radhë të parë është se ne jemi shqiptarë”

Gjatë rrugës Leskovik-Permet, Durhami ndeshi një kishëz guri të dalë jashtë funksionit, sepse tashmë fshati përreth ishte kthyer në mysliman. Megjithatë, asaj i kishin thënë se kjo kishë ishte e mbrojtur nga një mrekulli dhe se asnjë njeri nuk guxonte të priste dru pranë saj.

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, aktivistët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare forcimin dhe zhvillimin e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, e vendosën në qendër të veprimtarisë së tyre patriotike. Thirrja “feja e shqiptarit asht shqiptaria” u bë parrullë bashkuese në luftën për çlirimin kombëtar nga sundimi osman dhe themelimin e shtetit shqiptar të pavarur më 1912. Në këtë mënyrë, shqiptarët ftoheshin për bashkim jo duke i mohuar, por përkundrazi, duke i respektuar fetë e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirim nga sundimi osman dhe krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të singertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, pavarësisht nga përkatësia e ndryshme fetare, të cilët dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar.

Solidariteti dhe toleranca fetare midis shqiptarëve u shfaqën me një shkëlqim të veçantë edhe në periudhat e mëvonshme. Atë Luigj Bumçin, Atë Gjergj Fishtën, Mehdi Frashërin, Mihal Turtullin, Hoxhë Kadrinë, Luigj Gurakuqin, Fan Nolin dhe Faik Konicën, i shohim të gjithë së bashku në Shqipëri apo jashtë saj në mbrojtje të çështjes shqiptare.

Prifti katolik Luigj Bumci i cili në dhjetor të 1919 shkoi në Vatikan në mbrojtje të çështjes shqiptare i tha Papës se shumica e shqiptarëve që ndodheshin në Paris si anëtarë të delegacionit shqiptar ishin myslimanë, dhe se e kishin zgjedhur atë kryetar të tyre dhe e kishin dërguar atje (pra në Vatikan – F.D) për të kërkuar Shenjtërisë së Tij të ndihmonte në zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Ishte pikërisht ky realitet fetar në Shqipëri që tërhoqi dukshëm vëmendjen edhe të diplomatëve të huaj në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara për Shqipërinë në fillim të viteve 20-të. Duke marrë fjalën në Gjenevë më 17 dhjetor 1920 në Lidhjen e Kombeve kur diskutohej çështja e pranimit të Shqipërisë në te, delegati Indian u shpreh “Kur në botë zhvillohen ende luftëra ndërfetare, në Shqipëri, myslimanët, katolikët, ortodoksët, jetojnë në harmoni dhe është fakt i shkëlqyer për një vend me shumice dërmuese të popullsisë myslimane të perfaqësohej këtu nga një kristian (është fjala për Fan Nolin – që kryesonte delegacionin shqiptar) dhe pikërisht një prift.

Fan Noli i kapërceu kufijtë e përkatësisë fetare dhe mendoi dhe veproi gjatë gjithë jetës së tij në dobi të mbarë popullit shqiptar. Në këtë prizëm ai vlerësonte si të domosdoshëm afrimin dhe bashkimin kishtar të krishterëve shqiptarë si dhe për zhvillimin e dialogut ndër-fetar krishtero-mysliman.

Edhe mbreti i shqiptarëve Zogu I, i cili bëri shumë për modernizimin e institucioneve fetare në Shqipëri, për ndarjen e shtetit nga feja, ditën që u bë mbret i shqiptarëve me 1 shtator 1928, bëri betimin e tij duke vendosur duart mbi Bibël dhe Kuran duke premtuar se do të mbronte unitetin kombëtar.

Me shembjen e komunizmit në Shqipëri, me rihapjen e institucioneve fetare, myslimanët, katolikët dhe ortodoksët, morën pjesë së bashku në ceremonitë e rihapjes së këtyre institucioneve, ashtu siç festojnë sot së bashku festat fetare të njëri-tjetrit.

Sot kur e gjithë bota e civilizuar është duke luftuar kundër terrorizmit të shfaqur nën petkun fetar, ne shqiptarët jemi më të vetëdijshëm që të luftojmë më shumë për fuqizimin e faktorëve që ndihmojnë dhe ushqejnë harmoninë dhe bashkëjetesën paqësore fetare e kultivuar historikisht, duke luftuar dhe shmangur ndikimet negative që mund të imponohen shqiptarëve kryesisht nga jashtë Shqipërisë.

Prof. As. Dr. Ferit Duka

THE HISTORICAL ROOTS OF RELIGIOUS TOLERANCE IN ALBANIA

(Summary)

The history of the Albanian people offers a unique model as far as the religious composition of its people during the centuries is concerned. The Albanians were among the first in Europe to embrace Christianity at the beginning of the new era. The great schism in 1054 marked the division of the church into Catholic (western) and Orthodox (eastern). The schism affected the Albanians as well. There is no doubt that this created a specific situation compared to the other peoples of the Balkans, who were homogenous as far as their religious structures were concerned.

فريد دوكا

الجدور التاريخية لظاهرة التسامح الديني في البانيا

(خلاصة البحث)

أن تاريخ لشعب الالباني يمثل نموذجا فريدا من نوعه فيما يتعلق بخصائصه الدينية عبر القرون. الشعب الالباني كان من الشعوب الأولى الذي اعتنق المسيحية في عصورها الأولى. و عندما حدث الانفصال الكبير سنة ١٠٤٥ بين الكنيسة الشرقية و الغربية فان الشعب الالباني هو من اوائل الشعوب التي تأثر بهذا، اذ جزء منهم تبع الكنيسة الشرقية الارثوذكسية و الجزء الآخر تبع الكنيسة الغربية الكاثوليكية. و كان لهذا التنوع الديني لدى الشعب الالباني أثر كبير لاكتسابه ميزة التسامح اذ كانت بقية الشعوب البلقانية تتميز بوحدة التماسك الديني.

Në të gjitha rastet ato janë të dëmshme dhe të dhembshme. Si duhet ta zgjidhim problemin e intolerancës? Ç’duhet të ndërmarrim në besimin tonë që të mos jemi intolerant ndaj të tjerëve? Ç’duhet të ndërmarrim ne që në rajonin tonë të mbretërojë toleranca? Unë do të përpiqem të diskutoj për këto çështje nga aspekti islam.

Ç’është toleranca?

Por, para se t’i hyjmë çështjes në fjalë, të shohim se çfarë kuptojmë me shprehjen tolerancë. Kjo është një fjalë latine (tolerantia), që do të thotë durim.¹ Ndërsa në aspektin konceptual do të thotë: “respekti, pranimi i së drejtës së tjetrit apo të të tjerëve që të jetojnë, besojnë, vlerësojnë, veprojnë etj. sipas bindjes së tyre, bile edhe atëherë kur mendimet, bindjet, veprimet e tyre janë në kundërshtim me mendimet, bindjet dhe interesat tona. Toleranca e njëmendtë është jo vetëm heqja e ekskluzivitetit, jo vetëm mosmarrja e masave ndëshkimore fizike, terrorit shpirtëror etj., por edhe respektimi i atij që mendon, beson apo vepron ndryshe.”²

Në gjuhën arabe toleranca quhet “tesamuh” (“me u sjellë mirë ndaj njëri-tjetrit, njëri-tjetrit me ia fal, me u pajtue”).³

Ekzistojnë edhe fjalë të tjera, të cilat japin të njëjtin kuptim, si: “hilm”⁴, “vetëpërmbytje”, ose “afw”⁵ (pardon, kërkim falje), apo “safaha”⁶ (përsëritet, i shtrij dorën).

Toleranca është parim themelor i Islamit. Ajo është obligim fetar dhe moral.⁷ Në literaturën islame për tolerancën përdoret, siç thamë pak më parë, fjala “tesamuh” në arabisht, kurse fjala hosgörü (hosh-goru) në turqisht. Këto dy shprehje, edhe pse të shumtën e rasteve përkthehen si tolerancë, sipas disa dijetarëve muslimanë kanë kuptim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës. Për shembull, Husejn Batuhan

KUMTESË

Mr. Qemajl Morina

BAZA DOKTRINORE E TOLERANCËS ISLAME*

E nderuara Kryesi, zonja dhe zotërinj,

Kumtesën time po e filloj me citimin e këtij ajeti (verseti) kuranor: **“... O ithtarë të Librit (Tevratit e Ungjillit), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos i bëjmë askënd shoq Atij, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos Allahut” (Ali -Imran, 64).**

Kam nderin që sot kam rastin që, në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, të përshëndes Institutin e Shqipërisë për Studime Ballkanike dhe Fondacionin Fridih Ebert për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare *“Marrëdhëniet Ndëretnike dhe Toleranca e Religjioneve”*.

Kjo iniciativë për mbajtjen e kësaj konference ka ardhur në momentin e duhur dhe zgjedhja e Tiranës për mbajtjen e saj është një hap shumë i qëlluar, për shkak të prestigjit dhe rolit që duhet të luajë ajo në të ardhmen për tejkalimin e pasojave që lanë pas luftrat si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë për rritjen e intolerancës në kohën e sotme. Pasojat e saj janë vdekjet, gjenocidi, dhuna, persekutimi fetar si dhe konfrontimet e niveleve të ndryshme. Në disa raste ato janë racore dhe etnike, në disa raste ato janë fetare dhe ideologjike e në raste të tjera janë politike dhe sociale.

¹ Ekrem Murtezai, Fjalor filozofik, Prishtinë, 1995, f. 828.

² Ibid, f. 828.

³ Tefik Muftic, Arapsko-bosanski rjecnik, Sarajevo, 1997, s. 673.

⁴ Tefik Muftic, Arapsko-bosanski rjecnik, Sarajevo, 1997, s. 326.

⁵ Ibid, s. 1032.

⁶ Ibid, s. 802.

⁷ Muzzamil Siddiqi, Tolerance: Islamic Perspective, The Spirit of Tolerance in Islam: (www.erescentlife.com).

dhe Xhemil Meriç fjalën “tesamuh” (musamaha, hosgörü) nuk e për-kthejnë tolerancë, për arsye se fjala tolerancë nuk ngërthen në vete një bashkëjetesë të gjerë, një respekt reciprok apo qëndrim dhe të jetuar bashkë.⁸

Dijetarë të tjerë muslimanë, kur diskutojnë për tolerancën, thonë se kjo shprehje ka kuptimin që edhe në momentet kur diçka nuk të shkon për qejfi ose nuk të pëlqen, je i detyruar ta pranosh. Edhe pse ke të bësh me një çështje që nuk e dëshiron, si për shembull, ke një fqinj, një mik apo një shok, ose kushtet ta mundësojnë të jetosh me ndonjë pjesëtarë të ndonjë besimi, ideologjie, bindjeje tjetër nga ajo për të cilën je i përcaktuar ti, dhe je i detyruar që atë ta pranosh ashtu si është. Pra, kemi të bëjmë me një mundim që i bëjmë vetes sonë. Ndërsa toleranca islame (tesamuh, hosgörü) është diçka tjetër; në tolerancën islame nuk ekziston ajo që njeriu të detyrojë vetveten, por që njeriu të pranojë e të pajtohet me realitetin. Për shembull, kur Islami i lejon një muslimani të martohet me një ithtare të Librit (Ehli Kitab), këtë nuk e bën që muslimani ta ndiejë veten e tij të munduar, duke menduar se s’ka ç’të bëjë dhe patjetër duhet të pajtohet me këtë realitet. Por, muslimanit ia mundëson që ai një gjë të tillë ta pranojë me bindje e pa detyrim, duke menduar se kjo është nga ithtarët e Librit dhe unë pajtohem me bindjen dhe besimin e saj. Pra, në tolerancën islame nuk mund të përdoret dhuna.⁹

Nëse i bëjmë një vështrim historisë së Islamit, do të shohim se ai nuk ka ndërhyrë asnjëherë në parimet esenciale të ndonjë feje dhe as që do t’i lejohet të ndërhyjë ndonjëherë në të ardhmen, asnjëherë nuk ka themeluar ndonjë organizatë inkuizicioni dhe asnjëherë nuk ka pasur për qëllim ndërrimin me forcë të fesë së ndonjë njeriu apo të ndonjë populli, sepse kjo bie ndesh me parimet themelore të Kur’anit, i cili urdhëron e thotë: **“Nuk ak detyrim në fe...”** (El-Bekare, 256). Edhe ajeti kuranor: **“O ju që besuat, hyni në Islamizmin e tërësishëm (fis-silmi – në paqe), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armiku juaj i hapët”.** (El-Bekare, 209).

Pra këto dy ajete dhe shumë ajete të tjera që gjenden në Kur’an, na tregojnë se Islami kategorikisht është kundër dhunës dhe se me një

imperativ kategorik është dhe urdhëron për paqe. Kjo kuptohet nga fjala “silm”, që u përmend në ajetin e cituar më parë e që do të thotë paqe, respekt; edhe fjala Islam rrjedh prej së njëjtës rrënjë dhe ka kuptimin nënshtrim ndaj Allahut.

Respekti i muslimanëve ndaj të krishterëve

Ne muslimanët e pranojmë Ungjillin (Inxhilin) e zbritur, si njërin nga librat e Allahut, të cilit duhet t’i besojmë. Gjithashtu, ne pranojmë edhe Krishtin si profet midis profetëve, si dhe nënën e tij që Allahu e ka zgjedhur dhe shenjtëruar midis të gjitha grave.

Në Kur’an nuk ekziston asnjë sure (kaptinë) që flet për gruan e Muhamedit (a.s.), Hatixhen, dhe bijën e tij, Fatimen, por ekziston një sure që i kushtohet Marisë (Merjemes) dhe një tjetër që i kushtohet familjes së Jezusit (Isait a.s.), e cila quhet “surja (kaptina) e familjes së Imranit”. Imrani ishte babai i Marisë: **“Allahu zgjodhi Ademin, Nuh-un, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit përmbi popujt e tjerë”.** (Ali-Imran, 13).

Në Kur’an ka ajete (versete) që flasin për Krishtin që nuk përmenden as në Ungjill.

Gjithashtu ne muslimanët jemi të urdhëruar të bëjmë dialog në mënyrën më të mirë, veçanërisht me Njerëzit e Librit (Ehlul-Kitab). Allahu thotë:

“Ithtarët e Librit mos i polemizoni ndryshe vetëm ashtu si është më së miri”. (Ankebut, 46). Kjo do të thotë se, nëse do të ekzistonin dy mënyra diskutimi, njëra e mirë dhe tjetra më e mirë, atëherë muslimani do të ndiqte atë që është më e mirë.

Ajo që fut paragjykime në raportet ndërmjet ithtarëve të të dyja feve të mëdha, është pikërisht moskuptimi reciprok si dhe ndërhyrja e disa individëve të huaj, të cilët duan ta përdorin fenë si mjet për arritjen e objektivave jofetarë.¹⁰ Prandaj, është detyrë e njerëzve të arsyeshëm, veçanërisht e dijetarëve të të dyja feve, që të shmangin këtë përplasje, duke ndërhyrë me urtësinë e tyre për ta shuar këtë zjarr që përpin gjithçka.

⁸ Dituria Islame, nr. 134-135, Prishtinë, f. 16.

⁹ Ibid, f. 16.

¹⁰ Dr. Jusuf Kardavi, ne jemi bij të së ardhmes, Interesi Nacional, nr. 11-12, 24 dhjetor 2001 Prishtinë, f. 44-46.

Islami, edhe në luftërat e rregullta të zhvilluara me ushtri, ndalon kategorikisht vrasjen e atyre që nuk marrin pjesë në luftë. Kur Profeti i Islamit, Muhamedi (a.s.), pa një grua të vrarë në një betejë, u zemërua dhe i qortoi pasuesit e tij duke u thënë: “Kjo grua nuk po luftonte!” Që nga ai çast, ai ndaloi vrasjen e grave, fëmijëve dhe pleqve. Pasuesit e tij i këshillonin komandantët e tyre ushtarakë që të mos i shqetësonin murgjit në manastiret e tyre, fshatarët në fusha dhe tregtarët. Një nga këshillat më të njohura, ishte: “Mos sulmoni në befasi dhe mos e shfryni zemërimin mbi kufomat e armiqve. Mos i prisni pemët dhe mos i shkatërroni ndërtesat. Mos vrisni asnjë dele a lopë, veçse për t’u ushqyer”.

Islami ka theksuar respektimin e njeriut dhe ka urdhëruar ndëshkimin për atë që vret. Kur’ani, së bashku me librat e tjerë qiellorë, thekson: **“...kush vret një njeri, pa vrarë ky i fundit ndonjë tjetër dhe pa bërë ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është sikur t’i kishte vrarë të gjithë njerëzit”**. (El-Maide, 32).

Islami luftën e lejon vetëm për vetëmbrojtje kundër ushtarakëve që i sulmojnë muslimanët. Kur’ani thotë: **“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë”**. (El-Bekare, 190).

Hirësi, Shkëlqesi dhe Miq të nderuar!

Islami e konsideron njerëzimin si një familje të vetme, pjesëtar në adhurimin e Allahut dhe pasardhës të Ademit. Pikërisht këtë e ka shpallur Profeti i Islamit përpara masave të besimtarëve gjatë Haxhit Lamtumirës: “O njerëz! Zoti juaj është Një. Babai juaj është një; të gjithë ju rridhni nga Ademi që u krijua nga dheu. Askush nga ju nuk ka më shumë merita se të tjerët, veçse për devotshmëri ndaj Allahut”.

Islami i ka përcaktuar raportet me jomuslimanët në dy ajete të Librit të Allahut, të cilat janë ekuivalente të një kushtetute. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu jua ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën nga shtëpitë tuaja dhe ndihmuan dëbimin tuaj, ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë**

dëmtues të vetvetes”. (El-Mumtehaneh, 8-9). Këto dy ajete janë shpallur për shkak të idhujtarëve.

Për Njerëzit e Librit (Ehlul-kitab), Islami ka rezervuar një trajtim të posaçëm, bile ka lejuar edhe martesën me bijat e tyre. Kjo do të thotë se i ka lejuar muslimanit të marrë një të krishtere apo çifute për grua, shoqe të jetës dhe nënë të fëmijëve të tij. Kështu të afërmit e saj bëhen gjyshë dhe gjyshe, daja dhe teze, kushërinj dhe kushërira të fëmijëve të tij, dhe këta fitojnë të drejtat e farefisnisë së afërt.

Islami i ka konsideruar të krishterët me përzemërsi si më të afërmit me muslimanët. Allahu i Gjithëfuqishëm në Kur’an thotë: **“Ndërsa do të vësh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thonë: “Ne jemi të devotshëm dhe se ata nuk janë kryelartë”**. (El-Maide, 82).

Ndërsa Profeti islam ka thënë: “Jam miku më i ngushtë i Isait, birit të Merjemes, si në këtë botë, edhe në tjetrën”.

Ne muslimanët besojmë dialogun, sepse ai është urdhëruar nga Sheriati. Kur’ani ynë është kulmi i dialogëve ndërmjet të dërguarëve të Allahut dhe popujve të tyre, bile edhe ndërmjet Allahut dhe disa adhuresve të Tij. Allahu ka dialoguar edhe me më të keqen e krijsave të Tij, Iblisin (djallin). Për këtë arsye ne marrim kulturën e dialogut në vend të asaj të konfliktit, si ndërmjet qytetërimeve, ashtu dhe ndërmjet feve. Nuk jemi dakord me logjikën e disa intelektualëve amerikanë, si Hantingtoni, që besojnë në konfliktin e paevitueshëm ndërmjet qytetërimeve dhe veçanërisht ndërmjet atij islam me atë perëndimor. Përse vallë këto dy qytetërime nuk duhet të ndërveprojnë dhe të plotësojnë njëri-tjetrin? Përse çdonjëri nga qytetërimet të mos marrë arritjet më të mira të tjetrit?

Baza doktrinale e tolerancës së muslimanëve ndaj atyre që ndryshojnë prej tyre

1. Muslimani beson se dallimet ndërmjet popujve dhe feve kanë ardhur nga vullneti i urtë i Allahut: **“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t’i bënte njerëzit të një feje. Ata vazhdimisht janë në kundërshtime mes vetes, përveç atij që mëshiron Zoti yt. Dhe për këtë i krijoi ata”**.

(Hud, 118-119). Domethënë i ka krijuar për të qenë të ndryshëm, sepse u ka dhënë intelegjencën, lirinë dhe vullnetin.

2. Muslimani beson se gjykimi i të humburve dhe pabesimtarëve nuk do të ndodhë në këtë botë, por në tjetrën. Nuk na takon neve të gjykojmë. Vetëm Allahu i Madhërishëm është Gjykatësi i Drejtë, Falësi dhe i Urti. Ai në Kur'an thotë: ***“E për këtë shkak, ti thirr dhe përqëndrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre e thuaj: “Unë kam besuar në librat që shpalli Allahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj: Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona dhe ju të veprave tua, nuk ka polemikë mes nesh dhe jush. Allahu do të na tubojë të gjithë dhe vetëm tek Ai është përfundimi”.*** (Shura, 15).

3. Muslimani beson në dinjitetin e njeriut për vetë faktin që është njeri. Në lidhje me këtë, Buhariu përcjell nga Xhabiri se Profeti a.s. u ngrit në këmbë kur përpara tij kaloi një xhenaze. I thanë: “O i dërguar i Allahut! Kjo është xhenazja e një çifuti”. Ai, paqja dhe shpëtim i Zotit qofshin mbi të iu përgjigj: “A nuk kishte shpirt ky njeri?!” Çfarë qëndrimi madhështor dhe çfarë përgjigjeje mahnitëse!

4. Muslimani beson se Drejtësia e Allahut zbatohet mbi të gjitha krijesat e Tij. Allahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: ***“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të vërtetën dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë: bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë”.*** (El-Maide, 8).

Prandaj muslimani nuk vepron me drejtësi vetëm ndaj atij që e do, dhe me padrejtësi ndaj atij që e urren. Ai e mban drejtësinë me cili-ndo, qoftë ai musliman apo jo, mik apo armik.

Gjithashtu në histori ka shumë fjalë të shkruara, qoftë më herët qoftë më vonë, për qëndrimet tolerante të Muhamedit (a.s.) ndaj muslimanëve dhe jomuslimanëve. Kështu në hadithet e Pejgamberit a.s. thuhet:

“Ai që mundon një çifut ose një të krishterë, në Ditën e Gjykimit mua do të më gjejë si paditës. Për cilindo që e mundon pa të drejtë një grup jomuslimanësh, unë jam armiku i tij. Ndërsa kujt i bëhem armik unë, ai edhe në Ditën e Gjykimit do të jetë armik me mua”.

Në qytetin – shtet që ka formuar Pejgamberi a.s., dhe në marrëveshjen që është bërë për atë shtet e që njihet me emrin Karta e Medinës, merrnin pjesë edhe muslimanët, edhe çifutët, e edhe politeistët arabë, bile edhe ata pak të krishterë që jetonin në Medinë. Këtë e vërteton edhe Kushtetuta e Muhamedit a.s.. Vesika e Medinës, e cila u përgatit nga ai dhe shokët e tij në kohën kur ai u shpërngul nga Meka në Medinë. Në këtë kushtetutë, pjesa më e madhe e së cilës ka të bëjë me Ehli Kitabët (Ithtarët e Librit) gjenden edhe disa shprehje, si: Hebrenjtë që do të jetojnë në mesin tonë, do të fitojnë të drejtën e ndihmës dhe të barazisë; Hebrenjtë benu Avf me besimtarët (muslimanët) janë një popull (ymet); Hebrenjve u takon feja e tyre, ndërsa besimtarëve (muslimanëve) feja e tyre; Askush nuk mund të bëjë krim ndaj aleatëve; Ata që do të strehohen tek hebrenjtë, do të llogariten si vetë hebrenjtë. E tërë kjo tregon për tolerancën e pakrahasueshme të manifestuar nga Muhamedi a.s. si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik.¹¹

Edhe pasardhësit e Muhamedit a.s., Hulefai-Rrashidinët, kishin qëndrime që ia vlen të merren si shembull për njerëzimin në përgjithësi. Si shembull mund të përmendim Ebu Bekrin, halifin e parë të shtetit islam, i cili në një fjalim të mbajtur para ushtarëve të tij, pati thënë: “Popullin mos e torturoni! Të jeni të drejtë dhe të mirë në sjellje; suktesi të jetë dobia juaj. Kur të ballafaqoheni me armikun, sulmoheni ashpër. Nëse fitoni në luftë, mos vritni fëmijët dhe gratë. Kurseni arat, fushat dhe shtëpitë. Nëse bëni ndonjë marrëveshje, përmbajuni të gjitha parimeve. Në tokat e krishtera do të takoheni me njerëz fetarë, të cilët i shërbejnë Zotit nëpër kisha dhe manastire. Mos i mundoni ata. Mos i prishni kishat dhe manastiret e tyre”.

Edhe qëndrimet e Omerit r.a. kur kishin hyrë në Jerusalem, tregojnë për tolerancën, qëndrimet pozitive të muslimanëve ndaj të tjerëve. Trimi mbrojtës i Jerusalemit, Patriku Sofranus, pas katër muajsh rrethimi, pranoi të dorëzonte qytetin, por me kusht që të vinte vetë halifi i muslimanëve Omeri r.a. Kur erdhi Omeri, të gjithë pritnin me pasion qëndrimin e tij. Duke iu drejtuar poullit Omeri, tha: “Jini të sigurt; për udhëheqjen e qytetit do të krijohet një rregull; pasuria dhe njerëzit

¹¹ Edukata Islame, revistë tremujore nr. 58-59, Prishtinë 1996, f. 55-75.

janë të garantuar, kishat dhe vendet e shenjta do të respektohen". Pastaj Omeri shëtit qytetin dhe, kur arriti te kisha më e madhe, patriku i tha: "Urdhëroni, faluni", mirëpo Omeri ia ktheu: Kisha në të cilën do të falem unë, bëhet muslimane, prandaj duke falur namaz në të, nuk dua t'ua marrë të krishterëve kishën e tyre. Dhe kështu nuk pranoi që të falej në atë kishë".

Ndërsa më 1099 Jerusalemi u okupua nga kryqtarët, dhe ata vepruan të kundërtën, jo si Omeri. Prifti Rajmond d'Agiles tregon për vrasjen e dhjetë mijë muslimanëve në Xhaminë e Omerit. Në tempullin e Pejgamberit Sulejman është derdhur aq gjak, saqë trupat e njerëzve notonin në gjakun e derdhur; notonin duar, krahë të prerë të tyre mbi gjak. Këto duar dhe këto këmbë nuk dihej se të cilat trup ishin. Edhe vetë ushtarët që kishin bërë këtë gjenocid, përballonin në vështirësi tymin që dilte nga ai vend.

Edhe Perandoria Osmane, që është faza e fundit e shtetit islam, është një shembull par excellence dhe pa precedent për tolerancën fetare në viset ku ajo kishte shtrirë pushtetin e saj. Shembujt e këtillë janë të shumtë. Ne këtu po përmendim vetëm disa prej tyre. Me rastin e hyrjes së sulltan Mehmet Fatihut në Stamboll, ai i kishte ftuar edhe muslimanët, edhe hebrenjtë, edhe armenët, që të vinin dhe të vendosehshin në Stamboll.¹²

Në kohën e sulltan Muratit II, më 1394, hebrenjtë e përzënë nga ana e mbretit të Francës Charl (Charle), kanë qenë të shpërngulurit e parë që qenë strehuar në shtetin osman.¹³

Në vitin 1577, sipas një regjistrimi që ishte bërë në atë kohë, në Stamboll ka pasur 485 xhami, e numri i kishave ishte 743.¹⁴

Sulltan Mehmet Fatihu, të krishterëve ortodoksë u ka dhënë aq të drejta, saqë Patriku kishte më tepër të drejta se vaziri (ministri) i Padishahut.

Në lidhje me sulltan Fatihun tregohet për një rast:

"Mbreti serb Brankoviç, kishte dërguar dy delegacione, njërin te mbreti i Hungarisë, Huniadi, e tjetrin te sulltan Mehmet Fatihu. Të

dyja delegacionet patën të njëjtin mision: Misioni i tyre ishte të pyesnin mbretin dhe sulltanin se, në qoftë se Serbia u nënshtrohej atyre, çfarë ofronin ata?

Mbreti hungarez që përgjigjur kështu: "Të gjitha kishat ortodokse që ekzistojnë në Serbi, do t'i prish dhe në vend të tyre do të ndërtoj kisha katolike".

Ndërkaq sulltan Fatihu ishte përgjigjur: "Do të lejoj që afër çdo xhamie të ndërtohet nga një kishë ortodokse dhe do t'ua mundësoj që në Serbi çdokush të besojë në fenë që dëshiron ta besojë".

Nga e gjithë, kjo shihet se Islami dhe muslimanët gjithmonë në vend të dhunës kanë preferuar dhe porositur paqen, në vend të forcës, kanë preferuar dhe porositur tolerancën, në vend të detyrimit, kanë përdorur metodën e bindjes.

Toleranca ndërfetare tek shqiptarët

Nuk ka dyshim se feja si njëri prej komponenteve me rëndësi në jetën shpirtërore të çdo populli, luan një rol të rëndësishëm në formimin e vetëdijes së popullit shqiptar. Ky ndikim, varësisht prej rrethanave të caktuara, ndonjëherë është më shumë e ndonjëherë më pak i theksuar.

Meqenëse trojet shqiptare gjenden në një udhëkryq me rëndësi strategjike, ku gërshetohen interesat si të Lindjes, ashtu edhe të Perëndimit, ato shumë herë gjatë historisë u shndërruan në mejdane të fushëbetejave të ndryshme të interesave të fuqive të mëdha. Si rezultat i ballafaqimeve të tilla dhe dominimit politik, ushtarak e fetar të asaj apo kësaj fuqie, u krijua një mozaik ndërfetar tek shqiptarët. Për këtë arsye, sot shqiptarët, pa marrë parasysh se ku jetojnë, në Shqipëri apo në trojet e tyre etnike në Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi a në Diasporë, u përkasin religjioneve të ndryshme. Shumica dërmuese i takojnë fesë Islame, ndërsa pjesa tjetër fesë së krishterë me dy ritet e saj, katolik dhe ortodoks. Këtu vlen të përmendim se, edhe pse populli shqiptar numerikisht është i vogël dhe i ndarë në dy konfesione e disa rite, historia nuk mban në mend të kenë ndodhur ndonjëherë konflikte fetare. Aq më tepër ai gjatë historisë tregoi një tolerancë dhe respekt të paparë edhe ndaj religjioneve dhe objekteve sakrale të fqinjëve të

¹² T.W. Arnold, The Preaching of Islam, third Reprint, May 1968, Lahore (Pakistan), p. 147.

¹³ Ahmet Hikmet Eroglu, Osmanli Devleti, Ankara, 1999, f. 61.

¹⁴ Ibid, f. 93.

tij, duke i ruajtur ato brez pas brezi. Shqiptarët për shekuj me radhë i kanë ruajtur kishat ortodokse në Kosovë dhe familjet serbe, kur ato gjendeshin në rrezik. Mjerisht, objektet fetare islame në Serbi, si dhe popullata muslimane nuk e patën të njëjtin fat. Beogradi në kohën e Perandorisë Osmane kishte afër 85 xhami, mesxhide, mejtepe e medrese, e sot ka vetëm një xhami.

Të njëjtën fatkeqësi objektet fetare islame pësuan gjatë agresionit të fundit serb në Kosovë. Vlen të përmendim se gjatë periudhës 28 shkurt 1998 – 20 qershor 1999 nga soldateska serbe u dogjën, u granatuan dhe u shkatërruan 218 xhami, disa prej të cilave me vlera të mëdha arkitektonike.

Edhe pse ne jemi të mendimit se konflikti serbo-shqiptar në Kosovë nuk kishte karakter fetar, pala serbe është përpjekur që simbolet fetare t'i përdorte për mobilizimin e forcave serbe, për pastrimin e territoreve ku jetojnë shqiptarët, dhe për zhdukjen e monumenteve kulturore të tyre, siç janë xhamitë, minaret, mejtepet, si dhe vizatimi i katër S-ve si simbol i ortodoksizmit, bile këtë në shumë raste e bënte policia serbe në kraharorët dhe fytyrat e të rinjve shqiptarë.

Me gjithë tërë ato që kanë ndodhur në Kosovë, qoftë në të kaluarën e largët apo të afërt, shqiptarët si popull shumicë në Kosovë, i janë kthyer ardhmërisë dhe ata jetësisht janë të interesuar për stabilizimin e gjendjes në të. Na gëzon fakti që kemi edhe ndihmën e Bashkësisë Ndërkombëtare.

Ndikimi ynë, si njerëz të fesë, nuk mund të jetë vendimtar, mirëpo as nuk duhet të nënçmohet. Të bëjmë diçka për uljen e tensionit. Ta kthejmë besimin midis fqinjëve. Ky është obligim yni si njerëz të fesë. Për këtë na obligojnë librat tanë të shenjtë, të cilët i lexojmë në namazet dhe meshat tona. Ky është misioni ynë që midis njerëzve të kultivojmë dashurinë dhe respektin e ndërsjellë e të luftojmë urrejtjen dhe armiqësinë. Të bëjmë diçka që Kosova të bëhet oazë e paqes dhe bashkëjetesës midis popujve që jetojnë në të. Ne kemi qenë dhe jemi të gatshëm. Zoti na ndihmoftë! Amin.

* Kumtesë e paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare "Marrëdhëniet Ndëretnike dhe Toleranca e Religjioneve" mbajtur në Tiranë më 11 e 12 dhjetor 2002, organizuar nga Instituti i Shqipërisë për Studime Ballkanike dhe Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich Ebert).

Mr. Qemajl Morina

THE DOCTRINAL BASIS OF ISLAMIC TOLERANCE

(Summary)

If we have a look at the history of Islam, we will notice that Islam has never interfered with the essential principles of the other religions and will never do so. Islam has never established tribunals similar to the inquisition and has never aimed at changing the religion of people or nations by force (as this is in contravention with the basic principles of the Koran - "Let there be no compulsion in religion..." (Al Baqarah, 256). "O' ye who believe! Enter into Islam whole-heartedly; and follow not the footsteps of the Satan for he is to you an avowed enemy" (Al Baqarah, 208)).

The ayats of the Koran show that Islam is against the use of violence.

The word "silm", which was mentioned in Al Baqarah, 208, means peace. The word Islam derives from the same base and has the meaning of subordination to Allah.

كمال مورينا

مبدأ التسامح في الاسلام

(خلاصة البحث)

إذا ما امعنا النظر في التاريخ الاسلامي فسوف نرى أنه لم يتدخل قط في المبادئ الأساسية لاي دين، و لن يسمح له بان يفعل ذلك في المستقبل، و التاريخ الاسلامي لا يذكر انه اقام محكمة تفتيش و لا يذكر التاريخ بان الاسلام حاول تغيير معتقدات مجموعة من الناس أو الشعوب عن طريق اسخدام القوة او بحد السيف، لان ذلك يتنافي تماما مع المبادئ الأساسية للقرآن الكريم الذي يقول: "لا اكراه في الدين قد تبين الرشد من الغي" (سورة البقرة ٢٥٦) وكذلك الآية: "يا أيها الذين آمنوا ادخلوا في السلم كافة و لا تتبعوا خطوات الشيطان انه لكم عدو مبين" (السورة البقرة ٢٠٨)

KUMTESË

Prof. Ascc. Edlira Haxhiymeri*

FEJA DHE PROBLEMET SOCIALE NË SHOQËRINË SHQIPTARE NË TRANSIZION

Të nderuar pjesëmarrës!

Duke përshëndetur nismën për të organizur një aktivitet të tillë, që i shërben nxitjes së frymës së bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në rajon, më lejoni të theksoj që në fillim se tek ne mungojnë ose janë në fillimet e tyre studimet në fushën e fesë, aq më tepër ato të marrëdhënieve të saj me problemet sociale. Një situatë e tillë si dhe vlerësimet me ngarkesa politike, ideologjike dhe paragjykime si dhe vlerësimet shpesh intuitive, e bëjnë të vështirë vlerësimin e rolit të fesë në jetën social politike të shqiptarëve, veçanërisht në ditët tona, kur situata komplikohet edhe me sfidat që duhet të përballojnë shqiptarët pothuajse në të gjitha fushat.

Periudha e tranzicionit u shoqërua me ndryshime të mëdha duke filluar nga ato me natyrë politike, ekonomike dhe sociale, ku ishin më të ndjeshme ndryshimet në fushën e vlerave, të sistemeve, të familjes përjetimi apo shpërthimi i problemeve që deri më parë ishin konsideruar si tabu, të cilat u shoqëruan nga lëkundja deri në humbjen e besimit tek institucionet, tek ligji dhe shteti.

Të tilla situata janë shumë të rrezikshme për çdo shoqëri pasi mund t'i lëshojë njerëzit në krahët e dëshpërimit ekstrem dhe të një egoizmi të shfrenuar, ku humbasin vlerat e vërteta shpirtërore dhe etja për fitim dhe mashtrim mbysin gjithçka pozitive të krijuar prej shekujsh.

Në të tilla raste njerëzit kanë nevojë për një shpëtim. Ata kanë nevojë t'i drejtohen dikujt që u premton lirinë, sigurinë, dhe një jetë ku sundojnë vlerat e vërteta njerëzore.

Por si paraqitet problemi i besimit fetar mes nesh para dhe gjatë kësaj periudhe të quajtur tranzicion?

Të gjithë ne jemi dëshmitarë që gjatë periudhës së regjimit komunist shpëtimtari u bë Partia dhe vendin e librit të shenjtë e zunë veprat e udhëheqësit. Feja u godit rëndë, u shkatërrua nga pikëpamja institucionale, por që në një farë mase u shoqërua me forcimin e ndjenjes së besimit fetar tek njerëzit, dhe veçanërisht tek besimtarët. Persekutimi që regjimi u përpoq t'i bënte fesë në fakt në vend që të shkonte në favor të persekutorëve por shkoi në favor të forcimit të ndjenjës së besimit të besimtarëve.

Pas rënies së sistemit komunist njerëzit besuan në pluralizmin politik, në programet dhe premtimet e partive politike mbi vendosjen e demokracisë, shtetit të së drejtës, drejtësisë sociale dhe lirisë së individit. Vitet e tranzicionit në përgjithësi, por viti 1997 në veçanti, goditi shumë besime dhe iluzione. Në kushtet kur u thellua pasiguria, kur u shtuan problemet, kur mungonin zgjidhjet dhe në vend të tyre njerëzit u bombarduan me politikë dhe diskutime të pafundme pa produkt përfundimtar, kuptohet që u shtua nevoja për të gjetur diçka për t'u mbështetur dhe për të besuar.

Një filozof i lashtë do të thoshte se feja është një nga shpikjet më të mrekullueshme të njerëzimit. Nëpërmjet saj ne arrijmë të krijojmë një tablo të përkryer të botës ku jetojmë, të cilën e vëmë në kontrast me realitetin e korruptuar në të cilën ne jetojmë dhe në këtë mënyrë feja bëhet një model për përsosjen e moralit dhe të vlerave të njerëzimit. Ky mesazh filozofik duket se është shumë aktual për shoqërinë tonë sot të mbërthyer nga krizat ekonomike dhe politike, por edhe nga kriza e moralit, nga të cilat ne nuk po shkëputemi dot edhe pas një periudhe përpjekjesh më tepër se 10 vjeçare.

Në një situatë të tillë, pa dashur të jemi pesimistë, por edhe jo më tepër optimistë se çduhet, cila është shkalla e besimit fetar mes shqiptarëve sot?

Në një studim të bërë nga disa pedagogë të fakultetit të shkencave sociale për problemet e fesë dhe të vlerave në shoqërinë shqiptare janë

grumbulluar disa fakte mjaft domethënëse për nivelin e besimit fetar në Shqipëri në varësi të disa komponenteve sociale që ne do të përpiqemi t'i prezantojmë më poshtë:

Të pyetur se sa e rëndësishme është feja për ta.

33.8% e të anketuarëve u përgjigj se e konsiderojnë fenë si shumë të rëndësishme,

41.9% si mjaft të rëndësishme,

16.4% si pak të rëndësishme

7.2% si aspak të parëndësishme.

Pra, më shumë se 75% e shqiptarëve besojnë se feja është shumë e rëndësishme, dhe vetëm 25% e tyre e konsideron si të pa ose pak të rëndësishme.

Gjithnjë në varësi të pyetjes së parë është edhe pyetja nëse shqiptarët e përjetojnë fenë si diçka që ju jep forcë dhe qetësi shpirtërore. Për këtë kemi këto rezultate:

76% përgjigjen pozitivisht

14% përgjigjen negativisht

Të tjerët nuk e dinë

Të pyetur lidhur me besimin që kanë ndaj institucioneve fetare, ata përgjigjen

37.7% përgjigjen se kanë shumë besim tek institucionet fetare

41.2% kanë besim të madh

14.6% kanë pak besim

5.2% nuk e dinë.

Kuptohet se ky nivel i lartë i besimit tek feja dhe tek institucionet ka disa shpjegime. Kuptohet që një rol të rëndësishëm do të luajnë këtu faktorët socialë që ne përmendëm më lart. Fakti që shqiptarët nuk gjejnë dot një model real për t'u orientuar në jetën e tyre të përditshme të mbushur me sfida, përpjekje dhe vështirësi, ata i drejtohen Zotit për t'ua ofruar këtë model. Por këtu mund të ketë edhe një interpretim tjetër, atë që persekutimi i gjatë i fesë dhe i institucioneve gjatë regjimit komunist, ka çuar në forcimin e besimit. Por që këtu rrjedh një përgjegjësi e madhe për institucionet fetare për ta ruajtur dhe për ta rritur këtë besim për të ardhmen. E thënë më hapur, varet nga veprimtaria e klerikëve nëse ky besim do të vijë në rritje apo në rënie.

Le të vazhdojmë më tej me disa fakte dhe të dhëna të tjera.

Po të bëjmë një krahasim të shkallës së besimit mbi bazë gjinie, të bie në sy fakti se gratë dhe vajzat kanë një nivel shumë herë më të lartë besimi se sa meshkujt. Ne mendojmë se edhe në këtë rast interpretimi nuk është i vështirë, madje është i lidhur direkt me lëkundjet e fuqishme që ka ndjerë statusi i një femre veçanërisht gjatë periudhës së tranzicionit. Humbja e barazisë, qoftë kjo dhe formale që kishte ofruar sistemi i mëparshëm, kërcënimi nga papunësia, divorci, largimi i partnerit, mungesa e mbrojtjes sociale dhe deri tek fenomene të tilla si trafikimi i tyre dhe i fëmijëve, prostitucioni i detyruar, e të tjera në kushtet kur mungon ligji dhe funksionimi i tij lë për të dëshiruar, gratë dhe vajzat gjejnë prehje tek Zoti.

Si paraqitet situata e besimit midis grup moshave të ndryshme.

75% e 25 vjeçarëve besojnë shumë në fe

74% e 25-35 vjeçarëve besojnë po ashtu shumë në fe

80% e 45-55 vjeçarëve po kështu

Shkalla e besimit është pothuaj e barabartë për të tria moshat në vëzhgim, ndonëse pritej që besimi të ishte në nivele më të ulta në moshat e reja dhe më pas të rritej duke u rritur dhe mosha. Mirëpo nuk ndodhi kështu. Ky rezultat është i lidhur me mungesën e vizionit për të ardhmen, gjendjen e tyre e pasigurisë, përballimi me probleme të vështira ekonomike dhe sociale, i bëjnë ata të kthejnë sytë nga feja si një faktor që ju jep siguri dhe shpëtim përballë këtij realiteti të ri që nuk përkoi me imazhin që kishin krijuar për shoqërinë e tregut të lirë.

Një pamje interesante na japin të dhënat në lidhje me rëndësinë e fesë në varësi të grupit social.

Rëndësia e fesë është më e madhe për fshatarin që shkon deri në 90%, dhe bie duke rritur statusin social, si p.sh. në rastin e drejtuesve të institucioneve. Nuk përbën çudi fakti që midis biznesmenëve niveli i besimit fetar është shumë i lartë. Kuptohet përse i përket niveleve të ndryshme të besimit në grupe të ndryshme sociale ndikojnë faktorë të ndryshëm, si niveli i arsimit, ngarkesa dhe imponimi i madh në punë, jeta aktive në zonat urbane, intensiteti i lëvizjeve të njerëzve, etj. por do të dëshironim të theksonim se edhe në këtë rast ndjenja e pasigurisë që shoqëron disa grupe sociale, si p.sh. fshatarët, i bënë ata më besues tek Zoti.

Ishte e pritshme që besimi fetar të ulej me rritjen e shkallës së arsimi, por edhe në ato raste kur të intervistuarit i përgjigjeshin me pasiguri për besimin e tyre, a reagime që dëshmojnë se ata nuk kanë patur mundësi, mbase edhe kohë për të reflektuar mbi këtë aspekt të jetës së tyre. Një shpjegim të tillë e lidhim me përgjigjen shpesh të takuar mes të shkolluarëve “mbase”.

Por ndërsa besimi tek feja dhe institucionet fetare kap shifra të larta, që shpesh herë i tejkalojnë pritshmëritë e studiuesve, besimtarët aktivë në institucione dhe organizata fetare dëshmojnë për shifra të ulta. Pyetja që ngrihet është se pse ndodhë kjo?

Këtu mund të ndikojnë shumë faktorë, si angazhimi i njerëzve në jetën e përditshme për të siguruar mjetet e jetesës, ndikim i ateizmit në ndërgjegjen e njerëzve, skepticizmi ndaj kësaj veprimtarie, si dhe besimi tek kleri dhe praktikat fetare.

Duke analizuar shifrat e mësipërme në kontekstin social të shoqërisë shqiptare në tranzicion, do të dëshironim të tërhiqim vëmendjen tuaj për disa aspekte tërësisht unike të shoqërisë shqiptare në tranzicion në raport me fenë:

Së pari, në kundërshtim me pohimet e disa studiuesve vendas dhe të huaj për shpirtin afetar të shqiptarëve, të dhënat e mësipërme tregojnë të kundërtën, por duhet theksuar se tek ne kanë munguar ekstremistët në besimin fetar, ndoshta kjo e lidhur edhe me prioritet që kanë patur shqiptarët ndër shekuj, për të siguruar ekzistencën e tyre, ose me një farë dobësie në rrafshin dogmatik dhe teologjik të doktrinave fetare në ndërgjegjen e njerëzve.

Së dyti, shqiptarët të ndodhur nën kërcënimin e ekzistencës kombëtare, kanë vënë përkatësinë fetare në shërbim të ekzistencës kombëtare.

Së treti, lulëzimi i besimit fetar pas rënies së komunizmit ka krijuar problem të mprehtë, është një provë për atë që besimi fetar nuk u vra dot gjatë periudhës komuniste. Ai mbijetonte nën kujdesin e familjeve.

Së katërti, duke marrë në konsideratë faktet dhe shifrat e mësipërme mund të themi se kemi të bëjmë me një besim të ringjallur në kuadrin e një ndjenje tolerance për njëri-tjetrin, që natyrisht është e lidhur edhe specifikën shqiptare, por që duhet trajtuar e vlerësuar me kujdes,

për ta ruajtur dhe forcuar, veçanërisht kur tek ne po prezantohen sekte dhe besime të panjohura më parë dhe që nuk kanë traditë mes nesh.

* Autorja punon dhe vepron pranë Departamentit të Punës Sociale në Tiranë

Prof. Ascc. Edlira Haxhiymeri

RELIGION AND THE SOCIAL PROBLEMS IN THE ALBANIAN SOCIETY IN TRANSITION

(Summary)

The period of transition was accompanied with great changes (including changes of a political, economic and social nature). The biggest changes had to do with the values in society and the role of the family. Many problems have emerged, problems which have not been dealt with until recently (they were considered a taboo), which have led to the loss of faith in the institutions, the legal system and the state. Such situations are very dangerous for every society as they can lead to extreme disappointment. Consequently, true spiritual values are lost. In such circumstances people need consolation. They have the need to address somebody, who will promise them freedom, security and a life based on true human values.

ادليرا حجي عمرى

الدين و المشاكل الاجتماعية في المجتمع الالباني في الفترة الانتقالية

(خلاصة البحث)

تميزت الفترة الانتقالية بتغيرات ضخمة بداية بتحويلات سياسية و اقتصادية و اجتماعية و لكن أكثر حساسية كانت التحويلات التي حدثت في المجال العقائدي و النظام الاسرى و كذلك مواجهة المجتمع ببعض المشاكل الجديدة التي لم تكن معروفة من قبل مما احدث اهتزازا كبيرا في المجتمع ادى إلى فقدان الثقة بالمؤسسات و القانون و حتى فقدان الثقة بالدولة و النظام.

EXHINËT

Ahmed Sakr

“EXHINËT”

Lutje

O All-llah! Kërkoj mbrojtjen Tënde prej ankthit dhe hidhërimit; kërkoj mbrojtjen Tënde prej paaftësisë dhe përtacisë; dhe kërkoj mbrojtjen Tënde prej mposhtjes së borxheve dhe mposhtjes nga njerëzit.

O All-llah! Kërkoj mbrojtjen prej varfërisë përveç tek Ti; prej poshtërimit përveç për Ty dhe prej frikës përveç Teje.

O All-llah! Kërkoj mbrojtjen Tënde prej dëshmisë së rrejshme, imoralitetit apo shoqërimit të diçkaje për Ty; Dhe kërkoj mbrojtjen Tënde prej ligësisë së armiqve, sëmundjeve të panjohura dhe prej humbjes së shpresës.

O All-llah! Kërkoj mbrojtjen Tënde prej njerëzve të ligj, lakmimit të pasurisë dhe prej vrazhdësisë.

O All-llah! Ti je Mëshirues i mëshiruesve, dhe Ti je Sundues i gjithësisë.

O All-llah! Amin!

Kur’ani për exhinët

“(Kujto) Kur disa prej exhinëve i drejtuam tek ti që të dëgjojnë Kur’anin dhe kur u afruan edhe e dëgjuan atë, thanë: “Kështu! Dhe kur u kthyen, u kthyen te populli i vet dhe e këshilluan. Thanë: o Populli ynë, ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, që udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën e drejtë. O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të All-llahut dhe besoni atij! Ai ju fal mëkatet tuaja dhe ju shpëton prej një dënimi plot vuajtje. E kush nuk i përgjigjet atij që thërret në rrugën e All-llahut, ai nuk është i pamposhtur në Tokë dhe pos Atij, ai nuk ka mbrojtës, të tillët janë në një humbje të hapët”. (el-Ahkaf: 29-32)

1

Hyrje

“Unë nuk i krijova exhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë”. (edh-Dhariyat: 56)

Tema më e vështirë për një autor që të shkruaj, është tema rreth exhinëve. A quhen ata fantazmë, exhinë, xhinë, shpirtra, shejtanë, djaj, apo janë krijesa? Apo çfarë tjetër? A janë ata që i frikësojnë njerëzit, që i sulmojnë dhe i sundojnë ata, si dhe shtëpitë e tyre? A janë ata të vetmit që janë të gatshëm të ndihmojnë, dhe të marrin informata si dhe ndonjë lajm që i nevojitet dikujt prej çdo vendi të botës? A janë ata prej atyre që i dëmtojnë njerëzit? A është e vërtetë që ata marrin informata prej qiellit? A janë të vetmit që mund të tregojnë të ardhmen?

Më shumë pyetje do të jepen më poshtë:

- Si duken?

- Si mund t’i shohim?

- Nëse dëshirojmë t’i shohim, a mund të na lëndojnë apo çfarë tjetër?

- Si mund të lirohemi prej tyre jashtë dhe brenda shtëpive tona?

- Si mund të lirojmë veten dhe shtëpitë tona prej tyre?

Nuk është frikësues fakti se ata mund të na shohin ne, kurse ne ata jo. Nëse janë armiq të tanë, pse i lejojmë të qëndrojnë me ne? Nëse janë armiq të tanë, si mund të bëjmë një marrëveshje me ta dhe të përpiqemi të jetojmë në paqe me ta? Nëse janë pasardhësit e shejtanit të madh (Iblisit), atëherë si hanë, flenë, martohen dhe a kanë fëmijë?

Ka shumë thashetheme, tregime e përjetime që tregohen prej një numri të madh të njerëzve rreth exhinëve. Disa prej tyre janë frikësuese, te tmerrshme dhe vështirë të kuptohen. Ndërsa të tjera janë aq të bukura e të këndshme, por gjithashtu vështirë të besohen.

Në këtë punim dëshiroj t'i prezantoj pikëpamjet e Islamit rreth exhinëve nga Kur'ani dhe syneti i Pejgamberit s.a.v.s. Mund të konsultohet se janë dy grupe të exhinëve: **besimtarë** dhe **pabesimtarë**. Grupi i parë pranon mesazhin e Islamit që i është shpallur Muhamedit a.s., ndërsa grupi tjetër janë vetë shejtanët, djajtë e keqbërësit. Disa prej temave kryesore që do të diskutohen këtu janë:

- Ademi dhe Iblisi
- Mallkimi i Iblisit nga All-llahu xh.sh.
- Armiqësia e shejtanit ndaj njerëzve
- Biografia e shejtanit
- Krijimi i exhinëve
- Veprimet e shejtanit
- Premtimet e reme të shejtanit
- Shoqëruesit e shejtanit
- Grupi me shejtanin
- Ushtria e shejtanit
- Fisi i shejtanit
- Vjedhja e informatave nga qielli
- Adhurimi i exhinëve
- Harrimi i All-llahut
- Urdhrrat e shejtanit
- Fantazma dhe magjia
- Mbrojtja prej shejtanit
- Pema e Zekumit
- Exhinët muslimanë

Ka edhe disa tema të tjera që janë diskutuar në këtë libër. Në këtë mënyrë dëshiroj të jap të dhëna për exhinët, e që do të jenë të dobishme për muslimanët e jomuslimanët.

Këto të dhëna do të largojnë dyshimin prej të gjitha llojeve të supozimeve të këqija që janë bartur (pa ndonjë bazë a dëshmi të fortë) nga brezi në brez.

Në fund, nuk pretendoj se kam kompetenca të flas për këtë temë, dhe as pretendoj se me këtë temë janë përfshirë të gjitha çështjet. Hulumtimet e tjera do të orientohen në këto tema të lëna pasdore duke pasur parasysh objektivitetin dhe të dhënat e vërteta prej burimeve të sigurta të literaturës.

Lusim All-llahun xh.sh. që të pranojë përpjekjet tona të thjeshta dhe të na falë mëkatet tona.

2 Terminologjia

Arraf

Kjo është një fjalë arabe që do të thotë parashikues e falltar. Gjinia femërore e fjalës arraf bën arrfa. Fjalë të ngjashme me këtë janë: parashikim i së ardhmes, fall apo zanat i falltarit.

Falltari mbështetet në exhinët, që t'i sjellin lajme e të dhëna rreth së ardhmes. Të shumtën e rasteve, ata sjellin lajme që janë pjesërisht të vërteta. Kur tentojnë të marrin të dhëna nga qielli, mbyten nga me-teorët. Prandaj, asnjëherë një arraf nuk mund të jetë falltar i vërtetë. Jeta e tij zakonisht përfundon fatkeqësisht për shkak të besimit se exhinët do ta ndihmojnë.

Iblis

Është fjalë arabe, e përmendur 11 herë në Kur'an. Fjalët e tjera kuranore janë:

Jublisu

Është folje në kohën e tashme, që ka kuptimin: të goditurit me një dëshprim të heshtur. Është përmendur vetëm një herë në Kur'an, në suren err-Rrum:

“E ditën kur ndodhi Kiameti, kriminelët heshtën”. (err-Rrum: 12)

Mublisin

Është kundrinë në shumës e fjalës mublis. Ka kuptimin e njerëzve që janë të zhytur në dëshpërim. Është përmendur në Kur'an, në suren err-Rrum:

“Edhe pse para se t’u binte (shiu) atyre, ata para tij ishin të dëshpëruar”. (err-Rrum: 49)

Mublisun

Është kryefjalë e foljes eblese dhe është shumës i mublis. Është përmendur tri herë në Kur'an. (el-En'am: 44; el-Mu'minunë: 77, ez-Zuhruf: 75)

“Meqë lanë pasdore atë për se u këshillaun (t'i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) derisa, kur u gëzuan për atë që u ishte dhënë, i kapëm befas, e ata mbetën të zhgënjyer”. (el-En'amë: 44)

“Derisa t’ua hapim një derë dënimi të ashpër, atëherë ata do të mbesin aty me shpresa të humbura”. (el-Mu'minunë: 77)

“Atyre as nuk u lehtësohet (vuajtja) dhe aty hanë të dëshpëruar”. (ez-Zuhruf: 75)

Prandaj, kuptimi i fjalës Iblis është që ai ka qenë krijesa e parë e exhinëve. Ai mund të konsiderohet si baba i gjithë exhinëve. Një njeri këtë krijesë mund ta krahasojë në mënyrë të ngjashme me krijesën e parë të njerëzve të quajtur Adem. Kur'ani është përplotë të dhëna rreth këtyre krijesave të veçanta, që këmbëngulin për të mos u nënshtruar ndaj All-Ilahut dhe nuk pendohen për mëkatet e vëta. Iblisi është larguar nga Xhenneti dhe prej atëherë është bërë armik i Ademit e pasardhësve të tij.

Ifrit. Është fjalë kuranore e përmendur vetëm në suren en-Neml (en-Neml: 39). Ka kuptimin djall a shejtan. Shumësi i kësaj fjale është afarit. Ka kuptim keqdashës, i dëmshëm, tinzar, dinak, i lig, dreq e shejtan.

Exhin. Është fjalë arabe që u referohet krijesave të padukshme të krijuara nga zjarri. Ata mund të jenë të dëmshëm ose të dobishëm. Ata ndërhyjnë me jetërat e vdekura. Fjala exhin është përmendur 51 herë në Kur'an në forma të ndryshme si:

Xhana. “E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: “Ky është Zoti im!” E kur u zhdruk ai (perëndoi) tha: “Unë nuk i dua ata që humbin”. (el-En'amë: 76)

Xha-an. Kjo fjalë është përmendur 7 herë në Kur'an u referohet exhinëve e shejtanëve.

el-Exhin. Krijesa të padukshme. Disa prej tyre besojnë duke u bërë muslimanë, ndërsa të tjerët refuzojnë dhe mbesin si pabesimtarë. Grupi i parë është i mirë e i dobishëm, ndërsa grupi tjetër është i djallëzuar, i keq e i dëmshëm. Kjo fjalë është përmendur 22 herë në Kur'an. Gjinia femërore e fjalës exhin është exhinah.

Exhinah. Është fjalë arabë, e përmendur 10 herë në Kur'an. I gjithë grupi quhet exhinah. Gjithashtu mund të ketë kuptimin “i pushtuar nga exhini”.

Mexhnun. Personi i marrë, i pushtuar nga djalli, i çmendur e budalla. Në Kur'an është përmendur 11 herë.

Kahin. Ka kuptimin falltar. Rrënja e saj është folja kahana dhe takah-hana, që ka kuptimin të predikojë e të tregojë të ardhmen. Kaahin ka edhe një kuptim tjetër. Prifti është i njohur si kahin, shumësi i së cilës fjalë është kahanah ose kuh-han.

Munaxhim. Është fjalë arabe që ka kuptimin astrolog, dhe sinonim i saj është naxham. Shumësi i munaxhim është munaxhumun.

Shejtan. Fjalë arabe, e përmendur 138 herë në Kur'an, në katër forma të ndryshme:

esh-Shejtan: 68 herë është përmendur në Kur'an. Ka kuptimin: dreqi a djalli i veçantë.

Shejtanan: Në Kur'an është përmendur dy herë dhe ka kuptimin dreqi i veçantë që shkon tinëzisht rreth njerëzve që t'i largojë prej rrugës së drejtë.

esh-Shejatin: 67 herë është përmendur në Kur'an. Është shumës i shejtan.

Shejatinihim: Vetëm një herë është përmendur në Kur'an. I drejtohet formës së përemrit pronor të emrit shejtan në trajtën e shumësit.

Shejtanii: Nganjëherë thuhet se njeriu vepron në të njejtën mënyrë si një shejtan. Ajo i referohet fjalës shejtanii ose quhet shejtanii, që ka kuptimin djallëzor etj.

3

Ademi dhe Iblisi

“(Rikujto) Kur u thamë engjëjve: “Përlujuni Ademit, e ata iu përulen, përpos Iblisit. Ai ishte nga exhinët, prandaj nuk respektoi urdhrin e Zotit të vet. Vallë, a në vend Timin do ta merrni për mik atë dhe pasardhësit e tij, ndërsa ata janë armiq tuaj?” Sa këmbim i shëmtuar është ai i pabesimtarëve!” (el-Kehf: 50)

Marrëdhëniet në mes Ademit e Iblisit janë sikur të dy krijesave të ndryshme. I pari ishte i bekuar nga All-llahu i Madhëruar, ndërsa tjetri i mallkuar e i dëbuar. I pari bëri një gabim, dhe pasi u pendua, u fal nga All-llahu xh.sh. Ndërsa Iblisi ishte mendjemadh dhe nuk u pendua. Duke qenë mendjemadh, refuzoi të përulej e të pendohej. Prandaj, u fajësua, u mallkua dhe u dëbua prej mëshires së All-llahut xh.sh.

Të dhënat e hershme rreth këtyre dy krijesave janë marrë drejtpërdrejt nga Kur’ani. All-llahu xh.sh., pasi krijoi Ademin urdhëroi engjëjt dhe krijesat e tjera t’i nënshtroheshin atij. Të gjitha iu bindën urdhërit të All-llahut, me përjashtim të Iblisit. Shpjegimin më të mirë për këtë e kemi në suren el-Bekare, ku All-llahu xh.sh. thotë:

“(Rikujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!” Ata thanë: “A do të vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!” E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve), pastaj ua prezantoi engjëjve dhe u tha: “Më tregoni për emrat e këtyre (sendeve të emërtuara), nëse jeni të drejtë (ç’mendoni)? (Engjëjt) Thanë: “Ti je i patëmetë, ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na e mësove Ti. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!” (Zoti) Tha: “O Adem njihi ata (engjëjt) me emrat e atyre (sendeve)!” E kur u rrëfeu atyre për emrat e tyre, (Zoti) tha: “A nuk ju kam thënë juve se Unë më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të Tokës dhe më së miri e di atë që ju e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë. E kur u thanë engjëjve: “Përlujuni (bini në sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përulën me përjashtim të Iblisit (djallit). Ai refuzoi e u mbajt në të madh e u bë pabesimtar”. (el-Bekare: 30-34)

Marrëdhëniet në mes Ademit e Iblisit tendosen. Fillon xhelozia e Iblisit ndaj Ademit e gruas së tij, Havës. Iblisi nuk mund të duronte

faktin që Ademi të ishte në një pozitë më të lartë. Tentoi të gjente të metat në personalitetin e Ademit e të Havës. Kështu, arriti të mësonte që Ademi dhe Hava ishin të urdhëruar nga All-llahu xh.sh. që të kënaqeshin me të mirat e Xhennetit, por të ruheshin prej një peme. Prandaj, ai përdori afërsinë e tij të fshehtë në drejtim të tyre. Filloi të bisedonte me ta, duke ua bërë joshëse shijen e pemës, e cila do t’ua pamundësonte qëndrimin e përjetshëm në Xhennet. Ademi e Hava harruan porosinë e All-llahut, dhe në këtë mënyrë ranë në grackën e Iblisit.

All-llahu xh.sh. në suren *Ta ha* na flet për këtë:

“Ne i patëm urdhëruar edhe Ademit (të mos i afrohej pemës), por ai harroi, pra tek ai nuk gjtëm vendosmëri”. (Ta ha: 115)

Fatkeqësisht, Ademi e Hava kishin ngrënë prej pemës së ndaluar dhe për këtë arsye u zbuluan pjesët e turpshme të tyre. Provuam ta mbronin veten duke u larguar nga Xhenneti, ndiheshin të turpëruar. Kjo është përmendur disa herë në Kur’an. All-llahu xh.sh. në suren el-A’raf thotë sa vijon:

“Shejtani i nxiti (i mashtroi) ata të dy që t’ua zbulonte pjesët e turpshme që i kishin të mbuluara, dhe tha: “Zoti juaj nuk jua ndaloi të dyve atë pemë vetëm të mos bëheni melek (engjëj), ose të mos bëheni prej të përjetshmëve. Dhe ju bëri be atyre (duke u thënë) unë jam këshillues për ju”. (el-A’rafë: 20-21)

Gjithashtu duhet cekur se All-llahu xh.sh. nuk na njofton për llojin e pemës. Ajo mund të jetë molla apo pema e diturisë, ashtu siç e përmendin të krishterët citatet biblike, dukë e quajtur si “pemë të diturisë”, ndërsa të tjerët si “pema e ndaluar”. “Pema e diturisë” nuk mund të jetë, ngasë All-llahu ia mësoi Ademit të gjitha njohuritë që duhej t’i dinte. Gjithashtu, shpallja e parë e All-llahut xh.sh. për të Dërguarin e Tij s.a.v.s. ishte rreth të lexuarit e kërkimit të diturisë.

Megjithatë, All-llahu xh.sh. në surën *Ta ha* na njofton se që të dy, Ademi e Hava, pas ngrënies nga pema, u vetëdijësuan se organet e turpshme të tyre ishin të zbuluara. Ndihehin të turpëruar e me keqardhje. Kështu Ademi theu urdhrin e All-llahut e gaboi. Kur’ani e përmend këtë:

“Por, atë e ngacmoi djalli duke i thënë: “O Adem, a do të të tregoj për pemën e pavdekshmërisë dhe të sundimit të pazhduk-

shëm! Ata të dy hëngrën nga ajo (pemë) dhe që të dy u zhveshën, e ia nisën të mbulonin veten e tyre me gjethe që mblidhnin nëpër Xhennet, dhe kështu Ademi theu urdhrin e Zotit të vet e gaboi".
(Ta ha: 120-121)

Prandaj, nuk ishte Hava ajo që bëri gabimin dhe nuk ishte ajo që e shtyri bashkëshortin e saj të hante prej pemës. Ajo nuk ishte shkaktare që bashkë me burrin e saj të largoheshin prej Xhennetit. Ajo nuk ishte burim i fatkeqësisë, por burim i fatkeqësisë ishte vetë djalli.

Megjithatë, kur të dy, Ademi e Hava, gabuan, ata ishin në gjendje të kërkonin falje prej All-llahut. Kërkuan mëshirën e Tij. Dhe, All-llahu me mëshirën e Tij të pakufishme i fali ata. All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë, në suren el-Bekare thotë:

"E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje), prandaj Ai ia fali (gabimin). Ai është mëshirues dhe pranues i pendimit". (el-Bekare: 37)

Prandaj, asnjë mëkat nuk mund të bartet me ta. Koncepte të tilla kurrsesi nuk pranohen në Islam. Nuk ka nevojë për ndonjë shpëtimtar që të kryqëzohet në mënyrë që të na shlyejë mëkatet. Dhe nuk ka nevojë për rrëfim e as për pagëzim. Çdo qenie njerëzore është lindur e pastert, e papërzier në ndonjë gabim a mëkat të prindërve të vet a të njerëzve të tjerë. Nëse pas moshës madhore bën ndonjë mëkat, do të përgjigjet për atë. Megjithatë, ka parime e rregulla për fshirjen e ndonjë gabimi. All-llahu na ka mësuar se si të kërkojmë falje drejtpërdrejt nga Ai, me kusht që ne të jemi të ndershëm, të singertë e të mos përsëritim të njejtën vepër me qëllim të keq. Ne duhet të jemi nismëtarë për vepra të mira para se të bëhet vonë. All-llahu xh.sh. në suren el-Furkan thotë:

"Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira. All-llahu është mëshirues, Ai fal shumë". (el-Furkan: 70)

All-llahu kërkoi prej të dy grupeve (Iblisit në një anë, Ademit e Haves në anën tjetër) që të vinin në Tokë e të shikojnë punën e vet. Në të njëjtën kohë, All-llahu xh.sh. i njoftoi të dy grupet se që prej atij momenti do të ishin kundërshtarë të njëri-tjetrit. Armiqësia e tyre do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit. Gjithashtu, All-llahu xh.sh. paralajmëroi Ademin, Havën e pasardhësit e tyre që të jenë të kujdes-

shëm ndaj qëllimeve të këqija e pëshpëritjeve të Iblisit e pasardhësve të tij.

Ndonëse, Iblisi e pasardhësit e tij janë armiq të Ademit e njerëzimit, njeriu ka për detyrë që të vërë në jetë atë se udhëheqja është dhënë prej All-llahut për të gjithë ata që e kërkojnë. Nëse e gjithë bota, përfshirë gjithë njerëzimin e exhinët do të bashkohen për t'i bërë dëm dikujt, kurrë nuk mund ta bënin këtë pa urdhrin e All-llahut të Madhëruar. All-llahu xh.sh. në suren el-Bekare thotë:

"Ne u thamë: "Dilni prej atje që të gjithë, e juve gjithsesi do t'ju arrijë udhëzim prej Meje, e kush e pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë për t'u brengosur". (el-Bekare: 38).

All-llahu xh.sh. në ajetin vijues në suren Ta ha, na ka njoftuar për mëshirën e Tij, kërkimin e Tij që ata të vijnë në Tokë, për armiqtësinë e shejtanit ndaj njerëzve dhe udhëzimin e All-llahut për ata që kërkojnë:

"Mandej Zoti i vet e bëri atë të zgjedhur, ia pranoi pendimin dhe e vuri në rrugën e drejtë (të vendosur). Ai (All-llahu) u tha: "Zbritni prej atje që të gjithë, do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Nëse ju vjen nga Unë udhëzim (libër e pejgamber), kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në dynja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër). E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kiametit do ta ringjallim të verbër". (Ta ha: 122-124)

Iblisi e pasardhësit e tij bëjnë luftë kundër Ademit dhe pasardhësve të tij. Një luftë e tillë ekziston dhe do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit. Nga ana tjetër, Ademi e pasardhësit e tij janë njoftuar për armiqtësinë e Iblisit e të pasardhësve të tij. Megjithatë, shumë njerëz nuk e marrin këtë seriozisht, dhe për këtë arsye bien në intrigat e grackat e tyre.

Është fatkeqësi që Ademi e Hava nuk vepruan për të bindur Iblisin e pasardhësit e tij të kërkonin falje nga All-llahu xh.sh. e të bëheshin muslimanë. Muhamedi a.s. është i vetmi që ka arritur ta bindë shejtanin e tij të bëhej musliman. Gjithashtu duhet cekur se disa prej exhinëve u bënë muslimanë gjatë jetës së Muhamedit a.s., duke dëgjuar ajetet e Kur'anit.

4

Mallkimi i Iblisit

“(All-llahu) tha: Dil pra, prej aty, ti qofsh i mallkuar! Vërtet. Mallkimi kundër teje qoftë deri në Ditën e Gjykimit”. (el-Hixhr: 34-35)

All-llahu xh.sh. kërkoi prej të gjithë melekëve e krijesave të tjera (exhinëve) që t'i përuleshin Ademit, në shenjë nënshtimi. Të gjithë iu bindën urdhrit të All-llahut, përveç Iblisit që kundërshtoi. All-llahu e pyeti për arsyen e mospërkuljes. Përgjigjja e Iblisit ishte se ai ishte krijuar prej zjarrit, ndërsa Ademi prej baltës. Besonte se ishte krijesë më e mirë dhe vërtet i tha All-llahut se ishte më i mirë se Ademi.

Duke refuzuar nënshtimin pa pasur argumente, dhe duke mos kërkuar falje nga All-llahu xh.sh., ai për këtë u fajësua e u mallkua. All-llahu e dënoi dhe e largoi nga Xhenneti, dhe më kurrë nuk do të jetë i mëshiruar e i bekuar nga All-llahu. Ndonëse në suren el-Hixhr është mallkuar nga All-llahu, ai u mallkua edhe në suren Sad. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Zoti) tha: Dil prej tij (prej Xhennetit), ti je i mallkuar. Dhe largimi prej mëshirës Sime ka për të të përcjellë deri në Ditën e Gjykimit!” (Sad: 77-78)

Duke qenë i mallkuar, dëshironte të hakmerrej ndaj kundërshtarëve të vet (Ademit e Havës). All-llahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë:

“Atë e mallkoi All-llahu. Ai ka thënë: Unë do të përfitoj një pjesë të caktuar të robërve të Tu”. (en-Nisa: 118)

Për llojin dhe dimensionin e armiqësisë së Iblisit ndaj Ademit, Havës e pasardhësve të tyre, do të flitet më vonë.

Duhet përmendur se kushdo që e pason shejtanin, do të ketë mallkimin e All-llahut. Kur'ani përmend një grup njerëzish që janë apo do të mallkohen nga All-llahu xh.sh. Fjala mallkim në gjuhën arabe është “la'nah”, folja e së cilës është “la'ana”. Fjala “la'neh” (mallkim) në forma të ndryshme është përmendur në Kur'an 51 herë.

All-llahu i ka mallkuar grupet vijuese të njerëzve:

- Pabesimtarët

“All-llahu i ka mallkuar pabesimtarët dhe për ta ka përgatitur zjarr të ndezur fort”. (Ahzab: 64)

- Njerëzit e së shtunës

“O ju që ju është dhënë libri, besojeni atë që zbritëm (Kur'anin) e që është vërtetues i atij që e keni (Tevratit), para se të shlyejmë fytyra (t'ua fshijmë shqisat) dhe t'i rrotullojmë ose t'i mallkojmë ata si i mallkuam ata të së shtunës. Urdhri i All-llahut është i kryer”. (en-Nisa: 47)

- Beni Israilët

“Thuaj: “A t'ju lajmëroj për një të keqe (të zezë) më të dëmshme (nga ajo e metë që na e shihni) si dënim nga All-llahu? (Ajo është) Mallkimi i atij që e mallkoi All-llahu dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e në derra, e i bëri adhures të djallit. Të tillët janë në pozitë më të keqe dhe më të humburit prej rrugës së drejtë”. (el-Maide: 60)

- Ata që shpifin ndaj grave të ndershme

“Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ata i pret një dënim shumë i madh. Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar”. (en-Nur: 23-24)

- Ata që përhapin të këqija në shoqëri

“E ata që e thejnë besën e dhënë All-llahut, pasi qenë zotuar, e këpusin atë për të cilën All-llahu ka urdhëruar të jetë e pakëputur, bëjnë shkatërrime në tokë, ata janë të mallkuar dhe ata kanë përfundim të keq”. (er-Ra'd: 25)

- Ata që i kalojnë kufijtë (zullumqarët)

“E kush është më mizor se ai që trillon gënjeshtër për All-llahun? Të tillët paraqiten para Zotit të tyre, e dëshmitarët thonë: “Këta ishin që gënjyen ndaj Zotit të tyre, pra mallkimi i All-llahut qoftë kundër mizorëve”. (Hud: 18)

- Ata që vdesin si pabesimtarë

“Ata të cilët mohuan dhe vdiqën si pabesimtarë, kundër tyre është mallkimi i All-llahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve”.

(el-Bekare: 161)

- Ata që janë hipokritë, politeistë e mushrikë (ata që i bëjnë shok All-llahut):

“E në anën tjetër, për t’i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtare, mendimi i të cilëve ndaj All-llahut ishte mendim i keq. Atyre u raftë e keqja! All-llahu shprehu urrejtje kundër tyre dhe i mallkoi e Xhehennemin e përgatiti për ta, që është vendbanim i keq”. *(el-Feth: 6)*

- Ata që janë tiranë:

“E ato ishin (gjurmë të gjeshtarëve të fisit) Ad, që mohuan argumentet e Zotit të tyre, kundërshtuan të dërguarin e Tij, shkuan pas urdhrave të çdo kryelarti kundërshtar. Ata u përco-llën me mallkim si në këtë botë, ashtu edhe në Ditën e Gjykimit. Le të dihet, Adët mohuan Zotin e tyre. Qoftë i shkatërruar Adi, populli i Hudit!” *(Hud: 59-60)*

- Ata që gënjejnë

“E vërteta është (kjo) nga Zoti yt, e ti kurrësi mos u bëj nga ata që dyshojnë. E kush të kundërshton ty në çështjen e tij (Isait), pasi t’i jetë bërë e ditur e vërteta, ti thuaju: “Ejani i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, mandej sinqerisht të lutemi për mallkim dhe mallkimin nga ana e All-llahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve”. *(Ali Imran: 60-61)*

5

Biografia e shejtanit

Emri: Shejtan ibn Iblis, këshilltar i çdo qenieje njerëzore

Vendi i lindjes: Babai i shejtanit është i lindur në Xhennet, dhe më vonë në planetin e Tokës.

Adresa: Çdo shtëpi e njeriut është shtëpi e zyrë e tij, dhe çdoherë është afër çdonjërit.

Si mund ta takojmë: Nuk është lehtë. Duhet të mësoni për të me njeri të veçantë në mënyrë që ta takoni. Gjithashtu duhet të lexoni libra të caktuar për shejtanin. Duhet të zotoheni e t’i bindeni vetes që

të jeni të dëgjueshëm ndaj tij. Duhet t’i dëgjoni këshillat e mësimet e tij, që të mund ta shihni në çfarëdo forme a trajte që dëshironi.

Lëvizja: Në çdo kohë është në gjendje të lëvizë, sa herë që është nevoja për të gjetur njerëz që e dëgjojnë e i binden.

Gatishmëria: 24 orë në ditë gjatë tërë vitit.

Pamja dhe veshja: Nuk është lehtë të shihet në formën e vet, që sa kohë që është krijuar nga tymi e zjarri. Megjithatë, mund të paraqitet si njeri, si hije, si tym, si qen i zi, si gjarpër apo në pamje e forma të tjera.

Ku mund ta takojmë: Ai mund të vijë e t’ju vizitojë me a pa paralajmërim. Mund të hyjë në zyrën tuaj, shtëpinë tuaj, dhomën e gjumit, banjon tuaj etj., pa leje. Ju sheh vazhdimisht, kurse ju për këtë nuk jeni të vetëdijshëm.

Përvoja e udhëtimit: Mund të udhëtojë në çdo vend të botës. Dhe për këtë i duhen vetëm disa sekonda të kohës suaj të çmuar. Këmba e tij e majtë do të lëvizë në drejtim tuajin e në të njejtën kohë këmba e tij e djathtë do të jetë në horizont.

Aftësia e bindjes: Shejtani punon si tregtar në interes të shefit tuaj. Dhe për këtë merr shpërblim. Ai duhet t’i shesë artikujt e vet.

Ndërmjetësi më i mirë: Është ndërmjetësi më i mirë për çdo qenie njerëzore. Shkon te klientët e vet e i josh me gjërat që ua ofron. Pastaj, shkon djathtas e majtas, pastaj para e më në fund nga prapa. Është i mësuar me çdonjerin: mashkull a femër, i ri a i vjetër, i ditur a i paditur, fetar a jofetar (ateist), e madje edhe me kriminelët e njerëzit e pafajshëm.

Gjuhët: Di çdo gjuhë në botë dhe është shumë i rrjedhshëm në to. Mund të lexojë, të kuptojë dhe flet e komunikon pa pasur ndonjë theks të huaj/ klientët e tij mendojnë së është pjesë e tyre në çdo aspekt të jetës: cilësi, zakone, kulturë, fe etj.

Ushqimet: Nuk i paguan askujt për ushqimin që i nevojitet, por ushqimin e ndanë me njerëzit pa e parë ata fare. Mund të hajë çfarëdo dhe çdo lloj të ushqimit pa marrë parasysh shijen, aromën a llojin e ushqimit. Mund të hajë të gjitha llojet e ushqimit edhe pse njerëzit i konsiderojnë hallall apo haram. Mund të pijë të gjitha llojet e lëngjeve. Koha më e mirë për të ngrënë është kur njerëzit hanë e veçanërisht

kur harrojnë ta përmendin All-llahun. Nëse nuk është i kënaqur, hanë edhe eshtrat e kafshëve që janë hedhur në mbeturina.

Artikujt: Duke qenë tregtar, ai mund t'i shesë çdo gjë ndonjë blerësi. Artikujt e tij janë të shumtë që të numërohen. Në depo industriale e ushqimore gjenden të gjitha llojet e artikujve që duhen shitur. Shejtani nuk bën dallime në mes artikujve hallall e haram. Kjo është e parëndësishme për ata që janë naivë, të paditur e të pacivilizuar. Kjo është afarizëm për t'i bindur të tjerët/ shejtani e pasardhësit e tij janë ekspertë në këtë fushë. Asnjë krijesë në këtë planet nuk mund të shtyhet më ta. Ai mund të provojë përdorimin e çdo artikulli e mund ta dërgojë që të festojë para blerjes së tij a marrjes me qira të tij.

Karakteristikat e përgjithshme të shejtanit

Shejtani është një mashtrues. Është shumë afër me të gjithë ata njerëz që nuk e kujtojnë All-llahun, nuk falen, nuk agjërojnë dhe me ata që nuk lexojnë Kur'an. Si një mashtrues, tenton t'i hutojë ata në mendimet e tyre, të blloktojë të kuptuarit e tyre, t'u pëshpërit të tjerëve derisa janë duke kryer obligimet e tyre fetare. Pasi është mashtrues, njerëzit nuk dëshirojnë ta shohin ose të jenë në prani me të. Kështu, ai flet me ata e ata provojnë të flasin me vetveten. Ata nuk mund të kuptojnë se janë duke folur me të. Kështu që, ai e pëlqen bisedën me ta në tema e sfera të ndryshme. Arrin t'i bindë që ata të mund të jenë të zënë në këtë jetë, që ata ta duan jetën dhe që ata të punojnë shumë për të jetuar jetë të mirë. Mundohet t'u japë përgjigjet më të mira pyetjeve të tyre.

Shejtani mundohet t'i bindë njerëzit se çdo gjë në këtë botë është e lejuar dhe se nuk ka asgjë që është e ndaluar. All-llahu krijoi çdo gjë që të jetë e lejuar. All-llahu është Mëshirues, Mëshirëbërës e Mëkatfalës. Ai është më i mëshirshmi e mbi të gjithë të mëshirshmit. Ai është Mëkatfalësi e Mëshiruesi më i madh. Shejtani me këta emra të bukur të All-llahut mund të bindë ndonjërin që të mos brengoset për dënimin e rëndë të Tij. Ai mund të bindë ndokënd apo edhe juve se All-llahu kurrë nuk do t'u ndëshkojë përderisa ju i besoni Atij. Bëni ç'të dëshironi, e All-llahu do t'ju falë dhe All-llahu do të kujdeset për ju, ngase ju i besoni se Ai është më i Mëshirshmi.

Shejtani di se si t'ua bëjë tërheqëse njerëzve pirjen e të gjitha llojeve të alkoolit, ngrënien e të gjitha llojeve të ushqimit, vallëzimin, përzierjen me gjininë e kundërt, përfshirjen në marrëdhënie seksuale, grabitjen, bixhazin, vjedhjen, gënjeshtren, sharjen, vrasjen e kështu me radhë. Ai di se si t'i bindë njerëzit që të punojnë punë të tilla. Arrin t'i bindë se të gjitha këto veprime janë të lejuara për ta. Të gjithë ata që thonë se këto veprime janë të ndaluara, ata nuk e dinë se ç'flasin. Ata nuk dinë se si të kënaqen me jetën dhe nuk dinë se sa janë të humbur. Të gjithë ata që deklarojnë se këto veprime janë të ndaluara, ata e bëjnë këtë me qëllim që t'i ndalojnë njerëzit prej kënaqësisë së jetës. Pas të gjithave, njerëzit duhet të kënaqen në jetë deri në maksimum. Askush nuk duhet ta ndalojë askënd prej epshit të vet. Se përndryshe, pse do t'i krijonte njerëzit All-llahu? Sa kohë që All-llahu krijoi këtë botë me të gjitha kënaqësitë e gëzimet e saj, njerëzit nuk duhet të ndalojnë veten nga kënaqësitë e kësaj jete.

Pasi shejtani është një mashtrues, ai mundohet me të gjitha mënyrat t'i largojë njerëzit prej rrugës së vërtetë. Është e qartë se ai është mashtrues dhe në të njëjtën kohë armik i çdo qenieje njerëzore. Prandaj, është e pëlqyeshme që ai të mos dëgjohet. Nëse një besimtar sulmohet nga shejtani, ai duhet të thotë: "Mbështetëm në All-llahun prej shejtanit të mallkuar".

Më detajisht, kjo tematikë do të trajtohet më vonë në këtë libër

6

Armiqësia e shejtanit ndaj njeriut

"O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk ju dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armik juaji i hapur?!" (Ja sin: 60)

Pas mallkimit nga All-llahu xh.sh., shejtani filloi të kishte zili ndaj Ademit e Havës. U mundua të hakmerrej ndaj tyre në çfarëdo mënyre. Filloi armiqtësinë ndaj Ademit e Havës. Arriti t'i bindë që të thyenin urdhrin e All-llahut. E për këtë ata kërkuan falje, ndërsa Iblisi ishte kryelartë e nuk u pendua.

Pasi gabuan, All-llahu i porositi që të ruheshin prej mësimëve të shejtanit, ngase ai është armik i tyre. Për këtë All-llahu xh.sh. në suren el-A'raf thotë:

“Atëherë i zbriti me mashtrim (në nivel të palakmueshëm). E kur e shijuan pemën, u zbulua turpi i tyre dhe filluan të mbulonin atë (duke vënë gjeth mbi gjeth) nga gjethet e (pemëve) të Xhenetit. Zoti i tyre i thirri (duke u thënë): A nuk jua ndalova ju të dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë së shejtani është armik i hapur për ju?!” (el-A'raf: 22)

All-llahu i urdhëroi të vinin në këtë planet e të gjenin rrugën për shpëtim. Shejtani e pasardhësit e tij mbetën armiqtë më të mëdhenj të Adem, Havës e pasardhësve të tyre deri në Ditën e Gjykimit. Por, disa nga pasardhësit e Adem kanë harruar se pasardhësit e Iblisit janë ende armiqtë e tyre. Ata kanë rënë në grackën, mashtrimin e komplotin e tij.

Nga mëshira e Tij, All-llahu xh.sh. vazhdimisht ka dërguar një numër të pejgamberëve e të dërguarve, mësuesve e predikuesve, da'vet-exhinjve e njerëzve të ditur, që t'i udhëzojnë njerëzit e t'i kthejnë në rrugën e All-llahut. Njerëzve u është bërë e ditur të jenë të vetëdijshëm për armiqësinë e shejtanit. Kështu që, All-llahu kërkoi prej njerëzve të jenë të mirë ndaj njëri-tjetrit, të thonë të vërtetën, të jenë modestë, të jenë të mirë dhe të thonë atë që është më e mira. Përndryshe, shejtani do të bëjë trazira, urrejtje e armiqësi. All-llahu në surën el-Isra, thotë:

“E ti robërve të Mi thuaju: Le ta thonë atë që është më e mira, sepse djalli ndërhyr mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapur i njeriut”. (el-Isra: 53)

Armiqësia e shejtanit dhe pasardhësve të tij është e njohur në histori. Ngjarja më e famshme është ajo e Jusufit e vëllezërve të tij, kur shejtani arriti të bënte turbullira e armiqësi në mes tyre. Jakubi, babai i tyre, e mësoi Jusufin që të mos ua tregonte vëllezërve të tij ëndrrën që kishte parë. Se përndryshe, shejtani do të luante rolin e tij në krijimin e problemeve e krizave. Ai është i njohur si armik i njerëzimit. Kjo ngjarje është e përmendur në Kur'an, ku All-llahu xh.sh. në suren Jusuf thotë:

“Ai (Jakubi) tha: O biri im, mos u trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, se po të bëjnë ndonjë dredhi, s'ka dyshim se djalli për njeriun është armik i hapur”. (Jusuf: 5)

Roli i shejtanit është edhe që të bëjë mospajtime e ndarje mes burrit e gruas. Në këtë mënyrë, prishet familja e shoqëria përçahet. Ky veprim i veçantë i shejtanit është i njohur gjatë historisë. Kur'ani përshkruan rolin e shejtanit në ndarjen e familjeve, si vijon:

“(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafe, por djajtë ishin të pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil, dy engjëjve, Harutit e Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thoshin: Ne jemi sprovë, pra mos u bëj i pafe. E mësonin (njerëzit) prej atyre të dyve atë (magjinë) me se ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e All-llahut askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çfarë u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehudinjtë) e dinin se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (për mëshirën e Zotit). Po ta dinin ata se për se e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe”. (el-Bekare, 102)

- vijon -

Ahmed Sakr

GENIES

(Summary)

To write about genies is a very difficult thing to do. Are they ghosts, spirits, demons or devils? Do they scare people, attack them or haunt their homes? Do they harm people? Is it true that they can tell the future?

أحمد صقز

الجن

(خلاصة البحث)

من أصعب الموضوعات لاي كاتب هو ان يكتب عن الجن. هل هم يسمون جنا او ارواحا او شياطين او دجالين و هل هم مخلوقات؟ هل هم الذين يخوفون الناس و يهاجمونهم و يحكمونهم في بيوتهم؟ هل هم الوحيدون الذين يقدمون المساعدة و يأخذون المعلومات و كذلك خبرا ما لاي شخص هو في حاجة اليه في اى مكان من العالم؟ هل باستطاعتهم القاء الاذى بالناس؟ و هل صحيح انهم يتلقون معلومات من السماء؟ هل هم الوحيدون الذين بإمكانهم التنبؤ بالمستقبل؟

AKTUALITETE

Tahir Ben Jellun

SI UA SHPJEGOVA ISLAMIN FËMIJËVE - 2

Njëmbëdhjetë shtatori shpjeguar fëmijëve

Dita e gjashtë

- Sot do të flas për praninë arabe dhe muslimane në Andaluzi, në jug të Spanjës. Historianët na thonë se, kur arabët kanë ardhur në Andaluzi janë tronditur nga varfëria kulturore e këtij vendi përkundër pasurisë së Perandorisë romake. Një historian madje ka shkruar: “Nuk kishte asgjë”. Imigrantët (ardhësit) që vinin në grupe të tëra nga Arabia dhe nga Siria gjenin aty popullsi të paafta që t’u jepnin çfarëdoqoftë. Nuk ekzistonte asgjë që mund të mirrej, të asimilohej, të imitohej ose të zhvillohej. Po në atë çast, që Bagdadi, Kordova do të bëhen qendrat më të mëdha kulturore të botës muslimane. Kalifi Abd Al Rahman i III-të, mbretëroi në Spanjën musliman gjatë një gjysmë shekulli. Ai Kordovën e bëri një qytet të mrekullueshëm, një qytet që shkëlqen dritë nga kultura. Ai mbledhte rreth vetes dijetarë muslimanë, çifutë dhe të krishterë, u jepte mjete financiare që t’i vazhdonin hulumtimet e tyre. Kjo është periudha kur poezia andaluziane – një simbol shumë i bukur i takimit judeomusliman, letërsia e dashurisë do të zhvillohen në atë shkallë-masë sa që ato do të kenë një ndikim të madh dhe të gjatë mbi Perëndimin. Poeti francez Lui Aragoni në

veprën “I çmenduri i Elzës” thotë tërë atë që i detyrohet poezisë arabe të asaj periudhe.

- Mund të më shpjegosh se çka i detyrohet?

- Është kjo një poezi dashurie, lirike, që këndon dhe që çan për dashurinë. Lu Aragoni një poet i madh francez i shek. XX, shumë është inspiruar nga këto këngë për të shkruar poemën e tij të gjatë të dashurisë për Elzën, gruanë e tij. Dhe pastaj vjen poezia muslimane e cila është shumë e bukur.

- Ç’është mistiku?

- Në këtë fjalë gjendet shprehja “mister”. Mistiku është ai i cili ka një lidhje të fortë dhe të brendshme me Zotin i cili përjashton çdo lidhje tjetër, kjo lidhje është si besimi, nuk mund të shpjegohet lehtë. Poezia mistike është një madhështi e dashurisë së madhe për Zotin. Në botën muslimane, mistikët quhen “sufi”. Fjala sufi rrjedhë nga sof, që në gjuhën arabe do të thotë “lesh”. Sufitë visheshin me rrobe të bëra prej leshi të trash, duke u dalluar kështu nga ata që banin rrobe luksoze dhe me ngjyra shumë të bukura. Sufia heq dorë nga gjërat sipërfaqësore të jetës për t’iu kushtuar tërësisht lutjes, meditimit dhe dashurisë për Zotin.

- Ishin ata poetë?

- Po. Poetët gjithashtu do të shënojnë civilizimin musliman. Poeti më i njohur quhet Al Hallaj. Duke folur për Zotin ai thonte: “Unë jam Atë që e dua”. Një ditë, ai do të del në rrugët e Bagdadit dhe do të thotë: “Unë jam e Vërteta”. Kjo përzierje me Zotin nuk do të tolerohet, ai do të konsiderohet si një i gjindosur. Ai do të arrestohet, gjykohej dhe do të dënohet me vdekje në vitin 922. Ai ka lënë poema të një bukurie të rrallë. Ti duhet ta dijshe gjithashtu se Zoti nuk i beson poetëve sharllatanë. Në versetin 224, sure XXVI, thuhet: “Përsa i përket poetëve, i përcjell vetëm ata që janë futur në rrugë të gabuar, do të thotë ata që janë mashtruar, ata që e kanë gabuar rrugën. Ai shton: “Ata thonë atë që nuk e bëjnë”.

- Ti më ke thënë një ditë më parë se atë që e do më së shumti në Kur’an, është poezia!

- Kur’ani është shkruar në një gjuhë shumë të bukur. Më duket plot me poezi! Por “poetët” në kuptimin e versetit ka të bëjë me ata të

cilët paguhen për fjalë dhe nuk veprojnë. Kjo nuk është ajo që i karakterizon poetët në përgjithësi.

- Pra, çdo gjë që bëhej e mirë ishte arabe!

- Të themi se arabët e kishin kuptuar një gjë të thjeshtë për të përparuar, për t'u pasuruar, nuk duhet mbyll shtëpinë, përkundrazi, duhet hapur dyert dhe kufinj, duhet shkuar drejt të tjerëve, duhet interesuar se çka kanë shkruar, se çka kanë ndërtuar. Ata dëshironin të shkonin përpara dhe për këtë kishin nevojë të mësonin atë që të vjetrit e vendeve tjera tashmë kishin bërë. Zgjuarsia e arabëve rrjedh nga të qenët modest dhe nga pranimi i faktit se dijetar është ai që thotë: “unë nuk di asgjë”.

Për të kërkuar dije ata shkojnë atje ku të tjerët e kishin zhvilluar, në Greqi për shembull.

- Përse në Greqi?

- Sepse Greqia e madhe e shek. III dhe IV para erës sonë, do të thotë para 2.400 vjetve, ishte vendi në të cilin dijetarët kishin studiuar matematikën, astronominë, mjekësinë.

- Të gjitha ndodhnin në Greqi?

- Jo, ishte gjithashtu Persia – Irani i sotëm.

- Ç'është astronomia?

- Astronomia është studimi i yjeve dhe pozita e tyre në qiell.

- Arabët interesoheshin gjithashtu për qiellin?

- Sigurisht, sepse për t'u orientuar në mes të oqeanit, duhet njohur pozitën e yjeve në qiell. A e di ti se dy observatorjumat e para të qiellit janë krijuar në vitin 827, njëri në Damask, tjetri në Bagdad.

- Ndërsa grekët nuk i studijonin yjet?

- Po, i studijonin, në shek. e II-të, Ptolemeu ishte një astronom i madh. Arabët kanë lexuar atë që ai kishte shkruar dhe kishin përcjell hulumtimin e tij. Ai i cili më së shumti do të inspirohet nga Ptolemeu quhet Ibn Haythan (i vdekur në vitin 1040). Ai ishte matematikan, fizikan dhe astronom. Ka shkruar një studim mbi optikën prej një mijë faqesh që ka qenë bazë mbi të cilën bota perëndimore ka punuar ndërmjet shek. XIII dhe XVI për orientim në tokë dhe në det.

- Për çka flet optika?

- Për çdo gjë që ka të bëjë me syrin, me të pamurit, dhe me mjetet teknike për t'i vështuar gjërat që nuk i dallon syri i lirë i njeriut.

- Arabët ishin çdokund të fortë!

- Insistoj edhe një herë: forca e tyre vjen nga modestia e tyre, ata pranojnë të mësojnë dhe nuk thonë se janë dijetarë as nuk thonë se civilizimi i tyre është më i lartë se një tjetër.

- Ç'është modestia?

- Modestia është fakti i të qenurit modest, mos të mendosh se di çdo gjë dhe askush s'ka çka të na mësojë. Modestia është si thonë Marok të jesh “kokëulur”, do të thotë të mos jesh mburravec. I urti është ai i cili e pranon se nuk di shumë, i cili çdo gjë ka për ta mësuar nga të tjerët.

- Ti më ke thënë se në disa vende arabe, mjek e quajnë “të urtin” *al hakim*.

Në të vërtetë, mjekësia arabe ka qenë vepër e dijetarëve, prandaj vepër e njerëzve të urtë. Ta dijmë se prej spitaleve më të njohura, spitali më i vjetër është ndërtuar nga Harun Al Rashid rreth vitit 800. Dy emra të mëdhenj imponohen në historinë e mjekësisë: Al Razi, nga Irani, dhe Avisenë (Avicenne), i lindur në stepet e Azisë qendrore. Ky i fundit ka shkruar në gjuhën arabe *Parimi i mjekësisë*, një enciklopedi në pesë volume e njohur në Perëndim si apogje – kul – dhe kryevepër e shkencës arabe. Ajo është përkthyer në gjuhën latine në shek. XII-të.

Kjo do të jetë dominante në mësimdhënien e lëndës së mjekësisë në Evropë deri në fund të shek. XVII-të. Po të jap definicionin e saj për mjekësinë: “...mjekësia është shkenca e cila studion trupin e shëndosh ose të sëmurë të njeriut për të ruajtur shëndetin që kemi dhe për të kthyer shëndetin që kemi humbur”. Në të njejtën epokë, mjeku, Al Zahrani e përparoi kirurgjinë dhe instrumentet kirurgjike. Pikërisht në shek. XVIII-të kirurgjia u imponua (u bë e njohur) në Evropë. Ajo u vonua sepse feja krishtere nuk pajtohej me këtë shkencë. Po sheh, sot akuzohen muslimanët se janë prapa (janë vonuar) por edhe të krishterët kanë kaluar nëpër këtë.

- Është e vërtetë se të jesh sot musliman, është vështirë!

- Pse e thua këtë.

- Nuk e them unë, këtë e kam dëgjuar në television.

- Kjo është e vërtetë. Për shkak të disa fanatikëve që e glorifikojnë islamin, muslimanët keqkuptohen dhe në këtë moment nuk mirëpri-

ten. Por para se të kthehem këtu, më lejo të jap disa shembuj për muslimanët të cilët kanë qenë përpara të gjithë botës.

- Në cilën lëmi?

- Në letërsi për shembull. Ti i njeh fabulat e La Fontenit?

- Po, natyrisht.

- Atëherë, ta dish se shumë përpara La Fontenit, shkrimtari arab, Ibn Al Mustafa (Ibn Al Mustafa) shek. XVII ka përkthyer dhe adaptuar në gjuhën arabe përrallat dhe tregimet indiane me titull *Kalila dhe Dimna*. La Fonteni do të lexoj këtë libër në gjuhën frënge në vitin 1644. Ai do të inspirohet nga këto përralla dhe nga ato të Ezopit për të hartuar përrallat e veta për kafshët.

- La Fonteni qenka një kopjues!

- Jo, nuk është kopjues, por është një njeri inteligjent që ka ditur të merrë atë çka kishte për të marrë dhe ka shkruar për fëmijët e Francës. Por pa Ibn Al Mustafanë me siguri nuk do të ishin *Përrallat e La Fontenit*.

- Edhe një shembull!

- Ti e njeh historinë e Robinson Krusos?

- Po, e kemi lexuar në klasë.

- Në shek. XII një njeri i cili jeton në Grenadë, pastaj në Tanzher dhe në Marrakesh, ka shkruar *Haxh Ibn Jakdhan* (Yay Ibn Yaqdan). Kjo është historia e një njeriu të vetëm në një siujdhesë të shkretët i cili ai vet do t'i zbuloj të vërtetat e mëdha të cilat shpejtojnë në atë që quhet "Drita e Zotit". Një profet i ardhur nga një siujdhesë fqinje do t'i konfirmojë atij se të vërtetat e zbuluara nga feja janë ato të njejtat që ka mundur t'i zbulojë ai vet.

- Kjo vepër i ka paraprirë pesë shekujve librit të Daniel Defo-s.

- Një shembull tjetër!

- Marko Pollo u bë i njohur se kishte udhëtuar rreth botës... Shumë përpara tij, arabi Ibn Batuta, i lindur në vitin 1304 në Tanzher, kishte udhëtuar dy herë rreth botës. Ai ka lënë një ditar në të cilin tregon për atë se çka ka parë dhe dëgjuar.

- Çka tjetër?

- Një italian nga Amalfia, Flavio Gioja shpesh ishte konsideruar si zbulues i busollës. Në të vërtetë, lundruesit arabë e kanë zbuluar këtë instrument i cili mundëson orientimin në det dhe në tokë. Anijet treg-

tare arabe ishin zotëruese të detnave që nga shek. XII. Në vitin 1304 Flavio Gioja do të zbulojë në një libër ekzistimin e këtij instrumenti të zbuluar nga arabët.

- Mirë! Arabët paskan zbuluar shumë gjëra! Po sot, ata nuk po zbulojnë më asgjë?

- Që të kuptosh gjendjen aktuale të vendeve arabe dhe muslimane më duhet të tregoj pak histori. Nëse më ke përcjellë mirë, islami ka qenë ai i cili do t'i shtyjë arabët të udhëtojnë nëpër botë për të përhapur mesazhin e profetit dhe gjithashtu për të kthyer – konvertuar sa më shumë njerëz që është e mundur në këtë fe të re. Duke udhëtuar ata do të zbulojnë një botë tjetër dhe do të dëshirojnë të arsimohen dhe të marrin pjesë në zhvillimin e njerëzimit. Gjë që kjo edhe ndodh. Do të ketë luftëra, beteja, të vdekur, konflikte brenda islamit. Kur muslimanët okupojnë një vend ata do t'i marrin në mbrojtje të krishterët dhe çifutët. Këta duhet t'u paguajnë tatim.

- Ata e blejnë (paguajnë) mbrojtjen e tyre?

- Si minoritete, po.

- Minoritete?

- Në tokën islame, çifutët dhe të krishterët, që muslimanët i quajnë "njerëz të librit" do të thotë ata të cilët kanë një fe të bazuar në një libër të shenjtë, si Kur'ani për muslimanët-, nuk ishin të shumtë në numër, ajo që quhet minoritet. Për shkak të kësaj situatë, ata duhej të paguanin një shumë të hollash drejtpërsëdrejti në Trezor si garancë për sigurinë e tyre fizike dhe morale.

- Përse duhej të paguanin për të jetuar me muslimanët?

- Ndoshta se muslimanët dëshironin t'i shtynin të ktheheshin në Islam... Por kjo situatë nuk ka zgjatur tërë kohën. Përkundër kësaj, në mes shek. IX dhe XI, janë zgjeruar dituria dhe kultura që i karakterizojnë aksionet e muslimanëve. Pas Avicenës (Avicenne) 980-1037, i cili do të mësohet në Evropë deri në shek. XVII. Pas Al Farabit, i cili ka krijuar një pasqyrë të përgjithshme të shkencave – vjen Avërro (Averroes). Ky është një njeri i rëndësishëm.

- Më shumë se të tjerët?

- Po, sepse ai do të shkojë edhe më larg sesa paraardhësit e tij. Ai shfaqet një shekull pas Avicenës. I lindur në Kordovë (Cordoue) në vitin 1126, ai vdes në mërgim në Marok në vitin 1198.

- Përse ka mërguar në Marok?
- Me të drejtë, ishte filozof. Është ai i cili ka mbledhur trashëgiminë e filozofit grek Aristotelit dhe e ka dërguar në Perëndim. Ai gjithashtu është një jurist i madh musliman.
- Ç'është thotë jurist?
- Jurist është ai i cili studion drejtësinë, do të thotë rregullat dhe ligjet që janë në baz të çdo shoqërie. Kjo i përcakton kriteret e drejtësisë.
- Mirë. Pra, ai ishte dashamir i diturisë dhe i drejtësisë.
- Do të mundohet të fut *arsyen* në zemër të fesë.
- Arsyeja, është logjika, feja është besimi apo jo?
- Po, ai do të tentojë të jap në të vërtetë të besoj në një farë logjike.

Pastaj ai do të vërej se feja muslimane shfrytëzohet nga njerëz të cilët kanë interese tjera. Ekzistojnë sekte, klane të cilët nuk pranojnë të diskutojnë dhe sidomos të pranojnë ndihmën e të huajve. Do të bëhen diskutime. Shtëpia islame nuk është më Shtëpia e diturisë. Avërro e dënon tërë këtë, por politikanët në Kordovë nuk janë të mendimit me të. Ai ik dhe kërkon mbrojtje në Marok. Prej kësaj kohe civilizimi musliman do të helmohet nga fanatizmi dhe jotoleranca. Por nuk janë vetëm këto shenja për të shpjeguar dekadencën, është gjithashtu tërë periudha e kryqzatave.

Dita e shtatë

- Ç'është thotë *dekadencë*?
- Kjo është diçka që degradohet, që perëndon, e cila në vend se të shkojë kah përparimi merr rrugën e tatëpjetës dhe të rënies. Një shtëpi që nuk mirëmbahet më, që nuk është e banueshme më ose jomjaft e banueshme, prishet, shkatërrohet, asgjë më nuk funksionon brenda. Civilizimi është si shtëpia e madhe. Nëse themelet e saj janë të forta, nëse muret e saj bëhen me gurë të mirë, nëse njerëzit të cilët shkojnë shpesh, i sjellin pasuri të reja, e ajrosin dhe e zbukurojnë, ajo do të mbahet. Në fund, kjo është më e komplikuar, por civilizimi është një tërësi njohurish e krijuar nga trashëgimia dhe nga frytëzimi i asaj që stërgjyshërit e kanë lënë. Duhet ditur të kujdesemi për civilizimin sikur për një shtëpi të vjetër dhe të bukur.

- Civilizimi arab nuk është mbajtur mirë.
- Pas epokës së vet të lavdisë dhe të diturisë ai mori goditje, më parë sepse u bënë ndarje brenda shtëpisë së madhe. Kundërshtime në mes kalifve: këtyre udhëheqësve gjithnjë e më shumë iu shtuan apetite të mëdha, ata nuk mendonin më për interesin e përgjithshëm, por për intereset imediate të egoizmit të tyre. Kështu kalifatet e Bagdadit dhe të Kordovës ishin sunitë, do të thotë në traditën klasike të profetit, ndërsa kalifati i Kajros ishte shiit, do të thotë ihtarë i Aliut.
- Si shprehen këto ndarje?
- Prej vitit 1055, kalifët u bëjnë thirrje mercenarëve Selgjuqidët (të ardhur nga Turqia e sotme) për të mbajtur territorin e tyre. Për shembull kjo armatë selgjuqide do t'i pengojë të krishterët që të arrijnë në vendet e shenjta të Jerusalemit dhe do t'i persekutojë. Kështu ata do ta marrin pushtetin politik.
- Ç'ndodh atëherë?
- Papa Urban II (Urbain II) do të përfitojë nga situata e ndarjes së arabëve dhe nga ardhja e mercenarëve për të filluar kryqëzatat kundër muslimanëve, prej vitit 1096 deri më 1099. Në fillim ai i përgjigjet thirrjes për ndihmë të kërkuar nga perandori bizantin kryeqyteti i të cilit – Konstantinopojë – ishte kërcënuar nga muslimanët selgjuqidë (Seldjuqid). Pastaj, armatat krishtere do t'i udhëheqin pushtimet e tyre.
- Nga vjen fjala kryqzatë?
- Nga fjala “kryq” kryqi ishte simbol i krishterëve meqë Jezukristi ishte mbërthyer (thumbuar) në kryq. Kryqzata është lufta në emër të krishterizmit kundër atyre të cilët e kundërshtojnë këtë fe ose të cilët e pengojnë përhapjen e saj. Në atë kohë islami vazhdonte të përhapej dhe të shëndriste nga të gjitha pikëpamjet. Do të krijohen gjithsej tetë ekspedita krishtere të armatosura. E fundit do të krijohet në vitin 1223. princërit katolikë marrin Kordovën në vitin 1236, pastaj Sevilen 1248. Këto janë disfata politike dhe ushtarake për civilizimin arab dhe musliman. Vetëm Granada do të rrezistojë. Ajo do të jetë vatra e fundit e civilizimit arab në Evropë. Ajo bie në duar të mbretërve katolikë në vitin 1492. Ky është fundi i një epoke dhe i një civilizimi të madh. Bota ndryshon. Viti 1492 është gjithashtu viti kur Kristofor Kolombo zbulon Amerikën.
- Ç'ndodh atëherë me arabët e Andaluzisë?

- Kishte çifutë dhe muslimanë. Do t'i ndjekin, do t'i dëbojnë nga Spanja. Atyrë të cilët dëshirojnë të rrinë, u thonë: "Ju mund të zgjidhni në mes dy gjërave, pagëzimin ose vdekjen".

- Ç'do të thotë kjo?

- Të bëhesh i krishterë ose të vdesësh. Shumë vendosnin të kthehen në katolicizëm. Por përkundër këtij kthimi ata ende do të persekutohen, sepse thellë në zemrën e tyre nuk kishin hequr dorë nga feja e tyre. I quajnë maure. Ata do të persekutohen dhe do të internohen jashtë Spanjës. Ky quhet inkuizicion. Ai do të përfundojë më 22 shtator 1609. Dije në fund se Spanja katolike do të apsorbojë pa e pranuar kurrë tërë atë që arabët e kishin sjellë në regjion. Ndër muslimanët të cilët u detyruan të largohen nga Grenlanda në kohën e ripushtimit të këtij vendi nga katolikët, ishte një dijetar, një gjeograf Afrikani Leon. Me emrin e tij të vërtet Hasan Al Vazan (Mates) Hasan Al Wazzan (le Peseur), ka kaluar disa vite pranë papës Leon X-të (1518). Ai ka dhënë mësim në gjuhën arabe dhe italiane, ka futur në oborrin e këtij pape tekste greke të përkthyer në gjuhën arabe që pastaj i ka përkryer në gjuhën latine.

Ai është simbol në mes Lindjes dhe Perëndimit.

- Ç'do të bëhet me muslimanët dhe arabët?

- Bota arabe do të izolohet, do t'i ndalohet të ketë marrëdhënie tregtare me Evropën, filozofia arabe vazhdon të mësohet në universitetet evropiane, por ajo pushon të mësohet në botën arabo-muslimane.

- Çka mësohet në vend të saj?

- Në vend të filozofisë që na mëson metodën, mëdyshjen, përqendrimin e mendimit i cili na hap horizonte të ndryshme dhe të shumta mbi mendimin e popujve tjerë, mësohet feja islame dhe asgjë përveç fesë islame, pra s'ka përqendrim të mendimit dhe të mëdyshjes. Kështu kalohet prej një tradite të hapur në botë, në një izolim, në një mbyllje në vetvete. Ky është një varfërim. Kjo do të jetë e rëndë për botën arabe dhe muslimane. Kjo do të marrë kohë, por rezultatet po shihen sot. Kur jemi të mundur (të mposhtur) kemi pasojat të disfatës gjatë një kohë të gjatë, shumë të gjatë.

- Ç'do të ndodhë në mes shek. XVI dhe kohës sonë?

- Kanë ndodhur shumë ngjarje. Por të mundohemi të kuptojmë përse bota arabe do të njohë (do të ketë një) një periudhë të rënies.

- Ç'është rënia?

- Të biesh do të thotë të ulësh nivelin dhe cilësinë. Thuhet për dikë që është i sëmurë se shëndeti i tij po bie, nëse nuk dëgjon, se po i dobësohet dëgjimi. Kjo është si dekadencia. Shifen shenjat e një rënie të ngadalshme.

- Atëherë pse ndodh kjo rënie?

- Fillimin e dijes, përkthimet, takimet në mes dijetarëve, lirinë filozofike, të gjitha këto i kanë kërkuar, i kanë financuar dhe i kanë mbajtur princat. Kjo hapje i përgjigjej nevojës për ta kuptuar botën për një udhëheqje të mirë të një perandorie të madhe në të cilën kishte vetëm popuj arabë. Ditën kur princat fillojnë të grinden, dijetarët dhe filozofët nuk kanë mund të gjejnë mbështetje as politike as financiare për të vazhduar punën.

- Më thuaj një emër të ndonjë dijetari arab i cili shënon këtë epokë?

- Nëse duhet mbajtur mend vetëm një emër, dijetari i madh arab i fundit, ai i cili e ka shkruar një vepër me rëndësi universale, është Ibn Haldum (Khalidoun). Ai është zbulues i asaj që sot quhet "sociologji" do të thotë studimi i fakteve dhe sjelljeve të shoqërisë. Ai ka jetuar në fund të shek.XIV dhe në fillim të shek.XV në Afrikën Veriore (1332-1406). Ka studiuar mentalitetin dhe sjelljet arabe. I ka vëzhguar mirë dhe shumë i ka kritikuar. Ai ia hapi rrugën kritikës dhe ndërrimeve. I merrte në mbrojtje kalifët kundër njerëzve të pakualifikuar të cilët marrin përsipër mësimin fetar dhe të cilët nga kjo përfitojnë për ta mashtruar popullin. Ai ishte gjithashtu kundër faktit që disa i shfrytëzojnë xhamitë vetëm për të mësuar Kur'anin. Tashmë, në kohën e tij ai shihte rrezikun i cili qëndron në shfrytëzimin e Islamit për qëllime që nuk kanë asgjë të bëjnë me fenë. Ai ishte një vizionar. Ka dëshmuar ndikimin që mund të ketë klima mbi temperamentin dhe mentalitetin e popujve. Do të duhet pritur fundin e shek.XIX dhe fillimin e shek.X që njerëzit inteligjentë dhe të hapur, si Ibn Halldum, të propozojnë reforma në Islam.

- Ç'janë reformat?

- Është fjala për ndryshimin e disa rregullave dhe shprehive në mënyrën e ushtrimit të fesë.

- Është e mundur të ndryshohet diçka në fenë Islame?

- Nuk është fjala të preken vlerat dhe parimet që e themelojnë, por duke u mbështetur në atë që është fundamentale, është e mundur që në te të futen reforma. Për këtë duhet guxim dhe ngulm-durim. Duhet mbajtur mend emrat e Afgan Xhameludin Al Afgani (i vdekur në vitin 1897), të egjiptianit Muhamed Abdul (i vdekur në vitin 1905). Ata rekomandonin “dialogun, tolerancën dhe sidomos përshtatjen në botën moderne”. Ata thonin se nuk duhet pranuar verbërisht atë që impononin zotërinjtë e vjetër si rregull sjellje sepse koha kur ka lindur Islami ndryshon shumë prej kohërave moderne. Për t’i ndryshuar gjërat në vendet myslimane, ata bazoheshin në një verset të Kur’anit i cili thotë: “Zoti nuk e ndryshon fatin e një populli derisa ky nuk e ndryshon vet-veten”. (Sureja XIII, verseti 11). Kjo do të thotë se, nëse sot muslimanët shikohen me sy të keq në botë, nuk është gjithmonë faji i të tjerëve, i jomuslimanëve. Ata duhet të vendosin për të ndryshuar atë që është e keqe ose e sëmurë në shoqërinë e tyre. Edhe nëse jomuslimanët u kanë bërë të keqija popujve islamë nuk duhet ngarkuar atyre tërë atë që nuk shkon mirë në këto vende. Secili ka pjesën e vet të përgjegjësisë. Kryqzatat janë një kujtim i largët gjithashtu edhe kolonializmi. Nëse ndër muslimanë ka të rinj që janë bërë agresivë dhe fanatikë, ata janë bërë për shkak se nuk janë edukuar mirë, i kanë lënë në duar të injorantëve dhe të paskrupullë. Nuk kanë ditur ose nuk kanë dashur që t’i bëjnë të duan zhvillimin, kulturën dhe jetën. Kanë pasur frikë nga liria dhe nuk kanë bërë asgjë kundër korrupsionit dhe padrejtësive. Atëherë ata i kthehen fesë të cilët nuk e njohin mirë. Ata siç thotë Kur’ani, janë të humbur (të mashtruar). Mendimi i tyre është i gabuar. Rrënjët e së keqes nuk janë gjithmonë te të tjerët.

- Ç’është skrupulli?

- A e di ti si quhet guri i vogël që të hynë në këpucë dhe të pengon kur ec?

- Jo. Një gurë i vogël i mërzitshëm – i poshtër.

- E quajnë “skrupull” sepse ai është kokërr rëre i cili e pengon njeriun (e mirë) të flejë. Ai është punuar nga diçka që quhet ligj, rregull, parim. Njerëzit të paskrupull flejnë pa probleme (rehat). Atyre nuk u pengon mosrespektimi i parimeve.

Dita e tetë

- Cilat janë ngjarjet kryesore të cilat do të ndodhin në botën arabe në momentin kur ajo (bota arabe) njeh fillimin e dekadencës?

- Nga Perandoria arabo-muslimane do të kalohet në Perandorinë Otomane do të thotë në Perandorinë Turke. Turqit do të vendosen në Egjipt, në Liban, në Siri, në Iran, në Ballkan, në Tunizi, në Algjeri. Maroku do t’u bëjë rezistencë dhe do të shpëtojë nga tirania e tyre. Shek. XVI ka qenë kulmi i fuqisë ushtarake otomane. Islami është një fe shtetërore. Në shek. XIX perandoria e madhe përjeton rënie. Pas Luftës së Dytë Botërore Turqia vendos të bëhet një shtet modern duke e ndarë fenë nga politike. Kalifati, do të thotë drejtoria shpirtërore dhe politike e të gjithë muslimanëve u suprimua në vitin 1922. Në sajë të Mustafa Kemalit Turqia bëhet një vend laik.

- Ç’është laikë?

- Të jesh laik, do të thotë të mos jesh fetar.

- Kjo do të thotë të mos besosh në Zot?

- Jo, mund të besosh në Zot dhe të jesh laik. Laicizmi (jofetarizmi) është fakti të mos përdoret feja për të imponuar ligje për jetën e njerëzve. Laicizmi është bërë zyrtar në Francë prej 9 dhjetorit të vitit 1905, datë kjo kur u shpall ndarja e Kishës nga Shteti. Një shembull: shkolla publike në Francë është një shkollë në të cilën fetarët nuk kanë të drejtë të japin mësim. Përkundrazi, ata kanë të drejtë t’i kenë shkollat e veta. Ka kisha, sinagoga, xhami. Shteti nuk ndërhyr në ushtrimin e fesë. Turqia ka qenë vendi i parë që është bërë një shtet laik-jofetar.

- A është kjo me rëndësi?

- Duke pasur parasysh se ç’po ndodh sot, është shumë me rëndësi të shpëputet feja dhe politika. Derisa nuk krijohet një barrierë në mes të dyve, do të ketë probleme. Në Francë muslimanët duhet të ushtrojnë fenë e tyre duke i respektuar ligjet e Francës.

- Si?

- Të kujtohen ato vajzat marokene të cilat vinin në Kolegj duke mbajtur shami rreth kokës?

- Jo, nuk më kujtohen, por më trego.

- Profesorët nuk kanë dashur t’i pranojnë në klasë, duke thënë se meqë Franca është një vend laik (jofetar), nuk duhet të tregohet përkatësia fetare në shkollë.

- Dhe pastaj ç'ka ndodhur?
- Ka pasur shumë diskutime. Më në fund, disa vajza kanë hequr dorë që të mbajnë shami. Të tjerat prindërit i kanë larguar nga shkolla. Ata kanë gabuar që i kanë lënë pa arsim.
- Një ditë kam parë në televizion gra të mbuluara prej këmbëve deri në kokë. Dukeshin si fantomë...
- Ato që ke parë, janë gra afgane që burrat i maltretonin në emër të Islamit.
- Por, a e obligon islami gruan të mbulohet tërësisht?
- Jo. Ti dëshiron të flasësh për shaminë që quhet "*hixhab*" (*hijab*) në botën arabe, ndërsa *çador* (*tedhador*) në gjuhën iraniane. Ajo që thuhet në Kur'an është e qartë: gruaja që lutet, pra që i drejtohet Zotit, duhet të mbulojë kokën dhe të mos vesh rroba të ngushta që i puthiten për trupi. Kjo gjë haset gjithashtu te të krishterët dhe te çifutët. Nëse një grua vishet në mënyrë provokuese, për shembull nëse ajo vesh minifustan ose bluzë që le të duket gjokësi, nëse flokët nuk i ka të lidhura nuk e lejojnë të hyjë në kishë ose në sinagogë. Gratë muslimane kanë të drejtë të shkojnë në xhami, por nuk duhet të përzihen me burra. Kjo bëhet për t'iu shmangur turbullirave, incidenteve. Vendi i lutjes nuk është njëvendtakim në mes të gjinive.
- Pra, Zoti flet për shaminë?
- Po. Në suren XXIV (Drita), verseti 31, u rekomandon besimtareve që të "ulin shikimin" dhe me "shami t'i mbulojnë gjinjtë". Në suren XXXIII, verseti 59, ai kështu i drejtohet profetit: "...thuaju bashkëshorteve dhe vajzave tuaja dhe grave të besimtarëve, që t'i lëshojnë deri poshtë rrobet e sipërme. Kështu do të jetë më lehtë që të mos dihen-njihen, dhe që të mos fyhen fare". Kjo do të thotë se gratë e besimtarëve duhet të dallohen nga gratë me virtyte të këqija.
- Përse Zoti flet për bashkëshortet? Profeti i kishte disa?
- Në islam burri ka të drejtë që t'i ketë katër gra.
- Kjo quhet poligami.
- E di. Mono do të thotë një, poli do të thotë disa. Por kjo nuk është e drejtë.
- Mirë e ke, kjo nuk është e drejtë. Shiko, nëse e përcjellim mirë tekstin e Kur'anit, kuptojmë se është e pamundur për një njeri të besueshëm dhe musliman të mirë të jetë poligam, sepse thuhet "me kusht

- që t'i duash njësoj (barabart)" do të thotë të jemi të drejtë dhe të paanshëm me secilën. Gjë që është e pamundur. Nuk mund të kesh të njëjtën dashuri për katër gra në të njëjtën kohë. Medoemos ekziston animi, pra padrejtësia. Sot poligamia është në zhdukje e sipër sepse gruaja është duke i fituar të drejtat, mjerisht jo në të gjitha vendet islamike, por në disa, si Tunizia në të cilën poligamia është e ndaluar. As perçja, mënyrë talibane as poligamia sot nuk janë të pranueshme.
- Mendoj se gratë janë revoltuar!
- Po, por jo përherë dhe jo në të njëjtën kohë. Fatmirësisht disa shoqata të grave në vendet muslimane, si Egjipti, Maroku ose Algjeria, luftojnë që Kodi i familjes të ndryshohet dhe që gruaja t'i ketë të njëjtat të drejta si burri. Kjo nuk është e lehtë sepse edhe sikur të ndryshoheshin tekste ligjore, do të duhej kohë që mentaliteti të pranojë ndryshimin e shprehive të tyre. Muslimani i mirë, duhet të jetë njeri i drejtë, pra ai do të duhej të pranonte që gruaja të ketë të njëjtat të drejta si ai në jetën e përditshme. Dije se në Islam thuhet qartë dhe në mënyrë të prerë se nuk është turp të flitet për seksualizëm. Në gjuhën arabe thuhet: "... *La haja'a fidine*".
- Ç'do të thotë kjo?
- Kjo do të thotë se islami flet pa dredhi për marrëdhëniet në mes burrave dhe grave. Kur isha adoleshent, kam lexuar një libër "Kopshti i parfumuar". Është shkruar në shekXV nga një njeri fetar prej Tunisit, Sheik Nafzavi. Ky është një doracak mbi edukatën seksuale për të rinjtë muslimanë.
- Sigurisht, ai u drejtohet djemve, e jo vajzave. Sipas udhëzimeve të Islamit sheiku shprehet dhe shpjegon se si bëhet dashuri.
- T'i kthehem historisë?
- Pra, pas mbarimit të Perandorisë turke, rrada u vjen evropianëve që të hyjnë dhe të vendosen me armë dhe paisje në vendet në të cilat nuk janë ftuar: francezët zbarkojnë në Algjeri në vitin 1830, anglezët në Egjipt në vitin 1882, pas Tunizit, francezët vendosin një protektorat në Marok në vitin 1912.
- Përse ata vijnë në këto vende?
- Ky quhet kolonizëm. "Të kolonizosh" do të thotë të krijosh koloni në tokat e huaja, do të thotë të okuposh me forcë dhe të imponosh

në një vend ligje dhe rregulla të cilat nënshtrojnë popullsinë vendore. Ky është dominim-sundim.

- Kjo është e padrejtë!

- Po, ky është agresion dhe e padrejtë! Vendeve arabe dhe muslimane okupimi u shkaktoi rënie. Është sikur trupi i sëmur i cili nuk mund të mbrohet dhe e shikon veten sesi e pushtojnë sëmundjet tjera.

- A janë revoltuar njerëzit?

- Po, pas disa deceniesh, ata zgjohen. Lufta më e tmerrshme nga këto lufta për pavarësi ka qenë lufta e Algjerisë, në mes vitit 1954 dhe 1962. Ka pasur qindra mijëra të vdekur nga të dy anët, pastaj francezët të cilët kishin lindur dhe jetuar në Algjeri janë detyruar të ikin.

- A ka luajtur rol islami në këto lufta?

- Po. Islami, si fe dhe si kulturë, i ka bashkuar të gjithë luftëtarët. Ai i ka bërë solidarë. Por kjo nuk është shndërruar në luftë fetare. Pas pavarësisë këto vende patën – përjetuan ndryshime politike.

Dita e nëntë

- Prej nga rrjedh dhuna e muslimanëve?

- Të gjithë muslimanët nuk janë agresivë.

Kurrë nuk duhet përgjithësuar gjërat. Dije se asnjë fe nuk është plotësisht paqësore ose plotësisht e prirur për luftë. Në Kur'an mund të gjejmë shumë versete të cilët rekomandojnë dashuri, drejtësi, harmoni dhe paqe në mes njerëzve, falje, urti dhe pastaj mund të gjejmë gjithashtu versete që i shtojnë muslimanët në luftë kur këtë e kërkojnë rrethanat. Dhuna ekziston çdokund. Dhe pastaj muslimanët nuk formojnë më perandori si në fillim të islamit. Bashkësia muslimane është e shpërndarë nëpër të gjitha kontinentet. Nuk mendoj se kinezi ka të njëjtin koncept të ushtrimit të fesë muslimane si marokeni ose si afrikani ose si evropiani i konvertuar. Është e vërtetë se, pas vdekjes së profetit pati dhunë dhe luftëra. Kjo rrjedhë nga shkaku se islami nuk është një fe e shkëputur nga jeta e përditshme. Ajo preokupohet për sjelljen e njerëzve në qytet, për moralin e tyre, për organizimin dhe për drejtimin e bashkësisë së tyre. Ajo (që) quhet politikë. Kjo do t'i mundësojë Homeinit, ai i cili e përmbysi Shahun e Iranit në vitin 1978 dhe vendosi Republikën islamike, që do të thotë: "Islami është politi-

kë ose nuk është asgjë". Kështu Islami rregullon jetën e njerëzve në mënyrë më të drejtëpërdrejtë sesa që e bëjnë krishterizmi dhe judaizmi (besimi i çifutëve). Duke u nisur nga kjo, i hapet dera luftës dhe dhunës. Politika shpesh është luftë për pushtet. Nëse kjo luftë bëhet në emër të islamit siç është rasti me Iranin, dhuna që do të përdoret medoemos do t'i hudhet – veshet Islamit.

- Po. Po e di, po e kuptoj, sepse sot, flitet për Islamin për shkak të atentateve.

- Ke të drejtë. Atëherë duhet të jesh i durueshëm dhe të vazhdosësh të dëgjosh historinë e Islamit. Këtu më duhet të të flas për një sektë që quhet "hashashen" (sekti është tërësi njerëzish që ndjekin verbërisht një udhëheqës të quajtur "guru"). Fjala arabe "hashish" do të thotë "bar" dhe më gjerësisht "drogë". Hashasheni është adhurues i drogës. Kjo sektë ka ekzistuar në Azinë perëndimore do të thotë në Siri dhe në Persi-Iran në shek.XI dhe XII. Udhëheqësi i saj, Hasan As-Sabah, musliman i rreptë, i vështirë dhe autoritar, është quajtur "Plaku i maleve (ka vdekur në vitin 1166)". Pasi bëhet "guru" ai do të vendoset në kështjellën e Alamytit, jo larg Detit Kaspik, dhe prej këtu do t'i drejtojnë trupat e veta për ekspeditat ndëshkuese kundër qeverive. Më parë i drogonte përkrahësit e vet me hashish. Ai bëri që mbretërit dhe princat të dridhen nga frika. Armët e tij ishin terrori, urrejtja dhe masakrat. Fjala "ashashen" dhe në gjuhën frenge asase "assassins" – vrasës.

- "Plaku i maleve" gjithashtu ishte një musliman i keq?

- Ai ishte shiit dhe dëshironte të mbetej misterioz. Por kjo nuk vjen nga Islami.

- E di. Islami do të thotë t'i bindesh paqes, të mos bësh krime. Por ata që bënë atentate janë muslimanë.

- Po, por muslimanët nuk janë islami (nuk e përfaqësojnë islamin).

- Ç'do të thotë kjo?

- Kjo do të thotë se feja nuk kuptohet në të njëjtën mënyrë nga të gjithë ata që pretendojnë se janë muslimanë.

- Mirë. Ç'ndodhë pastaj?

- Islami përhapet shumë në Afrikë dhe në Azi, a e di ti se vendi më i madh muslimanë është në Azi, Indonezia?

Shiko, ata ishin disa qindra në shek.XII, ata sot janë më tepër se një miliard.

- Një miliard muslimanë në botë! Përse kaq shumë njerëz bëhen muslimanë?

- Arabët janë pakicë krahasuar me aziatikët të cilët janë bërë muslimanë. Kështu mund të hasish arab të krishterë në Egjipt (këta janë koptë), ata paraqesin 15% të popullsisë, në Liban, këta janë maronitë. Ata e thonë meshën në arabisht. Kjo është shumë mirë.

- Po në Francë?

- Islami është feja e dytë në Francë. Numri i muslimanëve në Francë vlerësohet në katër milionë, pjesa më e madhe janë magrebianë, të tjerët janë turq, afrikanë, pakistanez, egjiptianë etj. Meqë në Islam nuk ka kler, ata nuk po arrijnë të pajtohen për të caktuar një përfaqësues të vetëm për të gjitha këto bashkësi. A mendon se muslimanët dhe të krishterët do të mirren vesh për të jetuar në paqe këtu në Francë dhe gjetiu në Evropë?

- Nuk ka luftë në mes të dy feve. Muslimanët e Francës kanë pasur fat që jetojnë në një vend demokratik që u garanton të drejtën të ushtruar lirisht fenë e tyre. Por nuk duhet harruar se Franca është një vend laik – kjo do të thotë se asnjë fe nuk është fe e shtetit. Të gjitha fetë kanë të drejtë të ekzistojnë por asnjëra nuk mund të mbizotërojë të tjerat. Për të përfunduar, po të citoj një verset nga Kur’ani që lavdëron atë që quhet kryqzim (përzierje racash): “O ju njerëz, me të vërtetë, Ne ju krijuam nga një mashkull dhe nga një femër, dhe Ne ju formuam në popuj dhe fise që të dini njëri-tjetrin”. (Sureja II, verseti 13).

- Ne dëgjuam fjalë dhe do të dëshironim t’ua dimë kuptimin. A mund të na i shpjegojsh?

- Cilat janë këto fjalë?

- Integristet.

- Sipas fjalorit, kjo fjalë është marrë nga spanjolishtja *integrasta*, që do të thotë “anëtar i një partie e cila dëshiron që shteti të jetë i varur nga kisha”. Megjithatë, në këtë nocion, gjindet fjala “integre” që do të thotë diçka e mirë. Një njeri i mirë i drejtë është lojal, besnik ndaj parimeve dhe ndaj vlerave. Kuptimi i kundërt i kësaj fjale është “i korruptuar” i korruptuari është dikush i cili është shitur. Ai flijon vlerat dhe parimet për të holla ose për ndonjë interes.

- Por çka ka të bëjë “integristi” me Islamin?

- Muslimanët ekstremistë nuk e përdorin këtë fjalë për të treguar aksionin që ata udhëheqin. Përkundrazi, kjo fjalë është përdorur për të treguar katolikët të cilët dëshirojnë më tepër përpikëri në zbatimin e fesë së tyre. Për shembull ata dëshirojnë ta thonë meshën në gjuhën latine dhe jo në gjuhë tjetra. Kur muslimanët filluan të reklamojnë një Islam më të rreptë, më besnik në kohën e lindjes së tij, shtypi i tregoi me fjalën “integristë”.

- Si përcaktohen ata pra?

- Ata thonë se janë islamistë. Në mes tyre të gjithë ata njëri-tjetrin e quajnë vëlla.

- Kjo rrjedh nga lëvizja e parë e formuar në vitin 1928 nga një arsimtar, Hasan Al Bena, në një qytet të vogël të Egjiptit, Ismajlia dhe i cili mbante emrin “Vëllezërit Muslimanë”. Ai luftonte kundër degradimit të zakoneve dhe kundër ndikimeve të evropianëve mbi muslimanët. Ai e kundërshtonte partinë nacionaliste egjiptiane Vafd, e cila luftonte për një sistem politik demokratik dhe parlamentar. Njëri prej udhëheqësve të tyre, Said Kutbi, do të arrestohet dhe torturohet për “komplot kundër Naserit” i dënuar me vdekje dhe i ekzekutuar më 29 gusht 1966. Mësuesi i tij, El Benna, ka thënë: “Çdo pjesë e tokës në të cilën ka vluar flamuri islam për çdo musliman është një pjesë që duhet të ruaj, për të cilën duhet të punoj dhe të bëjë luftë të shenjtë. Lëvizja vazhdoi rrugën e vet në Egjipt dhe në vende tjera muslimane. Ata janë mirë të organizuar, u vijnë në ndihmë të varfërve dhe të sëmurëve, dhe u referohen librave të shumta të lëna nga Sejid Kutbi, i cili ishte një njeri shumë i ngritur. Kur i dëgjojmë lavdërimet e islamistëve, kuptojmë se ata mundohen të imponojnë me forcë një mënyrë të jetës, të sjelljes, të veshjes që koha sot nuk e pranon. Ata harrojnë një çështje që dihet mirë: Islami ka lindur para më shumë se 14 shekujve. Në shkrimet e tij ka vlera që vlejnë gjithmonë, përjetësisht. Pastaj ka gjëra që kanë pasur të bëjnë me kohën e lindjes së tij dhe të cilat nuk i përshtaten më kohës moderne. Ata dëshirojnë të kthehen në kohën e Profetit dhe Mesazhin e Muhamedit e kuptojnë në një mënyrë të thjeshtë, shumë shematike dhe të shtrembëruar.

- Për shembull?

- Islamistët nuk dëshirojnë që gruaja të jetë e barabartë me burrin, as që të ketë të drejtë, as që të mund të vendos vet për fatin e saj. Ata janë për lëshuarjen e gruas dhe për poligami.

- Ç'është lëshuarja. Ç'është të thotë lëshuarje?

- Burri ka të drejtë të ndahet nga gruaja pa e pyet atë (pa pëlqimin e saj) dhe pa dalë para gjykatës. Ai do të shkojë te nëpunësi për çështje fetare dhe kërkon nga ai të njoftojë gruan e tij.

- Por kjo nuk është e drejtë.

- Kjo nuk është e drejtë dhe as humane, por kjo po ndryshon në disa vende muslimane të cilat dëshirojnë të jenë moderne. Është bërë shprehje – zakoni t'i thuhet gruas: "Duhet të dëgjosh burrin, nëse nuk ke burrë, duhet ta dëgjosh babanë, etj. Gratë nuk duhet të vishen në këtë ose në atë mënyrë.

- vijon -

Tahir Ben Jellun

THE WAY I EXPLAINED ISLAM TO CHILDREN

(Summary)

Today, I will have a word about the Arab presence in Andalusia, in the south of Spain. Historians claim that when the Arabs arrived in Andalusia they were touched by the cultural inferiority of this region (despite the riches of the Roman Empire). The settlers, who came to this region in large groups (from Arabia and Syria), came across a population from which there was nothing to gain. Those were the times when Baghdad and Cordova became the largest cultural centers of the Moslem world. Caliph Abd Al Rahman III ruled in Moslem Spain for half a century. He turned Cordova into a magnificent town, a cradle of culture. He brought Moslem, Christian and Jewish scholars to his court. He supported their work financially. These were the times when

Andalusian poetry reached its highest peaks, which would have a very large impact on the west.

طاهر بن يلون

كيف شرحت الاسلام للأطفال (٢)

الحادي عشر من سبتمبر شرحت للأطفال

(خلاصة البحث)

اليوم السادس

اليوم سوف اتحدث اليكم يا اطفالى عن وجود المسلمين بالاندلس في الجنوب الاسباني. المؤرخون يقولون بان العرب عند قدومهم إلى الاندلس قد استغربوا بالفقر الثقافي الذي وجدوه هناك بالرغم من التقدم الذي كانت تتسم به الامبراطورية الرومانية. و قد كتب أحد المؤرخين الذي قال: لم يكن هناك شئ يذكر. المهاجرون الذين قدموا في مجموعات متتالية من سوريا و بقية المناطق العربية وجدوا شعبا لا يستطيع أن يقدم اليهم اى شئ. لم يكن هنالك اى شئ يمكن ان يؤثر لدى المهاجرين الجدد في الوقت الذي تحول فيه البغداد و القرطبة إلى مراكز ثقافية للعالم الاسلامى الخليفة عبد الرحمن الثالث سوف يصبح ملكا على اسبانيا لمدة نصف قرن.

*Dr. Tonin Gjuraj**

DEMOKRACIA ISLAME DHE POLEMIKAT RRETH SAJ

Hyrje

Shumë përpjekje janë bërë për të krahasuar sistemet demokratike të vendeve Përendimore me vendet në zhvillim. Analistë të ndryshëm politikë janë përpjekur të kategorizojnë sistemet politike të vendeve në zhvillim në sisteme gjysmë demokratike ose jodemokratike, sipas shkallës së zhvillimit të sistemeve politike. Në këtë proces, vendet e Lindjes së Mesme shpesh janë përjashtuar nga studimet krahasuese të vendeve të tjera. Duket që shumica e studiuesve kanë pranuar në mënyrë shumë të qartë diferencën kulturore ndërmjet Lindjes së Mesme dhe kontinenteve të tjera, sidomos të Përendimit. Diferenca kulturore u atribuohet në mënyrë të konsiderueshme diferencave fetare.

Kohët e fundit është shkruar shumë rreth Islamit dhe demokracisë, ose Islamit dhe shoqërisë civile. Kur hedh vështrimin në këto çështje del, qartë se debatet më polemizuese përfshijnë faktin nëse Islami ose kultura islame përputhet ose jo me demokracinë. Në këtë polemikë ekziston një trajtim paradigmatic, i cili përpiket të kuptojë proceset e demokratizimit mbi bazën e një supozimi të tillë që kapitalizmi nxit liberalizmin, i cili pastaj eventualisht prodhon demokraci. Ky trajtim

kërkon të shpjegojë demokratizimin e vendeve islamike (jo të gjitha) nga aspektet e një panorame të idealizuar të demokracisë dhe në atë çfarë ajo konsiston. Samuel Huntington (1996) përdorë kulturën si variabël kryesor dhe koncepti i tij i “përplasjes së qytetërimeve” është një nga shembujt më të mirë, i cili jep një shpjegim normativ të demokratizimit. Sipas tij, duket që qytetërimi islamik nuk do të përputhet me demokracinë liberale përendimore. (shih: Samuel Huntington 1996: 22-49). Kjo tezë, pra që shoqëritë e Lindjes së Mesme, bazuar në Islam, janë rezistente ndaj demokratizimit, është mjaft e përhapur në ditët tona. Pengesat kryesore në procesin e demokratizimit i atribuohen Islamit dhe rrymës islamiste. Megjithatë, në epokën e institucioneve dhe perspektivave postmoderne, dy çështjet më të rëndësishme në kohën e sotme: ringjallja fetare dhe zhvillimet politike përbëjnë burimet bazë potenciale për impulse demokratike brenda traditës së vetë Islamit. Kjo ese nuk do të argumentojë vetëm faktin se vetë Islami përkrah demokratizimin e shoqërisë, por edhe se simbolet e demokracisë krahas atyre të Islamit janë përdorur madje edhe nga fundamentalistët e ndryshëm në mënyrë që të justifikojnë marrjen dhe konsolidimin e pushtetit.

Duke u ndaluar në analizën e marrëdhënieve midis Islamit dhe demokracisë, menjëherë mund të vihen re dy paradigma: Islami kundër modernizimit dhe demokracisë, ose teo-demokracia islamike kundër demokracisë përendimore. Eseja ka për qëllim të kritikojë të dyja këto paradigma. Gjithashtu ajo do të zhvillojë një konceptim të demokracisë brenda burimeve të traditës Islame. Kjo do të kryejë dy funksione: jo vetëm do të ofrojë një kornizë për të kritikuar argumentet teo-demokratike, por më e rëndësishmja është se do të bëjë përpjekje të tregojë mbështetjen e Islamit për një qeveri demokratike.

Teo-demokracia

Termi teo-demokraci u shpik nga Abul Ala Mawdudi, një mendimtar i rëndësishëm mysliman (i traditës Sunni). Sipas tij:

“një emër më i përshtatshëm për politikën Islame do të ishte mbretëria e Zotit, e cila përcaktohet në anglisht si teokraci. Por teokracia islame është diçka krejt e ndryshme nga e para. Teokracia islame

është diçka krejt e ndryshme nga teokracia prej së cilës Evropa ka pasur një eksperiencë të hidhur. Nëse do të më lejojnë të shpikja një term të ri, do ta përkufizojë këtë sistem qeverisjeje si teo-demokraci, domethënë një qeveri demokratike hyjnore, sepse nën të myslimanit i është dhënë një sovranitet i kufizuar popullor nën ligjin e Zotit. (në: John L. Esposito and John O. Voll 1996: 24).¹

Mawdudi vëren se në këtë sistem, çdo myslimani që është i aftë dhe i kualifikuar të japë një opinion të shëndoshë mbi çështjet e Ligjit islamik, i jepet e drejta ta interpretojë ligjin e Zotit, kur një gjë e tillë bëhet e nevojshme. Është teokraci në kuptimin se asnjë, as edhe i gjithë komuniteti mysliman i bashkuar, nuk ka të drejtë të ndryshojë një urdhër të shprehur qartë të Zotit. Në ligjin Islamik, fakih-ut (juristi/gjykatësi ose dijetari legal islamik) dhe muxhtahid-it (interpret/jurist) u jepet e drejta e pushtetit, pra e autoritetit legal racional. Kështu, si minimum kërkohet që personi të jetë muxhtahid para se të angazhohet në politikë. Pastaj bëhet fjalë për demokraci, sepse çdo mysliman është i aftë të bëhet jurist. Në këtë pikëpamje nuk ekziston një klasë klerikale e paracaktuar.

Një qeveri e organizuar në këto vija të përgjithshme është Republika e Iranit, e cila është Shi'i në specifikat e saj të Sheriatit islamik, por e ngjashme me traditën konservatore Sunni në pikëpamjet e saj, që kanë të bëjnë me organizimin e një politike islamike. Homeini shihet qartë si arkitekti i parë i sistemit politik iranian. Sipas kësaj tradite, shembull i së cilës është Homeini, shoqëria myslimane duhet të udhëhiqet nga Ligji islamik (Sheriati), juristët (fukahenjtë) dhe muxhtahidët e këtij ligji. Në lidhje me të, Homeini ka shkruar:

“Ne nuk themi se qeveria duhet të jetë në duart e fakihut, por më tepër themi se qeveria duhet të drejtohet në përputhje me ligjin e Zotit, sepse këtë kërkon mirëqenia e vendit dhe vetë njerëzit, e kjo nuk është e mundur pa mbikëqyrjen e udhëheqësve fetarë.” (në: John L. Esposito and John O. Voll 1996 :62).

Homeini gjithashtu argumentonte se ishte një fakt i njohur që fakihu kishte autoritet mbi sundimtarin. Në një rast të tillë, sundimtarët e vërtetë janë vetë fukahenjtë (shumësi i fakih) dhe sundimi duhet të jetë i tyre, në mënyrë që t'u drejtohem atyre dhe jo njerëzve të detyruar të ndjekin udhërrëfimin e fukahenjve për shkak të mosnjohjes së

ligjit nga ana e tyre. Si ekspertë të Sheriatit, argumentonte Homeini, fukahenjtë ishin më të përgatitur për të siguruar një qeverisje sipas Ligjit islamik. Ai pohonte se vigjilenca ose udhëheqja nga juristi, është e ngjashme me atë të ushtruar nga Profeti Muhamet. Juristi ka të njëjtin autoritet për të qeverisur dhe administruar punët e shtetit, megjithëse jo me të njëjtin status si Profeti. Një qeverisje e tillë mund të ushtrohet nga një grup juristësh, madje edhe nga një individ i veçantë. Versioni i fundit i kushtetutës, ratifikuar në nëntor 1979, u bazua në konceptin e Homeini-t të vilayat-i-fakih (sovranitet i juristit). Kështu, ajo vendosi autoritetin përfundimtar të klerikëve në menaxhimin dhe udhëheqjen e shtetit.

Parimi i qeverisjes së juristit (vilayat-i-fakih) dhe mbizotërimi i Ligjit islamik (për rrjedhojë i sovranitetit hyjnor) u shenjtëruan në Kushtetutën iraniane. Fakihu ndihmohej nga një Këshill gardianësh prej 12 anëtarësh, i përbërë nga juristë islamikë, gjashtë të emëruar nga Homeini dhe gjashtë nga Parlamenti (Asambleja Konsultative Kombëtare, ose majlis-i-shura). Ata shërbenin për të interpretuar kushtetutën dhe për të siguruar që i gjithë legjislati i të përputhej me Ligjin islamik dhe Kushtetutën. Hapësira e saj reflektohej në nenin 96 të Kushtetutës iraniane, i cili deklaronte se Këshilli i gardianëve kishte fuqinë e vetos (të drejtën e vetos) mbi të gjitha ligjet e miratuara nga parlamenti, që i gjykonte si joislamike. Gjithashtu u krijua një Këshill Juridik Suprem i dominuar nga muxhtahid-et (juristët islamikë). Sipas kushtetutës, fakihu vishej me autoritetin final si udhëheqësi suprem fetaro-politik i shtetit. Ai është interpretuesi i fundit i Ligjit islamik. Ai emëron Këshillin e gardianëve dhe krerët e gjyqësorit, të ushtrisë, si dhe ushtarët revolucionarë (revolutionary soldiers). Ai shërben për të kontrolluar presidentin, kryeministrin dhe parlamentin.

Ky sistem, mendoj unë, është një teokraci apo diktaturë e qartë. Të argumentosh se kushdo që njeh Ligjin islamik, mund të marrë pjesë në politikë, është njësoj si të argumentosh se dikush ka nevojë vetëm të ndjekë Fakultetin e Shkencave Politike, për shembull, në Oksford (Oxford) ose Kembrixh (Cambridge) për të hyrë në sferën e politikës. Një sistem i tillë nuk lë shteg për pluralitet apo diversitet, pasi një grup ekspertësh vendosin se kush mund të bëhet i tillë. Ky sistem arrin të përçajë vullnetin popullor përmes retorikës së Ligjit islamik.

Gjithashtu ai dështon në pesë fushat që merren si kritere të një demokracie të konsoliduar të elaboruara nga Juan Linz dhe Alfred Stepan: shoqëria civile, shoqëria politike bazuar në zgjedhjet e lira, sundimi i ligjit (konstitucionalizmi), aparati shtetëror me norma burokratike racionale legale dhe shoqëria ekonomike me treg të institucionalizuar. (Shih Juan Linz & Alfred Stepan 1996: 14). Nën rrethana të tilla, është e pamundur që të ekzistojnë kushtet për zhvillimin e një shoqërie të gjallë civile e të lirë. Më tej, do të ishte mjaft e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të krijohet një shoqëri politike relativisht autonome dhe e vlefshme.

Islami kundër Modernizimit dhe Demokracisë: Shekullarizimi Qemalist

Në kohën e sotme supozohet se modernizmi është i dëshiruar dhe i nevojshëm dhe se kultura Islame nuk përputhet me të, kështu që ajo duhet të braktiset, ose të hidhet poshtë. Sipas teorisë së modernizimit, shoqëritë në tërësi duhet të përendimorizohen plotësisht, në mënyrë që të modernizohen me sukses. Modernizimi dhe përendimorizimi përforcojnë njëri-tjetrin dhe duhet të ecin së bashku. Drejtimi i zhvillimit dhe progresit është unilinear dhe në këtë proces, gjithnjë sipas kësaj teorie, Islami nuk ofron një rrugë alternative për modernizim. Për rrjedhojë, shekullarizimi nuk mund të evitohet. Shkenca dhe teknologjia moderne kërkojnë një absorbim të procesit të të menduarit që i shoqëron vazhdimisht ato dhe e njëjta gjë ndodh edhe me institucionet politike. Siç nënvizon Daniel Pipes:

“Meqenëse përmbajtja duhet të lartësohet jo më pak se forma, mbizotërimi i qytetërimit përendimor duhet të njihet në mënyrë që të mësojmë prej tij. Gjuhët evropiane dhe institucionet arsimore përendimore nuk mund të shmangen edhe n.q.s. këto të fundit inkurajojnë mendim të lirë dhe jetesë të lehtë.” (në: Samuel Huntington 1996: 73/74).²

Kjo traditë mishërohet nga Mustafa Qemal Ataturku. Ai krijoi një Turqi të re nga rrënojat e Perandorisë Osmane dhe ndërmori një përpjekje masive për ta përendimorizuar dhe modernizuar shoqërinë turke. Me t’ia hyrë kësaj pune dhe duke mohuar të kaluarën islamike,

Ataturku e ktheu Turqinë në një shoqëri që ishte myslimane në fe, trashëgimi, zakone dhe institucione, por me një elitë sunduese të vendosur për ta bërë atë moderne, përendimore dhe një me Përendimin. Mohammed Reza Shah (1941-1979) i Iranit përbën një tjetër shembull të mirë.

Ka një sërë problemesh në lidhje me këtë traditë. Para së gjithash, sa demokratik mund të jetë një shtet nëse ai shtyp vlerat dhe normat e shoqërisë? Turqia moderne është një shembull konkret. Ushtria turke e detyroi Erbakanin, udhëheqës i Partisë së Mirëqenies, të jepte dorëheqjen nga frika e islamizimit. Më pas, gjykata e kontrolluar nga ushtria larguan zyrtarisht Erbakanin dhe partinë e tij nga politika. Si rezultat, as shoqëria politike nuk është relativisht autonome, as ajo civile nuk është shumë e lirë, nëse nuk lejon të drejtën e shprehjes. Megjithatë, rreziku më i madh në këtë rrugë jepet nga shembulli i Iranit. Politika ekstremiste bëhet më e mundshme kur feja shtypet dhe injorohet. Nën këto rrethana, mendoj unë, Turqia duhet të jetë e gatshme dhe të forcohet më tej për një reagim të fuqishëm dhe radikal, i cili është i mundshëm në të ardhmen.

Ky konceptim vuan gjithashtu nga defektet e brendshme të bazës shekulare të teorisë së modernizimit. Specializimi ekonomik, sipas teorisë së modernizimit, çon tek institucionalizimi politik. Zëvendësimi i elitës tradicionale (bazuar kryesisht tek toka si pasuri) me klasën e mesme të qytetit çon në shfaqjen e strukturave të centralizuara tregtare, burokratike dhe arsimore. Sipas këtij formulimi të teorisë së modernizimit, dyshimi dhe bestytia zbehen, ndërkaq edhe feja sprapset nga roli i saj në jetën publike. Liderhipi fetar shihet si rezistent ndaj ndryshimit. Ndërsa rregulli qytetar shekullarizohet, sjellja racionale bëhet normë dhe kjo çon në një pjesëmarrje më të madhe politike, ose të paktën në stabilitet politik.

Vështirësia esenciale e teorisë së modernizimit shtrihet në kontrastin e mprehtë mes dy konstrukteve artificiale, modernitetit dhe traditës, si dhe keqkuptimi pastaj i funksioneve të fiksuara sociale të traditës. Sipas C. E. Black:

“nëse dikush e mendon modernizimin si integrim ose riintegrim të shoqërive mbi bazën e parimeve të reja, duhet gjithashtu që ta

mendojë atë si përfshirje e dezintegrimit të shoqërive tradicionale.” (në: James Piscatori & Dale F. Eickelman 1996: 24).³

Modernizimi shihet pra si një zgjerim i lirive njerëzore dhe lartësim të mundësive për zgjedhje, ndërkohë që njerëzit fillojnë të marrin përgjegjësi për veten e tyre. Tradita, pra, zhvlerësohet kur nënkuptohen vlera të kundërta. Ajo gjithashtu shihet aq armiqësore ndaj modernizimit, sa që zëvendësimi i saj shpesh i hap rrugë dhunës dhe paqëndrueshmërisë politike.

Megjithatë, tradita nuk duhet të interpretohet në terma negative. Familja tradicionale dhe rrjeti fetar munden në fakt të lehtësojnë zhvillimin dhe se ndryshimet sociale dhe politike shpesh bëhen të mundshme, sepse ata shkrihen në kornizën tradicionale. Sipas Siu-Lun Wong: “Familizmi promovues” dhe nepotizmi, për shembull, kanë kontribuar në suksesin ekonomik të Hong Kongut” (në: James Piscatori & Dale F. Eickelman 1996: 25).⁴

Pra, duke mbrojtur idenë se gjoja Islami nuk ndihmon procesin e modernizimit, do të thotë se në përpjekje për të ngritur pretendim se ndryshimet janë islamike, nënkuptohet fakti se ata janë legjitime dhe të pranueshme. Duke mbrojtur ndryshimet në përputhje me thelbin e Islamit, reformatoret mund ta zbusin kritikën se këto ndryshime janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë. Po ashtu, duke mundësuar reforma përkundrejt përgjegjësisë fundamentale të myslimanëve për t’iu bindur Zotit dhe atyre që zotërojnë pushtet legjitim, siç nënvizohet në Kur’an, mund të përforcohet besimi se proceset dhe rregullimet rinovuese janë të detyrueshme për shoqëritë e tyre.

Demokracia Islame

Në historinë islamike ka një numër konceptesh dhe imazhesh shumë të rëndësishme që formësojnë vizionet bashkëkohore se si duhet të jetë një shoqëri e drejtë njerëzore. Kjo mund të shërbejë si bazë për një përceptim islamik të demokracisë, nëse ajo mund ose duhet të jetë një demokraci islamike shekullare, apo një demokraci islamike bazuar në ligjin e Sheriatit.

Pavarësisht nga dinamizmi dhe diversiteti i madh midis myslimanëve të sotëm përsa u përket pikëpamjeve politike, ekzistojnë koncepte

te thelbësore rreth pozicioneve politike pothuajse për të gjithë ata. Është bërë e qartë se sistemi politik i Islamit është i bazuar në pesë parime: Tawhid (Uniteti i Zotit), Khilafa (Halifati), Shura (konsultimi/këshillimi), Ixhma (konsensusi), dhe Ixhtihad (gjykimi i pavarur interpretiv).⁵ Këto parime janë një pikënisje e rëndësishme për konceptimin e demokracisë islame. Udhëheqës të tjerë myslimanë mund t’i shprehin këto çështje brenda një formati tjetër, por këto koncepte thelbësore përbëjnë një bazë për kuptimin e perspektivave politike islame. Konsiderimi i rikonceptimit të tyre në kontekstin bashkëkohor jep një bazament të rëndësishëm për të kuptuar bazat konceptuale për demokratizimin në Botën Islame.

Myslimanët e të gjitha traditave janë të një mendjeje se pranimi i Tawhidit është koncepti thelbësor i besimit islam, i traditës dhe praktikës. Megjithëse mund të shprehet në shumë mënyra të ndryshme, i përkufizuar thjeshtë tawhid, do të thotë “bindja dhe dëshmia se nuk ka asnjë Zot tjetër përveç Allah-ut”. Për rrjedhojë, në thelb të eksperiencës fetare islame qëndron Zoti, i cili është unik dhe vullneti i Tij është obligim dhe udhëzues për të gjitha qeniet. Duke u nisur nga kjo bazë, në gjuhën e filozofisë politike, myslimanët pohojnë se ekziston vetëm një sovran dhe ky është Zoti.

Si vëzhguesit jomyslimanë, ashtu dhe disa vëzhgues konservatorë myslimanë kanë argumentuar se tawhid domosdoshmerisht i jep fund mundësive për një demokraci islame, sepse koncepti i sovranitetit të njerëzve konfliktin me sovranitetin e Zotit. Në dukje ai mohon plotësisht filozofinë e sovranitetit të popullit dhe ngre një politikë mbi themelet e sovranitetit të Zotit. Por, kjo nuk do të thotë se një mysliman domosdoshmerisht duhet të hedh poshtë idenë e një sistemi politik demokratik. Ky pozicion vetëm ka nevojë të skicohet brenda botë-kuptimit të tawhidit. Mund ta quajmë politiken islame si një qeveri demokratike hyjnore, ku komunitetit mysliman i jepet sovranitet popullor nën udhëheqjen e Zotit. Ekzekutivi nën këtë sistem qeverisjeje konstituohet nga vullneti i përgjithshëm i myslimanëve, të cilët kanë edhe të drejtë ta rrëzojnë atë. Në këtë sistem, çdo mysliman është i kualifikuar të zgjedhë përfaqësuesin e vet përmes votës, ose ai apo ajo mund të konkurrojë vetë për këtë post.

Një kontrast i mirë me këtë vëzhgim, siç është nënvizuar më parë, është rasti i shtetit teo-demokratik parashikuar nga përkrahësit e Republikës së Iranit. Njëri prej teoricienëve kryesorë politikë të traditës shi'í në kohën e revolucionit iranian, Ayatollah Baqir al-sadr (i cili u ekzekutua nga Qeveria Irakene më 1980) argumentonte se çdo mysliman që është i aftë dhe i kualifikuar të japë një opinion të shëndoshë mbi çështje të Ligjit islamik, i jepet e drejta të interpretojë ligjin e Zotit, kur një gjë e tillë bëhet e nevojshme. Gjithashtu, në këtë strukturë gjendet një jurist islamik, i cili mban pozicionin e një autoriteti fetar përfundimtar dhe formalisht është deputet i përgjithshëm i Imamit (lider mesianik i përzgjedhur hyjnisht në teologjinë shi'í), pozicion ky i mbajtur nga Ayatollah Homeini pas revolucionit iranian të 1979-s. Në këtë sistem, ky jurist duhet të ketë mbështetjen e shumicës së anëtarëve të këshillit konsultativ të autoritetit fetar. Në rastin kur ka më tepër se një person që i përshtatet pozicionit të autoritetit fetar, njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin njerin prej tyre përmes referendumit.

Ashtu siç kam argumentuar më parë, ky është një konceptim i gabuar i një shteti të vërtetë demokratik islamik. Ky formalizim mund të sfidohet me anë të botëkuptimit të tawhidit. Sovraniteti absolut i Zotit e bën çdo hierarki permanente fetare jolegjitime, derisa para Zotit janë të gjithë të barabartë. Kështu, tawhidi jep bazën konceptuale dhe teologjike për të vënë theksin e barazisë brenda sistemit politik. Një sistem hierarkik diktatorial, si ai i vendosur nga qeveria iraniane, mund të dënohet si joislamik. Më sa duket, vetëm një shtet demokratik mund të përballojë provën e dhënë nga koncepti i tawhidit.

Një koncept i dytë i rëndësishëm është khilafa. Në studimin e mendimit politik islamik, ky koncept është lidhur fillimisht me çështjen e përcaktimit të lidershit politik për komunitetin. Titulli i udhëheqësit të komunitetit mysliman pas vdekjes së Profetit Muhamet, ishte kalif (khalifa). Sistemi i përgjithshëm politik quhet khilafah me termin kalif (khalifa) që do të thotë “pasues i Profetit”. Teoritë e kalifatit janë një pjesë e rëndësishme e historisë intelektuale të Botës Islame. Dokumentohet se sistemi politik i drejtuar nga një kalif ka zgjatur për shumë kohë. Në debatet tradicionale dhe moderne mbi natyrën e kalifatit, institucioni është shikuar në terma esencialisht monarkike. Megjithatë,

të, ka një kuptim thellësisht të ndryshëm të këtij termi, të cilit i është kushtuar një vëmendje më e madhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit 20. Përveç konotacioneve të pasuesit që përfshin termi arabik halifa, ka edhe një kuptim tjetër si deputet, përfaqësues, ose agjent. Është e mundur të interpretohet një pjesë e Kur'an-it që identifikon qeniet njerëzore në përgjithësi si agjentë të Zotit (khalifatë) në tokë dhe sundimin njerëzor mbi krijesën e Zotit si kuptim më të gjerë të khilafatit.

Koncepti i khilafatit, i përcaktuar në këtë mënyrë mund të përdoret si bazë për demokraci në Islam. Si implikime specifike të sistemit politik është që autoriteti i kalifatit vihet mbi të gjithë grupin e njerëzve, komunitetin në përgjithësi, i cili është i gatshëm të plotësojë kushtet e përfaqësimit. Një shoqëri e tillë mbart përgjegjësinë e kalifatit si i tërë dhe secili prej individëve ndan Kalifatin Hyjnor (the Divine Caliphate). Kjo është pika ku demokracia fillon në Islam. Çdo person në një shoqëri islamike gëzon të drejtat dhe fuqitë e kalifatit të Zotit dhe në këtë aspekt të gjithë individët janë të barabartë. Ia vlen të shënohet se identifikimi i kalifit me humanitetin në tërësi, më shumë se sa me një sundimtar të vetëm ose një institucion politik, pohohet në Deklaratën Universale Islamike të të Drejtave të Njeriut, një dokument i krijuar nga Këshilli Islamik i Evropës.

Në paraqitjen e demokracisë brenda një kornize të gjerë konceptuale islamike, mjaft vëmendje u kushtohet disa aspekteve specifike të veprimit social dhe politik. Në veçanti, demokracia islame shihet si afirmim i koncepteve të qëndrueshme islamike të konsultimit (Shura), konsensusit (Ikhma) dhe gjykimit të pavarur interpretiv (Ixhtihad). Si shumë koncepte në traditën politike përendimore, këta terma nuk janë identifikuar gjithnjë me institucionet demokratike, por kanë një varietet përdorimesh në diskursin bashkëkohor mysliman. Megjithatë, pavarësisht nga kontekstet dhe përdorimet e tjera, këta terma janë thelbësorë ndaj debateve dhe diskutimeve që kanë të bëjnë me demokratizimin në shoqëritë myslimane. Domosdoshmëria e konsultimit është një konsekuencë politike e parimit të kalifatit të qenieve njerëzore. Agjencia popullore në një shtet islamik reflektohet veçanërisht në doktrinën e konsultimit reciprok. Meqenëse të gjithë myslimanët e rritur dhe normalë (mendërisht) janë agjentë të Zotit, janë pikërisht ata

që delegojnë autoritetin e tyre ndaj sundimtarit, opinioni i të cilëve duhet gjithashtu të kërkohet në sjelljen e shtetit. Kuptimi kuranik i Shura-ut nuk do të thotë që një person u kërkon të tjerëve këshilla, por më tepër flet për këshilla reciproke përmes diskutimeve reciproke me të drejta të barabarta. Prandaj, Shura-u bëhet një element kyç operacional në marrëdhëniet mes Islamit dhe demokracisë.

Një koncept i ngjashëm dhe i rëndësishëm operacional është konsensusi ose Ixhma. Baza për vlefshmërinë e konsensusit, ose gjykimit kolektiv të komunitetit, është një traditë shpesh e përmendur, të cilën profeti Muhamet e nënvizon në fjalinë: “Komuniteti im nuk do të bjerë dakord me gabimin”. Megjithatë, për pjesën më të madhe të historisë islamike, konsensusi i njerëzve të ditur (dijetarëve) dhe konsensusi i përgjithshëm popullor kishin më pak rëndësi në aspektet specifike dhe operationale të jetës së komunitetit mysliman. Kjo gjithashtu tentoi të ishte një forcë konservatore, sepse një konsensus mbi një subjekt tentoi të çonte në fundin e spekulimeve në atë fushë. Nëse i afrojmë përsëri Ixhma-në komunitetit, kjo do të forcojë lidhjen midis Islamit dhe demokracisë.

Një koncept i tretë operacional i një rëndësie kryesore është Ixhtihadi, ose ushtrimi i gjykimit të pavarur e të informuar. Në mendjet e shumë mendimtarëve myslimanë, ky është çelësi për implementimin e vullnetit të Zotit në një periudhë apo vend të caktuar. Me terma specifike politike, reformatori intelektual mysliman nga Azia Jugore Muhammad Iqbal, kishte shënuar aty rreth vitit 1930 marrëdhëniet ndërmjet konsensusit, demokratizimit dhe Ixhtihadit:

“Rritja e shpirtit republikan dhe formimi gradual i asambleve legislative në tokat myslimane përbën një hap të madh përpara. Transferimi i pushtetit të Ixhtihad-it nga përfaqësuesit individualë të shkollave tek një asamble legislative myslimane, e cila nga pikëpamja e rritjes së sekteve kundërshtarë, ishte forma e vetme që mund të merrte Ixhma në kohët moderne, do të siguronte ndihmesë në diskutimet ligjore nga lajmenët, të cilët ndodh të zotërojnë një aftësi të mprehtë për të kuptuar këto çështje. Vetëm në këtë mënyrë mund të vëmë në lëvizje shpirtin e fjetur të jetës në sistemin tonë legal.” (në: John L. Esposito & John O. Voll 1996: 29)

Konkluzione

Opinione dhe mendime nga më të ndryshmet që kanë ardhur kryesisht nga Përendimi, të cilat barazojnë Islamin me terrorizmin dhe dhunën, kanë shkaktuar me të drejtë reagime dhe kritika nga ana tjetër. Ndërsa studiues të tjerë e paraqesin Islamin si rrezik gjeografik. Pra, vërehet një tendencë për të barazuar violencën me Islamin. Në fakt, ekstremizmi fetar mbetet një rrezik, por nuk mund të kufizohet vetëm në një fe. Spektri i sulmeve të terroristëve, motivuar nga bindjet etnike, fetare ose ideologjike është real. Frika e rritjes së rrezikut islam bëhet më e evidente në rast kundërpërgjigjeje ndaj ngjarjeve politike dhe veprimeve shtetërore. Është e domosdoshme që të evitojmë një përgjigje, e cila projektonte një rrezik të vetëm, por të dallojmë në mes besimeve dhe aktiviteteve të shumicës, qofshin ato myslimane, kristiane, çifute, budiste, konfucioniste, hinduiste apo një minoritet ekstremistësh që justifikojnë agresionin dhe violencën në emër të fesë, etnicitetit dhe ideologjise politike. Pas vitit 1990, vakuumi i krijuar nga mbarimi i Luftës së Ftohtë nuk arriti të mbushej si rrjedhojë e ekzistencës së një lloji frike të ekzagjeruar të Islamit, i cili dukej se po rritej çdo ditë dhe që ishte në luftë me rendin e ri botëror. Me fjalë të tjera, ngjarjet e ndryshme në Algjeri, Egjipt, Lindjen e Mesme, vende të tjera arabe ose aktet terroriste në disa vende të Evropës, paraqiteshin si një sfidë ndaj stabilitetit global. Do të ishte më mirë dhe më drejt, sipas meje, të shikonim ringjalljen islamike si rrugë drejt një profili më të lartë në shoqërinë dhe politikën myslimane, pra si realitet politik dhe shoqëror. Shumëllojshmëria e grupeve dhe eksperiencave aktiviste islamike është një dëshmi e fleksibilitetit të Islamit dhe Islamit politik në veçanti. Politika Islame lypset të shikohet brenda kontekstit të një vendi specifik, i cili manifeston një diversitet udhëheqësish dhe formash. Në përgjithësi ideologjitë islamike, do të shprehej John Esposito (1995), ofrojnë një kornizë për kuptimin dhe qëllimin që u përgjigjet çështjeve të identitetit, besimit dhe autenticitetit. Përpjekjet për demokraci dhe rend demokratik shfaqen edhe në këto vende në forma, alternativa dhe korniza të ndryshme. Në këtë

kontekst, mund të dallohen tre lloje të ndryshme të demokracive islamike: demokraci islamike shekullare, demokraci islamike bazuar në Sheriat dhe demokraci islamike, bazuar vetëm në një inkorporim të pjesshëm të Sheriatit. Një diskutim i meritave dhe dobësive të secilës prej tyre do të përbënte një ese në vete. Por gjëja më e rëndësishme është se secila prej këtyre kornizave do të jepte një mësim të rëndësishëm rreth politikës islame. Siç vë në dukje James Piscatori, kjo politikë përfshin:

“konkurrencën dhe ndeshjen për interpretimin e simboleve dhe kontrollin zyrtar dhe jozyrtar të institucioneve që i prodhojnë dhe i mbështetin ato”. (James Piscatori & Dale F. Eickelman 1996: 5)

Interpretimi i simboleve, ndërsa u nënshtrohet nuancave kontekstuale, është gjë e zakonshme për myslimanët në të gjithë botën. Duhet të shënohet se konsideratat doktrinale gjithnjë në zhvillim janë vetëm një fakt në mes shumë të tjerëve që kontribuojnë në krijimin e kësaj kornize. Një sistem politik qoftë në Botën Islame apo kudo tjetër, në menyrë të pashmangshme përfshin menaxhimin e interesave konkurrues, madje dhe përplasës. Në një aspekt më të gjerë, politika në kontekstin bashkëkohor islamik duhet të konceptohet si konkurrencë dhe luftë mbi kuptimin e simboleve dhe kontrollin e institucioneve që përcaktojnë dhe artikulojnë vlera shoqërore. Për Immanuel Wallerstein: “.....pushteti qëndron jo vetëm në zotërimin e burimeve ekonomike, por edhe në kontrollin e institucioneve kulturore”. (në: James Piscatori & Dale F. Eickelman 1996: 9).⁶

Duke konsideruar çështjet polemizuese të mësipërme dhe të tjera supozime që nuk preken në këtë ese, duket që përpjekjet për të parqitur vetë Islamin si pengesë ndaj demokratizimit, janë jokorrekte dhe jobindëse. Islami vetë nuk është pengesë për demokratizim. Problemi real i demokratizimit të vendeve islamike mund të gjendet në manipulimin e Islamit prej shtetit, pra në përdorimin që i bën shteti Islamit dhe kulturës islamike në përpjekjet e tij për të zgjeruar kontrollin mbi shoqërinë.

* Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Buletini Shkencor i Universitetit
-Seria e Shkencave Shoqërore

Shënime

1. Idetë e Abul Ala Mawdudi-t trajtohen gjerësisht në “Political Theory of Islam” në: John J. Donohue & John L. Esposito, eds., Islam in Transition: Muslim Perspectives (New York: Oxford University Press 1982).
2. Për një panoramë më të plotë të kontributit të Daniel Pipes lexo: In the Path of God: Islam and Political Power (New York: Basic Books), 1983: 105-142.
3. Problemet polemizuese të modernizimit dhe traditës preken nga C. E. Black në: The Dynamics of Modernization: A Study in Comparative History, New York: Harper & Roë, 1996.
4. Për më gjerë shih: Siu-Lun Wong Emigrant Entrepreneurs: Shanghai Industrialists in Hong Kong. Hong Kong: Oxford University Press, 1988: 170-171.
5. Termat janë marrë nga ekspertet e njohur të demokracisë islame James Piscatori dhe Dale F. Eickelman në Muslim Politics tek Glossary pp. 175-177. Princeton University Press Princeton, New Jersey 1996.
6. Shih Immanuel Wallerstein “Crises: The World Economy, The Movements and the Ideologies.” në: Crises in the World-System, edited by Albert Bergesen, Beverly Hills: Sage Publications 1983: 21-36.

BIBLIOGRAFIA

1. Esposito, John L., The Islamic Threat Myth or Reality? New York Oxford University Press (Ribotim), 1995.
2. Esposito, John L. & Voll, John O., Islam and Democracy in the Muslim World (New York: Oxford University Press, 1996).
3. Huntington, Samuel P., The Clash of Civilisations and the Remaking of World Order Simon & Schuster, 1996.
4. Linz, Juan H. & Stepan, Alfred, Problems of Democratic Transition and Consolidation Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe The Johns Hopkins University Press Baltimore and London, 1996.
5. Piscatori, James & Eickelman, Dale F., Muslim Politics Princeton University Press Princeton, New Jersey, 1996.

Dr. Tonin Gjura

ISLAMIC DEMOCRACY AND THE VIEWS ABOUT IT

(Summary)

In the last decade, critical issues about the compatibility of Islam and Democracy have been the focus of many studies both in the contemporary Muslim World and the West. Aspirations of Islamization and Democracy set the framework for most of the problems covered in this essay. In attempting to anchor our analysis to the relationship between Islam and Democracy, the paper notices two paradigms: Islam versus Modernization and Democracy, or Islamic Theo-Democracy versus Western Democracy. It also criticizes both of these paradigms but, at the same time, develops a conceptualization of democracy within the resources of the Islamic tradition.

First, the paper offers a critical attitude toward theo-democracy arguments maintaining that this system allows no plurality or diversity to come into existence in the Muslim World; then, it briefly covers the Kemalist Secularism as an attempt to avoid the paradigm: Islam versus Modernization and Democracy; next, a relatively broad interpretation is devoted to important concepts and images that shape the contemporary vision of what a just human society should be. Here, it is argued that the five principles of Tawhid (Unity of God), Khilafa (Caliphate), Shura (Consultation), Ijma (Consensus), and Ijtihad (Independent Interpretive Judgement) become key operational elements in the relationship between Islam and Democracy. Finally, we present some general considerations about Islamic Democracy and advance the conclusion that it is not Islam itself which is an obstacle to democratization, but its manipulation by the state in its attempts to put control over society.

تونين جوراي

ديموقراطية الاسلام و الخلافات حولها

(خلاصة البحث)

كتب كثيرا في الآونة الأخيرة حول الاسلام و الديموقراطية أو الاسلام و المجتمع المدني. و اذا امعنا النظر في هذه الامور سوف يتضح لنا أن الخلاف الجارى هو هل الاسلام او الثقافة الاسلامية تتفق ام لا مع الديموقراطية. في هذا الخلاف يكمن الراى القائل بان الراسمالية تشجع التحرر و من ثم الديموقراطية. و هذا الراى يطلب أن يشرح كنفية نفاذ الديموقراطية إلى البلاد الاسلامية.

INTEGRIME

Akademik Jashar Rexhepagiq

PËRPARËSITË, FUSHAT E VEPRIMIT DHE KUFIJTË E NDIKIMIT TË PROCESVE INTEGRATIVE NË RAJONIN E SANXHAKUT DHE NË TERRITORIN E KOSOVËS

1.

Janë disa çështje qenësore nga kjo fushë që imponohen vetvetiu, nga të cilat, veçohen: *e para*, mbi përparësinë e proceseve integrative në territorin e Kosovës e të Sanxhakut, *e dyta*, mbi fushat në të cilat integrimi është më krijimtar, dhe *e treta*, çështja e kufizimit të proceseve integrative.

Këto janë, pa dyshim, çështje më të rëndësishme, domethënëse edhe për orientimin e asociacioneve shoqërore, etnike dhe kulturore në mjediset e përmendura, por edhe në hapësira më të gjera.

Në literaturë dhe në disa shkenca janë në përdorim terma të shumta, si: *integrimi*, *proceset integrative*, *integrimi ekonomik*, *integrimet etnike dhe integrimet ndërkombëtare*, *rajonale*, *shpirtërore* dhe zërat e tjerë, me të cilët merren në radhë të parë shkencëtarët dhe ekspertët e shkencave ekonomike. Aspekti ekonomik ka vlerë të veçantë edhe për proceset integruese në arsim, kulturë dhe në fusha të tjera. Integrimi si proces është me rëndësi edhe për marrëdhëniet shoqërore-ekonomike dhe zë vend në shumë shkenca. Për shembull, në psikologji

janë në përdorim termat: *integrimi*, *integrimi cerebral*, *integriteti i personalitetit* (sipas P. Giomit: uniteti i personalitetit, *Psihologjia*, Zagreb, 1958, fq. 229), *akti integrativ* dhe *integrimi i lëvizjeve*, sipas Vudvortit¹. Janë interesante edhe kërkimet e Dejvid Kreçit dhe të autorëve të tjerë, sipas librit: *Pojedinac u drustvu* (Beograd, 1972), në të cilin, për tematikën tonë, gjejmë dy të dhëna relevante: e para, se personat e një profesioni nga i njëjti grup me të ardhura të njëjta, ose për nga arsimimi nga i njëjti grup, shfaqin aspirata që të jetojnë në fqinjësi dhe që të gjenden në aksion të afërt të ndërsjellë², dhe e dhëna e dytë mbi marrëdhëniet e ndërsjella personale më të shpeshta dhe më të afërta midis zezakëve dhe të bardhëve në dy vendbanime të integruara në të cilat banesat ndahen pa marrë parasysh racën, sesa në vendbanimet e segreguara. Në bazë të intervistave, shkallës së vlerësimit dhe përvojës së banimit në vendbanimin e integruar, është vërtetuar se në këto vendbanime ka shumë më pak paragjykime ndaj zezakëve, p.sh. në vendin e punës, në pikëpamje emocionale dhe në lidhje me besimet mbi zezakët, sesa në vendbanimet e segreguara, ku këso paragjykimish ka pakrahasueshmërisht më shumë³.

Në shkencën mbi edukatën gjejmë këtë terminologji: *edukata integrale*, *zhvillimi harmonik dhe integral i personalitetit* (qëllimi i edukatës), *integrimi i personalitetit*, *integrimi i fëmijëve me vështirësi në zhvillim*, *integrimi i sistemit të arsimit*, *integrimi në shkollë*, *integrimi i arsimit dhe i punës*, *integrimi i mësim*, *integrimi i grupeve arsimore*, *parimi i tërësisë në mësim*, *integrimi i sistemit të arsimit të tërriturve*, *metodat e integrimit të të mësuarit*.

Integrimi si faktor, parim dhe proces është i pranishëm dhe me ndikim edhe në disiplinat e ndryshme pedagogjike dhe në strukturën e temave konkrete.

Ka shumë përmbajtje tematike të lokaliteteve të ndryshme, sikurse është rajoni i Sanxhakut ose ndonjë krahinë më e vogël. Tema e integrimit nuk mund të studiohet pavarësisht nga format socio-filozofike,

¹ R. Vutvort, *Eksperimentalna psihologjia*, Beograd, 1959, fq. 104. 274. Autori e përshkruan integrimin e dy lëvizjeve – të duarve dhe të qepallës së syrit në bazë të refleksit të kushtëzuar.

² Dejvid Kreç etj., *Pojedinac u drustvu*, Beograd, 1972, fq. 323.

³ Dejvid Kreç etj., *Po aty*, fq. 263, 264.

etnike, gjuhësore, kulturologjike, historike dhe format e tjera edhe jashtë kushteve ekonomike konkrete.

Hulumtimet integrative, duke supozuar se kanë mbështetje të duhur metodologjike, mund të japin lëndë të besueshme shkencore dhe gjeneralizime prej të cilave dalin edhe konsekuenca të caktuara praktike. Një prej tyre, lidhur me proceset integrative në arsim dhe shkolla, është se shkollat dhe të gjitha nivelet e arsimit (p.sh. arsimit fillor, i përgjithshëm e profesional, teorik e praktik dhe format e tjera të arsimit) duhet të integrohen patjetër. Integrimi në shkolla ka domethënie edhe më të gjerë në vështrim të ndjekjes së përbashkët të shkollës dhe të mësimi të fëmijëve të popujve të ndryshëm, e veçmas të racave të ndryshme, pas eliminimit të segregacionit racor, do të thotë pas eliminimit të shkollimit të ndarë të fëmijëve. Dihet se Gjykata Supreme e SHBA, që në vitin 1954, ka marrë vendim për integrimin e shkollave. Të kujtojmë edhe një rezultat pozitiv të proceseve integrative në arsim dhe mësim, e kjo është lidhshmëria më e ngushtë midis arsimit integrativ dhe permanent. Në popull është në përdorim prej lashtësisë maksima se dituria fitohet “nga djepi deri në varr”, me të cilën mbështetet ideja mbi mësimin e përrjetshëm dhe të përhershëm. Nga përvoja e dimë se mësimi nuk përfitohet vetëm në shkollë, por edhe para se fëmija të shkojë në shkollë e krahas shkollës, përkatësisht edhe jashtë shkollës, por edhe pas mbarimit të shkollimit – në formë të vetarsimit. Edhe në mjediset tona është me rëndësi ta kultivojmë arsimimin integral dhe në lidhje të pandashme me të edhe t’i aftësojmë të rinjtë për vetarsimim.

Pa arsimim integral permanent as që mund të merret me mend funksioni i shkollës bashkëkohore dhe suksesi i veprimtarisë së veprimtarëve të arsimit. Ka autorë, të cilët, të nxitur nga ideja e integralitetit dhe edukata integrale⁴, edhe shkencën pedagogjike e quajnë edukatë integrale. Është, gjithashtu, një varg autorësh, para së gjithash nga radha e teoricienëve amerikanë, të cilët i qasen shumë gjerësisht lëndës së pedagogjisë, sepse konsiderojnë se, përveç përmbajtjeve pedagogjike, përfshin edhe faktet dhe njohuritë teorike nga psikologjia, sociologjia dhe shkencat ekonomike. Kuptimi i këtillë tejet i gjerë i

⁴ Për shembull, Paul Robin, autor i punimit *L'éducation integrale*, publikuar në “Revue de philosophie” më 1869-1872.

pedagogjisë na përkujton panpedagogjizmin, sipas të cilit, edukon gjithçka në jetë – madje edhe përmbajtjet e pavetëdijshme.

Termi *integrim* (lat. *integer* – i tërësishëm, *integratio* – përtëritje, plotësim i diçkaje që është qenësore, *integritas* – plotësi, tërësi, paprekshmëri) tekstualisht do të thotë bashkim, ndërlidhje, shoqërim, diçka që përtëritet, ndërlidhet dhe plotësohet në tërësi. Kjo nuk është ndërlidhje e thjeshtë e pjesëve ose e elementeve, por kualitet i ri, më i lartë, lidhshmëri, unitet, bashkim organik i sferave të ndryshme të punës njerëzore dhe vendosje e ndikimeve të ndërsjella reciprokisht të qëndrueshme (p.sh. midis dy ose më shumë shteteve, popujve, partive politike etj.). Fjala është për raportin e ndërsjellë dhe ndikimin e të gjithë faktorëve dhe të asociacioneve në shoqërinë njerëzore, në një varg vendesh, në një vend ose në cilëndo hapësirë më të ngushtë. Prej këndeje del se integrimi është fenomen kompleks dhe konsistent, i cili nuk është studiuar mjaft në shkencë.

Proceset integrative kanë bazë shoqërore-ekonomike, dimension sociologjik, filozofik, tekniko-teknologjik, gjithsesi edhe etik, psikologjik dhe pedagogjik, si dhe domethënie historike dhe etnike. Shkurt, proceset integrative nuk janë të ndara nga asnjë sferë e veprimtarisë njerëzore, as jashtë arritjes së cilësdo sferë shkencore.

Procese integruese gjejmë edhe në organizimin e prodhimit (p.sh. në kombine). në marrëdhëniet familjare, në kopshtin e fëmijëve, në spital, në shkollë, në shtëpinë e kulturës etj. Ja, për shembull, si shkrimtari pedagog Alis Majl e analizon integritetin në marrëdhëniet në klasë: “Integriteti tregon një lloj kualiteti aktiv në marrëdhëniet e arsimtarit dhe nxënësit, ose fëmijës dhe grupit, kualiteti që e lehtëson procesin e integrimit të individëve dhe të grupeve.”⁵

2.

Integrimet e bashkësive në shoqërinë sanxhakase dhe kosovare mund të renditen në dy grupe dhe këto janë:

Universale, dinamike, esenciale, dhe

konkrete, ndividualë dhe që i imponon jeta e përditshme.

⁵ Alis Majl, *Kreativnost u nastavi*, Sarajevo, 1968, fq. 77.

Edhe të parat edhe të dytat kanë lidhje të pashkëputshme. Fundja, në perspektivë, vlerat e përgjithshme botërore dhe e ato pozitive evropiane e vlerat e tjera do të ndërthuren gjithnjë e më tepër në marrëdhëniet dhe veprimtaritë e bashkësive, të grupeve dhe të asociacione etnike e kulturore (gjithsesi edhe politike) të Kosovës dhe të Sanxhakut.

Lufta dhe pasojat e saj në Bosnjë dhe në Kosovë, e cila ka lënë gjurmë edhe në këto hapësira, do të tejkalohen më lehtë sa më shumë që të përballohen rrjedhat integruese në ndërmarrëdhëniet e të gjitha bashkësive shoqërore dhe nacionale në këto mjedise. Si t'i zhvillojmë sot dhe në të ardhmen te ne ato vlera më pozitive etike dhe të përgjithshme njerëzore (jetën e përbashkët, punën, jetën në paqe, mirëbesimin, tolerancën, ndërmarrëdhëniet humane dhe të bashkëpunimit, kujdesin për të gjithë njerëzit që jetojnë në mjerim, varfëri dhe mosdije, ose që vuajnë nga sëmundjet dhe infektimet e ndryshme, si t'i mbrojmë të rinjtë nga tmerret dhe vështirësitë në jetën bashkëkohore, e të tjera) – kjo është ideja themelore prijëse që mund të ketë rol të dorës së parë dhe efekt orientues të sigurt te të gjitha bashkësitë në mjedisin e Sanxhakut, të Kosovës dhe në cilindo mjedis tjetër.

3.

Hulumtimet e deritashme tregojnë se integrimi manifestohet më tepër në ekonomi, arsim, gjithashtu në shkencë dhe në forma të ndryshme të artit. Kjo nuk do të thotë se procese integrative nuk ka, për shembull, në fiskulturë e sport, në shëndetësi ose në ndonjë sektor tjetër të veprimtarisë njerëzore, por është fakt se idetë dhe esenca e integritit manifestohen më tepër në marrëdhëniet konkrete në prodhim, në art, arsim, shkencë e kulturë, gjithsesi edhe në asociacionet politike (për shembull, në bashkësitë e komunave).

Përparësitë e proceseve integrative janë të shumta dhe me rëndësi të dorës së parë. Integrimi, para së gjithash, i *ndërlidh njerëzit dhe popujt e strukturave të ndryshme etnike, fetare dhe sociale, kulturave, gjuhëve dhe zakoneve të ndryshme dhe të nivelit të ndryshëm të zhvillimit. Me të përparohen marrëdhëniet ndërnjerëzore. Parimi i integritit, realizimi i tij, shpie drejt besimit më të madh midis njerëzve dhe*

kombeve. Faktori i integritit është njëkohësisht mënyra më e mirë për parandalimin dhe pengimin e çdo gjëje që nuk është demokratike e humane dhe që e pengon zhvillimin shkencor, teknik dhe të gjithmbarshëm të cilësdo bashkësi nacionale dhe të Kosovës e të Sanzhakut në tërëri, si dhe të mjediseve të tjera në këtë pjesë të Ballkanit. Një analizë më e përafërt e integritit në ndonjërin nga sferat e jetës, p.sh. në arsim, në shkencë, në komunikimin midis njerëzve, në krijimtarinë artistike, në bujqësi, në prodhimin industrial e të tjera, tregon në mënyrë edhe më të përafërt dhe më të gjithanshme se kërkesa për integritet është rregullativë qenësore e realitetit, shumë aktuale dhe shumëfish e rëndësishme. Për shembull, në shkencë na ruan nga uniformiteti, shablonizmi, zgjidhjet e ngutshme, preskricionet (botëkuptimet e vjetruara), provincializmi, neofobia, negativizmi, teoretizimet e ndara nga jeta dhe ekskluzivitetet e tjera.

4.

Duke theksuar anët e mira dhe përparësitë e parimeve të integritit, veçmas në zhvillimin e komuniteteve në Sanxhak, në Kosovë dhe në mjedise të tjera, nuk duhet harruar edhe disa *kufij të ndikimeve*, madje edhe të kufizimeve, nga të cilat nuk është e liruar as kjo kërkesë. Nga metodologjia shkencore dihet se tejtheksimi i rolit të një faktori, për shembull, vetëm një metode në punën shkencore hulumtuese, ose vetëm një parimi, qoftë ai edhe integritet ose, ta themi edhe këtë parim, demokratizmi, nuk siguron fakte dhe përgjithësime valide, teori shkencore të sigurt dhe aplikim adekuat të saj. Pra, integritet në shkencë është i pashmangshëm, në disa domene të saj është madje dominant, në fusha të tjera shkencore është i intensitetit më të dobët, por kurrë dhe askund nuk është i vetmi faktor, parim ose metodë, edhe nëse është fjala për aplikimin e tij në ekonomi, arsim ose në ndonjë fushë tjetër.

Në teorinë didaktike dhe në praktikën arsimore, për shembull, përveç parimeve të tërësisë, përkatësisht të integritit të mësim, janë të paevitueshme edhe parimet teorike të formësuar më herët – qartësia, aktiviteti i vetëdijshëm në mësim, individualizimi i mësimi e të tjera. Mospërfillja e këtyre parimeve, veçmas në punën edukativo-

arsimore, e me qëllim që mësimi integrativ në shkolla të ketë aplikim më të gjerë, në rezultatin e fundit, do ta kthente prapa mësimin dhe fitoret pozitive të tij të arritura gjatë katër shekujve të fundit, përkatësisht nga Komenski e deri në ditët tona. A thua pse ky mendimtar filozof, ky prift modest, pedagog klasik, gjithsesi pedagogu më i madh i shekullit XVII (J. A. Komenski), ky reformator i shkollave, veprave të tija ua vuri titujt: Pansofia, paraardhësit e pansofisë; Aspiratat pansofiste, Bota në piktura, Didaktika e madhe, Dyert e hapura për të gjitha gjuhët, kurse në Didaktikën e madhe, që në fillim, kërkonte që në shkolla të ketë më pak zhurmë, mërzi, përpjekje të kota e më shumë pushim, kënaqësi e përparim serioz. Në bashkësi, këshillonte që të ketë “më pak errësirë, tollovi dhe mospajtime, e më tepër dritë, rregull, qetësi e urtësi”⁶. Në vend të dashurisë së ndërsjellë dhe vërtetësisë, tërhiqte vërejtjen kundër “urrejtjeve të e ndërsjella, armiqësive, luftërave, vrasjeve, rrenave, mashtrimeve dhe intrigave”.

Në lidhje me integrimin e gjuhëve, Komenski dha një varg idesh të çmueshme, sikurse janë: që, përveç gjuhës amtare “për jetën shtëpiake”, të mësohen edhe gjuhët e popujve fqinjë “për komunikim me fqinjët”. Polakut, sipas tij, i “duhen gjermanishtja, mandej hungarishtja, rumanishtja dhe turqishtja; njerëzve të arsimuar, për leximin e librave të shkruar me mençuri, u duhet latinishtja; filozofëve greqishtja e arabishtja, kurse teologëve greqishtja dhe hebraishtja.”⁷

Meqenëse në punën shkencore-hulumtuese dhe në relacionet konkrete të kolektiviteve etnike faktori edhe ideja e integritimit në disa pjesë të botës janë vetëm në fazën e depërtimit, aplikimi i integritimit, duke u ruajtur nga ngutja dhe tejtheksimi i vlerave të tij, është shumëfish i rëndësishëm për cilindo mjedis, e veçmas për ato mjedise, që janë ekonomisht e shpirtërisht dhe në shumë pikëpamje të tjera shumë të ngjashme sikurse janë komunat e Tutinit, të Rozhajës, të Plavës, por edhe të Pazarit të Ri dhe komunat e tjera të Sanxhakut, të cilat edhe territorialisht janë shumë të afërta me komunat fqinje të Kosovës. Do të mund të rendohej një shkallë e tërë temash dhe problemesh që, në radhë të parë, hyjnë në domenin e *hulumtimeve integrative multidisiplinare dhe komparative*, para së gjithash në relacionin

Sanxhak – Kosovë, por edhe më ngushtë: në territorin e një komune ose në disa këso tërësish më të vogla administrativo-territoriale.

5.

Me qëllim studimi integrativ të marrëdhënieve multientike në këto hapësira, si më aktuale dhe shumë pak të trajtuara, veçohen këto fusha tematike:

1. Rrethanat ekonomike dhe strategjia e zhvillimit integrativ të rajonit të Sanxhakut dhe të Kosovës,
2. Proceset integrative në arsim dhe edukim në Kosovë dhe në Sanxhak,
3. Zhvillimi dhe perspektivat e edukimit integrativ dhe multietnik në këto mjedise,
4. Qasja komparativo-integrative e studimit të boshnjakëve në Sanxhak dhe në Kosovë,
5. Çka i bashkon dhe i integron njerëzit e së njëjtës përkatësi etnike dhe çka i ndërlidh me poujt fqinjë (për shembull, boshnjakët dhe shqiptarët),
6. Studimi i marrëdhënieve integrative (midis) zhvillimit ekonomik, arsimit dhe kulturës në territorin e komunës së Tutinit,
7. Studimi komparativ dhe integral i traditës, i zakoneve dhe i veçorive të tjera të popujve të Sanxhakut dhe të Kosovës,
8. Elementet puqëse e të përbashkëta dhe ndryshimet në të folurit e serbëve e të boshnjakëve në komunën e Tutinit dhe në komunën e Pazarit të Ri,
9. Si të zhvillohen dhe të harmonizohen në të ardhmen marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndëretnike në jug të Ballkanit,
10. Varfëria, prapambeturia dhe papunësia – probleme të përbashkëta dhe më komplekse të Sanxhakut dhe të Kosovës,
11. Integrimi në të ardhmen dhe për të ardhmen e jetës së përbashkët të njerëzve në territorin e Kosovës e të Sanxhakut,
12. Ndikimi i mjeteve të informimit në proceset integrative të ne,
13. Çka e ndërlidh qytetin e Tutinit me fshatrat më të largëta të komunës së Tutinit (hulumtime empirike),

⁶ Jan Amos Komenski, *Velika didaktika*, Beograd, 1954, fq. VIII.

⁷ Po aty, fq. 5, 164.

14. Identifikimi i parakushteve më të rëndësishme për integrimin e bashkësive etnike të ne,
15. Libri si faktor i integrimit shpirtëror në trevat e Sanxhakut.

Nga lista e temave, e cila, qartazi, nuk është e plotë, mund të veçohet problemi më i përgjithshëm, i pahulumtuar në shkencë, por që është reprezentativ dhe shumë aktual. Fjala është për *arsimin e shkencën dhe raportin e tyre me proceset e integrimit ekonomik në mjediset jo mjaft të zhvilluara* (për shembull, në Kosovë dhe në Sanxhak). Me nocionin “proceset të integrimit ekonomik” nënkuptojmë kushtet ekonomike dhe ndikimin e tyre primar në zhvillimin shoqëror dhe historik. Këtu duhet të përkujtojmë vështrimet lucide të Engelsit se “zhvillimi i politikës, i filozofisë, i religjionit, i letërsisë, i artit etj. mbështetet në zhvillimin ekonomik. Por, të gjithë këta faktorë ndikojnë në njëri-tjetrin dhe në bazën ekonomike.”⁸

Tematika meriton hulumtime shumëvjeçare dhe multifaktoriale e shumëdimensionale në kuadrin e një projekti studimor. Në një projekt të tillë kanë qenë të angazhuar teoricienë dhe ekspertë të lartë të një vargu fushash, para së gjithash, filozofë, pedagogë, sociologë, metodologë të shkencave shoqërore, historianë (sidomos të arsimit), teknologë, ekonomistë dhe ekspertë të fushave të tjera të shkencës dhe të artit. Nuk është vështirë të supozohet se kjo punë ekipore do të mund të siguronte lëndë të pasur dhe rezultate të vlefshme shkencore.

Meqenëse arsimit në botën bashkëkohore, si “pasuri e përgjithshme njerëzore”⁹, është burim qenësor për zgjidhjen e shumë nevojave të njeriut, duke filluar prej problemeve vitale të tij, për këtë pjesë të projektit të përmendur, do të duhej të angazhohim, së paku në fazën e parë të hulumtmeve, shumë punëtorë të shkollave (p.sh. nga komuna e Tutinit), sidomos kuadrin mësimor që shquhet për aftësitë krijuese individuale dhe ka përvojë të pasur pedagogjike, si dhe të gjithë ata që, sipas fjalëve të Alis Majlit, “mësimin e shikojnë si diçka më tepër se punë rutinore, të cilëve mësimi u ofron kënaqësi, prandaj bashkëpunëtorët e tyre dhe prindërit e nxënësve i respektojnë si mësimdhë-

nës.”¹⁰ Mësimi, faktikisht, është proces krijues dhe i papërsëritshëm, me supozim se është i afërt dhe interesant për fëmijët, se çdo orë mësimore përmban diçka të re (me sjelljen e inovacioneve), se ai mësim edhe për nga përmbajtja edhe për nga mënyra e punës është me të vërtetë bashkëkohor, se e zgjon mendimin, emocionet dhe aktivitetin e vullnetshëm me ide të reja dhe të guximshe, dhe se prej ditëve të para shkollare të fëmijëve është me të vërtetë proces integral.

Të mos harrojmë se edhe vendet dhe popujt më të vegjël mund t’i japin integrimit shpirtëror dhe kulturës së botës kontributin e vet, e shpeshherë edhe rezultate të rëndësishme dhe origjinale.

6.

Nga një shumësi çëhtjesh mbi integrimin në Sanxhak dhe në Kosovë kemi ndarë dhe në vija qenësore kemi ndriçuar këto: së pari, cilat janë përparësitë e proceseve integrative të ne, së dyti, në cilat fusha është përfaqësuar më tepër integrimi, dhe së treti, cilat janë kufizimet e proceseve integrative.

Qëmoti është vërtetuar postulati se, p.sh., “sa më i mirë dhe më i gjerë të jetë arsimiti, aq më shumë dituri ka shoqëria dhe aq më e aftë është ajo që atë dituri ta vërë në shërbim të bashkësisë dhe të të gjithë anëtarëve të saj.”¹¹ Autori vërteton se integrimi është ai që i ndërlidh njerëzit, popujt dhe trevat, traditën e tyre, gjuhën dhe fitoret e qytetërimit. Meqenëse kjo problematikë është hulumtuar tepër pak, me shembullin e rajonit të Kosovës dhe të Sanxhakut është vërtetuar se mund të jetë tërheqëse për punë shkencore hulumtuese. Është me rëndësi edhe për arsimin, ekonominë, kulturën dhe jetën multietnike. Është dhënë edhe lista e temave për trajtim dhe është propozuar projekti i studimit me titull: *Arsimi e shkenca dhe raporti i tyre ndaj proceseve të integrimit ekonomik në mjediset jo mjaft të zhvilluara të Sanxhakut dhe të Kosovës*.

⁸ F. Engels, *Pismo W.Borgiusu* (25.I 1894), *Dela*, vëll. 46, fq. 182-183.

⁹ Dusan M. Savicevic, *Komparativno proucavanje vaspitanja i obrazovanja*, Beograd, 1984, fq. 11.

¹⁰ Alis Majl, vepra e cituar, fq. 45.

¹¹ Sipas librit: *Glavne tendencije razvoja obrazovanja u svetu*, nga Milenka Nikoliq, Zagreb, 1984, fq. VII.

Academician Jashar Rexhepagiq

THE ADVANTAGES AND THE LIMITATIONS OF THE INTEGRATION PROCESSES IN THE SANDJAK REGION AND THE TERRITORY OF KOSOVA

(Summary)

Out of a large number of issues on the subject of integration (in Sandjak and Kosova) we will focus on the following: firstly, what are the advantages of such processes, secondly, what areas they cover, and thirdly, what are the limitations of such processes.

The postulate "the better the education of a certain society the more capable it will be to use that knowledge for the benefit of the society as a whole and all its members" was substantiated a long time ago. The author establishes that the process of integration brings together people and territories, their traditions and languages. It is a very important process in the fields of education, economy, culture and interethnic coexistence.

ياشار رجب آغيش

اولويات التقارب في سانجاق و كوسوفا

(خلاصة البحث)

بعد ما ذكرنا مجموعة من العوامل التي تساعد على عملية التقارب بمنطقة "سانجاق" و كوسوفا قد سلطنا الاضواء على ما يلي: أولا ما هي أولويات عوامل التقارب و ثانيا ما هي المجالات التي يجب علينا التركيز فيه و ثالثا ما هي حدود اجراءات التقارب.

و في رأينا فان محال التعليم و الاقتصاد و الثقافة سوف يساعد على التعاون و التعايش بين شعبي البلدين، و بناء عليه فقد قمنا بتقديم المواضيع التي سوف تكون محورا للبحث تحت عنوان: التعليم و العلم و علاقتهما في اجراء التكامل الاقتصادي بالاوساط في مرحلة النمو بمنطقة سانجاق و كوسوفا.

KËNDVËSHTRIME

*Murad Hoffman**

ALEANCA PËR UDHËZIME MORALE

*Besimtarët duhet të potencojnë
se shoqëria nuk mund të mbijetojë pa religjion.
Murad Hofman*

Kombi është familja më e zgjeruar. Por në proces që t'i takojmë një grupi të brendshëm, grupet e jashtme automatikisht krijohen - e kjo sjell fillimin e ngatërresave. Skenari i njohur është se të gjithë të tjerët janë barbarë, që nuk mund ta kuptojnë gjuhën tonë të mrekullueshme. Në një mënyrë ne kuptojmë se luftërat, ekzili, skllavërimi dhe vrasjet e të tjerëve ftojnë një arsyetim-religjion që e bën të mundshme në një mënyrë luftën për Zotin e njërit, kundër "idolit" të të tjerëve, çështje nderi.

Në princip, së paku politeizmi dhe prania e shumë zotëve të fiseve gradualisht sollën një paqe relative në marrëdhëniet ndërfisnore. Por, monoteizmi ndryshon çdo gjë pasi që besimi në Një Zot frymëzon universalizmin. Kjo është arsyeja që të krishterët dhe muslimanët tentojnë t'i globalizojnë besimet e tyre. Hebrejtët, e konsiderojnë veten "të zgjedhur" dhe nuk bëjnë propagandimin e fesë.

Historia e të krishterëve dhe muslimanëve sa i përket universalizmit, ofron ndryshime fundamentale në çështjet e trajtimit të teorisë dhe praktikës.

Krishterismi, fe e themeluar nga qenia hyjnore (Jezu Krishti) siç të besojnë krishterët, që nga ditët e para e konsideroi vetën superior ndaj të gjitha religjionve profetike. Ky "superioritet" u ngrit edhe më lart kur Shën Augustini (354 - 430) zhvilloi nocionin e shpëtimit në kryq-sakrifikimit final. Si pasojë, Kisha u bë mbrojtëse e mëshirës së Zotit dhe eventualisht edhe garantuesi ekskluziv i shpëtimit.

Asnjë doktrinë tjetër fetare nuk solli më shumë mizori dhe vrasje se deklarata extra ecclesiam nulla salus – nuk ka shpëtim jashtë Kishës. Ky besim kondemnoi me miliona hebrenj dhe "moreshë" në Andaluzi (Spanjë), popujt autokton të Amerikës dhe "rebelët fetar" gjermanë e sllavë në Evropën Veriore dhe Lindore, e po ashtu edhe inicoi luftërat e përgjakshme të Reconquistas, Kryqëzatat, Inkuizicionin, djegien e "shtrigave" – e të mos flasim për luftërat ndër-krishtere.

Këshilli i Dytë i Vatikanit shpërfilli në mënyrë publike këtë doktrinë vetëm në vitin 1965. Si rezultat, Kisha Katolike ka filluar një frymë të re të tolerancës duke mirëpritur pluralizmin fetar dhe duke anuluar metodat e vjetra të propagandimit.

Toleranca ndaj muslimanëve, fatkeqësisht, nuk gjeti ndonjë për-krahje fetare. Kurani thekson se tek krishterët, hebrenjtë, dhe sabianët janë "njerëz të Librit", dhe se muslimanët nuk mund ta përdorin forcën që t'i shtyjnë njerëzit e tjerë të pranojnë fenë islame (2:256), dhe se krijimi i bashkësive të tjera është pjesë e planit të Zotit (5:58).

Kjo doktrinë e bashkimit në prani të popujve të ndryshëm nuk, parandaloi fushatat ushtarake të Perandorisë Osmane në Evropën Qendrore, por shpjegon faktin pse edhe pas 1400 vjetesh, Egjipti ka ende 14 milionë besimtarë të krishterë-koptët me kishat dhe manastiret e veta; pse muslimanët janë pakicë në Indi, edhe pse ata ishin njerëzit që sunduan Indinë më se 1000 vjet; pse Greqia mbeti vend i krishterë edhe pse muslimanët osmanlinj e kishin nën pushtim për 500 vjet; pse kishat në bankinat e Damaskut kanë kryqe të ndriçuara me drita neoni, dhe pse Stambolli ka kisha armene, katolike, ortodokse e protestante, e po ashtu edhe sinagogë të hebrenjve.

Stimulimet e Sheriatit sa i përket tolerancës fetare, janë shumë më liberale se Karta mbi të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara. Feja islame u ofron pakicave fetare autonomi legale në administrim religjioz, çështje familjare, të trashëgimisë e (pjesërisht) edhe në ligjin penal.

Në kontrast, përveç SHBA-së, Perëndimi fuqimisht iu kthye monoreligjionit, fakt i cili shpjegon arsyen pse Evropa ka hasur në kaq vështirësi në përshtatjen (akomodimin) e 15 milionë muslimanëve që kanë emigruar në Evropë. Megjithatë, pluralizmi është në rritje e sipër në Evropë, falë punës së disa teologëve të krishterë. Madje, edhe kisha krishtere ka mënjeluar deri diku ekskluzivitetin e vet. Vatikanin ende heziton ta pranojë Pejgamberin Muhamed (a.s.) si udhëheqës, dhe Kur'anin si udhëheqje solide, por në një mënyrë e ka pranuar besimin islam si mënyrë të shpëtimit. Po ashtu, klasifikimi i dikurshëm i muslimanëve si “të krishterë anomnimë” deri diku është larguar nga përdorimi.

QËLLIMET E PËRBASHKËTA - Në një skenar të këtillë, terreni përgatitet për një bashkëpunim ndërmjet religjioneve që të ballafaqohen me armikun e përbashkët-ateizmin, agnosticizmin dhe materializmin, të gjitha këto me fille nga koha e Rilindjes (shekulli XVI), ilumizimit (shekulli XVIII), dhe pozitivizmit (shekulli XIX) nën mbulesën e marksizmit, darvinizmit, dhe frejdizmit. Momenti kulm ishte proklamacioni i Fridrik Niçes (1844-1900) “Vdekja e Zotit.” Si pasojë, civilizimi perëndimor është i vetmi civilizim në histori, që bazohet në supozimin se Zoti nuk ekziston.

Ironikisht, krijuesit e kësaj rryme ateiste nuk ishin kundër religjionit. Emanuel Kanti (1724-1804), edhe pse refuzon ndonjë fakt për ekzistencën e Zotit, e kuptoi se realiteti nuk mund të shpjegohet pa e konsideruar Zotin si hipotejë të nevojshme. Ngjashmërisht, Xhon Lok (1632-1704), Volteri (1694-1778), Fredriku i Madh (1712-1786) dhe Wolfgang von Gete (1749-1832) ishin deistë (besimtarë në kishën, por pa përkatësi kishtare), të cilët dëshironin abolimin e qeverisjes kishtare, që ishte dhunuese dhe opresive, e jo abolimin e Zotit.

Me një keqardhje, emancipimi nga Kisha Katolike u shndërrua në emancipim nga Zoti, dhe njerëzit filluan ta konsideronin vetveten si racionalizues supremë e autonomë, mbi të gjithë.

David Hume (1711-1776) dhe August Komte (1798-1857) janë ndër themeluesit e scientizmit - këta mbizotëruan pseudo-religjionin që pranon vetëm atë që mund të definohet dhe të përsëritet me anën e eksperimenteve, dhe nuk mund të kontradiktohet nga metoda të tjera shkencore. Aspektet kualitative të jetës, siç janë dashuria dhe vlerat etike, nuk ekzistojnë. Si pasojë, shumica në Perëndim nuk e shfaqin ateizmin e tyre në mënyrë të hapur, por materializmi i teprueshëm i tyre paraqet ndjenjat e tyre se Allahu është irelevant sa u përket sjelljeve të tyre.

Me arritjen e mekanikës kuantum dhe biokimisë moderne, shkencën ka kaluar nga materializmi në një idealizëm të ri. Maks Planku (1858-1947) i cili zbuloi se energjia vjen në pako (quanta), ishte njeri fetar, ashtu siç ishin edhe Anjstajni (1879-1955) dhe Verner Hajzenbergu (1901-1976), të cilët zbuluan se fenomeni subatomik është i papërcaktuar (indeterminant). Filozofët që dominuan shekullin e njëzet, në fund u shndërruan në besimtar të metafizikës, e deri diku edhe në njerëz me besim mistik.

Edhe pse feja nuk është e përfshirë në shkencë, sidomos pasi që Paul Durak dhe Steven Hoking ende janë në mesin tonë, fizika e re ua ka bërë të ditur të gjithëve se nuk është e verifikueshme më sa është besimi në Zotin. Njerëzit, si Eduard Viteni nga Universiteti i Prinstonit, i cili mundohet të përkufizoj realitetin me formula matematikore, siç është teoria 10-dimensionale e ashtuquajtur Teoria e Super Litarit, është shumë më afër idealizmit se materializmit.

Ka shkas për një optimizëm, pasi rruga në shekullin XXI ka marrë prapë ngjyra fetare, pas shekullit XVIII që ishte agnostik, shekullit XIX që ishte shekull ateist dhe atij ideologjik (shekulli XX).

Njerëzimi ndeshet ende me materializëm në shoqëri dhe në shtetin shekullar. Në qoftëse shekullarizmi implikon mungesën e fesë shtetërore, atëherë Britania dhe Skandinavia nuk hyjnë në këtë klasë. Në qoftë se implikon mungesën e religjionit nga shërbimet publike, atëherë SHBA-ja dhe Gjermania nuk janë vende shekullare. SHBA-ja inkudronë rabinj,ë priftërinj, dhe hoxhallarë në ushtri, simbolet fetare zyrtarisht shfaqen gjatë Kërshëndellave, dhe pranimi i detyrës për kryetar të shtetit hapet me lutje. I vetmi shtet që përmbush këtë kusht,

është Franca, e cila ka ndaluar pranin e fesë në hapësirën shoqërore-madje edhe në shkolla.

Perëndimi ka marginalizuar fenë në një funksion folklorik dhe dekorativ, po ashtu edhe në një çështje personale. Postmodernizmi, me fobinë e saj ndaj temave siç janë sisteme të mendimit, pikëpamje botërore dhe relativizmi i pafund i së “vërtetës”, ka zgjeruar këtë trend. Thuhet se nuk është e mundshme të dimë çdo gjë për të vërtetë, sikurse të kishte thënë Anjshajni se çdo gjë, përfshirë kohën dhe gjithësinë, është relative, kështu që çdo gjë është e mundshme. Si pasojë në Perëndim, besimtarët e religjioneve hyjnore janë duke u ballafaquar me ata, “religjioni” i të cilëve është personal dhe kishtar, kështu që asgjë nuk e meriton këtë emër.

Aleanca që muslimanët duhet ta mbjellin për udhëheqje dhe kryesi në shoqëritë shekulare të Perëndimit, nuk duhet të përqendrohet aq shumë në rreziqet e ateizmit, por në rreziqet e agnosticizmit bashkëkohor, siç evidentohet me një marginalizëm mendjehollë dhe privatizim të fesë.

Në mënyrë që të shqyrtohet kjo çështje, muslimanët duhet të bëjnë të ditur se asnjë shoqëri nuk mund të mbijetojë pa vlerat elementare të etikës që sjell feja. Perëndimi, sidomos amerikanët, duhet të kenë në mendje se shtetet e tyre u themeluan mbi vlera të tilla dhe ende përfitojnë nga ato vlera që kanë mbetur në përdorim. Prandaj, është shumë tipike amerikan që ne si muslimanë të kërkojmë nga organet ligjdhënëse dhe administrata, mbrojtjen e këtyre vlerave themelore siç janë drejtësia, barazia racore, zellshmëria, besnikëria, nderi, dashuria pri ndore dhe afekti, si dhe besnikëria seksuale. Shkatërrimi i familjes, delikuenca e të miturve, përdorimi i drogës, pornografia, dhuna, dhe stimulimi i homoseksualitetit në të njëjtën kohë janë në kundërshtim me vlerat hebraike, krishtere dhe islame.

Besimtarët e të gjitha religjioneve duhet të potencojnë me një zë, se veëm feja mund ta shpëtojë Perëndimin nga një kolaps i brendshëm, i ngjashëm me atë sovjetik. Muslimanët e Amerikës janë të gatshëm t'i ofrojnë SHBA-së “barin” që i nevojitet për të mbijetuar si shoqëri etike.

Ngjashëm, besimtarët duhet të bashkëpunojnë që të konfrontojnë privatizimin e religjionit dhe ta bindin Perëndimin se, edhe pse ne nuk

mund t'i shpalosim zanafillat e qenies njerëzore në mënyrë intelektuale, apo përmes vështirimeve me anë të shqisave, pasojat e nevojshme të kufijve epistemologjikë nuk janë të pashpresë në një agoni dëshpëruese. Fundi-fundit, Zoti e shfaq Vetën në natyrë edhe përmes lajmëtarëve dhe peygamberëve.

Besimtarët duhet të ndihmojnë të dëshpëruarit që të shohin religjionin si një burim të diturisë, i cili komplementon shkencën si metodë tjetër po e barabartë, që të afron tek Realiteti suprem. Kjo supozon se ne i pranojmë shkrimet hyjnore e nuk kemi dilemë për to. Ne duhet t'i tregojmë gjeneratës së sotme narcistike se, në qoftë se Zoti ekziston, atëherë të gjithë ne jemi të Zotit dhe duhet t'u nënshtrohemi të njëjtave rregulla të sjelljes.

*E përktheu dhe përshtati
Elis Vllasi*

* Dr. Murad Hoffman, ish-Ambasadori Gjerman në Algjeri dhe Marok, është autor i librave “Religjioni në Rritje: Islami në Mileniumin e III”; “Islami: Alternativa; Islami 2000; dhe “Rruga për në Mekë”.

Artikulli u botua në revistën amerikane “Islamic Horizons” në numrin e muajit Mars/Prill 2002.

Murad Hoffman

THE ALLIANCE FOR MORAL GUIDANCE

(Summary)

The faithful must emphasize the fact that society cannot survive without religion.

The nation is an extended family. In the process to become part of a certain group, other groups are created –and this brings to problems. The usual scenario

is that all the others are barbarians, who do not understand our beautiful language. There are efforts to find the justification for certain wars, the enslavement and the killings of the others, in religion and this makes the wars for a certain God and against the “idols” of the others an issue of honor.

موراد هوفمان

التحالف للقيم الاخلاقية

(خلاصة البحث)

القومية تعتبر عائلة على شكل موسع، و لكن في انتمائنا إلى مجموعة اصغر بصورة تلقائية يتم تكوين مجموعات خارجية و هذا يترتب عليه خلق مشاكل. الانطباع المعروف هو أن الآخرين كلهم برابرة لانه ليس باستطاعتهم فهم لغتنا الجميلة بطريقة ما نحن نفهم بان الحروب و الهجرة و الرق و قتل الآخرين يتخذون من الدين كمبرر ليحاربوا معتقدات الآخرين.

EDUKATË FETARE

Artan Shaqiri

RRITJA E PËRGJEGJËSISË INDIVIDUALE DHE SHOQËRORE NËPËRMJET EDUKATËS FETARE

Ndjenja fetare si një element i domosdoshëm fiziko-shpirtëror i pandarë nga njeriu, asnjëherë nuk ka vepruar e ndarë nga shoqëria civile. Askush nuk mund të mohojë rolin e fesë në përgjithësi dhe edukatës fetare në veçanti në një sistem shoqëror të caktuar, kjo sepse ekziston një lidhje e brendshme, një sistem reciprok midis tyre. Kjo lidhje dhe ky bashkëpunim është historik. Plutarku, një nga përfaqësuesit e hershëm të botës shpirtërore, thekson: “Kudo që të shkosh, kudo të qëndrosh dhe sikur gjithë botën ta shetisësh, ndoshta mund të gjesësh qytete dhe fshatra pa mure, pa shkolla, pa mbretëri, pa teatër, pa monedha, por qytete dhe fshatra ateiste që të mos kenë tempujt e adhurimit të Zotit, në të cilat banorët e tyre lusin dhe thërrasin Perëndinë, asnjë nuk ka gjetur dhe as të mos mendoj se do të gjejë. Pra qytetërimi pa besim dhe mbështetje në Zotin Fuqimadh dhe të mençur nuk mund të ekzistojë dhe në qoftë se ekziston ai kurrë nuk mund të jetë i qëndrueshëm”.

Me të vërtetë, po të hedhim një sy në popujt e vjetër kemi për të parë se Feja e atëhershme, ndonëse kishte të meta dhe nuk qëndronte në lartësinë e duhur, megjithatë ushtronte influencën e saj mbi moralin e njerëzve. Ky ishte shkaku i vetëm që gjeti përkrahje nga ana e filozofëve dhe moralistëve më të shquar të atyre kohëve, si Sokrati,

Plutarku, Ciceroni etj.. Gjithashtu është konstatuar dhe provuar prej historisë, se sa herë në luftë midis shoqërisë dhe qarqeve të ndryshme antifetare mundej kjo e fundit dhe ajo pushonte përkohësisht së luajturi një rol aktiv në marrëdhëniet e ndryshme shoqërore ose private, atëherë shënohej një rënie morale e njerëzve, një sundim i së ligës dhe një mbetje prapa në fushën e përparimit moral e shoqëror, ashtu edhe në atë të zhvillimit intelektual dhe shkencor.

Përkundrazi, kur në këtë luftë triumfonte Feja dhe parimet fetare, popujt merrnin një hov të madh përparimi e lulëzimi që historia s’e harron kurrë qytetërimin e zhvillimin e Andaluzisë (Spanjës) burim i qytetërimit evropian e botëror sado që të mundohen ta fshijnë nga historia, virtyti e drejtësia rregullonin marrëdhëniet e qytetarëve si në jetën politiko-shoqërore ashtu dhe në atë private dhe familjare.

Nga ana tjetër, shkenca dhe dituria zhvilloheshin me hapa të shpejtë, morali dhe kultura ngjiteshin në një lartësi të paparë si në pikëpamjet politike dhe ushtarake, ashtu dhe në atë letrare, shkencore e artistike. Por kur u zhduk shprestaria dhe frika e Zotit dhe bashkë me te nderimi dhe zbatimi i ligjit moral e i parimeve fetare, pikërisht që nga ky moment filloi demoralizimi i këtyre popujve, shkatërrimi familjar dhe shoqëror, zhdukja e çdo mendimi dhe ndjenje të lartë, dhe në fund, humbja e lirisë dhe pushtimi i tyre prej popujsh barbarë.

Pra historikisht vërtetohet se edukata morale e popujve është e pamundur në qoftë se kjo nuk ka për bazë e themel kryesor mësimet fetare dhe edukimin fetar.

Edukimi fetar me nxitjet, urdhërat, ligjet dhe parimet e tij që mbajnë vulën e një fuqie të mbinatyrshme ndikon në forcat, organizmat, nivelet dhe sistemet e ndryshme shoqërore. Konkretisht, ky ndikim kalon nëpër tri etapa:

1. Së pari: Ndikimi i tij në sensibilizimin e shoqërisë për zbulimin dhe njohjen e problemeve të saj.
2. Së dyti: Si ndikon edukimi fetar në suportimin sa më real dhe pozitiv të problemeve të shoqërisë.
3. Së treti: Ndikimi i edukimit fetar për marrjen pjesë aktive të shoqërisë për zgjidhjen e këtyre problemeve.

- Feja me anën e ndikimit fetar ndikon në njohjen e problemeve të shoqërisë.

Problemet shoqërore kanë preokupuar dhe preokupojnë gjithmonë qenien njerëzore, ato kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë.

Shoqëria është gjithmonë në zhvillim dhe gjatë këtij zhvillimi disa probleme të saj zgjidhen, por nga ana tjetër shfaqen vazhdimisht probleme të fenomeneve të reja individuale dhe shoqërore të njohura dhe të panjohura më parë.

Prandaj shoqëria është e interesuar për njohjen e këtyre problemeve. Edukimi fetar luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ai duke mos qenë i ndarë nga shoqëria, por një pjesë e rëndësishme e ekzistencës shpirtërore të sajë mer pjesë aktive në sensibilizimin e njerëzve për njohjen e problemeve të ndryshme. Edukata fetare krijon njerëz të hapur, aktivë e të lirë dhe si të tillë janë të interesuar për gjithçka që i rrethon dhe aq më tepër për problemet që ndeshen në jetë.

- Etapa e dytë lidhet me edukimin fetar në suportimin sa më mirë të problemeve shoqërore. Edukimi fetar nëpërmjet forcës shpirtërore, që është e para primare e virtyteve të larta njerëzore, virtyt që e rrënjos tek njerëzit e bën të mundur të ndjekë sa më realisht dhe pozitivisht këto probleme. Ky realizëm është i rëndësishëm, por edhe ndjekja pozitive, d.m.th. mosmjaftimi vetëm me qëndrimin e drejtë ndaj këtyre problemeve, por dhe vështrimi i tyre me optimizëm, pra si të zgjidhshme.

Ky qëndrim vjen si rezultat i karakterit që mbart në vetvete edukata fetare dhe sidomos besimin në Zotin Krijues dhe Sundues i vetëm.

- Etapa e tretë është më e rëndësishme dhe lidhet me anën praktike të problemit që po diskutojmë. Edukimi fetar konsiston në faktin që njerëzit të marrin pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve shoqërore duke u nisur nga mësimet e Kur'anit Famëlartë. Zoti i Lartëmadhëruar thotë: ***“Me të vëretë All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ta ndryshojnë ata vetë”***.

- Kjo gjë përbën një ngritje të madhe të përgjegjësisë qytetare të shoqërisë. Kjo edukatë rrënjoset tek njerëzit që përfetojnë besimin në Zotin, ndjenjën e optimizmit, guximin, vetëpohimin e sakrificës. Shoqëria ka ngritur institucione të superstrukturës së saj siç janë media e shtypur dhe elektronike, shkolla, shoqata e organizata të ndryshme që marrin pjesë aktive në rritjen e përgjegjësisë qytetare.

Shumë mund të mendojnë se një përgjegjësi të lartë kanë dhe njerëz që disponojnë këtë edukim, dhe kjo është e vërtetë. Njerëz me një edukatë qytetare kanë një përgjegjësi qytetare të lartë, por kjo s'mund të krahasohet me një përgjegjësi qytetare që mbart një njeri me besim dhe edukatë fetare. Edukata fetare fisnikëron e ndriçon, dhe edukatën tjetër, nëse e kemi, ose e plotëson mungesën e saj, sepse kjo lartëson mendjen, fisnikëron zemrën, forcon vullnetin në të mirën, kënaq aspiratat fisnike të shpirtit dhe të gjitha këto të çojnë në ngritjen e përgjegjësisë qytetare. Nuk do të thotë se jeton në qytet dhe je i qytetëruar, por qytetërimi, zhvillimi arrihen vetmë me besim të plotë dhe edukatë fetare të lartë. Kjo përgjegjësi buron nga brenda, nga zemra, nga besimi dhe bëhet pjesë e jetës së njerut, sepse nuk ka frikë ligjin policor, por ka një frikë më të madhe, e cila është e mbrojtur (thurur) me respektin dhe dashurinë për Zotin xh.sh. Kjo përgjegjësi nuk është edukuar forcërisht, ose nga jashtë njeriut me rregulla e ligje, siç ndodh shpesh me edukimin qytetar, por rrjedh natyrshëm nga zemra e tij. Morali qytetar dhe ligji, të bazuar dhe të edukuar nga feja nëpërmjet një bashkëpunimi harmonik, do të zhdukin të keqen nga shoqëria njerëzore që përfeton sot, dhe e zëvendëson me dashuri dhe paqe në mbarë rruzullin tokësor. Këtë e garanton besimi në një Zot dhe kultura e lashtë fetare, e cila u trashëgua dhe nuk humbi nga zemra e kombit shqiptar, e cila i ruajti kombësinë, besimin, gjuhën këtij populli. Por provat dhe vëzhgimet e përditshme flasin për shtete dhe shoqëri që admirohen, për legjislaturën dhe dispozitat ligjore të përsosura, megjithatë janë të kalbura nga brenda dhe nuk kanë mbarësi, sepse ato mbeten “Letër e vdekur” e nuk zbatohen si duhet nga autoritetet përkatëse. Ky moszbatim vjen se mungojnë në zemrën e zbatuesit të ligjit, besimi, virtyti, dhe morali i vërtetë, që janë fryt i besimit në Zotin dhe i edukatës fetare.

Në botë nuk ka popull dhe shoqëri pa religjion (pa fe)

Lirisht mund të konsiderohet fakti se në botë nuk ka shoqëri ose bashkësi ku nuk ekziston aktiviteti fundamental i quajtur religjion (ose fe). Religjioni është besimi aktiv individual shoqëror dhe institucional i një mjedisi të dalluar në jetën e njerëzve. Me anë të religjionit

shoqërisë i afrohet një jetë humane si në formë kënaqësie kuptimplotë krijesave të gjithësisë. Besimi është një arritje e madhe e civilizimit botërore, sepse qëllimet fundamentale të tij përqendrohen në zhvillimin e filozofisë së të menduarit, në humanizmin shpirtëror të njerëzimit, madje feja është një arritje e madhe kumore, kulturore e njerëzimit. Religjioni për një bashkësi ose komb paraqet “Një legurë shpirtërore”, me anë të së cilës fisnikërohet cilësia e komponenteve kombëtare. Në botën aktuale rrallëkund mund të takosh një popull që predikon një fe, por prania multikonfesionale ose bikonfesionale e një populli është shkas shumë më i rrallë për konflikte e acarime sesa ndarja e popujve mbi baza kombëtare, etnike ose fisnor. Kuptohet se edhe për këtë ka përjashtime në botë. Për këtë dimension të besimit, ne shqiptarët paraqesim një shembull karakteristik.

Th. Arnold për këtë problem thekson: “Ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë nuk ekziston kurrfarë antagonizmi edhe kjo ka vazhduar në breza të tërë. Faktori i besimit nuk ka qenë përçarës ndërmjet tyre”.

Artan Shaqiri

THE CULTIVATION OF INDIVIDUAL AND COLLECTIVE RESPONSIBILITY THROUGH RELIGIOUS EDUCATION

(Summary)

Religious feelings are an inherent physical and spiritual element of the human beings. No one can deny the role of religion in general and religious education in particular in a certain society due to the existence of an inner connection between them. Such a connection dates from the ancient times. Plutarch, one of the early representatives of the spiritual world, pointed out the following: “Wherever you go, you will find towns and villages with no walls, schools and theatres, but you will never find an atheist town or village which does not have shrines to worship God. There can be no civilization without faith in the Almighty God. Even if it exists, such a civilization cannot last.”

آرتان شاكيرى

المسئولية الفردية و الجماعية عن طريق التربية الدينية

(خلاصة البحث)

الشعور الدينى كعامل مهم فى حياة الانسان لم يتغيب و لا مرة واحدة عن المجتمع المتحضر. ليس هناك أحد يستطيع ان ينكر دور الدين بصفة عامة و التربية الدينية بصفة خاصة فى مجتمع انسانى محدد و ذلك لان هناك علاقة وثيقة فيما بينهما. هذه العلاقة و هذا التعاون يعتبر تاريخيا، الفيلسوف "بلوتاركو" احد الممثلين الاوائل للجانب الروحى يقول: "اينما تذهب و فى أى بقعة من العالم تتجول بمكنك ان تجد مدنا و قرى بدون اسوار و بدون مدارس و بدون ملوك و بدون مسارح و بدون نقود، و لكن لا يمكن أن تجد مدنا و قرى بدون معابد".

JURISPRODENCË

Dr. sc. Ejup Sahiti, prof. ordinar

RËNDËSIA SHKENCORE E GJURMËVE TË GISHTAVE SI SHENJË IDENTIFIKIMI KRIMINALISTIK

1. Ndikimi i zhvillimit shkencor teknik në luftimin e kriminalitetit

Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative dhe e rrezikshme paraqet dukuri shoqërore të ndërlikuar, i cili manifestohet në forma të ndryshme gjatë gjithë rrjedhës së historisë njerëzore. Meqë kurrnjehere as bashkësia as individët nuk kanë qenë indiferent ndaj veprimeve kriminale, ndaj kryesve të veprave penale është reaguar me masa dhe metoda të ndryshme, qofshin ato të karakterit moral apo fetar apo të karakterit ndëshkimor -penal. Gjithësesi, metodat që zbatoheshin për zbulimin e kryesit të krimit dhe masat që shqiptoheshin ndaj tij gjatë historisë ishin të llojllojshme dhe ato shprehin nivelin kulturo social të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në perioda të ndryshme historike. Shoqëria njerëzore e organizuar në shtet, e ballafaquar me nivel të lartë të kriminalitetit si për kah vëllimi ashtu edhe sa i përket veçorive të tij në një anë, si dhe me të ashtuquajturin numër i errët i kriminalitetit në anën tjetër, ku shumë vepra penale dhe kryes të tyre mbeshin pa u zbuluar, është dashur që në luftë kundër kriminalitetit të shërbehet me metoda të cilat në perioden e caktuar historike i ka çmuar si të domos-

doshme. Në kohën bashkëkohore ajo shërbehet gjithnjë e më shumë me të arriturat shkencore. Andaj, në vazhdim do të përqendrohemi në trajtimin e rolit të të arriturave shkencore në luftë kundër kriminalitetit.

Zhvillimi i gjithanshëm dhe dinamik i shkencës dhe teknikës, pa dyshim, i ka sjellur shoqërisë njerëzore nivel të lartë civilizimi dhe të mirëqenies materiale. Mirëpo, zhvillimin e gjithanshëm të jetës shoqërore e shoqëron edhe zhvillimi dinamik (kuantitativ dhe kualitativ) i kriminalitetit dhe i dukurive të tjera asociale. Me të drejtë mund të konstatohet se çështja penale (causa criminalis), si lëndë-objekt i të drejtës së procedurës penale (e cila është degë juridike pozitive e jurisprudence), me kalimin e kohës po bëhet gjithnjë e më e komplikuar dhe se zhvillimi i mëtejshëm i shkencës dhe teknikës patjetër do ta mbajë dhe, me gjasë, do ta përforcojë këtë tendencë.

Sot, përkundër procesit historikisht të kushtëzuar lidhur me dekriminalizimin e disa formave të sjelljes njerëzore, është i pranishëm poashtu procesi i inkriminimit të veprave penale të reja, i cili duhet të përfshijë gjithnjë e më shumë dukuri shoqërore të rrezikshme. Është e vërtetë se legjislacioni penal bashkëkohorë i inkriminon të ashtuquajturat delikte klasike siç janë: vrasja, vjedhja etj., por ai inkriminon edhe veprat penale të cilat deri para pak kohësh jo vetëm që nuk ekzistonin por ka qenë e pamundur që të mendohen (mashtrimi kompjuterik etj.). Veç kësaj, thelbësisht ka ndryshuar përmbajtja e shumë veprave penale klasike (p. sh. Vepra penale e vjedhjes¹ shekuj me rradhë nënkuptonte dhe inkriminonte veprimin e “marrjes së sendit të huaj të tundshëm ...”, me ç’rast send i tundshëm konsiderohej një objekt real – i prekshëm. S’ka dyshim se sot nën nocionin vjedhje e “sendit të tundshëm” duhet kuptuar edhe vjedhjen e energjisë elektrike etj.

Në anën tjetër, më tepër ka ndryshuar teknika dhe mjetet e kriminelve për kryerjen e veprave penale. Kështu, ndikimi i të arriturave shkencore e teknike në kriminalitet, si në aspektin e llojllojshmërisë së formave të paraqitjes, ashtu edhe sa i përket keqpërdorimit të të arriturave shkencore dhe të teknologjive të reja në kryerjen e veprave penale është karakteristikë e theksuar e shoqërisë bashkëkohore. Në

¹ Neni 134 I Ligjit penal të Kosovës.

shoqërinë bashkëkohore është evident organizimi i lartë, shpeshherë edhe në planin ndërkombëtar, specializimi dhe profesionalizimi i kriminelëve jo vetëm për kryerjen e veprave penale por edhe për mbrojtjen nga zbulimi.

Zhvillimi i shkencës dhe teknikës, sidomos në kushtet bashkëkohore, ka bërë ndikim të rëndësishëm edhe në format dhe metodat e pengimit të kriminalitetit. Të arriturat e sipër përmendura veçanërisht janë akceptuar në Kriministikë, gjë që në zbatimin praktik ka hapur mundësinë e zbulimit dhe sigurimit të provave të cilat në praktikën e më parshme as që mund të mendoheshin.

Konsiderojmë se luftimi me sukses i kriminalitetit është front i gjerë, i cili nuk mund të fitohet vetëm me perfeksionim të metodave shkencore dhe të teknikës si dhe me zbatimin e tyre në kuadër të masave represive që duhet t'i ndërmerret shteti kundër kësaj dukurie negative, por duhet bërë shumë më tepër përpjekje në planin preventiv. Andaj, në këtë drejtim me të drejtë mund të shtrohet pyetja nëse qëndron pikvështrimi se teknikës së lartë të kriminalitetit patjetër duhet kundërvënë me teknikë edhe më të lartë të kriminalitetit. Sepse, pranimi i konceptit të tillë qonë në një garë të cilën, siç tregon praktika, kriminelët janë një hap përpara!

Njeriu është qenie shoqërore i përberë nga dy komponente, nga ajo fizike dhe shpirtërore. Njeriu, si krijesë që mendon, duke u marrë me hulumtime shkencore rezultatet e studimit të vet, si për kah vëllimi ashtu edhe sa i përket saktësia dhe kualiteti, i përjeton këndshëm. Ndonse nxënja e dijes dhe marrja me punë shkencore herë herë është punë e mundimshme dhe jo rrallë përfundon pa rezultate apo me rezultate fragmentare, megjithatë është punë e këndëshme, punë e cila hulumtuesit i sjell kënaqësi, veçanërisht atëherë kur hulumtimet e tij shkencore paraqesin kontribut shkencor. Me të drejtë shkruente Hume² se sadoqë përpjekjet njerëzore në hulumtimin e ndonjë fenomeni në të kaluarën kanë qenë të pasuksesshme apo ato përpjekje mund të na duken edhe si të suksesshme, gjithnjë ekziston shpresa se me punë përkushtuese, me fat më të mirë ose me mençurine e gjeneratave të ardhshme më tutje mund të thellohen njohuritë dhe të arrihet deri te

² David Hume, Istraživanje o ljudskom razumu, Zagreb, 1988, fq. 63.

zbulimet për të cilat deri me tani nuk dihet. Në këtë drejtim do të ishte i pafalshëm gjykimi i shpejtë se një problem i tejkalon mundësitë intelektuale njerëzore, meqë të gjithë dijetarët e kohrave të ndryshme pa sukses kanë hulumtuar një fenomen. Përfundimi i tillë nuk benë të nxirret edhe poqëse inkuadrohen të gjitha butimet e njohjes dhe në një periudë të caktuar kohore konkludohet se ato janë të pamjaftueshme, sepse ndodh që edhe më tutje të mbetet ndonjë komponent e fenomenit që hulumtohet e cila nuk është marrë në konsiderim me rastin e hulumtimit.

Njerëzimi bazuar në përpjekjet e individve që merren me hulumtime shkencore nëpërmjet rrugës mendore perceptuese mund ta njoh realitetin objektiv (botën reale), ndonse shpeshherë për njohjen e disa fenomeneve natyrore është dashur të bëhen përpjekje të mëdha apo edhe më tutje do të nevojitet përpjekja e gjeneratave të ardhshme. Konstatimin se njeriu në rrugë mendore perceptuese mund ta njoh realitetin objektiv e mbështesim në ajetin kur'anor³ (El Bekare: 31) sipas të cilit "Ai (Zoti) ia mësojë Ademit emrat e të gjitha sendeve ...". Duke u mbështetur në përmbajtjen e më tejme të ajetit të sipërpërmendur del se me nocionin Adem më tepër duhet kuptuar njeriun si lloj se sa si individ. "Mësimi i emrave të të gjitha sendeve"⁴ na jep të kuptojmë se njeriu si qenie e arsyeshme është paisur me mundësinë intelektuale që nëpërmjet kërkim studimit të depertojë në fshehtësitë e fenomeneve natyrore, të zbulojë esencën dhe qëllimin e tyre dhe efektet pozitive të tyre t'i orjentojë në të mirë të njerëzimit. Dija e njeriut, si pjesë e Inteligjencës së përgjithshme, është e fshehur në thellësi të mendjes së njeriut, në thesarin e ndërtdijes së tij. Në ndërtdijen njerëzore qëndron inteligjenca e paskajshme dhe fuqia çudibërëse. Njeriu me besim në sukses dhe me përpjekje vetmohuese mund të bë-

³ El- Bekare: 31.

⁴ Nocionin "send" si objekt studimi i fillozofisë në kohën antike të Lindjes kishte domethënë të gjerë fillozofike. Në Kinë ekzistonte drejtimi fillozofik i cili quhej "shkolla e emrave". Përpjekjet e studjuesve të të shkollës së emrave synonin që, duke u marrë me trajtimin e nocioneve për të cilat mendojnë shumica e njerëzve përkitazi me atë "që gjendet brenda formave dhe veçorive", do të thotë brenda botës ekzistuese, të arrijnë të zbulojnë "atë që gjendet jashtë formave dhe veçorive". Më gjërsisht për këtë shih Fung Lu – Lan: Historia e fillozofisë kineze (përkthim nga anglishtja), "Rilindja" Prishtinë, 1987, fq. 116 etj.

jë që t'i hapet ndonjë e çarë në mbështjellsin e ndërdis, ti shëndris ndonjë shëndijë nga Inteligjenca e Përgjithshme, prej nga dalin zbulime dhe shpikje të ndryshme shkencore me vlerë të papërcaktuar për njerëzinë. Prandaj e drejtë, dhe do të shtoja, detyrë e secilit “është që të zbuloj botën e brendëshme të mendimeve, të ndnjenjave, të forcës, të dritës dhe të bukuriës. Edhe pse të padukshme, fuqitë e ndërdis janë të furishme”.⁵

Ndonse gjatë zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore mund të hasen religjione të cilat jeten e tyre e shohin në menjanimin (mohimin) e shkencës,⁶ sikurse që ka edhe të atilla që në një periudhë historike ishin në konflikt të ashpër me shkencën, Kur'ani e lartësojë vlerën e diturisë dhe e ngriti pozitën e dijetarëve aq lartë sa që nuk e ka shembullin në librat e mëparshëm të religjioneve të mëparshëm.⁷

Në të vërtetë, megjithëse baza themelore e besimit islam është besimi në Allah – Zotin e madhrishëm, urdhëri i parë Kur'anor që iu shpall profetit Muhamed a. s. është: “Lexo (mëso, studio) në emër të krijuesit ...” Kur'ani më tutje në mënyrë permanente e nxitë njeriun në shfrytëzimin e mendjes për të zgjeruar diturinë.⁸ Kjo porosi hyjnore ishte një ngjarje madhështore historike. Se muslimanet e moren me seriozitet këtë porosi hyjnore flet fakti se nëpër qendra urbane u hapen shkolla, ndërsa nëpër qytete të mëdha u themeluan universitete dhe biblioteka me qindra mijë ekzemplarë librash.

Nuk ka pse të habitemi kur thuhet se Kur'ani është burim i shkencave. Gjithë ajo për të cilën flet Kur'ani ka qenë temë studimi e dijetarëve dhe komentatorëve (mufesirve), kështuqë veprimi i tyre hapi rrugë të gjerë për hulumtime empirike. Kjo gjithsesi solli deri te përparimi i muslimanve në fusha të ndryshme të shkencës, rrezet e të cilit u reflektuan edhe jashtë kufijve të shoqërisë muslimane. Me këtë rast vlen të potencohet fakti se nuk ka ndonjë fushë të zhvillimit evropian në të cilën civilizimi Islam nuk ka pasur ndikim. Këtë fakt të pamohu-

eshëm nuk hezitojnë ta pranojnë orjentalistë të shumtë perendimor. Në këtë drejtim me arsye mund të shtrohet pyetja nëse muslimanët sot do duhej të mjaftohen në krenarinë e tyre duke i rikujtuar meritat e gjeneratave të herëshme, të cilat me siguri nuk mund të mohohen, pa e analizuar në mënyrë kritike gjendjen e tyre të sotshme?

Kur'ani si libër i shejtë përmban rregulla, udhëzime dhe rekomandime nga fusha të ndryshme të jetës dhe besimit të individit dhe të jetës së bashkësisë njerëzore. Meqë shpallja hyjnore u dedikohet të gjithë njerëzve, për t'ia afuar njerëzve kuptimin dhe veçoritë e Hyjnisë, i cili është transshendent, patjetër duhet të shërbehet me gjuhë dhe nocione të shprehjës të cilat janë të kuptueshme për njeriun. Duke e shprehurdhe përshkruar atë që është në transhendentën përdori nocione që janë imanente për njohjen njerëzore të botës reale si psh. Zoti “sheh”, “dëgjon” e tj. Pra edhe kur ka të bëjë me transhendenten, që nuk ka ekvivalent në botën e krijuar, shpallja shërbehet me nocionet që i përkasin botës njerëzore. Prandaj gjuha e Shpalljes shpeshherë është metaforike dhe simbolike⁹ dhe se aftësitë mendore të njiut janë të pamjaftueshme për të depërtuar në essence të asaj që është trashe-dente. Mirëpo, për fenomenet që e rrethojnë ambijentin e njeriut dhe për çështje të tjera me interes për njerëzinë herëherë njohuritë jepen në formë parimesh apo ofrohen asisojë që për kuptimin e brendisë së tyre kërkohet studim, përpjekje shitesë e njerëzisë. Ato pra e nxisin njerëzinë (dijetarët) që të mendojnë për to dhe nëpërmjet studimit të tyre të gjejnë zgjidhjet adekuate.. Kësisoj, shumë fenomene kur'anore, të cilat në fillim të civilizimit islam, ishin të panjohura, me kalimin e kohës dijetarët zbuluan kuptimin e tyre. Ka edhe të atilla për gjetjen e kuptimit të të cilave do të nevojitet përpjekje e vazhdueshme edhe në të ardhmen. Njeriu sot ka treguar aftësi ta zbërthej atomin dhe të udhëtojë në gjithësi. Marrë teorikisht njeriu, siç kemi theksuar më lartë, ka aftësi zbulimi të pakufizuara. Mirëpo praktika ka treguar se për të depërtuar në fshehtësi të fenomeneve – për t'i zbuluar ato shpeshherë duhen përpjekje të vazhdueshme jo vetëm të një individi por përpjekje të shumë e shumë gjeneratave.

⁹ Sipas citimit të Daniel Bučan-it në fq. xxv-xxvi të parathënies së librit: *Averoës, Nesuvislost nesuvislosti*, Zagreb, 1988 – (përkthim e veprës filozofike të Ibni Rushdit, *Tehafut-et-tehafut*).

⁵ Dr. Khozef Marfi, *Forca e ndërdis, (përkthim shqip)* Prizren, 2001, fq. 13.

⁶ Në librin e përmendur më sipër – *Historia e fillozofisë kineze* thuhet se Taoistët e kanë idealizuar thjeshtësinë e shoqërisë primitive dhe e kanë denuar qytetrimin. Ata gjithash-tu e idealizojnë virgjërinë e fëmijëve dhe e urrenin dijeninë.

⁷ Ali imran:18; Taha:114; Ez-Zumer:9; El-Muxhadale 11; Fatir: 28 etj.

⁸ (El Bekare: 44; El En'am: 50 etj.).

Sipas ideologjisë Islame Kur'ani është shpallur për gjithë njerëzinë. E pranon ai I cili dëshiron; nuk mund t'i imponohet askujt (El Bekare: 256). Pavarësisht a pranohet si libër i shejtë apo jo, ai mund të jetë dhe de fakto është objekt studimi edhe në tavolinen e atyre që nuk e njohin si të tillë. Ndryshe, si do të mund të spjegohet fakti se shumë zbulime shkencore që përputhen me thëniet kur'anore i bënë jomuslimanët.

Nga gjithë kjo që thamë më sipër mund të konkludohet se hulumtimet shkencore në çdo fushë janë të domosdoshme dhe se kjo edhe në aspektin fetar është imperativ. Prandaj është primitivizëm të mos besosh në shkencë. Mirëpo, është primitivizëm gjithashtu, ndoshta edhe më i madh, të besosh në gjithfuqishmërinë e shkencës në një moment të caktuar.

Përpjekjet e vazhdueshme të shoqërisë njerëzore për t'u përballur me sukses me kriminalitetin kanë rezultuar me zbulime të rëndësishme si përsa i përket metodave për vërtetimin e identitetit të kryesit të veprës penale ashtu edhe përsa i përket zbulimit dhe fiksimit të provave. S'ka dyshim se zbulimi i gjurmëve të gishtave si shenjë identifikimi është një ndër zbulimet e rëndësishme në këtë fushë.

2. Përdorimi i gjurmëve të gishtave si mjet për identifikimin e individit

2.1. Historik i shkurtër mbi shfrytëzimin e gjurmëve të gishtave

Kur vështrojmë historikun e shfrytëzimit të gjurmëve papilare për nevoja identifikimi (daktiloskopisë) dallojmë tri perioda: parahistorike, empirike dhe shkencore¹⁰. Për periudhën parahistorike vështirë mund të përcaktohet rëndësia e gjurmëve të gishtave, të cilat i hasim në shpella dhe posaçërisht në keramikë. Në zbulimet arkeologjike të Babilonasve dhe të Asirianve shpesh hasen gjurmët e gishtave. Supozohet se gjurmët e gishtave të gjetura në disa pllaka të zbuluara në Ninivë, kanë rëndësinë e nënshkrimit. Periudha empirike fillon diç para epokës sonë dhe përfundon në gjysmen e shekullit XIX dhe karakterizohet me shfrytëzimin e gjurmëve të gishtave për

qëllime identifikimi. Kësisojë, gjurmët e gishtave janë shfrytëzuar në Lindjen e Largët kur kinezët dhe japonezët në fund të kontratave që lidhnin vendosnin gjurmët e gishtave me të cilat zëvendësonin nënshkrimet e tyre. Disa kriminalistë dhe biologë evropian, që kanë vizituar Kinën, kanë bërë studime mbi këto dokumente dha kanë dalë në përfundim se gjurmët e gishtave të vendosura në vend të nënshkrimeve të tyre kanë pasur më tepër karakter mistik për ta lidhur personin me një kontakt material. Këto gjurmë pasqyrojnë më shumë një njollë të padallueshme se sa një figurë të rregullt papilare¹¹.

Për Grekët e vjetër dhe për Romakët nuk ka prova se gjurmët e gishtave janë përdorur për identifikim.

Zhvillimit të daktiloskopisë i kanë kontribuar edhe hulumtimet anatomike të lëkurës së njeriut që nga gjysma e dytë e shekullit XVII deri në gjysmën e shekullit XIX të kryera nga hulumtues anglez, italian etj.

Mund të thuhet se aplikimi praktik i gjurmëve të gishtave si mjet identifikimi në Lindjen e Largët dhe në Lindjen e Mesme, si dhe hulumtimet shkencore të anatomeve mbi natyrën dhe format e figurave papilare, kanë përgatitur terenin për zbulim dhe pranim të daktiloskopisë si system identifikimi.

Daktiloskopia është metodë studimi, krahasimi dhe klasifikimi i vijave papilare me qëllim identifikimi të personave në bazë të karakteristikave individuale që ekzistojnë në vijat papilare¹².

Daktiloskopia si shkencë e gjurmëve të gishtave siç e njohim ne sot është e re. Piknisja e saj zë fill në punën e dy anglezve në të njëjtën kohë, por në mënyrë të pavarur nga njeri-tjetri, të cilët punonin në Azi. William J. Herschell si administrator i Bengalit (Indi) në vitin 1858 fillojë studimin e gjurmëve të gishtave me qëllim aplikimi praktik të tyre. Si administrator ishte i ballafaquar me keqpërdorime që i bënin punëtorët vendor analfabet me rastin e pagimit të rrogave ose të pensioneve dhe vështirësitë për identifikimin e tyre, atij i lindi ideja që në fundin e kontratave që lidhte me banorët vendor të vendoste gjurmët e gishtave të tyre. Me këtë veprim ai shfrytëzoi zakonet e vjerta lindore të besimit që kishin banorët kur linin gjurmë materiale

¹⁰ Tomislav Marković, Savremena tehnika istraživanja krivičnih djela Zagreb, 1961, fq. 66.

¹¹ Skender Begeja, Kriminalistika, Tiranë, 1997, fq. 96.

¹² Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë 2001, fq. 50.

të një pjese të trupit. Kjo iniciativë i dha mundësi atij të familjarizohet me figurat e gishtave. Ai konstatoi ndryshimet e mëdha që kishin gjurmët e gishtave. Edhe Henri Faulds drejtues i spitalit Tsukiji në Tokio u muar me studimin e gjurmëve të pasqyruara në poçeritë japoneze. Në të njejtën kohë atij i takoj të analizojë gjurmët e gishtave në dy çështje penale (1879-1880). Në rastin e parë ai arriti të identifikojë personin në bazë të gjurmëve të gishtave të lëna në një gotë uji dhe në rastin tjetër vërtetoi mungesën e identitetit¹³.

Edhe mjeku skotlandez Francis Galton u mor me studimin e gjurmëve të gishtave duke e analizuar problemin nën prizmin biologjik. Nga ky studim Galtoni doli në përfundim se vijat papilare nuk janë të trashigueshme dhe se ato ishin të pandryshueshme gjatë gjithë jetës së njeriut.

Duke iu falenderuar studiuesve të sipërpërmendur dhe studiuesve që pasuan rrugën e tyre dhe përdorimit të kompjuterit daktiloskopia sot konsiderohet mjet identifikim më i sigurtë.

2.2. Çka thot Kur'ani për vijat papilare

...

2.3. Karakteristikat e figurave të vijave papilare dhe rëndësia e tyre shkencore për identifikim

Nëse me vemëndje e shikojmë shuplakën e dorës, posaçërisht majet (pjesen e tretë) e gishtave, edhe me shikim të thjeshtë do të vërejmë se lëkura nuk është e rrafshët por në të paraqiten kanale dhe kreshta, të qitura të lëkurës të cilat krijojnë figura (vija) me forma të ndryshme, të cilat në kriminalistikë quhen figura papilare. Vijat e tilla papilare formojnë figura të ndryshme harkore, lakore, rrethore etj., të cilat në praktikë mundësonë klasifikimet e vijave papilare. Ato janë shumë të rëndësishme për identifikimin e njeriut. Figurat papilare të gishtave kanë disa cilësi:

- figurat papilare nuk ndryshojnë nga lindja deri te zbrërthimi i lëkurës dhe se në rast dëmtimi gjatë jetës së njeriut ato regjenerohen;

- figurat papilare janë individuale, çka do të thotë se nuk ekzistojnë dy njerëz me figura papilare të të njejtë.

Në aspektin praktik është veti thelbësore se figurat papilare mund të klasifikohen dhe se me ndihmen e kompjuterit shumë shpejt bëhet krahasimi i gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes me gjurmët e atij personi nëse ato gjenden në evidencën kompjuterike.

Për nevoja kriminalistike rëndësi të veçantë ka rrethana se figurat papilare, me që në to gjenden daljet e gjëndrrave të djersitjes, çdo prekje e tyre me sipërfaqe të lëmojta, të ngurrta dhe të terura lënë gjurmë të dukshme ose të padukshme të gishtave (të cilat me metoda të ndryshme mund të bëhen të dukshme) dhe ato mund të fiksohen dhe të përdoren për identifikim. Me identifikimin e personave në bazë të gjurmëve të gishtave të tyre merret daktiloskopia si një nëndegë e Kriminalistikës. Si metodë identifikimi sot është e pazavendësueshme.

Bazë e sistemit bashkëkohorë të identifikimit paraqesin evidencat daktiloskopike, sepse gjurmët e vijave papilare janë element më stabil, më i qëndrueshëm dhe më i llojllojshëm të cilat përjashtojnë çfardo lajthimi të mundshëm. Që të sjellin gjurmët e regjistruara jo vetëm deri te identiteti i dy gjurmëve, por edhe deri të vërtetimi i identitetit në mënyrë të pamohueshme, është e nevojshme që të dhënat e personit me të cilin krahasohen gjurmët e vijave papilare të shenuara në kartotekë (të futura në kompjuter) të jenë marrë nga shenimet origjinale mbi gjendjen statusore të atij personi (qërtifikatë e lindjes, vdekjes, letërnjoftimi etj.).

Daktiloskopia si metodë identifikimi sot ka shtrirje të gjërë zbatimi. Kështu, varësisht nga gjurmët e vijave papilare (të një ose të dhjetë gishtave, të shuplakës së dorës apo të shputës së këmbës) dhe varësisht nga ajo se identifikimi i çfarë personave duhet të bëhet (kryesve të panjohur të veprave penale, kufomave që kanë pësuar në ndonjë fatkeqësi hekurudhore, ajrore, në termet etj.) mund të flitet për lloje të ndryshme të daktiloskopisë. Përcaktimi i fajtorit në bazë të gjurmëve papilare të lëna në vendin e kryerjes së veprës penale është rezultat i disa proceseve. Niset me zbulimin, dhe vazhdon me fiksimin, marrjen e gjurmëve, përgatitjen e materialeve për krahasim dhe ekspertimin e tyre. Secili nga këto procese ka metodat e veta të veça-

¹³ Ibid.

nta. Evidenca e kompjuterizuar daktiloskopike sot mundësojnë identifikim efikas dhe të shpejtë.

Dr. Sc. Ejup Sahiti

THE ROLE OF SCIENCE IN THE FIGHT AGAINST CRIME

(Summary)

Crime is a negative and dangerous phenomenon in society. It is a complex social phenomenon, which has manifested itself in different forms in the course of the history of mankind. Criminal acts have always been a great concern to the society. Therefore, the society has always applied different measures against the perpetrators of such crimes (of a moral-religious character or of a penal character). The methods that were used to find the perpetrators of different crimes and the measures applied against them varied in different periods of time (they expressed the level of the social and cultural development of the human society in different periods of time). The human society being confronted with large numbers of crimes (a large number of crimes and their perpetrators are never identified) had to apply certain methods to fight this phenomenon (methods that were deemed necessary in certain periods of time). In the present days the human society uses science in its fight against crime. In this work we will focus on the role of science in the fight against crime.

أيوب ساهيتي

الاهمية العلمية لأثار الاصابع كدليل لاثبات الجرائم

(خلاص البحث)

الجريمة كظاهرة اجتماعية سلبية تعتبر ظاهرة اجتماعية معقدة ظهرت بصور مختلفة عبر التاريخ. و بما أن رد الفعل ضد الاعمال الاجرامية سواء كان من الافراد او الجماعات كان بطرق و مقاييس مختلفة سواء كان بمعايير اخلاقية دينية او معايير قانونية. استخدام الطرق لكشف الجرائم و تنفيذها و العقوبات التي تصدر في حقهم عبر التاريخ كانت متنوعة و هي تعبر عن التطور الثقافي و الاجتماعي للانسان عبر عهود مختلفة.

Korçën dhe Shkodrën, pasi kishim parë shumë qytete të Jugosllavisë, gjetëm në Gjirokastrë një madhështi të shkëlqyer dhe një individualitet të theksuar. Nuk besojmë të ketë në botë një qytet tjetër si Gjirokastra. Ka pjesë përrallore, por që kanë parë ditë të shkëlqyera...”² Kjo ngase dekori i qytetërimeve mbështolli gjithçka në këtë qytet dhe u shtresëzua në atë mënyrë që rrezatimi i tij të jetë i përjetshëm.

ARKITEKTURË

Dr. Ramiz Zekaj

NDIKIMI I ARKITEKTURËS ISLAME NË NDËRTIMET GJIROKASTRITE

Hyrje

Gjirokastra është një qytet monumental, trashëgimtar i kulturave dhe qytetërimeve të lashta që banorët e saj i ruajtën me kujdes si gjënë e tyre më të çmuar. Ai nuk është qyteti më i madh i trojeve shqiptare, por pa dyshim që është njëri ndër më të bukurit. Jo rastësisht ky qytet mahniti dhe bëri për vete të gjithë: mysafirët, udhëpërshkrues, artistë, poetë, historianë e kështu me radhë...

Evlija Çelebiu, udhëpërshkruesi që në shek. XVII shëtit jo vetëm Ballkanin po edhe Azinë, Arabinë, Egjiptin, Rusinë, Gjermaninë, Holandën e Suedinë, për Gjirokastrën dhe banorët e saj shprehej kështu: “Ky qytet ka një klimë shumë të bukur e të freskët, prandaj banorët e tij kanë një trup të drejtë e të gjatë. Është për t’u lavdëruar bukuria, si ndër meshkuj edhe ndër femra... Gjirokastra është vend burrërie. Sistemi i ndërtimit të mureve të kështjellës në Gjirokastrë nuk ka shembull në të gjithë botën”.¹

Ndërsa, kur një çift anglez, Kora e Xhon Gordon, pa për herë të parë Gjirokastrën, shkroi: “Pasi pamë Tiranën, Elbasanin, Pogradecin,

Pak histori..

Tema “Ndikimi i arkitekturës islame në ndërtimet gjirokastrite gjatë shekujve XV-XIX”, mund dhe meriton të trajtohet në disa disiplina e fusha studimore. Kjo na detyron që për lexuesin fillimisht të japim një tablo të situatës në kohën kur arti, kultura dhe feja islame po hidhte shtat në trojet tona.

Tashmë dihet se në pjesën e Ilirisë, përkatësisht të Dardanisë Antike, përkatësisht në Albaninë mesjetare u zhvillua njëri ndër krishterimet më të hershme që me manastiret romake perëndimore dhe ritet bizantine lindore joshi dhe rrezatoi në ndërtimin e një mentaliteti të veçantë, të një shoqërie të re urbane rreth peshkopit dhe aq më shumë rreth famullive që formoheshin ngadalë në brendësi të dioqezave, derisa jeta fetare kristiane vendoset edhe në ambientet e aristokracisë rurale dhe ushtarake, që ngrenë kishëzat e tyre vetjake, prej nga do të lindë bota e traditave dhe vlerave të reja kristiane të modeluara nga mitologjitë pagane të dikurshme të ilirëve, por tashmë të sistemuara në një frymë të re hyjnore-teologjike.

Ky krishterim (i ardhur nga Palestina e lashtë), ka lënë në vendin tonë kryevepra të mahnitshme në mozaikët e antikitetit të vonë dhe sidomos në ikonografinë mesjetare³.

Por jehonat e Lindjes nuk po ndalonin, bota po përjetonte zhvillime të reja, feja islame që kishte lindur në Arabi, po shtrihej tashmë në të tre kontinentet.

Feja, kultura dhe qytetërimi i ri tashmë nuk po vinte vetëm nga Lindja, veçse njëkohësisht rrezatonte edhe nga brigjet e Sicilisë dhe Portugalisë.

² Ferid Hudhri, Shqipëria dhe shqiptarët në vepra të piktorëve të huaj, 1987, 106.

³ Moikom Zeqo, Princërit e Mistikës, 1998, 13.

¹ Evlia Çelebi, Shqipëria 350 vjet më parë, 2000, 27, 32

Bota tashmë iu nënshtrua një qytetërimi të ri, i cili në shekujt e shtatë e të tetë përfshinte Persinë, Mesopotaminë, Egjiptin, Afrikën e Veriut dhe Spanjën. Kronikanët bizantinë thonë shprehimisht se prijësit strategë arabë - Soldani, Samba dhe Kallfa e 36 anije pushtuan edhe shumë qytete iliro-shqiptare në Dalmaci, gjatë viteve 867-876. Perandori dijetar i Bizantit, Konstandin Porfirogjeneti (i shekullit XI) thotë se arabët pushtuan Budvën, Kotorrin, Rizonin, dhe më pas kaluan në Otranto ku pushtuan qytetin e rëndësishëm të Barit. Pikërisht në shekullin IX, vërshimi arab mbartte me vete atë kulturë të Lindjes që po shkëlqente...duke bërë që fytyra kulturore e kontinentit të vjetër, të fitonte tipare të reja dhe të nxiste një ndryshueshmëri kulturore të pashembullt të Perëndimit.⁴

Kështu islamizmi u fuqizua dhe arabët u bënë pushtuesit e kontinenteve. Arabët krijuan kështu një histori të tyre, pa të cilën nuk mund të kuptohet historia botërore, siç nuk mund të kuptohet as pa historitë e babilonasve, indianëve, kinezëve, romakëve dhe bizantinëve.⁵

Në fillim të shek.IV, vllimet e vrullshme përbrenda tronditën mbretëritë e mëdha që shtriheshin ndërmjet Oksusit dhe Danubit – Mbretërinë ilhanidase në Iran, hordhinë e artë në Evropën Lindore dhe Mbretërinë Bizantine në Ballkan dhe në Anadoll. Në fund të të njëjtit shekull, pasardhësit e Osmanit do të formojnë një perandori të re, që shtrihej prej Danubi deri në Eufrat.⁶

Në shekullin XV, edhe Ballkani u përfshi në kuadër të sistemit feudal osman, ku përjetoj ndryshime rënjësore në jetën ekonomike, shoqërore e politike. Ky sistem i cili ishte mjaft kompleks në natyrën e vet, gradualisht edhe në trojet shqiptare po sillte një kulturë të re, një qytetërim të ri. Dekori i qytetërimit të mëparshëm nuk ndryshoi përnjëherësh me dyndjet dhe luftërat e mëdha. Vatrast tradicionale të kulturës, pavarësisht nga rrethanat e reja të krijuara, vazhdonin të ekzistonin dhe të rrezatonin nga e tanishmja tek e ardhmja. Kështu shumë qytete jo vetëm që ruajtën gjallërinë e tyre, por ato edhe u zhvilluan më tepër duke u kthyer në qendra të mëdha urbane, ku prania e tregëtarëve orientallë dhe mallrave të tyre po sillte një luks dhe eksperiencë të re.

⁴ Po aty, f.14.

⁵ Po aty, f.16

⁶ Halil Inalxhik, Perandoria Osmane, 1995, 9.

Ndërtimet në gur, stofrat, argjendaritë, punimet me metale, dru e qeramikë po merrnin dimensione të reja. Gjatë kësaj kohe qytete si Selaniku, Roma, Marseja, Arli, Narbona, Orleani, mbetën porte të Lindjes.⁷ Por gjithsesi vatrast urbane më të rëndësishme mbetën ato që shërbenin si rezidenca për mbretërit, pashallarët, selitë e peshkopatave si dhe qendrat fetare me influencë.

Gjatë shekullit XVI u forcuan mjaft marrëdhëniet tregtare ndërbalkanike. Në portet e Lezhës, Shkodrës, Vlorës e Durrësit, punonin gjithnjë e më tepër tregtarë vendës e të huaj, që sillnin nga perëndimi mallra për në krahinat e Ballkanit (Sofje, Selanik, Stamboll). Nga vendi ynë në këtë kohë eksportohej dru, peshk, fasule, kripë, asfalt, lesh, lëkurë e shumë drithë.⁸

Nga vende të largëta si Anadolli, Armenia, Egjipti etj. vinin karvane me mallra të ndryshme. Forcimi i zejtarisë në kushtet e rritjes së qyteteve tona si dhe aktivizimi i panairëve, i fuqizuan së tepërmi marrëdhëniet tregtare të brendshme e të jashtme, duke influencuar kështu në zhvillimin me ritme të shpejta të qyteteve shqiptare gjatë shekullit XVII, të cilët në këtë kohë njohën kriteret më të avancuara urbanistike. Popullsia e tyre, tashmë e rritur si numër dhe e diferencuar si strukturë sociale e ekonomike, është vendosur deri larg mureve rrethuese të kalave, ku ka formuar lagjet e banuara nga shtresa të ndryshme shoqërore.⁹ Veç zhvillimit të qyteteve të njohura, si Shkodra, Prizreni, Berati, Elbasani etj gjatë shekullit XVII u evidentuan edhe disa qendra të reja, ndër të cilat edhe Gjirokastra.

Në këtë qendër banimi pas vitit 1385 u shtri principata e Gjin Zenebishit, çka bëri që ky qytet të mbajë emrin: Qyteza-kështjellë e Gjinit, “Gjinokastra”.¹⁰

Sipas Evlija Çelebiut Gjirokastra gjatë kësaj kohe ishte një kadillëk me 180 akçe dhe rreth 2000 shtëpi. Në çarkun e saj bënin pjesë shumë katunde.¹¹ Gjatë shekullit XVIII me zgjerimin e tregut të brendshëm, me lulëzimin e esnafëve dhe me përhapjen e mëtejme të

⁷ Jacques Le Goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, 1998, 148.

⁸ Zija Shkodra, Esnafet Shqiptare, 1973, 24.

⁹ Valter Shtylla, Rugët dhe Urat e Vjetra në Shqipëri, 1997,72.

¹⁰ Mexhid Kokalari, Epiri, kryeqendra e qytetërimit antik në Evropë, 2001, 60.

¹¹ Evlia Celebi, Shqipëria 350 vjet më parë, 2000, 21.

pronës së madhe feudale, në qytet u shtua ndjeshëm numri i zejeve. Gjirokastra në këtë kohë kishte mbi 300 dyqane. Ndërkohë që në shekullin XIX esnafë gjirokastrit kishte agjenci tregtare në qytete të ndryshme brenda e jashtë vendit dhe ndiqte rregullisht tregjet ballkanike – Selanikun, Sofjen, Beogradin, Stambollin si dhe qytetet tregtare të Adriatikut dhe Mesdheut – Venedikun, Trieshtën, Napolin, Gjenovën, Ankonën, Marsejën, Tripolin, etj. Si tregtarët ashtu edhe çifligarët eksportonin kryesisht mallra bujqësore dhe artikuj të artizanatit artistik, ndërsa artikujt e importit përbëheshin prej mallrave të tekstilit, prodhimeve metalike, armëve etj.¹²

Ndërtimet gjirokastrite

I tërë ky zhvillim gjatë kësaj periudhe disashekullore për të kënaqur në rend të parë nevojat thelbësore të jetesës, bëri që qyteti i Gjirokastrës të ketë një përparim të veçantë në ndërtim. Në këtë periudhë u ndërtuan shumë hane (karavansaraje), karakolle, kroje, ura, medrese, shtëpi etj., ku përgjithësisht dominonte guri i cili simbolizonte prestigjin dhe pasurinë, gjë që i bënte gjirokastritët të përngjanin me borgjezët që ngrenë shtëpi të forta dhe të bukura. Ato mobiloheshin me sexhade e qilima që bashkë me elementet e theksuara orientale të modës së kohës, bartnin edhe vlerat tradicionale shqiptare.

Relievi i qytetit të Gjirokastrës është i veçantë, çka bënte që ndërtimet përgjithësisht të spikatnin për nga kompozimi i tyre arkitektonik. Shtëpitë ishin të larta, me dhjetëra dritare të gjera në fasadën kyesore, me ballkon të thellë që del jashtë mureve... Ndërtimet me gurë kishin edhe elemente të tjera dekorative, siç ishin relievet e gdhendura në ballë të qemerëve, konsolat e dala në formë trotuari në muret ballore, gurët me datën e mbishkrimit etj. Edhe ndërhyrjet me punime druri ishin mjaft funksionale-konstruktive si një zgjidhje kompozicionale me vlera arkitektoniko-ambientale. Kjo paraqitet qartë sidomos në dysheme, tavane, parmakë, flegra dollapesh, dhipatosët e odës së miqve, mimeret dhe mihrabet e xhamive etj.

Pa dyshim një prej kulmeve të banesës gjirokastrite përbën Banesa e Zekateve që zë kryet e lagjes Palorto, e ndërtuar rreth viteve 1811-

1812. Ndërkohë që banesa e xhokaxhinjve e ngritur në lagjen “Përrroi”, paraqet një prej shembujve më të goditur të banesës me çardak, e cila ruan elemente të lashta kompozicionale si dhe arkitektonike e konstruktive të tipologjisë së shekujve XVIII, në mos më të hershëm.¹³ Në kohën kur u krijuan, këto vepra patën rëndësi të madhe, pasi përfitohej nga një eksperiencë artistike dhe ndërtimore që vinte nga vende të ndryshme ballkanike, perëndimore dhe lindore, për të krijuar një vlerë të re me punime madhështore ku spikat individualiteti i theksuar kombëtar.

Gjatë kësaj kohe mjeshtrit shqiptarë i gjen jo vetëm në trojet e tyre por në të gjitha pikat e imperatorisë dhe që nga Frati e gjer ke Drini, në Misir, në Tonus dhe Xhezair, arnautët ose shqiptarët janë më të mirët...¹⁴ Ndërkohë që Samiu shprehej: “Shqipëria në këtë kohë u bë m’e pasurë e m’e begatë se kurdo; se shqiptarëtë suleshinë bashkë me tyrqitë nëpër gjith’ anët e botës dhe këtheheshinë ngarkuarë me ar e me ergjënt, me armë të vjejtura (vlefshme) e me kuaj të bukurë t’Arabisë, t’Egjyptësë, të Qyrdistanit, t’Ungarisë” etj.¹⁵

Ndikimi i arkitekturës islame në ndërtesën gjirokastrite

Dihet se Islami erdhi në trojet shqiptare pas feve të tjera të mëdha të botës, dhe artet e tij treguan ngjashmëri dhe vazhdimësi të asaj që kaloi më parë, si në formë ashtu edhe në detaj. Kjo ngjashmëri është veçanërisht prezente kur kemi të bëjmë me arkitekturën. Prapëseprapë, nëse çështja shihet me kujdes, është e mundur të paraqitet ndryshimi mes arkitekturës islame dhe të tjerave.

Në strukturën e ndërtimit arkitektura islame ndër ne ndahet në fetare dhe shekullare. Mes ndërtesave shekullare, më të rëndësishmet janë pallatet e udhëheqësve siç ishte ai i Memi pashës, i Osman beut, dhe i Zaim beut në Gjirokastër. Në kohët e hershme, veçanërisht gjatë periudhës bizantino-romake, pallatet e udhëheqësve ndërtoheshin në vende të larta në formë kalash e kështjellash. Më vonë, me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, ato u ndërtuan në qytet, zakonisht

¹³ Emin Riza, Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri, 1997, 104-105.

¹⁴ Lumo Skendo, Udhëtarët e huaj në Shqipëri (gjer në fund të shek. XIX), 1999, 36.

¹⁵ Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë ç’është e çdo të bëhetë? 2001, 31.

¹² V. Shtylla, vep.cit., 75.

afer xhamive. Gjatë shekujve XV-XIX në Gjirokastër, por edhe në qytete të tjera shqiptare pallatet e rëndësishme filluan të ndërtoheshin në kopshte dhe të rrethoheshin me mure, të ndërtuara nga gurët e bardhë e të prerë apostafat. Evlija Çelebiu thotë se gurët që janë përdorur me aq mjeshtëri në ndëtimet gjirokastrite, nuk mund të gjenden në vende tjera të botës, përveç se në Tire e Magnisë të Anadollit.¹⁶

Lloje të tjera të ndërtesave shekullare gjirokastrite përfshijnë hamamet (banjot), maristanet (spitalet), suk (pazaret) dhe vakëfet, që ishin ndërtuar nga shteti ose nga persona të pasur. Vakëfet funksiononin si pallate pushimi për udhëtarë në të gjitha vendet e Perandorisë. Ato shpesh përdorreshin edhe si vende lutjeje, ngase ua mundësonin besimtarëve të kryenin faljet edhe gjatë udhëtimit. Dihet se udhëtimi bëhej të shumtën e rasteve më këmbë, sepse rrugët dhe lehtësitë e tjera nuk ekzistonin.

Forma të tjera të strukturës shekullare në arkitekturën islame gjirokastrite përbëjnë edhe dyqanet, bujtinat (si Hani i Memi pashës), kullat e fortifikuara për mbrojtje nga sulmet e mundshme etj.

Ndërtesat fetare në Gjirokastër përfshijnë xhamitë (gjithsej tetë), medresetë ose shkollat fetare (tri), tyrbet e teqetë. Edhe pse muslimanët mund të kryejnë faljet e tyre kudo, në shtëpitë e tyre, në vendet e punës, ose në ndonjë hapësirë të hapur, përparësi i jepet kryerjes së namazeve në grupe të mëdha. Xhamitë janë ndërtuar pikërisht për këtë qëllim.

Në Gjirokastër, xhamitë ishin jo vetëm vende adhurimi, por ato gjithashtu funksiononin si vende të administrimit, drejtësisë, edukimit fetar, ashtu si edhe vende për të mbajtur takime të ndryshme, për të diskutuar çështje të lidhura me ndihmën sociale etj.

Para praktikimit të faljes, një musliman ose muslimane duhet të kryejë marrjen e abdesit (vudu). Gjatë namazit, ai duhet t'i drejtohet kiblesë (drejtimit të Qabesë në Mekë). Në xhami, kibleja tregohet nga një mihrab, një vend i shënuar (zakonisht i futur në formë gjysmëharkore) në mur në ballë të xhamisë, ku imami (udhëheqësi) drejton një falje. Mihrabi në shumë xhami është i zbukuruar me gdhendje tërheqëse ose me kaligrafi dekorativo-funksionale. Në të djathtë të mihra-

bit qëndron një mimber ose katedër, që është e ndërtuar nga druri i stilizuar, mermeri ose guri.

Disenjimet e xhamive në Gjirokastër ishin ngushtë të lidhura me funksionet e tyre që përcaktonte mjedisi i këtij qyteti. Kështu afër minares së Xhamisë së Pajazit Khanit të Shenjtë kishte një depo uji, ku mblidheshin ujërat e shirave që kullonin nga rasiat e pullazeve të fortesës. Uji i shiut bie poshtë nëpërmjet pjerrësisë së çatisë shumë shpejt. Kjo do të parandalojë amullinë e ujit mbi çati dhe ndihmon në shpëtimin e mbajtëseve të drunjtë të çatisë nga kalbja. Hapësirat mes shtresës në çati do të funksionojë si kalime filtrimi që ndihmon në qarkullimin e ajrit mes tyre. Nga kjo depo pinin ujë të gjithë banorët e fortesës.

Disa aspekte të rëndësishme të arkitekturës Islame në banesën gjirokastrite janë:

1.Krijimi, skicimi artistik në qeramikë

Ky lloj arti në arkitekturën islame është influencuar nga qeramikat kineze. Ky u zhvillua nëpërmjet një procesi evoluimi të vazhdueshëm, bartur nga një qytetërim tek tjetri, që në të njëjtën kohë zbuloi zhvillimin e punimeve të artit të qeramikës. Nuk është përcaktuar ende se kur është njohur në botë arti i punimit të porcelanit, por mendohet se ai do të ketë filluar në të njëjtën kohë me zhvillimin e teknologjisë agrikuturore. Në Kinën e vjetër vazot e porcelanit ishin një mall me vlerë në jetën e përditshme të kinezit dhe gjatë festivaleve. Gjatë funeraleve, porcelani varrosej gjithashtu së bashku me të vdekurin. Kjo simbolizon statusin social të njeriut në jetë, si e vetmja pasuri që kishte të drejtë të varrosej me të vdekurin. Shembujt më të njohur të porcelanit parahistorik të Kinës janë qeramikat e pikturuara nga Pan-p'o në rrethin e Shensit.

Me shtrirjen e Islamit në Azinë e Largët, filloi edhe bartja ose procesi i huasë nga kultura, arti e filozofia e lindjes në atë arabe, perse e kështu me radhë. Sigurisht që kjo teknikë arti në islam mori dimensione të reja duke u shoqëruar me një element të ri ornamentalo-kaligrafik si dhe me ngjyra të reja. Shtrirjen më të madhe kjo teknikë artistiko-dekorative e pati në Marok, Algjeri e Spanjë. Por kjo teknikë u

¹⁶ E.Çelebiu, vep.cit., 24.

bart edhe në ndërtimet e trojeve shqiptare-ballkanike. Sidomos kjo vërehet në enët e ndryshme, veshjet e udhëheqësve, zbukurimet e femrave, llampat dhe dritaret e xhamive, ndërtesat e esnafit e aq më tepër të pallateve qendrore të pashallarëve e udhëheqësve të lartë ushtarakë.

2. Punët në metal, që është një kombinim i forcës dhe bukurisë

Puna metalore është një nga mjeshtëritë më të rëndësishme në artet islame. Kjo formë e artit është më shumë e bërë në gdhendje. E krahasuar me forma të tjera të artit, puna në metal ka arritur një standard të lartë të zhvillimit teknik dhe të përfaqësimit në artet islame. Zhvillimi historik ka treguar se puna në metal në artin islam është gjerësisht e influencuar nga arti sazanik dhe pjesërisht i influencuar nga artet e Azisë Lindore.

Kallëpet janë përdorur për të prodhuar enët e përditshme dhe artikut e bukur dekorativë nga metali. Armët prodhoheshin gjithashtu nga metalet si bronzi dhe hekuri. Ari dhe argjendi përdorehin më rrallë. Kjo mund të jetë për shkak të ndalimit të përdorimit të arit dhe argjendit në kodin ligjor islam.

Si mjeshtrit e qeramikës dhe zanatçinjtë e metalit, zakonisht skalinin emrat e tyre mbi prodhime. Kështu që ne jemi në gjendje të mësojmë më shumë rreth një numri zanatçinësh të aftë dhe të famshëm në artet islame. Ne mund të shohim edhe datën, sepse edhe ajo ishte skalitur në to. Shumë modele teknike janë përdorur në punën metalore islame. Më popullloret ishin gdhendjet dhe zbukurimet me shkrime. Megjithatë, teknika më e rëndësishme ishte zbukurimi me mozaik, nëpërmjet të cilit ari i kthjellët, argjendi apo bronzi i bakërt derdhej në kanale në një copë table hekuri dhe goditej derisa të bëhej i butë. Kjo mënyrë është përdorur gjatë dinastisë Selxhuke dhe nga dinastia që pasoi. Shumë nga artikut zakonisht gdhendeshin me arabeska, dhe zbukurime gjeometrike e kaligrafike. Punimi i metalit në artet islame arriti majën gjatë dinastisë Selxhuke në shekullin e 13-të. Kajro, Mosuli dhe Damasku i vonë u bënë qendra të rëndësishme për prodhimin e punimeve metalore duke përdorur mënyrën me zbukurime mozaiku. Gjatë shek.XV-XVIII edhe në Ballkan pati një shtrirje të

madhe të punimeve në metal. Me kalimin e kohës, kjo u bë e njohur jo vetëm në shtëpitë qendrore, sarajet e kalatë, por edhe në popullin e thjeshtë për të zbukuruar shtëpitë e tyre me prodhime metali që ishin skicuar me anë të përdorimit të një teknike ose të kombinimit të të gjitha teknikave të përmendura më lart. Është e njohur se zejtarët shqiptarë të metalit i prodhonin vazot e metalit për tri qëllime: fetare, nevoja të përditshme, dhe për tregti.

3. Koncepti i hapësirës në skicat dhe artet islame (Lidhja mes njeriut dhe ambientit)

Kur ekzaminuam punët e artit islam ndër ne, në gdhendjet në dru, qeramika, tekstile ose pikturat në miniaturë si dhe elemente të tjera artistike të realizuara nga artistët dhe mjeshtrit shqiptarë, si nga Kosova ashtu edhe nga vilajetet e tjera shqiptare - Shkodra, Manastiri e Janina, ne arritëm të nxjerrim si përfundim se këta artistë kanë krijuar punët e tyre të artit me një vërtetë perceptim të veçantë. Në veprën e tyre ndihet edhe lidhja e ngushtë me mjedisin e tyre. Ne e quajmë atë “hapësira” e tyre në ambient. Ata shpesh janë ndikuar nga rregulla të caktuara fetare, për shembull, ata pranonin se hapësira është krijuar nga Zoti dhe ata vetë janë krijesat e Zotit. Ata duhet të pranonin Njëshmërinë e Tij etj. Kështu, krijimi i tyre nuk duhej të ishte ekstrem, sepse një veprim i tillë do të ndikonte në besimin e tyre dhe t’i bënte ata krenarë ose arrogantë e mendjemëdhenj. Prandaj, artistët muslimanë shqiptarë të kësaj periudhe i shmangeshin krijimit të figurave njerëzore apo përdorimit të formave njerëzore në krijimet e tyre, që të mos josheshin nga idolatria dhe politeizmi.

Duke u mbështetur në parimet e Islamit, ata kishin bindjen se njeriu duhet të përdorë sipërfaqen e siguruar nga Zoti me zgjuarsë. Ai duhet të studiojë rregullimin harmonik të hapësirës dhe njëkohësisht të kënaqet me bukurinë që rrjedh nga ajo.

Në këtë hapësirë Zoti ka krijuar gjithë universin, i cili përfshin qiellin dhe Tokën, bimët, malet, detet e të tjera, të gjitha janë për nevojat dhe kënaqësitë e njerëzve. Për shembull, që kur nuk mbahet mend, yjet në qiell e kanë drejtuar njeriun në udhëtimet e tij ndërsa detet kanë qenë siguria e jetesës. Kjo bëri që artistët të prodhonin

punime të bazuara mbi konceptin e harmonisë në hapësirë. Kjo është vënë re në piktura e peizazhe të prodhuara nga ata. Artisti riprodhon çfarë sheh rreth vetes në letër ose në pëlhurën e trashë të lirit. Një studim i kujdesshëm i pikturave të realizuara gjatë asaj kohe (shembulli i xhamive në Gjirokastër, xhamisë së Et'hem beut në Tiranë etj.) do të tregojë rregullimin e mrekullueshëm të natyrës, kjo e lidhur ngushtë me konceptin e matematikës. Duke shikuar në pikturën e një peizazhi, për shembull, ne do të gjejmë se hapësira është e ndarë përgjysmë. Harmoninë e natyrës e gjejmë edhe tek artistët islamë që përpiqen në punimet e tyre të japin më të mirën e elementeve natyrore. E gjithë kjo nuk është e rastësishme, ngase muslimanët janë të detyruar ta duan të bukurën. Kjo rrjedh nga hadithi i Muhamedit a.s.: “Vërtet Allahu është i Bukur dhe e do Bukurinë”.

Gdhendjet në dru janë gjithashtu një formë tjetër e artit që paraqet konceptin e rregullit dhe harmonisë në natyrë. Druri vjen nga pema që është krijuar nga Zoti. Lulet dhe bimët janë motive të punimeve të drurit. Shpesh janë shkruar edhe ajete Kur’ani të rrethuara me lule të ndryshme.

4. Kaligrafia islame (Elementet jetësore në art dhe arkitekturë)

Shpikja e shkrimit ishte një hap i madh në përparimin e qytetërimit njerëzor dhe shënon përparimin e qenieve njerëzore nga koha e të folurit tek ajo e të shkruarit. Realizimi i nevojës së të shkruarit që ngritur nga nevoja e njeriut për të regjistruar informacione dhe ngjarje të rëndësishme në jetën e tij, por që në artin dhe arkitekturën islame morën dimensione të reja.

Ka shumë lloje të kaligrafisë, por Kufi dhe Nas’hi janë dy më të njohura. Kufi e mori emrin e tij nga një qytet i quajtur Kufa në Mesopotami (Iraku i sotëm), ndërsa Nas’hi rrjedh nga fjala “kopje”. Ky është një shkrim tjetër arab që ka të njëjtën rëndësi ashtu si edhe kaligrafia Kufi. I pangjashëm me atë të fundit, ai është shquar nga forma e tij kursive dhe lineare. Megjithatë, që në shekullin e 12, ky e zhvendosi kaligrafinë Kufi dhe kështu ky filloi të përdorej si një repertor zbukurues në punët islame të artit. Format e shkronjave Kufi janë

kryesisht pingule, sepse mendohet të ketë origjinën nga mënyra e ecjes së ushtarëve në Mesopotami. Kur shkronjat janë në formë të drejtë dhe pingule, ato janë në veçanti të përshtatshme për të gdhendur mozaikë, tjegulla dhe gurë në ndërtesa si xhami e kështjella.

Kaligrafia islame ka filluar të përdoret në ndërtimet shqiptare që nga fundi i shekullit XIV. Megjithatë, ajo zhvillimet më të mëdha i pati në shekujt XVI-XVIII, kur kaligrafia filloi të zhvillohej nga forma e vet origjinale e drejtë dhe pingule në formën e bimëve.

Shumë studiues të kaligrafisë janë të mendimit se kaligrafia është përdorur në artet islame pikërisht për shkak të ndalimit të figurave njerëzore e të kafshëve dhe formave të tjera jete në art. Mjeshtrit e Lindjes, të cilëve nuk u lejohej të pasqyronin qenie njerëzore, i lanë udhë të lirë imagjinatës së tyre për të luajtur me motivet dhe format. Ata krijuan atë ornament shumë të hollë me qendrisje, që u njoh me emrin arabeskë... Meritën për këtë e kishte Muhamedi a.s., Profeti i Islamit, i cili, mendjen dhe shpirtin e artistëve e drejtoi për te kjo botë plot linja e ngjyra.¹⁷ Ishte frika se përdorimi i figurave të tilla mund të influenconte dhe të kishte efekt në besimin e ndonjë muslimani.

Megjithatë, të tjerët e ndiejnë se kaligrafia është përdorur në artet islame thjesht për qëllime zbukuruese. Studiuesit islamë gjithashtu mendojnë se kaligrafia nuk është përdorur thjesht për qëllime zbukurimi, por për qëllime të caktuara ashtu si në pikturë, arkitekturë, artet fine dhe të tjera.

Qëllimi kryesor për përdorimin e arteve islame ishte që të riprovinin besimin në Njëshmërinë e Allahut dhe të tregonin Madhësitinë e Tij apo të forconin Teuhidin mes muslimanëve. Kaligrafia luan një rol të rëndësishëm në jetën e një muslimani, nga koha e lindjes deri në vdekje. Mesazhe të shenjta, emra të Allahut e të profetëve dhe shokëve të tyre janë më shpesh të përdorura në punët e artit.

Edhe shqiptarët qenë mësuar të zbukurojnë me elemente kaligrafike muret e xhamive, ambientet e brendshme të sarajeve, prodhimet në porcelan, prodhimet në xham, gurë varresh, para, tapete, tekstile, punime metalesh dhe të tjera. Shprehja e Dëshmisë së besimit islam “La Ilahe il-lallah” (Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut) është përdorur aq

¹⁷ E.H.Gombrich, The story of art, 1995, 143.

shumë nga mjeshtrit dhe artistët shqiptarë, saqë janë të pakta ndërhyrjet e stilit kaligrafik ku të mos jetë e pranishme edhe kjo sentencë.

5. Simbolizmi (Mesazhet e fshehura në artet islame)

Simbolet, së bashku, si të shikuara dhe të dëgjueshme, janë përdorur me intensitet nga njeriu. Në lidhje me këtë ne gjejmë përkufizime të shumta për fjalën simbol. Por thënë shkurt, simbol është diçka që nënkupton diçka tjetër. Kështu në artin islam kurora simbolizon mbretërinë, uji begatinë etj. Pra, një simbol tregonte rëndësinë ose jepte dukshmëri të madhe të asaj çfarë simbolizonte. E rëndësishme është se si mjeshtrit dhe artistët lidhnin domethënien e këtij simboli me shoqërinë. Kjo bëri që të paraqitej koncepti i universalitetit në simbolizëm. Këtë koncept e hasim në të gjitha fetë. Kështu p.sh. Krishterimi shkëmbente disa ide duke përdorur simbole specifike. Megjithatë, artistët e patën të vështirë të përkufizonin simbolet dhe domethëniet që ato paraqesin në artet islame¹⁸.

Është një prej disa ironive në këtë analizë, të shprehemi se tek ne kjo marrëdhënie e ndërlikuar pothuajse nuk është prekur fare nga studiuesit e fushave përkatëse. Problemet zakonisht dalin kur ekspertët e arteve përpiqen të njohin çështje që lidhen me kuptimin e kohës në Botën Islame, rolin e artit në krijimin e mentaliteteve, konceptin e bukurisë dhe më e rëndësishmja përdorimin e figurave apo skulpturave në artet islame.

Gjatë periudhës moniste, studentët e arteve dhe studiuesit shqiptarë nuk ishin në gjendje të pranonin përkufizimin e arteve islame, për shkak të konjunkturës ideologjike marksiste që dominonte. Si rezultat i kësaj, kanë ngelur të mangëta shumë përfundime dhe interpretime që lidhen me artin, arkitekturën por edhe me kulturën islame ndër ne.

Por duhet vlerësuar nëse edhe shumë krijime të periudhës moniste që vazhduan të punohen nga mjeshtrit shqiptarë muslimanë, mund të konsiderohen si punime islame!? Gjithsesi, unë jam i prirur të përdor përkufizimin se artet dhe arkitektura islame nuk janë të kufizuara në krijimin e punës artistike vetëm me elemente religjioze. Por përfshijnë të gjitha veprat e prodhuara që përmbajnë vlera artistike-estetike dhe

që japin mesazhe islame, pa marrë parasysh a janë përdorur për qëllime fetare apo jo.

Dr. Ramiz Zekaj

THE INFLUENCE OF ISLAMIC ARCHITECTURE IN THE TOWN OF GJIROKASTRA

(Summary)

Gjirokastra is an astonishing town, which has inherited a lot from ancient cultures and civilizations (this heritage was preserved with great care by its citizens). Gjirokastra is not the biggest town in Albania but is one of the most beautiful. Therefore, it is no surprise that many travelers, travelogues, artists, poets, historians were astonished by its beauty...

رامز زكاي

تأثير المعمار الاسلامي في طراز البناء بمدينة جيروكاسترا

(خلاصة البحث)

تعد جيروكاسترا مدينة مميزة ذات جذور تاريخية قديمة و وريثة ثقافات مختلفة و قد قام سكانها عبر العصور بالاحتفاظ على هذا التراث الحضارى و الثقافي المميز لمدينتهم. مدينة جيروكاسترا ليست من اكبر المدن في الوطن الالباني و لكنها بلا شك تعد من اجمل المدن. و ليس غريبا اذن أن يبدى اعجابه بهذه المدينة العريقة كل السياح، و الرحال و الفنانين و الشعراء و المؤرخين إلى آخره.

¹⁸ Ismail R.Al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, f.XII

OPINIONE

KLONIMI I NJERËZVE DHE MENDIMI I DR. KARDAVIT RRETH TIJ

Klonimi është një faktor që vërteton besimin islam në ringjalljen e njerëzve pas vdekjes së tyre për të dhënë llogari përpara Krijuesit, ndërkohë që mohuesit e fesë dikur dhe materialistët sot, e kanë parë si diçka të largët këtë çështje. Klonimi në botën njerëzore eliminon llojshmërinë dhe çiftëzimin!

Vërtetësi lidhur me klonimin

Dr. Jusuf Kardavi u pyet nga gazeta katareze "Er-Raje" për mendimin e tij rreth çështjes së klonimit të njeriut, por u përgjigj i justifikuar se kjo është një çështje e re që duhet vëzhguar, menduar dhe duhet marrë me seriozitet, dhe se të nguturit nuk është specifikë e tij në këso punësh...

Por njëkohësisht ai nxori përpara lexuesve disa të vërteta të lidhura me klonimin që në burimin e tij, duke thënë:

"Islami e mirëpret dijen dhe kërkimin shkencor në përgjithësi, ma-dje e konsideron si detyrim të përgjithshëm përmbi ymetin musliman arritjen e rezultateve të larta në të gjitha sferat e dijes për të cilat ka nevojë ymeti, në fenë dhe në jetën e tij, në mënyrë që të plotësohen në njëra- tjetrën dhe të mjaftohen në mënyrë individuale në të gjitha filia-

let e dijes dhe praktikës së saj, në çdo specializim nga specializimet e ndryshme që ymeti të mos mbetet "i vobektë" për diçka...

Por, shembulli i diturisë në Islam është si shembulli i punës, ekonominë, politikës dhe luftës, se që të gjitha këto duhet të lidhen me vlerat e fesë dhe moralit, sakohë që Islami nuk e pranon mendimin e ndarjes së këtyre pikave nga feja, si të thotë dikush për shembull: Lëreni dijen të lirë, lëreni ekonominë të lirë, lëreni politikën të lirë, lëreni luftën të lirë dhe mos lejoni hyrjen e fesë apo moralit ndër to, për t'i ngushtuar ato dhe për t'i ndaluar nga shpejtësia e rritjes dhe shpejtësia e lëvizjes.

Prishjet që shkaktohen për shkak të klonimit

Islami e refuzon këtë parim që ka prishur dijen, ekonominë e politikën dhe shikon se çdo gjë në jetë duhet t'i nënshtrohet drejtimit të fesë... Logjika e Sheriatit islam -me tekstet e tij absolute, rregullat tërësore dhe objektivat e përgjithshëm- e ndalon futjen e këtij klonimi në botën e njerëzve, duke parë tek prishjet që sjell ai, si më poshtë:

1. Klonimi eliminon llojshmërinë:

All- llahu e krijoi këtë univers në bazë të llojshmërisë, prandaj këtë frazë e gjejmë të përsëritet disa herë në Kur'an, pas krijimit të gjërave dhe mirësisë së tyre për njerëzit (në ngjyra të ndryshme), pasi ndryshimi i ngjyrave shpreh dukurinë e llojshmërisë. Për këtë le të lexojmë thënien e All- llahut në Kur'an:

"A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilave është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. (*) Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës".¹

Kështu klonimi e kundërshton llojshmërinë, pasi ai ngrihet mbi bazat e krijimit të një kopjeje të përsëritshme të një personi, gjë që sjell shumë të këqija në jetën njerëzore dhe sociale, disa prej të cilave i kuptojmë e disa të tjera nuk i arrijmë veçse me kohën.

¹ Kur'ani, 35:27-28.

Imagjini një klasë me nxënës të klonuar... Si do mund të dallojë mësuesi nxënësit nga njëri-tjetri? Si do ta dallojë Zejdin nga Amri a Bekri, fjala vjen?

Si do ta dijë hetuesi, se cili person e ka kryer krimin, ndërkohë që fytyrat janë të njëjta, gjatësitë po ashtu dhe shenjat e gishtave të pandryshueshme?

Madje, si ta njohë burri gruan nga kopja e saj? E si ta njohë gruaja burrin duke parë edhe kopjen e tij njëkohësisht?

Nga një aspekt tjetër, nuk ka besë që të mos përdoret ky fenomen për keq, sikurse ndodhi me bombën atomike për të shkatërruar njerëzit e gjallesat në masë!

Kush na siguron ne, nga një këndvështrim tjetër, që të mos vijë një superfuqi apo kush fshihet nën petkun e saj, dhe të klonojë një ushtri me burra të fortë për të goditur me të, kë të dojë?

Pastaj kush na siguron ne për mosardhjen e kësaj superfuqie, për ta "privatizuar" dhe personalizuar klonimin, duke ia ndaluar të tjerëve e duke ia lejuar vetes, siç u veprua me bombën atomike?

Klonimi eliminon traditën e çiftëzimit

Klonimi, nëpërmjet pasqyrës në të cilën na u prezantua dhe na u shpjegua nga specialistët, eliminon fenomenin e çiftëzimit në këtë univers, në të cilin jetojmë.

All-llahu njerëzit i ka krijuar çifte, meshkuj e femra, sikurse edhe kafshët, zogjtë, kandrrat, madje edhe bimët.

Madje shkencat e reja na kanë treguar se çiftëzimi ekziston edhe në botën e ngurtësirave, siç e shohim në elektricitet fenomenin e pozitivit dhe negativit, madje edhe tek atomi që është njësia e ndërtimit universal në tërësi, i cili ngrihet mbi elektronin dhe protonin, dmth, karikimin elektrik pozitiv e negativ, e pastaj vjen bërthama.

Kur'ani e përmend këtë fenomen (çiftëzimin) duke na thënë:

“Dhe Ne ju krijuam ju në çifte”², si dhe: “Dhe Ai është që krijoi llojet - mashkullin dhe femrën(*) Nga pika e farës që hidhet”³, si dhe: “I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet)

² Kur'ani, 78:8.

³ Kur'ani, 53: 45-46.

nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë”⁴, sikurse thotë gjithashtu: **“Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të kujtoni (madhështinë e Zotit)”⁵**, sakohë që klonimi ngrihet mbi mospasjen nevojë për njërin nga dy sekset, duke u mjaftuar me një seks të vetëm, saqë një grua amerikane tha: Do të vijë dita që ky planet do jetë vetëm i grave!

Kjo pa dyshim që është kundër natyrës në të cilën është krijuar njeriu, dhe nuk është aspak në dobi të tij!

Njeriu për natyrë ka nevojë për seksin tjetër, jo thjesht për t'u shu-muar, por edhe për të plotësuar njëri- tjetrin, sikurse thotë All-llahu në Kur'an: **“Ju jeni nga njëri-tjetri (të një origjine)”⁶**.

Dhe për t'u kënaqur secili me partnerin e vet, siç na e thotë All-llahu i Madhëruar, në pasqyrimin e lidhjes martesore, në Kur'an:

“Ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato...”⁷

Për këtë, kur All-llahu krijoi Ademin dhe e bëri të jetojë në Xhennet, nuk e la të vetëm edhe pse ishte në Xhennet, por i krijoi atij nga vetja e tij bashkëshorten që të prehej tek ajo, sikurse ai do të prehej tek ai. Prandaj dhe thotë në Kur'an: **“E Ne i thamë: “O Adem, ti dhe bashkëshortja juaj banoni në Xhennet...”⁸**

E në qoftë se secili nga burri dhe gruaja kanë nevojë për njëri-tjet-rin për t'u prehur te njëri- tjetri e për të lindur më pas dashuria e mësh-ira ndërmjet tyre, pasuesit e tyre kanë edhe më tepër nevojë për ata të dy, për ambientin familjar, për butësinë e nënës dhe kujdesin e babait e mësimin e mirësive nga familja, mirësive të bashkëjetesës në mëny-rë të saktë, të këshilluarit, të kuptuarit e të ndihmuarit në raste nevojë.

Njerëzit e dinë fare mirë se fëmijëria më e gjatë, për nga mosha, është fëmijëria e njeriut që zgjat disa vjet, në të cilët fëmija ka nevojë për prindërit dhe familjen e tij materialisht dhe moralisht. Edukimi i plotë i identitetit të fëmijës nuk plotësohet veçse nën hijen e prindërve që e duan atë dhe kujdesen për të, duke shpenzuar çdo gjë të shtrenjtë

⁴ Kur'ani, 36: 36.

⁵ Kur'ani, 51: 49.

⁶ Kur'ani, 4: 25.

⁷ Kur'ani, 2: 187.

⁸ Kur'ani, 2: 35.

e të lirë, derisa të plotësohet zhvillimi i tij, duke ndier kënaqësi në shpenzimet e tyre për fëmijën e vogël.

Por, klonimi nuk realizon prehjen e secilit prej bashkëshortëve në njëri- tjetrin, sikurse nuk realizon as familjen për të cilën ka nevojë fëmija për të jetuar nën hijen dhe kujdesin e saj dhe plotësimin e zhvillimit të tij nën përkujdesjen e saj.

Lidhja ndërmjet personit të klonuar dhe të klonuarit prej tij

Kjo është një çështje formimi: S'ka dyshim se personi i klonuar është ndryshe nga personi i klonuar prej tij, pasi ai, edhe pse mban të gjitha virtytet e tij trupore, mendore dhe psikologjike, nuk është vetë ai, pasi ka ardhur shumë më vonë në kohë se i pari dhe rrethi shoqëror, edukimi e kultura e kohës së të klonuarit do të ndikojnë në veten e tij, duke e bërë atë një tjetër njeri në besimin, sjelljen dhe njohuritë e tij, pasi këto janë punë që fitohen dhe nuk mjaftojnë vetëm shkaqet trashëguese në to.

Kështu, ai do jetë tjetër njeri nga i klonuari prej tij, por cila është lidhja e tij me të?

A e ka djalë, apo vëlla, apo të huaj? Ky është me të vërtetë problem!

Disa thonë se është i biri, sepse është pjesë e tij, dhe kjo është e pranuar nëse vendoset në mitrën e së shoqes që do ta mbartë e do ta lindë, siç thotë All-llahu (xh.sh): **“Nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata”**⁹ që do të thotë, të ketë nënë dhe të jetë pa baba!!

Ndonjë tjetër thotë: Ai është vëlla binjak i personit nga i cili është klonuar, si dy binjakë që krijohen në një vezore të vetme. Mirëpo vëllazëria është degë e prindërisë (babës e nënës), e si vërtetohet dega pa u vërtetuar baza?

Kjo na detyron ta mohojmë këtë operacion që në burimin e tij, duke parë shkaqet negative që vijnë prej tij.

Përdorimi i klonimit në shërimin e disa sëmundjeve

Nuk e di me saktësi përse e bëjnë këtë (klonimin), megjithatë, nëse qëllimi i tij është klonimi i një njeriu, apo fëmije, apo një foshnje, për ta përdorur si pjesë këmbimi duke marrë një gjymtyrë të shëndoshë nga trupi i tij, për t'ia vendosur një njeriu të sëmurë, kjo pa dyshim që është e ndaluar në mënyrë absolute, pasi ai është krijesë që e ka fituar jetën njerëzore edhe pse me anë të klonimit, prandaj nuk lejohet loja me gjymtyrët e tij, as me asnjë pjesë tjetër të trupit të tij, edhe nëse është akoma fetus, pasi edhe ai duhet parë me seriozitet dhe ka vlerën e tij.

Por, nëse është i mundur klonimi i disa gjymtyrëve të caktuara të trupit, si zemra, mëlçia, veshka, apo një tjetër gjymtyrë, për të përfituar prej saj dikush që është i sëmurë, atëherë kjo është një punë, të cilën feja e mirëpret dhe e shpërblen, sepse sjell dobi për njerëzit pa i bërë dëm ndokujt dhe pa prekur vlerat e dikujt tjetër.

Çdo përdorim i tillë i klonimit, është i lejuar, madje i kërkuar si kërkesë pëlqyeshmërie (istihbab), e ndoshta kërkesë detyrimi (ixhab) në disa raste, sipas nevojës për të dhe mundësisë për ta bërë.

Dy sqarime të rëndësishme

I pari: Klonimi nuk është ashtu si e përfytyrojnë disa - krijim i jetës, por është përdorim i jetës që ka krijuar Krijuesi i Lartësuar, pasi vezorja prej së cilës hiqet bërthama e saj, është krijesë e All-llahut dhe qeliza që mbillet në vezore në vend të bërthamës, është krijesë e All-llahut, dhe të dyja punojnë në rrethin e tyre sipas rregullave, mbi të cilat All-llahu (xh.sh) ka ngritur këtë botë.

E dyta: Klonimi e ndihmoi fenë për të afruar në mendjet e njerëzve një çështje bazë prej besimit islam; besimin në ringjalljen dhe daljen e njerëzve pas vdekjes së tyre, për të dhënë llogari për punët që kanë bërë, ndërkohë që mohuesit e fesë dikur dhe materialistët sot, e kanë parë si diçka të largët çështjen e ringjalljes dhe kthimin e njeriut sërish në jetë.

⁹ Kur'ani, 58: 2.

Klonimi e ka afruar kuptimin e kësaj çështjeje, pasi me anën e një vezoreje dhe një qelize njeriu rikthehet në jetë në një formë të re. E në qoftë se njeriu arriti ta bënte këtë, pse duket e çuditshme që All-llahu (xh.sh) ta kthejë njeriun sërish në jetë, nëpërmjet asaj që shkencërisht quhet rruaza e kërbishtit¹⁰, e cila nuk vdes asnjëherë në trupin e njeriut, edhe pas vdekjes së tij, apo me ndonjë mënyrë tjetër, të ditur apo të paditur?

“Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për Të (sipas mendimit tuaj). Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e Tokë dhe Ai është mbizotëruesi, i urti”.¹¹

*Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip
Muhamed Sytari
teolog*

*P.S: Për sqarime të mëtejshme rreth temës, lexo faqen e Dr. Kardavit në Internet /www.qaradavi.net/, prej ku edhe është marrë ky material. (Shënim i përkthyesit).
Shkodër, më 25. 01. 2003*

THE VIEWS OF DR. KARDAVI REGARDING HUMAN CLONING

(Summary)

Human cloning confirms the theories on the resurrection of the dead on the Judgment Day. Human cloning eliminates diversity and mating!

عملية الاستنساخ و رأى الشيخ القرضاوى

(خلاصة البحث)

الاستنساخ من العوامل المهمة التي تؤكد إيمان الاسلام بالبعث بعد الموت لكي يحاسب امام الخالق سبحانه و تعالى في حين كان الملحدون يعارضون ذلك.

¹⁰ Rruaza e kërbishtit, për të cilën bëhet fjalë, sipas teksteve islame është sa një kokërr meli në fund të shtyllës kurrizore të njeriut. Transmetohet se Profeti Muhammed, në lidhje me këtë pikë ka thënë: "Secilën pjesë të trupit të njeriut do ta hajë toka, përveç rruazës së kërbishtit...Prej aty do ringjalleni Ditën e Kiametit (kataklizmës)" –Transmeton Buhariu dhe Muslimi. (Shih: "Sherh Xheheretut Teuhid", të një grupi dijetarësh muslimanë, vëll. i 2- të, fq.998- 999). **Shënim i përkthyesit.**

¹¹ Kur'ani, 30: 27.

GJURMËVE TË UMMETIT

Dr. Fikret Karçiç

MALAJZIA

- Rregullimi shtetëror dhe popullsia -

Malajzia është federatë e trembëdhjetë shteteve të siujdhesës Malaje (Malajzia Perëndimore) dhe të pjesës veriore të ujdhesës Borneo (Malajzia Lindore). Këto dy pjesë të shtetit i ndan deti i hapur. Emri Malajzia (Malaysia), si emër zyrtarë i shtetit, u pranua në vitin 1963, kur federatës së nëntë sulltanateve malajase dhe dy ish-kolonive britaneze (Federata e Malajeve) të gjeratëhershme iu bashkuan Singapori, Borneo Verior (i quajtur më pas Sabah) dhe Serevaku. Më vonë, pas mos marrëveshjes publike ndërmjet qeverisë federale dhe asaj të Singaporit, ky shtet (Singapori) është tërhequr prej federatës më 1965.

Siujdhesa Malaje ka histori të pasur juridiko-shtetërore dhe kulturore. Të parët e malajasve të sotëm në këtë rajon kanë ardhur nga Mongolia, midis viteve 2500-1500 para erës sonë, për t'u vendosur në brezin bregdetar të Siujdhesës Malaje dhe shumë herët kanë rënë në kontakt me kinezët dhe indianët.

Përderisa të parët (kinezët) kanë qenë të interesuar për nënshtrimin e popullit malajas dhe për kontrollimin e këtij territori "barbar", të dytët, kanë realizuar mjaftë mirë ndikimin shumë të fuqishëm kulturor. Ai ndikim është sendërtuar përmes hinduizimit të shtetit në Javë dhe Sumatër. Me atë rrugë në kulturën malajase kanë depërtuar fjalë të

sanskritishtes, si dhe zakone dhe besimi hindus. Ndikimi hindus posaçërisht është manifestuar në të konceptuarit e shtetit (negeri), të shoqërisë rreptësisht të ndarë në kasta, në etikën shoqërore, në ceremonitë oborrtare etj. Siujdhesa Malaje ka qenë në përbërje të shtetit të fuqishëm të Javës, gjithnjë deri në periudhën ndërmjet shek. 12 - 14, kur pati filluar përhapja intensive e Islamit dhe vendosja e shtetit të parë mysliman.

Në vitin 1445 u përmbys maharaxha hindus në Malakë, ndërsa pushtetin e mori i vëllai i tij, i cili pranoi Islamit dhe mori emrin Muzafer Shah (Mudzafer Shah). Malaka u bë shteti më i fuqishëm islam në Siujdhesën Malaje dhe qendra kryesore e përhapjes së Islamit në Arqipelag në pesëdhjetë vjetët e ardhshëm. Prosperiteti i Malakës u ndërpre me zbarkimin e portugezëve më 1511. Dinastia sunduese e malajasve u strehua në Xhohor (Johor) në jug të Siujdhesës dhe në Brunei të Borneos, ku rimëkëmbën sulltanatet e reja. Portugezët, pas sundimit të tyre njëqindvjeçar në Malakë, i zëvendësuan holandezët.

Në fund të shekullit 18, Mbretëria Britaneze tregoi interesim të veçantë për Siujdhesën Malaje, si vend strategjik për sigurimin e rrugës tregtare ndërmjet Indisë dhe Kinës. Me anë të disa marrëveshjeve me disa sulltanë, britanezët gjatë shek. 19, fitojnë të drejtën për themelimin e kolonive tregtare në Siujdhesë (Penang, Singapor). Me qëllim të eksploatimit më intensiv të pasurive të mëdha të kallajit, ata (britanezët) në vitin 1873 formuan koloninë e tyre të parë (Straits Settlements). Në të njëjtën kohë, nevoja e shtuar për fuqi punëtore, realizohet me shtimin e emigrantëve kinezë dhe indianë, gjë që në dekadat e ardhshme ndikoi esencialisht në strukturën etnike të Gadishullit.

Duke intervenuar në kontestet rreth trashëgimisë së fronit apo me anë të marrëveshjeve të veçanta, britanezët deri në fund të vitit 1880, në të gjitha sulltanatet e malajeve kishin emëruar përfaqësuesit e vet (rezidentë), me të cilët, sunduesit e vendit, doemos "duhej të konsultoheshin dhe këshillave të tyre t'u përmbaheshin" në të gjitha çështjet, përveç atyre që kanë të bëjnë me Islamit dhe zakonet malaje. Ky regjim paraqiste formën e konceptit të njohur britanezë të "administrimit indirekt", të aplikuar në disa terriore koloniale tejetdare.

Në vitin 1896 sistemi i rezidentëve u zëvendësua nga një strukturë shumë më e fuqishme administrative. Nga katër sulltanate - Perak,

Selangor, Pahang dhe Negeri Sembilan - që formuar Unioni (Federated Malay States). Jashtë kësaj skeme mbetën katër sultanatet veriore (Kelantani, Keddah, Perlis dhe Trenggan). Këta, nën kontrollin britanez patën rënë në vitin 1909, pas nënshkrimit të marrëveshjes britanezo-siameze, me të cilën qenë caktuar kufijtë e sotëm verior të Malajzisë. Administrimi britanez ka zgjatur, duke përjashtuar periudhën nën okupimin japonez (1941 - 1945), deri më 31 gusht 1957, kur u bë bartja e qetë e pushtetit dhe shpallja e sovranitetit të shtetit malajzias - Federatës Malajziasve.

Në Malajzi, sot është në fuqi Kushtetuta e vitit 1957, e cila ka pësuar disa ndërrime, më të rëndësishmet janë ato të viteve 1962 dhe 1965. Sipas formës së rregullimit shtetëror, Malajzia është monarki kushtetutare. Demokracia parlamentare është e garantuar në nivelin federativ dhe në atë të njësive federale. Marrëdhëniet në mes të federatës dhe të shteteve janë të rregulluara sipas formulës klasike: tërë ajo që nuk është shprehur qartë në kompetencat e federatës, bie në kompetencat e njësive federale. Në kompetencat e njësive federale janë edhe shërbimet fetare islame. Raportet në mes aktorëve të ndryshëm të pushtetit shtetëror janë të rregulluara sipas parimit të ndarjes së pushtetit.

Gjykata është e pavarur dhe, më përjashtim të gjyqit të Sheriatit, është në kompetencë të federatës. Ekziston spektër i gjerë i të drejtave dhe i lirive të garantuara qytetare. Gjuhë zyrtare është malajzishja (Bahasa Malaysia), ndërsa përdoren edhe anglishtja, gjuha mandare dhe ajo tamile. Të gjithë banorët e Malajzisë quhen malajziasve. Malajziasit, sipas definimit kushtetutar, janë personat që flasin malajzish-ten, e rrëfejnë Islamin dhe jetojnë në harmoni me zakonet malajase. Përkatësia e popullit malajziasve është identike me përkatësinë islame.

Kushtetuta federative garanton pozitën e veçantë të banorëve autokton të Siujdhesës Malaje në pikëpamje të arsimit dhe pozitës ekonomike në shoqëri. Të gjitha komunitetet etnike në Malajzinë e sotme ndahen në dy grupe: banorët autoktonë (Bumiputra) dhe banorët veçoritë kulturore të të cilëve nuk janë karakteristike për këtë rajon. Në grupin e parë bëjnë pjesë anasit e Siujdhesës Malaje (orang Asli), malajasit dhe banorët vendës të Borneos Veriore. Në grupin e dytë

bëjnë pjesë kinezët, indianët, aziatët e tjerë, si dhe bashkësia e vogël e evropianëve.

Sipas regjistrimit të popullsisë më 1980, struktura religjioze e popullsisë ishte si vijon: myslimanë 6.918.307, të krishterë 842.990, hindusë 920.393, budistë 2.265.456, ithtarë të konfucionizmit, taoizmit dhe të religjioneve të tjera tradicionale kineze 259.455, të tjerë 69.750 dhe individë pa fe 275.338. Myslimanët përbëjnë 55% të numrit të gjithmbarshëm të banorëve të Malajzisë. Krahë malajasve, në këtë grup hyjnë edhe myslimanët e Nënkontinentit Indian dhe bashkësi të vogla të arabëve. Përkatësia etnike në Malajzi ka implikime specifike sociale dhe politike. Ekziston, madje deri në ditët e sotme, identifikim i lartë i përkatësisë etnike dhe përkatësisë së profesioneve, përkatësisht të statusit social. Në mjediset rurale vendbanimet janë shpeshherë të ndara sipas parimit etnik, në bazë të të cilit rëndom bëhet edhe organizimi politik.

Deri në fillim të vitit 1970 pjesa dërrmuese e malajzasve kanë jetuar në fshatra dhe janë marrë me kultivimin e orizit. Kinezët, në anën tjetër, kryesisht kanë jetuar në qytete dhe janë marrë me tregti e zejtarri. Në fillim të viteve 70, në vend është shpallur "politika e re ekonomike", me qëllim të mënjanimi të zvogëlimit të varfërisë, korrigjimit të joekuilibrit ekonomik në shoqëri dhe anulimit të identifikimit të racës në funksionin ekonomik. Masa të veçanta janë marrë në funksion të realizimit të baraspeshës etnike në sektorët e ndryshëm shoqërore dhe në profesionet e ndryshme.

Malajzasve dhe popujve të tjerë autoktonë u janë dhënë mundësi të zënë vende përkatëse në zhvillimin e vendit. Kjo politikë zhvillimore, e plotësuar në vitin 1980, me programin e industrializmit dhe orientimit nga Japonia dhe Koreja Jugore, ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme.

Malajzia në vitin 1990, ishte vendi me shkallën më të lartë të zhvillimit në botë, ndërsa myslimanët malajziasve u bënë njëra prej bashkësive më të zhvilluara dhe më të organizuara në Botën Myslimane.

Myslimanët

Myslimanët malajzias ndjekin shkollën fetare-juridike shafiite, nderojnë tesavufin dhe ruajnë zakonet e tyre. Gjatë procesit të përhapjes së Islamit, malajzishtja u bë gjuhë e fesë islame në Azinë Juglindore. Në Bahasa Malaye-në malajzishte në shekujt e parë të shtrirjes së Islamit janë përkthyer një numër i madh i teksteve islame prej gjuhës arabe dhe persiane. Krahas veprave nga disiplinat klasike islame në historinë e kulturës malajase, vend me rëndësi zënë edhe tregimet për pejgamberët a.s., apo hikayatë (hikajet). Tregimet apo hikajet më të njohura janë ato për Muhammedin a.s. (Hikayat Nur Muhammad), për muxhizet e tij (Hikayat Mukjizat Nabi), për pejgamberin Sylejman a.s. (Hikayat Nabi Sulaiman) dhe shumë tregime të tjera.

Sulltanët malajas, sikur kudo tjetër në Botën Myslimane, kanë qenë të njohur si mbrojtës të letërsisë. Poezinë (syair) në letërsinë malajase e kanë futur sufistët, siç ishte Hamza Fansuri (1550 - 1600). Në Malaje është përdorur alfabeti arab, derisa pas Luftës së Dytë Botërore nuk u zëvendësua nga shkrimi latin. Edhe sot me të ashtuquajtura shkrime javvase shtypen disa libra dhe gazeta të organizatave mysli-mane.

Zakonet dhe traditat e malajasve (Adat Istiadat) paraqesin kompleks normash, të cilat përfshijnë tërë jetën e individëve dhe komuniteteve (Adat Resam), si dhe praktikën zakonore të lidhur për oborrin mbretëror (Adat Istiadat di Raja). Në esencë këto zakone paraqesin manifestim të mënyrës së jetës islame apo të trashëgimisë kulturore paraislamike, e cila është përshtatur me Sheriatin. Kështu, p. sh. Adat Resam urdhëron nderim dhe bindje ndaj prindërve dhe të moshuarve, marrëdhënie të mira fqinjësore, ruajtjen e rendit dhe ligjeve me anë të bashkëpunimit, respektim të pushtetmbajtësve, etj. Posaçërisht me rëndësi janë ngjarjet që kanë të bëjnë me synetinë e djemve (bersunat), me shpuarjen e veshëve të vajzave, me fejesën dhe me martesën.

Në rastet solemne malajasit bartin veshjen tradicionale, e cila përbëhet prej këmishës së gjerë (baju), pantallonave dhe pëlhurës, e cila lidhet rreth brezit dhe shtrihet deri në gjunjë (sarung). Në kokë

bartin kapelë të zezë (songkok). Gratë veshin baju kurung, e cila përbëhet prej bluzës së gjerë e të gjatë dhe fundit të gjatë.

Vendbanim tipik malajas (kampung) është grumbulli i shtëpive të drunjta, që shpeshherë janë të ngritura mbi shtylla me veranda dhe kopshte të gjata. Në mes të vendbanimeve gjendet mesxhidi (surau) apo një objekt më i vogël për kryerjen e namazit (balaisah). Në to, pas akshamit, rregullisht bëhet dhikër. Këso vendbanimesh tipike mund të gjesh edhe në Kuala-Lumpur.

Institucionet islame

Bazën juridike të statusit, të organizimit dhe të veprimtarisë së institucioneve islame e garanton Kushtetuta Federative e Malajzisë. Nëni 3 i kësaj kushtetute, Islamin e shpall fe të federatës. Të gjitha religjionet e tjera mund të praktikohen në qetësi dhe harmoni në cilëndo pjesë të Federatës. Statusi i Islamit si religjion i Federatës, nuk ka ndikim në të drejtat qytetare të jomyslimanëve. Qytetarëve u është garantuar e drejta për propagandimin e religjionit të tyre, por me ligje shtetërore mund të kontrollohet a të kufizohet propaganda e cilëndo doktrinë fetare apo besimit në mesin e personave që i takojnë fesë islame.

Secili komunitet fetar ka të drejtë të qeverisë punët e veta, të vendosë ose të mbajë institucione për qëllime religjioze a humanitare, të fitojë, të posedojë apo të qeverisë pasurinë në harmoni me ligjin.

Federata ose shtetet e caktuara kanë të drejtë të themelojnë, të mbajnë e të ndihmojnë institucionet islame, të sigurojnë a të ndihmojnë në mësimin e Islamit dhe të heqin shpenzimet që për këtë janë të domosdoshme.

Administrimi i punëve fetare

Në Malajzi nuk ekziston kryetari i Fesë Islame në nivelin federativ. Sulltanët janë njëherësh edhe kryetarë të fesë islame në shtetet e tyre, ndërsa mbreti (Yang di Petuan Agong), i cili zgjidhet nga mesi i nëntë sulltanateve malajas për një periudhë prej pesë vjetësh, është kryetar i fesë islame në shtetin qëi përketë dhe në shtetet dhe territoret

ku nuk ka mbret trashëgimtar (në Melak, Penang, Sabah, Serevak, në territorin federativ të Kuala-Lumpurit dhe Labuanit).

Në njësitë federale ekzistojnë këshilla të veçantë për Fenë Islame, të cilët quhen Majlis Ugama Islam ose diçka e ngjashme. Funkcioni kryesor i këtyre është që "ta ndihmojnë dhe ta këshillojnë sunduesin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me religjionin shtetëror dhe zakonet malajase". Organizimi dhe kompetencat e këtyre këshillave dallojnë nga një shtet në shtetin tjetër. Mund të thuhet se këto janë autoritetet kryesore fetare në njësitë federale, të cilët janë të autorizuar të japin fetva për të gjitha pyetjet që u shtrohen atyre, të ushtrojnë administrim mbi vakëfet, të paraqiten si zbatues të dëshirës së fundit (testamentit) apo si administratorë të trashëgimisë së myslimanëve të vdekur, të marrin vendime për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve të gjyqeve të Sheriatit, etj.

Në secilin shtet ekziston edhe organi civil i posaçëm për çështje fetare, i cili kryen të gjitha punët e përditshme që kanë të bëjnë me fenë islame. Në shumicën e shteteve ekziston myftiu si nëpunësi më i lartë fetar, i cili jep fetva dhe ndihmon Këshillin për Fenë Islame. Myftinjë të emëron sunduesi me propozimin e Këshillit për Fenë Islame apo Seksionit për çështje fetare. Imamët, hatibët dhe myezinët (bilalët - të quajtur sipas myezinit të parë të Muhammedit a.s., Bilal ibn Habeshiut r.a. - vër. e përk.) janë nëpunës shtetërorë. Është e përcaktuar me ligj që askush nuk mund të predikojë publikisht cilëndo doktrinë të fesë islame pa leje me shkrim nga organet kompetente, dhe as të kryejë cilëndo ceremoni a akt në kundërshtim me të Drejtën islame. Në nivelin federativ, prej vitit 1968 ekziston organi konsultativ - Këshilli Nacional për Çështje Islame (Majlis Kebangsaan Hal-avval Agama). Këtë organ e ka themeluar Konferenca e Sundimtarëve (sulltanëve malajas), për të koordinuar aktivitetet e këshillave të ngjashëm me ato në njësitë federale, për avancimin dhe unifikimin e të Drejtës islame dhe të administrimit në vend. Ky këshill në vete përfshin edhe shumë nënkëshilla, në mesin e të cilëve janë edhe nënkëshillat për fetva (në nivelin federativ), për mbledhjen, administrimin dhe distribuimin e mjeteve të zekatit, të fitrit dhe bejtul-malin, për avancimin e gjyqeve të Sheriatit, për studimin e së drejtës familjare, për hartimin e kalendarëve myslimanë, etj. Ndër organet qeveritare që

merren më çështje islame, mund të përmenden edhe Instituti për Arsimimin dhe Misionin Islam (INDAH) dhe Qendra për Kërkime Islame, e cila, ndër të tjera, është kompetente për publikim, kontrollim dhe distribuim të librave fetarë në vend.

Përveç organeve konsultative dhe administrative për çështje islame, në Malajzi ekzistojnë edhe shumë shoqëri kulturore, humanitare dhe misionare islame. Këto shoqëri regjistrohen në bazë të dispozitave të shtetit për shoqatat. Të tillë, p. sh. janë Shoqata Sociale Malajziase-Islame (PERKIM), Shoqata e Ylemave (PUM), Fondacioni i Misionarëve Malajzianë (YADIM), etj. Një shoqatë islame meriton të përmendet posaçërisht. Është ky Fondacioni i organizimit të haxhit dhe i kursimit (Lembaga Urusan dan Tabung Haji), i themeluar më 1962. Tabung-haxhi, siç njihet rëndom ky fondacion, sot paraqet një organizatë unikat në Botën Myslimane, që ka dëshmuar veten me efikasitetin dhe përfshirjen shumë të madhe në organizimin e haxhit. Aktivitetet kryesore të Tabung-haxhit janë kursimet, investimet dhe shërbimet e haxhinjve. Me anë të këtyre aktiviteteve, myslimanëve u mundësohet që me kurse shumëvjeçare të përgatiten për kryerjen e kushtit të pestë të fesë islame, që paratë e tyre t'i investojnë në mënyrë të lejuar sipas Sheriatit, si dhe të luajnë rol më të rëndësishëm në jetën ekonomike të shtetit.

Zinxhiri i shërbimeve të cilat u ofron myslimanëve Tabung-haxhi me rastin e kryerjes së haxhit, përfshin regjistrimin e kandidatëve, informimin dhe këshillimin për dispozitat e haxhit, kontrollimet paraprake mjekësore, sigurimin e vizave, vendosjen në komplekse të veçanta para marrjes së rrugës, vendosjen, informatat dhe ndihmën mjekësore në Arabinë Saudite, si dhe ndihma e shërbime të tjera pas kryerjes së haxhit. Një organizim i këtillë i haxhit, ka sjellë gati trefishimin e numrit të haxhinjve në periudhën 1970 - 1990.

Tabung-haxhi sot ka zgjeruar aktivitetin e vet me investime në degët ekonomike, që janë mbështetje e fortë e projekteve zhvillimore të Malajzisë, duke poseduar plantazhet e veta të palmave të vajit, të kauçukut, në infrastrukturën ndërtimore, në ndërtimin e banesave dhe në përqindje të rëndësishme në aksionet e korporatave kryesore malajziase.

Aktiviteti i myslimanëve malajzianë nuk është i kufizuar vetëm në planin nacional. Kështu, në Kuala-Lumpur vepron Këshilli për Misionin Islamik në Azinë Juglindore dhe rajonin e Paqësorit (RISEAP). Shteti i Malajzisë është mjaft aktiv në Organizatën e Konferencës Islamike (OIC). Në të vërtetë, idenë për themelimin e një organizate të vendeve myslimane, të ngjashme me Kombet e Bashkuara apo Komonueltin, në rrafshin politik, e pati inicuar kryeministri i parë malajzias, Tuanku Abdul Rahman. Pas Konferencës së popujve islamikë, mbajtur në Kuala-Lumpur më 1969, u themelua OIC (Organizata e Konferencës Islamike).

Institucionet arsimore

Arsimi dhe edukimi në Malajzi merret në kuadër të sistemit të degëzuar të institucioneve shtetërore dhe private. Njohuritë e para për Islamin merren në institucionet e shumta parashkollore, të cilat i hapin shoqëritë kulturore dhe humanitare islame zakonisht në afërsi a në anekse të xhamive. Në shkollat fillore dhe të mesme nacionale të tipit të përgjithshëm mësohen lëndët e domosdoshme të edukimit islam. Nga viti 1982 insistohet veçmas për mësimin e shkrimit javvan. Segment të rëndësishëm të shkollimit islam paraqesin "pondok-shkollat" tradicionale, të shtrira në pjesët veriore të vendit, dhe shkollat fetare moderne (Sekola Agama). Pondoka (nga ar. funduk - vend për banim) janë shkolla tradicionale islame në Siujdhesën e Malajzisë.

Në të vërtetë, fjala është për tërë vendbanimin që formohet rreth shtëpisë së mësuesit fetar (Tuan Guru). Këto vendbanime i përbëjnë kasollet e drunjtja në të cilat banojnë nxënësit (pondok), xhamitë (surau apo balaisah) dhe godinat shkollore (medresetë). Këto vendbanime ngrihen në truallin e vakëfnuar të vendësve, të ndonjë personi të dalluar apo nga vetë mësuesi i fesë. Vendbanimi zakonisht zgjerohet duke u vendosur në të nxënës që kanë mbaruar shkollimin në ato shkolla. Këtu ata krijojnë familje dhe kështu edhe fëmijët e tyre marrin dituri në të njëjtin pondok.

Ligjëratat në pondoke mbahen tri herë në ditë (në mëngjes, pasdreke dhe në mbrëmje). Gjatë këtyre ligjëratave tekstet islame shpjegohen në malajzishte dhe në gjuhën arabe. Kohëzgjatja e shkollimit

varet prej nxënësit - ndonjëherë shkollimi zgjat edhe më tepër se dhjetë vjet. Shkollimi është gratis. Mësuesve u jepet dhuratë vetëm njëherë - me rastin e regjistrimit të nxënësve dhe kur mësuesi i fesë shkon në haxh. Pas kryerjes së shkollimit, nxënësit i jepet dëftesa (surat akuan), në të cilën theksohet se cilat disiplina i ka ndjekur dhe i ka përvetësuar me sukses. Nxënësit në pondok-shkolla edhe sot e kësaj dite vishen tradicionalisht: me këmishë të bardhë dhe sarong, ndërsa në kokë mbajnë kapelë të madhe (kupiah), rreth së cilës ndonjëherë mbështillet shalli (sherban). Pandoke edhe sot e kësaj dite janë institucione me ndikim në shtetet Kelantan, Tranggan, Keddah dhe Perlis. Me kohë, duke u transformuar në një lloj të bashkësisë lokale myslimane, këto institucione tradicionale janë bërë qendra të jetës fetare dhe shoqërore në zona rurale.

Shkollat fetare (Sekolah Agama) janë institucione të modernizuara arsimore islame, të cilat në siujdhesën e Malajzisë kanë filluar të themelohen në dekadat e para të shek. 20. Në këto shkolla mësohen lëndë laike dhe fetare, gjuhët (anglishtja dhe malajzishtja). Rëndësi të veçantë i kushtohet gjuhës arabe. Për këtë arsye nganjëherë këto shkolla quhen edhe "shkolla arabe". Shkollat fetare mund të jenë me karakter shtetëror dhe privat. Në të vërtetë, këto shkolla gjenden nën jurisdiksionin e Ministrisë së Arsimit, në të cilën ekziston sektori i veçantë për arsimimin islam, dhe kanë statusin e institucioneve arsimore të pranuar. Sot në Malajzi ekzistojnë shumë qendra në të cilat merret arsimimi i lartë islam. Përpjekjet për themelimin e institucioneve të larta të arsimit islam kanë filluar në fillim të dekadës së pestë të shekullit tonë. Në vitin 1955 u themelua Kolexhi Mysliman Malajzian në Selangor, i cili tri vjet më vonë u bë pjesë e Universitetit Malajas (UM), me emërtimin Seksioni për Studime Islame. Me këtë emërtim, kjo qendër vepron edhe sot në kuadër të fakultetit filozofik. Në Kelantan më 1965 u themelua Qendra për Studime të Larta Islame. Kjo qendër më 1981 u bë pjesë e Universitetit Malajas, me emrin Akademia Islame. Me dy fakultete, Fakultetin e së Drejtës së Sheriatit dhe atë Teologjik, Akademia Islame në kuadër të Universitetit Malajas, ka ruajtur autonominë dhe identitetin e vet.

Në vitin 1970 në Bengia, jo larg Kuala-Lumpurit, u themelua Universiteti Nacional i Malajzisë (UKM), në kuadër të të cilit ekziston

fakulteti i veçantë i Studimeve islame. Këtyre institucioneve u duhet shtuar edhe Kolegji Islam mjaft i rëndësishëm i sulltan Zejnulabidinit në Kuala-Terenggan. Nga viti 1983 në qytetin Petaling Jaya (Selangor) ekziston Universiteti Islamik Ndërkombëtar (IIU), me fakultetin juridik, fakultetin e ekonomisë, fakultetin për njohuri publike dhe atë të shkencave humanitare, si dhe Qendra për gjuhë. Themelues i këtij universiteti është Organizata e Konferencës Islamike. Ky universitet tashmë është bërë institucioni më i rëndësishëm i arsimit dhe i shkencave islame në rajonin e Azisë Juglindore dhe Paqësorit.

Më 1990, në zhvillim e sipër ka qenë projekti për kompletimin e këtij universiteti (me fakultetet e shkencave natyrore dhe teknike) dhe ndërtimi i komplekseve të reja. Në kuadër të këtij universiteti nga viti 1987 vepron edhe Instituti i posaçëm Ndërkombëtar për Mendimin dhe Civilizimin Islam (IIITC), i cili do të jetë edhe institucion i specializuar për studime pasuniversitare dhe për punë kërkimore-shkencore.

- Institucionet juridike -

Historia e së drejtës së Malajzisë ndahet në tri periudha: 1) periudha e hershme myslimane-malajaze; 2) periudha e dominimit britanez dhe 3) periudha e pavarësisë shtetërore.

Në periudhën e parë e Drejta e Sheriatit dhe zakonet malajaze përbënin bazën e rregullimit juridiko-shtetëror të sulltanateve tradicionale malajziane. Nga kjo periudhë rrjedhin edhe përmbledhjet juridike të medhhebit shafii, të përkthyer në malajzishte dhe ligjet që i kanë botuar disa sulltanë. Kodifikimi i parë i njohur i së drejtës malajaze - myslimane daton që nga shekulli 15 dhe është i njohur me emërtimin Risalah Hukum Kanun apo Undang-Undang Melaka (Kodi prej Malakës).

Në periudhën e dytë pozicioni i së Drejtës së Sheriatit ndërron si bazë e sistemit juridik: fillon futja e së drejtës anglo-saksone, ndërsa vlefshmëria e jurisdiksionit administrativ të Sheriatit dhe të traditave malajaze reduktohet në çështje statusore, në shkelje të dicsiplinës fetare dhe në çështje pronësore-juridike.

Në kohën e dominimit britanez, gjyqet e Sheriatit kanë qenë pjesë përbërëse e gjyqeve të shteteve malajaze, ndonëse me gjyqet qytetare kanë qenë në raport subordinimi.

Në periudhën e tretë ka filluar konsolidimi i gjendjes ekzistuese juridike dhe formësimi i legjislacionit të ri nacional. Sistemin juridik të Malajzisë e përbëjnë normat, të cilat zanafillën e kanë prej sistemeve të ndryshme juridike: së drejtës malajaze-myslimane dhe asaj anglo-saksone. Krahas dikotomisë së të drejtës është trashëguar edhe dikotomia e gjyqeve. E drejta e Sheriatit në fuqi, e modifikuar me zakonet e vendit, në tekstet ligjore deri më 1980, është emërtuar si "e drejta myslimane". E drejta myslimane vlen vetëm për myslimanët, kurse vëllimi i vlerës së saj është konfirmuar me kushtetutën federative.

Fjala është për çështjet e së drejtës personale dhe familjare (trashëgimia, martesë, shkurorëzimi, dhuratat e martesës, mbajtja, adoptimi, legalizimi, kujdestaria (tutoria), dhuratat, vakëfimi, zekati, fitrat dhe bejtul-mali, shkeljet fetare të myslimanëve etj.

Rregullimi ligjor i aplikimit të së drejtës myslimane, të organizimit dhe të procedimit të gjyqeve myslimane janë në kompetenca të njëjësive federale. Parlamenti federativ mund të nxjerrë ligje të tilla vetëm për territorin federativ (të Kuala-Lumpurit) apo të bëjë propozimet e akteve ligjore për ndonjë shtet.

Pas fitimit të pavarësisë, në njësitë federale janë nxjerrë ligje me të cilat është rregulluar çështja e aplikimit të së drejtës - myslimane. Këto ligje patën ndikim të madh të së drejtës britaneze dhe kryesisht kishin të bënin me çështje organizative dhe procedurale. Gjatë vitit 1980 në disa shtete janë bërë përpjekje që të përmirësohej organizimi i gjyqeve myslimane, të reformohej dhe të kodifikohej e drejta myslimane. Këto përpjekje kanë sjellë nxjerrjen e një numri të madh të akteve ligjore mbi aplikimin e së drejtës islame. Në të gjitha këto tekste ligjore të shumtën përdoret emërtimi "e drejta islame", që shpreh dëshirën e ligjdhënësit që të drejtën ekzistuese ta harmonizojë sa më shumë me Sheriatin.

Deri më 1990 e Drejta familjare islame në Malajzi është kodifikuar në tërësi. Në kodifikim janë inkuorporuar rezultatet e reformizmit juridik mysliman. Është kodifikuar procedimi i gjyqeve të Sheriatit

dhe janë miratuar ligje për bankat islamike dhe për sigurimin islam (takaful). Në lëmin e vlefshmërisë të së Drejtës së Sheriatit të përcaktuar me Kushtetutën Federative, mbetet edhe kodifikimi i së drejtës trashëgimore dhe asaj të vakëfnimit.

Një dekadë pas aktivitetit ligjdhënës, në gjyqësinë e Sheriatit, e cila ka karakter të një dege të gjyqeve shtetërore, janë futur ligje të shumta. Është vënë shumëshkallësia e gjyqeve të sheriatit (shkalla e parë, gjykata e lartë dhe gjyqet e apelit). Për hir të unifikimit të praktikës gjyqësore, është planifikuar formimi i gjyqit të Sheriatit federativ të apelit. Kohë me parë, me ndërrimet e Kushtetutes Federative është zgjidhur çështja e mosmarrëveshjes së kompetencave në mes gjyqeve të Sheriatit dhe atyre qytetare në favor të gjyqeve të Sheriatit. Krahës të gjitha këtyre rezultateve pozitive, ekspertët e shquar të Sheriatit, siç është profesor Ahmed Ibrahim në Universitetin Islamik Ndërkombëtar, vënë në pah se masat e reformimeve dhe të kodifikimit kanë qenë me shtrirje të kufizuar. Fjala që për përmirësimet në kuadër të vëllimit ekzistues të aplikimit të së drejtës së Sheriatit. Në të ardhmen mbetet rishqyrtimi i tërësishëm i sistemit të drejtësisë në Malajzi, si dhe kodifikimi dhe harmonizimi me Sheriatin. Për realizimin e kësaj detyre dhe administritimit të së drejtës së Sheriatit në rrethanat malajziane, nevojiten ekspertë të cilët sublimojnë njohjen e lartë të Sheriatit dhe të së drejtës anglo-saksone.

Për përgatitjen e ekspertëve të tillë është themeluar Fakulteti Juridik (Kulliyyah of Lavvs) në kuadër të Universitetit Islamik Ndërkombëtar (IIU), dhe të diplomuarit e parë të tij tashmë janë inkuadruar në gjyqet e Sheriatit dhe në institucionet e shkencave malajziane të së drejtës së Sheriatit.

- Dimensioni politik bashkëkohor i Islamit -

Që nga hartimi i projektkushtetutës së vitit 1957, ndëre faktorët politikë malajzianë është shtruar çështja e karakterit të shtetit të ardhshëm të pavarur. Organizata e Bashkuar Nacionale Malajziane (UMNO), parti e cila që nga viti 1946 pati rol vendimtar në jetën publike të vendit, ka bërë të ditur qartë se nuk kërkon shtet islam. Në dokumentet në të cilat është argumentuar projektkushtetuta, është the-

ksuar se shpallja e Islamit si religjion i federatës "në asnjë mënyrë nuk ndikon në pozitën e tanishme të federatës si shtet shekullar". Në të njëjtën kohë, së pari në kuadër të krahut fetar (OBN), e pastaj edhe si parti të veçanta - Partisë Islame Panmalajziane, është marrë një qëndrim tjetër kundruall pasojave shoqëro-juridike të statusit të Islamit në shoqërinë malajziane. U parashtrua kërkesa për shtet të mbështetur në burimet kryesore të mësimit islam dhe në Sheriatin, si themel i sistemit të së drejtës.

Në tërë periudhën e pavarësisë, partia OBMN udhëhoqi vendin në koalicion me të tjerët, kryesisht me partitë kineze dhe indiane. Kjo do të thotë se koncepti i kësaj partie në aspekt të rolit shoqëror të Islamit pati rëndësi të plotë praktike. OBMN-ja është emërtuar kryesisht si parti e moderuar myslimane, e orientuar si moderne dhe me ndikim në mesin e shtresave malajziane të arsimuara në Perëndim. Qëllimi i kësaj partie ka qenë dhe ka mbetur "ruajtja e pozicionit malajas" në shtet. Kështu, ideologjia e saj shpeshherë është theksuar si "malajzizëm" apo "bumiputrizëm". Ajo angazhohet për ruajtjen e integritetit të Islamit si fe e malajziasve. Qëllimi i OBMN-së në politikë është shoqëria shumëracore harmonike dhe shumëkonfesionale në Malajzi, në të cilën malajasit si popull mysliman autokton, gëzojnë pozitë të veçantë, ndërsa feja e tyre ka statusin e religjionit shtetëror. Shteti duhet të ketë formë moderne dhe demokratike. Islami paraqet potencialin më të madh shpirtëror të malajziasve dhe shtytësin kryesor të zhvillimit të përgjithshëm të tyre. E drejta myslimane në mjedisin shumëkonfesional duhet të vlejë vetëm për myslimanët dhe vetëm në krahinat që më së shumti janë të lidhura për fenë.

Burim kryesor i opozitës malajziane (opozitë edhe e partisë së OBMN-së) është PAS-i (Partia Islamike Panmalajziane- vër. përk.), e regjistruar si parti e pavarur më 1955. Udhëheqjen e kësaj partie e përbëjnë kryesisht ulemaja e arsimuar tradicionalisht, ndërsa partia gëzon përkrahjen e malajasve, sidomos të atyre të vendbanimeve rurale dhe shtresave të lidhura për traditën. Ideologët e PAS-it konsiderojnë se shpallja e Islamit si religjion i Federatës nuk do të thotë vetëm zbatimi dhe shënimi i dispozitave islame, solemniteteve dhe statusit të së drejtës islame, por mësimet islame duhet të aplikohen në të gjitha aspektet e jetës.

PAS-i, me fjalë të tjera, si qëllim të vetin ka proklamuar vendosjen e shtetit islam në Malajzi. Forma e këtij shteti manifestohet në terminologjinë e shkencës tradicionale myslimane fetaro-juridike. Kjo parti ka qenë në pushtet në shtetin Kelantan në periudhën 1959-1978, dhe një kohë më të shkrutër në shtetin Terenggan.

Historia politike bashkëkohore malajziane konfirmon funksionalitetin e projektit shoqëror të elitës së modernizuar myslimane malajziane. Më 1970 u aprovua ideologjia shtetërore (Rukun-negara), së cilës në veprimtarinë e vet duhet t'i përmbahen organet shtetërore dhe qytetarët. Rukun-negara mbështetet në këto parime: besimi në Zotin, besnikëria ndaj shtetit dhe mbretit, supremacioni i kushtetutës, sovraniteti i ligjit, mirësjellja dhe moraliteti. Këto parime janë të mbrojtura me ligj, kështu që çdo rënie ndesh publikisht me to shkakton sanksione. Dëfinimi i kësaj ideologjie shtetërore, vetëm pas kalimit të një viti nga incidenti i përgjakur etnik ndërmjet malajasve dhe kinezve, kishte për qëllim që në mënyrë të saktë të përcaktonte vlerat e përbashkëta në shoqërinë multikonfesionale dhe multiracore, të shpartallonte ekstremizmat e ndryshëm dhe të përcaktonte kahet dhe qëllimet e zhvillimit shoqëror në të ardhmen.

Gjatë viteve 70 ndodh zgjimi i vetëdijes fetare, i vetëbesimit dhe i ndjenjës së identitetit të veçantë të myslimanëve malajzias. Procesi i tillë ishte pjesë e valës së madhe të rilindjes islame në botë, ndërsa në Malajzi së pari u theksua nga rinia urbane. U shtuan kërkesat për njohuri e dituri më të mëdha për Islamin dhe për respektimin e parimeve islame në jetën e përditshme. Ky proces u institucionalizua përmes Lëvizjes Islame të Rinisë së Malajzisë (ABIM), përkatësisht Angkatan Belia Islam Malaysia, sikurse quhet kjo lëvizje në gjuhën malajase. Këtë lëvizje, më 1970, e themeloi një grup studentësh me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve misionare (da'vva) dhe forcimit të vetëdijes islame tek myslimanët. Duke mos përfillur ndarjen në mes religjionit dhe politikës, ABIM inkadrohet në jetën publike të vendit, duke e trajtuar si shumë legjitim dhe të domosdoshëm angazhimin politik në frymën e Islamit. Shtytje të posaçme kësaj lëvizjeje i jep ardhja në krye të saj e Enver Ibrahimit (Anvvar Ibrahim) në vitin 1974. Nën udhëheqjen e tij kjo lëvizje merr kurs më të moderuar ndaj organizatave jomalajase si dhe qëndrim kritik ndaj partisë në pushtet.

Në të gjitha këto ndodhi qeveria përgjigjeje me përmbushjen graduale të kërkesave të grupeve islamike dhe me formulimin e politikës zyrtare të islamizimit. Udhëheqja kombëtare malajase Islamin e përkufizonte si futje graduale dhe të rregulluar të vlerave islame në administratën shtetërore, duke respektuar të drejtat kushtetuese të jo-myslimanëve. Përkrahja shtetërore dhe orientimi i procesit të islamizimit bënë që rajoni të kursehej nga veprimi dhe ndikimi i grupeve ekstreme myslimane.

Partia OBNM, e cila u bë bartëse e politikës zyrtare të islamizimit, arriti sukses të madh kur në radhët e saj u inkadrua udhëheqësi i ABIMI-it. Aktivstët e lëvizjes rinore më vonë angazhohen politikisht në kuadër të të dy partive rivale malajase, ndërsa vetë lëvizja përqendrohet në problemet e arsimit dhe të edukimit.

Politika zyrtare e islamizimit e zbatuar gjatë viteve 80, solli themelimin e institucioneve shtetërore për misionin islam, instalimin dhe intensifikimin e arsimimit islam në të gjitha nivelet arsimore, futjen e emisioneve islame në programet e radios dhe televizionit, organizimin e garave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në leximin e Kur'anit, ndalimin e importimit të mishit që nuk është therur sipas parimeve të Sheriatit, dhe sigurimin e përzgjedhjes së gjerë të ushqimit hallall. Në të njëjtën kohë forcohen pozitat dhe zgjerohen kompetencat e gjyqeve të Sheriatit si dhe themelohen institucione të reja islame - Universiteti Ndërkombëtar Islam, Banka Islamike, Shoqëria Islame për Sigurim, etj. Gjatë dekadës së tetë, tërësisht ndryshoi pamja e qyteteve të Malajzisë. Një numër i madh vajzash dhe grash e përqafuan veshjen islame dhe njëkohësisht me krenari zunë pozitë të dalluar në ekonominë, arsimin dhe kulturën kombëtare, si dhe në jetën publike. Në të gjitha institucionet publike sigurohen vende për kryerjen e namazit. U islamizuan madje edhe përmbajtjet perëndimore të marra gjatë dekadave të mëhershme. Në restorantet e "ushqimit të shpejtë", siç janë: "Mc Donald's", "Kentucky Fried Chicken", etj. u vendosën shënjat "hallall", etj.

Me gjithë këto ndryshime, në jetën publike të myslimanëve nganjëherë shtrohet pyetja e mundësive për të sëndërtuar islamizmin në kuadër të sistemit ekzistues. Pavarësisht nga motivet dhe baza ideolo-

gjike që fshihet në këtë pyetje, duket se politikës zyrtare të islamizimit në Malajzinë e sotme vështirë të mund t'i gjendet alternativë.

*Marrë nga: "Islam u Jugoshticnoj Aziji",
Sarajevo, 1991, s. 45 - 70.*

*Përktheu nga boshnjakishtja:
Sadik MEHMETI*

Literatura:

- R. S. Milne-Diane K. Mayzu, Malaysia-Tradition, Modernity and Islam, Vestviev Press, London 1986.
- Malaysia 1990-91 Yearbook, Berita Publishing Sdn. Bhd. Petaling Jaya, 1990.
- Tamadun Islam di Malaysia, Persatuan Sejarah Malaysia, Kuala Lumpur, 1980.
- Ahmad Ibrahim, Islamic Law in Malaya, Malaysian Sociological research Institute Ltd, Kuala Lumpur, 1975.
- Chandra Muzaffar, Islamic Resurgence in Malaysia, Penerbit Fajar Bakti Sdn. Bhd, Petaling Jaya, 1987.
- Simon Barraclough, A Dictionary of Malaysian Politics, Heinemann Asia, Singapore, 1988.

Dr. Fikret Karçiq

MALAYSIA STATE SYSTEM AND POPULATION

(Summary)

Malaysia is a federation of 13 states in the Malayan Peninsula (western Malaysia) and of the northern part of Borneo (eastern Malaysia). The two are divided by sea. The name Malaysia was introduced in 1963, when Singapore, northern Borneo and Sarawak joined the nine Sultanates and two former British colonies (the Malayan Federation). In 1965, Singapore withdrew from the federation after public disagreements with the federal government.

فكرت كارشيش

ماليزيا

(خلاصة البحث)

ماليزيا تمثل اتحادا لثلاثة عشر ولاية لشبه جزيرة مالايو (ماليزيا الغربية) و الجزء الشمالي لجزيرة بورنيو (ماليزيا الشرقية) و يفصل بين هذين الجزئين البحر المفتوح, و الاسم ماليزيا كاسم رسمي بدأ استخدامه منذ سنة ١٩٦٣ عندما تم الاتحاد بين ستة ولايات.

RECENSIONE

Seyyed Hossein Nasr

ZEMRA E ISLAMIT – VËREJTJE TËRË PERËNDIMIT!*

Libri më i ri i Sejjid Husein Nasrit me titull “The Heart of the Islam ...” (*Zemra e Islamit ...*), që kohë më parë u botua paralelisht në gjuhën angleze dhe boshnjake (ne kemi përkthimin boshnjak), përkthyer nga anglishtja nga tre intelektualë të njohur boshnjakë: E. Kariç, R. Hafizović dhe N. Kahteran, kurse shkruar pas akteve terroriste në disa qytete amerikane më 11 shtator 2001 dhe pastaj me rastin e terrorit medial perëndimor dhe të fushave të tjera ndaj Islamit dhe Botës Muslimane në tërësi.

S. H. Nasri, tashmë i njohur për lexuesit shqiptarë, ndonëse tejet pak i prezantuar, në nivelin e tij intelektual çfarë jemi mësuar ta lexojmë deri tash, po në dritë të sulmeve aktuale mbi Islamin dhe muslimanët në dy vitet e fundit, ofron një lexim të ri, tjetërfare, të kontekstualizuar të shkrimit të tij të shkëlqyeshëm “si vlera të përhershme për njerëzinë”. Në këtë libër, nëpërmjet temave *Një Zot, shumë peygamberë; Spektri i islamit; Ligjet hyjnore dhe njerëzore; Vizioni mbi bashkësinë dhe shoqërinë; Mëshira dhe dashuria; Paqja dhe bukuria; Hyjnia dhe drejtësia njerëzore; Përgjegjësitë njerëzore dhe drejtësia njerëzore; Natyra etike dhe frymore e jetës njerëzore të Lindjes dhe Perëndimit*, - shtron probleme me rëndësi, nga aspekti i burimeve islame, të historisë islame dhe të aktualitetit, duke thyer

paragjykimet ndjellakeqe dhe mitomaninë rrënuese evro-amerikane, në frymën e kryqëzatave dhe inkuizicionit, duke zënë shkas Perëndimi në aktet terroriste të eks-nxënësve të tyre. Mirëpo, Perëndimi gjatë tërë kësaj fushate të egër, harangere, kryqtare, neokolonialiste, harron një grup njerëzish të identifikuar në Bin Ladenin, të identifikohen me një fe, me një botë paqedashëse, të pasur me kulturë e civilizim, e vis a vis kësaj harrohen krimet dhe terrori, gjenocidi e etnocidi i serbëve, i maqedonasve, i grekëve ndaj shqiptarëve, pastaj i izraelitëve ndaj muslimanëve, i rusëve ortodoksë ndaj muslimanëve, i indianëve budistë e hinduistë ndaj muslimanëve, i kinezëve konfuçionistë ndaj muslimanëve, i filipinasve kristianë ndaj muslimanëve vendës etj. *Pasthënia* e frymëzuar e Reshid Hafizoviçit, e pasuron edhe më tej veprën dhe i jep edhe konotacion ballkanik, krahas atij botëror, dhe është për të shpresuar se do ta qartësojë pozicionin e Islamit në aktualitetin botëror kundrejt vlerave dhe jovlerave në botën aktuale.

Do të ishte e mirëseardhur që ndonjë shtëpi botuese t’i përvishej përkthimit të kësaj vepre në gjuhën shqipe, qoftë edhe nga boshnjakishtja. Nënqielli ynë do ta kishte një paraqitje përfaqësuese të Islamit në rrafshet më të ndryshme, nga një penë shumë e njohur.

* *Seyyed Hossein Nasr, Zemra e Islamit – vlera të përhershme për njerëzinë, (The Heart of Islam - Enduring Values for Humanity, HarperSanFrancisco, 2002), El-Kalem, Sarajevë, 1423 h./ 2002, fq. 429.*

(Libri mund të sigurohet në librarinë “Sinan Katibi” të Bashkësisë Islame të Prizrenit). (NI)

Seyyed Hossein Nasr

THE HEART OF THE ISLAM – A WARNING TO THE WEST!

(Summary)

“The Heart of the Islam...” is the latest work of Seyyed Hossein Nasr. It was recently published in both English and Bosnian. It was translated into Bosnian by three distinguished intellectuals: E. Kariq, R. Hafizović and N. Kahteran. It was written after the terrorist attacks on America on September 11, 2001 and in response to the media campaign in the west against Islam and the Moslem World as a whole.

سيد حسن نصر

قلب الاسلام

هو احدث كتاب لسيد حسن نصر تحت العنوان "قلب الاسلام" و الذي تم طبعه في نفس الوقت باللغتين الانجليزية و البوسنوية (ولدينا النسخة المترجمة إلى اللغة البوسنوية) و قد ترجمت من الانجليزية مباشرة. كتب هذا الكتاب بعد الاحداث الارهابية التي حدثت في ١١ سبتمبر ٢٠٠١ و كذلك ما ترتب عليه من حملة ارهابية اعلامية غربية ضد الاسلام و العالم الاسلامي بصورة عامة.

PËRMBAJTJA

<i>Qemajl Morina</i> Identiteti fetar i shqiptarëve..... <i>The religious identity of the albanians</i> الهوية الدينية لدى الالبانيين	5
<i>Xhabir Hamiti</i> Zanafilla e studimit të njohurive kuranore..... <i>The origin of the Koranic studies</i> بداية دراسات المعارف القرآنية	13
<i>Sabri Bajgora</i> Tefsiri i Kur'anit në kohën e Resulullahut s.a.v.s. <i>Comentary of the Koran during Prophet life</i> تفسير القرآن الكريم في عهد رسول الله صلى الله عليه و سلم	25
<i>Dr. Hasan Kaleshi</i> Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi <i>Arab manuscripts in Yugoslavia</i> المخططات العربية في يوغسلافيا	55
<i>Resul Rexhepi - Sadik Mehmeti</i> "Risaleja" e Haxhi Rrustem ef. Shportës - një vepër e rëndësishme për shkencat kuranore <i>"Risaleja" – an important contribution to the Koranic sciences</i> منشور "الرسالة" للحاج رستم شبورتا كتاب مهم لدراسة علوم القرآن	73
<i>Gazmend Shpuza</i> Koleksioni i dorëshkrimeve orientale i bushatasve <i>The collection of oriental manuscripts belonging to the Bushati family</i> مجموعة المخطوطات الشرقية لدى عائلة بوشاتلي	95
<i>Prof. As. Dr. Ferit Duka</i> Rrënjët historike të tolerancës fetare në shqipëri <i>The historical roots of religious tolerance in Albania</i> الجزور التاريخية لظاهرة التسامح الديني في البانيا	113
<i>Mr. Qemajl Morina</i> Baza doktrimore e tolerancës islame <i>The doctrinal basis of islamic tolerance</i> مبدأ التسامح في الاسلام	123

Prof. Ascc. Edlira Haxhiymeri

Feja dhe problemet sociale në shoqërinë shqiptare në tranzicion135

Religion and the social problems in the albanian society in transition

الدين و المشاكل الاجتماعية في المجتمع الالباني في الفترة الانتقالية

Ahmed Sakr

“Exhinët”141

Genies

الجن

Tahir Ben Jellun

Si ua shpjegova Islamin fëmijëve – 2161

The way i explained islam to children

كيف شرحت الاسلام للأطفال (٢)

Dr. Tonin Gjuraj

Demokracia Islame dhe polemikat rreth saj181

Islamic democracy and the views about it

ديموقراطية الاسلام و الخلافات حولها

Akademik Jashar Rexhepagiq

Përparësitë, fushat e veprimit dhe kufijtë e ndikimit

të proceseve integrative në rajonin e Sanxhakut

dhe në territorin e Kosovës197

The advantages and the limitations of the integration processes

in the Sandjak region and the territory of Kosova

اولويات التقارب في سانجاق و كوسوفا

Murad Hoffman

Aleanca për udhëzime morale209

The alliance for moral guidance

التحالف للقيم الاخلاقية

Artan Shaqiri

Rritja e përgjegjësisë individuale dhe shoqërore

nëpërmjet edukatës fetare217

The cultivation of individual and collective responsibility through

religious education

المسؤولية الفردية و الجماعية عن طريق التربية الدينية

Dr. sc. Ejup Sahiti, prof. Odinar

**Rëndësia shkencore e gjurmëve të gishtave si shenjë
identifikimi kriminalistik.....223**

The role of science in the fight against crime

الاهمية العلمية لأثار الاصابع كدليل لاثبات الجرائم

Dr. Ramiz Zekaj

Ndikimi i arkitekturës islame në ndërtimet gjirokastrite.....235

The influence of Islamic Architecture in the town of Gjirokastra

تأثير المعمار الاسلامي في طراز البناء بمدينة جيروكاسترا

Klonimi i njerëzve dhe mendimi i dr. Kardavit rreth tij.....249

The views of dr. Kardavi regarding human cloning

عملية الاستنساخ و رأى الشيخ القرضاوى

Dr. Fikret Karçiç

Malajzia.....257

Malaysia - State system and population

ماليزيا

Seyyed Hossein Nasr

Zemra e Islamit – vërejtje tërë perëndimit!.....275

The heart of the islam – a warning to the west!

قلب الاسلام